FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2017 – Numri: 205

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 24 nëntor 2017

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 186, datë 10.11.2017 Mbi miratimin e Kodit të Transmetimit..... 10653

VENDIM
Nr. 186, datë 10.11.2017

MBI MIRATIMIN E KODIT TË TRANSMETIMIT

Në mbështetje të neneve 16; 56, germa "g" dhe 63, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe të nenit 26, të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për miratimin e Kodit të Transmetimit,

konstatoi se:

- Në përputhje me përcaktimet e neneve 56, germa "g" dhe 63, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", Operatori i Sistemit të Transmetimit harton dhe publikon Kodin e Transmetimit. Operimi i sistemit të transmetimit kryhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Transmetimit, i cili hartohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, në përputhje me kërkesat e Kodit të Rrjetit të ENTSO-E dhe miratohet nga ERE.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 2, datë 27.1.2016, filloi procedurat për miratimin e Kodit të Transmetimit.
- ERE, me shkresën nr. 26/6 prot., datë 3.2.2016, publikoi për tri ditë me radhë në median e shkruar, njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të bordit, duke filluar nga data 4 shkurt 2016.
- Me shkresën nr. 2661/2 prot., datë 7.6.2016, ka dërguar në ERE versionin 1.2 të riorganizuar të Draftkodit të Transmetimit në zbatim të zhvillimeve më të fundit të ENTSO-E lidhur me Kodin e Gjenerimit.
- Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 236/1 prot., datë 21.7.2016, shprehet se Projektkodi i Transmetimit nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë Kodin e Transmetimit (bashkëlidhur).
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KODI I TRANSMETIMIT

Ky dokument i emërtuar "Kodi i Transmetimit" është hartuar nga shoqëria OST sh.a në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr.43/2015, datë 30/04/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe në pajtueshmëri me dispozitat e Kodeve të Rrjetit dhe Manualit Operacional të ENTSO-E.
Versioni në gjuhën shqipe është versioni bazë.

Draft–Miratohet nga Bordi i ERE.

Hyrje

Në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar, Strategjinë Kombëtare të Energjisë, kuadrin rregullator dhe angazhimin e Shqipërisë për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, zhvillim ekonomik, investime dhe stabilitet social si pjesë e Komunitetit të Energjisë, si produkt i bashkëpunimit të gjithë aktorëve në sektorin e energjisë elektrike është hartuar Kodi i Transmetimit të energjisë elektrike.

Në funksion të sa më sipër, ky dokument synon pikë së pari të kontribuojë në menaxhimin e rrjetit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike në baza jo-diskriminuese për të gjithë përdoruesit aktual apo në të ardhmen dhe të shërbejë në arritjen e objektivave të Strategjisë së Energjisë përfshirë implementimin dhe liberalizimin e sektorit të energjisë elektrike.

Nëpërmjet këtij dokumenti synohet që gjithashtu të arrihet një planifikim dhe operim koherent dhe i koordinuar ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe gjithë përdoruesve të rrjetit të transmetimit me qëllim vendosjen e kushteve më të mira të mundshme për zhvillimin dhe funksionimin e një tregu energjie të integruar dhe efektiv.

Kodi i Transmetimit trajton çështjet që lidhen me Operatorin e Sistemit të Transmetimit, planifikimin dhe operimin e sistemit elektroenergjetik në tërësi dhe aksesin e aktorëve të tregut të energjisë në rrjetin e transmetimit të shoqërisë OST sha.

Kodi i Transmetimit parashtron normat, rregullat, procedurat dhe kërkesat e përgjithshme dhe themelore që drejtojnë operimin dhe zhvillimin e sistemit elektroenergjetik të vendit.

Termat dhe përkufizimet e Kodit të Transmetimit

Në këtë Kod termat dhe përkufizimet kanë kuptimet e mëposhtme:
"Aksesi në rrjet", e drejta e Përdoruesve për t'u krijuar mundësi për lidhjen me Rrjetin e Transmetimit dhe në zbatim të Legjislacionit në fuqi për shërbime të Rrjetit të Transmetimit.
"Agregator", është një subjekt legal i cili është përgjegjës për operimin e një numri paisjesh të kërkesës, nëpërmjet bashkimit (agregimit) të Kërkesës.
"Avari", nënkupton ngjarjen që ndodh në pajisjet primare në një Sistem Transmetimi (ST) të tilla si të gjitha llojet e lidhjeve të shkurtra: një, dy, tre fazore me dhe pa kontakt me tokën, që do të thotë më tej një përcjellës i këputur, qark i hapur, ose një lidhje e paqëndrueshme që rezulton në daljen nga puna të elementit të ST;
"Aftësi për Ristartim (Black-start)", aftësi e një njësie gjeneruese që të rifillojë punën pas një rënie pa ndihmën e Sistemit Elektroenergjetik, nëpërmjet instalimeve të saj " Black-start".
"Aplikimi për Lidhje me Rrjetin e Transmetimit", një tërësi dokumentacioni që plotësohet nga Përdoruesit e rinj për të kërkuar akses për tu lidhur me rrjetin e Sistemit të Transmetimit të energjisë Elektrike, ose nga Përdoruesit egzistues për të modifikuar lidhjet e tyre egzistuese. Ky dokumentacion hartohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Transmetimit për të marrë miratim lidhje nga OST .
"De-energjizimi", akti fizik i ndarjes-çkyçjes së sistemeve/objekteve të Përdoruesve të rrjetit të Transmetimit, nga Rrjeti i Transmetimit.
"Diagrama e Pronësisë", është një diagram (skemë) që paraqet numrin dhe emertesën e përgatitur për çdo vendndodhje të lidhjeve dhe që tregon pronësinë e elementeve të rrjetit elektrik për çdo subjekt/Palë.
"Dispeçerimi", është veprimtaria e kryer nga Operatori i Sistemit të Transmetimit që konsiston në menaxhimin në kohë reale të flukseve të energjisë elektrike dhe zbatimin e masave të nevojshme për operimin e bashkërenduar të komponentëve të sistemit elektroenergjetik përfshirë centralet prodhuese, rrjetin e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse të nevojshme për operimin e sistemit elektroenergjitik. Është Operimi i Sistemit Elektroenergjitik në mënyrë që të ruajë balancat ndërmjet prodhimit, import/eksportit dhe konsumit të energjisë elektrike në nivel kombëtar, duke ruajtur sigurinë dhe qëndrueshmërinë operacionale të rrjetit të Sistemit të Transmetimit.
"ENTSO-E (European Network of Transmission System Operators for Electricity)", është Rrjeti Sinkron Europian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.
"Enti Rregullator i Energjisë" ose "**ERE**", është autoriteti rregullator kombëtar i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.
"Faktori i Fuqisë", është raporti i fuqisë elektrike aktive MW me fuqinë elektrike të plotë në MVA (cosφ).

"Frekuenca", është numri i cikleve të rrymës alternative për sekond të rrjetit të Sistemit Elektroenergjetik.
"Forcë madhore", është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm njerëzor dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.
"Fuqia e Instaluar", është fuqia aktive nominale e një njësie gjeneruese të energjisë elektrike bazuar mbi dokumentacionin e prodhuesit (certifikatën e prodhuesit), që gjithashtu është shkruar në etiketën përkatëse për çdo njësi gjeneruese (kW ose MW).
"Fuqia Maksimale e Gjeneruesit", është maksimumi i mundshëm i fuqisë aktive MW që është në gjendje të japë një gjenerues në kushte të caktuara mekanike dhe elektrike të tij.
"FCR" – rezerva e mbajtjes së frekuencës (rezerva e rregullimit primar)
"FRR" – rezerva e restaurimit të frekuencës (rezerva e rregullimit sekondar)
"RR"-Rezerva zëvendësuese (rezerva e rregullimit tercial)
"FRCE" – kontrolli i gabimit të restaurimit të frekuencës, ose ACE, ose devijimi nga programi.
"Gjendja e Sistemit", nënkupton gjendjen operacionale të Sistemit të Transmetimit në lidhje me limitet e sigurisë operative, ku dallohen 5 gjendje: Normale, Alarm, Emergjence, Rënie e Plotë e Sistemit (Blackout), Rivendosja;
"Interkonektor", është një linjë transmetimi e ndërtuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose një palë e tretë, e cila kalon nëpërmjet kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe të një vendi tjetër dhe lidh sistemet kombëtare të transmetimit të të dyja vendeve.
"Incident (difekt)", është fenomen që ndodh për arsye të brendëshme apo të jashtme dhe që sjell prishjen e parametrave të Energjisë Elektrike, ose ndalimin për një kohë të caktuar të një apo disa elementeve të rrjetit elektrik, që nga ana tjetër sjell ndërprerjen e furnizimit me Energji Elektrike për klientët.
"Kurba e Ngarkesës", është kurba e vijueshmërisë të ngarkesës me bazë orare gjatë ditës (00 – 24 orë) apo për një horizont tjetër kohor, për një element të rrjetit elektrik.
"Kodi i Transmetimit"- është tërësia e normave dhe rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të rrjetit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-E.
"Kodi i Matjes", është tërësia e normave minimale të detyrueshme për matjen/telematjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike.
"Kontrolli i tensionit", nënkupton balancimin e nevojave të energjisë reaktive të rrjetit dhe Përdoruesve të Rrjetit në mënyrë që të mbahet profili i lejuar i tensionit;
"Kontrolli Automatik i Tensionit", nënkupton veprimet automatike të kontrollit në nyjen gjeneruese, në nyjet fundore të linjave AC ose në linjat e tensionit të lartë DC, në Transformatorë, ose mënyra të tjera të projektuara për të ruajtur nivelin e përcaktuar ose të referuar të tensionit dhe vlerën e përcaktuar të fuqisë reaktive;
"Konxhestioni", nënkupton një situatë në të cilën ndërlidhja e Sistemeve Kombëtare të Transmetimit nuk mund të akomodoje të gjitha flukset fizike që rezultojnë nga tregëtia ndërkombëtare e kërkuar nga pjesëmarrësit e tregut, për shkak të mungesës së kapacitetit transmetues ndërkufitar dhe/ose sistemeve kombëtare të transmetimit në fjalë, pa cënuar limitet e sigurisë operative.

"Kushte Operimi të Sigurta", janë gjendje operimi të rrjetit të transmetimit ku plotësohet kriteri (n – 1) i operimit si dhe kriteret e qëndrushmërisë statike dhe dinamike të Sistemit Elektroenergjitik

"LFC"-shkurtesë e përdorur për kontrollin Fuqi-Frekuencë

"Humbjet teknike të Energjisë Elektrike", humbjet teknike të një elementi të rrjetit elektrik të cilat janë të barabarta me diferencën e energjisë elektrike të matur që futet në këtë element me energjine elektrike të matur që del nga ky element i rrjetit.

"Mbrojtja Rele", janë instalime inteligjente (IED) të nevojshme për parandalimin e kushteve jo normale në Sistemin Elektroenergjetik, zbulimin e difekteve dhe avarive, aktivizimin e alarmeve dhe dhënien të sinjaleve përkatëse, deri në çkycjen e elementit të rrjetit të difektuar ose në avari.

"Modeli i Përbashkët i Rrjetit (CGM)", do të thotë sistemi i të dhënave që përfshin gjithë zonën sinkrone (rrjetin Europian) ose rrjetin e disa TSO-ve të koordinuara brenda ENTSO - E, dhe që përdoret si një bazë unike për analizë të sigurisë për vitin, muajin, diten në avancë si dhe brenda ditës;

"modul gjenerues sinkron", është një grup i pandashëm instalimesh të cilat mund të gjenerojnë energji elektrike të tillë që frekuenca e tensionit të gjeneruar, shpejtësia e gjeneratorit dhe frekuenca e tensionit të rrjetit janë në një raport të pandryshueshëm pra sinkron;

"Mjaftueshmëria e gjenerimit", është një vlerësim i aftësisë së gjenerimit për të mbuluar konsumin e sistemi Elektroenergjetik në tërësi.

"Rregullorja e Komisionit (KE) 2016/631", është Rregullorja e Komisionit (BE) 2016/631 e dt. 14 Prill 2016 në lidhje me kërkesat për lidhjen e gjeneruesve në rrjet.

"Ndërprerjet në Sistemin Elektroenergjetik", ndërprerjet e furnizimit me Energji Elektrike si rezultat i çkycjeve të elementeve të rrjetit në Sistemin Elektroenergjetik (elementët mund të jenë linja elektrike, paisje elektrike primare dhe instalime të tjera në një nënstacion, njësi gjeneruese, sistemit/objektit të përdoruesit të rrjetit të transmetimit si klient etj).

"Ndërprerjet e Planifikuara", ndërprerje të cilat janë planifikuar dhe është rënë dakort ndërmjet OST dhe Përdoruesve të Rrjetit të Transmetimit. Ndërprerje e planifikuar gjithashtu do të thotë ndërprerje e ndonjë pjese të Sistemit të Transmetimit për mirëmbajtje ose remonte-riparime që mund të ndikojë në furnizimin me Energji Elektrike për klientët .

"njoftimi operacional final (FON) " është një njoftim i lëshuar nga operatori i sistemit të transmetimit drejt pronarit të objektit gjenerues, operatorit të rrjetit të shpërndarjes, pronarit të sistemit HVDC i cili plotëson kërkesat përkatëse specifkike për të konfirmuar që e lejon operimin e modulit gjenerues, objektit të kërkesës, sistemit të shpërndarjes dhe pronarit të sistemit HVDC duke përdorur lidhjen me rrjetin ;

"njoftimi operacinal i energjizimit (EON)", është një njoftim i lëshuar nga operatori i sistemit të transmetimit drejt pronarit të objektit gjenerues, pronarit të objektit të kërkesës, operatorit të sistemit të shpërndarjes ose pronarit të sistemit HVDC para energjizimit të rrjetit të tij të brendshëm.

"njoftimi operacional i ndërmjetëm/përkohshëm " ose "ION" është një njoftim i lëshuar nga operatori i sistemit të transmetimit drejt pronarit të objektit gjenerues, pronarit objektit kërkesës, ose operatorit të sistemit të shpërndarjes ose pronarit të sistemit HVDC i cili lejon atë të operojë respektivisht modulin gjenerues, objektin e kërkesës, sistemin e shpërndarjes ose sistemin HVDC duke përdorur lidhjet me rrjetin për një kohë të kufizuar dhe të filloje testet e pajtueshmërisë për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe specifikimet përkatese.

"njoftimi operacional i kufizuar" ose "ION", është njoftimi i lëshuar nga operatori i sistemit për pronarin e një objekti gjenerues, objekt kërkese, operator sistemi shpërndarje ose pronar sistemi

HVDC i cili ka arritur me parë statusin FON por është përkohësisht subjekt ose i një modifikimi ose i humbjes së aftësive që rezultojnë në papajtueshmëri me specifikimet dhe kërkesat përkatëse.
"Ngarkesë", është një paisje elektrike ose Klient i cili merr fuqi elektrike nga Sistemi Elektroenergjetik. Ngarkesa nuk duhet konfuzuar me Kërkesën e cila është sasia e matur e fuqisë që kërkon ose merr ngarkesa në kW, MW ose KVA, MVA.
"Ngarkesa Pik (Max)", maksimumi i vlerës së ngarkesës elektrike në MW të matur dhe regjistruar brenda një horizonti kohor ditor (00.00-24.00 orë).
"Ngjarje e rastit (kontingjenca)" do të thotë dalja nga puna e një elementi të rrjetit si pasojë e një incidenti;
"Njoftim i Ndërprerjes", një njoftim i paraqitur nga një Përdorues i rrjetit të transmetimit duke u bazuar në dispozitat përkatëse të këtij Kodi që njofton OST për një ndërprerje të paplanifikuar ose një njoftim i lëshuar nga OST tek Përdoruesit që njofton për një ndërprerje të paplanifikuar të rrjetit të Sistemit të Transmetimit, të cilat ndikojnë në sasinë e furnizimit me Energji Elektrike të Klientëve.
"**Normat"**, përbëhen nga Standartet, kodet, rregullat, instruksionet, procedurat, vendimet dhe të tjera dokumenta normative të vendosur nëpërmjet ligjeve, akteve nënligjore, standarteve kombëtare dhe ndërkombetare, dokumenteve të tjerë zyrtare dhe kontratave.
"**Marrëveshjet për akses në rrjetin e Transmetimit",** është dokumenti i nënshkruar bashkërisht ndërmjet OST dhe aplikuesit për të pasur akses në rrjetin e transmetimit
"Menaxhimi i kërkesës", janë masat që ndërmerren me qëllim ruajtjen e stabilitetit operacional të rrjetit, si reduktimi i ngarkesës ose ndërprerja e përkohshme e furnizimit, për të cilat është rënë dakord paraprakisht midis palëve.
"Mekanizmi i Balancimit", është një mekanizëm i operuar nga Operatori i Tregut të OST nëpërmjet të cilit pranohen oferta dhe propozime me qëllim që të arrihet balancimi fizik i SE.
"**objekt kërkese" ose "objekt konsumator",** është një objekti i cili konsumon energji elektrike dhe është i lidhur në një ose më shumë pika lidhje me sistemin e transmetimit ose të shpërndajes.
"Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" ose "**OSSH**", është një person juridik përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë në harmoni me mjedisin dhe efiçencën e energjisë.
"Operator i Sistemit të Transmetimit" ose "**OST**", është personi juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkonjeksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.
"Operimi i tregut", është veprimtaria që kryen operatori i tregut i lidhur me menaxhimin e tregut kompetitiv të energjisë elektrike dhe përgatitjen e raporteve/faturave financiare për pjesëmarrësit e tregut, pa përfshirë blerjen apo shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me Modelin e Tregut dhe Rregullave të Tregut.
"Operatori i tregut", është struktura përgjegjëse e licencuar për operimin, organizimin dhe menaxhimin e tregut të energjisë elektrike.
"Pala përgjegjëse për balancimin", është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike ose përfaqësuesi i zgjedhur prej tij, përgjegjës përballë operatorit të sistemit të transmetimit për disbalancat e krijuara gjatë operimit të tij.
"Pezullimet e përkohshme", është leje e përkohshme për përdoruesit e rrjetit të transmetimit që ju atribohet nga OST sipas procedurës së përshkruar në këtë Kod.

"Përdoruesit e rrjetit", janë personat fizikë ose juridikë, të cilët i furnizon ose furnizohen me energji elektrike nëpërmjet rrjetit të sistemit të transmetimit ose të shpërndarjes.
"Përdoruesi i rëndësishëm i Rrjetit", nënkupton atë Përdorues që është në gjendje të ndikojë në modelin e rrjedhës së fluksit përtej pragjeve të përcaktuara nga OST-ja, si pasojë e ngjarjeve apo veprimeve të ndërmarra në lidhje me pajisjet nën përgjegjësinë e vet;
"Pika e Lidhjes", është pika e lidhjes fizike të një Përdoruesi të rrjetit me rrjetin e Transmetimit.
"Pikat e Matjes së Energjisë Elektrike", është pika e lidhjes të instalimeve matëse/telematëse të energjisë elektrike nëpërmjet të cilave bëhet e mundur matja e Energjisë Elektrike (të plotë, aktive, reaktive) që kalon në atë element të rrjetit elektrik.
"Planifikim afatgjatë", është planifikimi i nevojave për investime në kapacitetet prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse në baza afatgjata, me qëllim përmbushjen e kërkesës për energji elektrike dhe sigurinë e furnizimit të pandërprere të klientëve të energjisë elektrike.
"Plani për Rivendosje i Sistemit", përmban udhëzimet teknike dhe organizative që kanë parasysh shmangien e zgjerimit të mëtejshëm të difektit (avarisë) në Sistemin Elektroenergjetik, duke kufizuar në këtë mënyrë pasojat që mund të sjellin, si dhe rivendosjen e Sistemit Elektroenergjitik kombëtar në gjendjen normale të punës. Ky plan përmban dhe procedurat e rivendosjes në gjendje pune pas rënies së pjesëshme apo të plotë të sistemit elektroenergjitik në përputhje dhe të dispozitave të Manualit të Operimit (OH) dhe të Kodit të rrjetit europian të ENTSO-E për Emergjncat dhe Restaurimin (NC E&R).
"Plani i Mbrojtjes", nënkupton përmbledhje të të gjitha masave teknike dhe organizative të marra, për të parandaluar përhapjen apo përkeqësimin e një incidenti në Sistemin e Transmetimit, me qëllim shmangien, zgjerimin e avarisë dhe rënien e Sistemit;
"Programimi (planifikimi) i ndërprerjeve", është programi i ndërprerjeve që përgatitet nga OST në konsultim me Përdoruesit e rrjetit të transmetimit, duke u bazuar në këtë Kod.
"Procedurat e ankimimit", janë procedurat e përshkruara në mënyrë të detajuar në këtë Kod për zgjidhjen e ankesave ndërmjet OST dhe Palëve (Përdoruesve të Rrjetit).
"Qëndrueshmëria Statike (përkundrejt incidenteve të vogla) e Sistemit Elektroenergjitik", është Aftësia e Sistemit Elektroenergjetik për të ruajtur gjendjen normale të Operimit apo kur shmangia nga ky regjim është shumë e vogël dhe brenda rregullave dhe standarteve të Operimit të rrjetit ENTSO-E; ose Aftësia e Sistemit Elektroenergjetik për tu kthyer shpejt në gjendjen e punës në regjim normal, pasi ka pasur një apo disa shmangie që e kanë çuar atë jashtë parametrave standart të përcaktuar të Operimit.
"Qëndrueshmëria Statike e Elementit të Rrjetit", është fuqia maksimale aktive e llogaritur që transmetohet prej një elementi të caktuar të rrjetit të Sistemit Elektroenergjetik për të cilin sigurohet qëndrueshmëria statike operacionale.
"SCADA", është Sistemi i Kontrollit dhe Përftimit të të Dhënave në një Sistem Elektroenergjitik ose në një përdorues të rrjetit të Transmetimit.
"Skedulimi i Fuqisë", është fuqia aktive që programohet për t'u gjeneruar për mbulimin e kërkesës së parashikuar për energji elektrike.
"Skedulimi" nënkupton një grup reference të vlerave të energjisë apo të fuqisë brenda një periudhe kohore të ardhshme dhe për një rezolucion kohor të caktuar.
"**Skema Normale e Operimit"**, është skema normale e lidhjes së elementeve të rrjetit elektrik në secilën nyje elektrike që formon Sistemin Elektroenergjetik.
"Rajon i Sistemit Elektroenergjitik", është numri total i linjave, paisjeve elektrike dhe instalimeve të tjera ndihmëse në një zonë të caktuar gjeografike të Sistemit Elektroenergjitik.
"Rënie e Plotë e Sistemit Elektroenergjetik (Blackout)", është një ngjarje e rëndë që ndodh për arsye të brendshme apo të jashtme dhe që sjell çkyçjen për një kohë të caktuar të një apo disa

elementeve të rrjetit, që nga ana tjetër shkakton ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike në gjithë Sistemin Elektroenergjetik.

"Rregullat e tregut", janë rregulla të hollësishme të cilat përcaktojnë mënyrën e operimit dhe menaxhimit të tregut të energjisë elektrike, regjistrimin e pjesëmarrësve, përgjegjësinë e balancimit prej pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, rregullat për balancimin e sistemit të energjisë elektrike, rregullat për llogaritjen e disbalancës për palët përgjegjëse të balancimit, rregullat për përgjegjësitë financiare të palëve përgjegjëse të balancimit në rast të disbalancimit, si dhe çështje të tjera lidhur me funksionimin e këtij tregu.

"Rrjeti i Transmetimit", është rrjeti elektrik i transmetimit të energjisë elektrike që përbëhet nga bashkësi linjash elektrike të tensionit të lartë 110 kV, 150 kV, 220 kV, 400 kV, nënstacionet transformuese elektrike dhe çdo instalim tjetër, funksioni i të cilave përfshin transmetimin dhe interkonjeksionin me vendet fqinje. Çdo aset që përfshin komunikimin, mbrojtjen, kontrollin, shërbimet ndihmëse, truallin, ndërtesat dhe asete të tjera ndihmëse, elektrike ose jo, të cilat nevojiten për funksionimin e duhur të instalimeve të veçanta të rrjetit të Transmetimit, janë elemente përbërëse të rrjetit të Transmetimit.

"Rrjeti i Telekomunikacionit", është tërësia e linjave të komunikimit, nyjeve të komunikimit, pajisjeve të telekomunikacionit që sigurojnë komunikimin dhe transmetimin e sinjaleve të komunikimit, atyre telefonike, të dhënave, Teleaksionit etj.

"Siguruesi i shërbimeve të balancimit", është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike i cili siguron shërbimet e balancimit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, bazuar në kontratën për pjesëmarrjen në tregun e balancimit sipas rregullave përkatëse të sigurimit të balancimit të sistemit të energjisë elektrike.

"Sistemi i shpërndarjes", është sistemi i linjave, strukturave mbështetëse, pajisjeve transformuese dhe kyçëse/shkyçëse, të përdorura për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe lëvrimin e saj tek klientët, pa përfshirë furnizimin.

"Shërbime të Transmetimit", janë shërbime që sigurojnë Transmetimin e Energjisë Elektrike ndërmjet dy apo me shumë pikave të Rrjetit të Transmetimit sipas parametrave të cilësisë të shërbimit të rrjetit elektrik.

"Shërbimi i balancimit", është sigurimi i kapacitetit rezervë i kontraktuar dhe/ose energjia elektrike balancuese të përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin.

"Shërbime Teknike të Sistemit Elektroenergjetik", janë shërbime që realizohen nga OST dhe Përdoruesit me qëllim që të mbahet niveli i sigurisë operacionale gjatë operimit të Sistemit Elektroenergjetik dhe i cilësisë së Energjisë Elektrike të Gjeneruar, Transmetuar, Shpërndarë dhe Furnizuar. Parametrat e vendosur në këtë rast bazohen në norma, metodologji dhe rregulla përkatëse.

"Shërbime ndihmëse", janë shërbimet e nevojshme për operimin e qëndrueshëm të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes.

"Tregu i balancimit", është menaxhimi i bazuar në treg i funksioneve të balancimit të sistemit të energjisë elektrike, i operuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

"Tregu i energjisë elektrike", është një sistem ku kryhen shitje dhe blerje efektive përfshirë edhe derivativët e energjisë elektrike nëpërmjet kërkesave dhe ofertave, të paraqitura në periudha afatgjata dhe afatshkurtra.

"Tregtar", është çdo person juridik i cili kryen veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

"Tregtimi i energjisë elektrike", është procesi që kryhet nga një person juridik që blen energji elektrike me qëllim rishitjen e saj brenda ose jashtë sistemit të vendit ku kryen veprimtarinë.

"Kriteri N-1", është kriter i cili përdoret për verifikimin, planifikimin dhe projektimin e Sistemit Elektroenergjetik, që plotësohet në se arrihen të përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) Nuk ka ndërprerje të furnizimit me energji elektrike;

b) Sistemi mbetet një i tërë, në një regjim të qëndrueshëm me parametra normale.

"Urdhër Operativ", është urdhër që jepet nga operatorët e Sistemit Elektroenergjitik, i detyrueshëm për tu zbatuar nga marrësi që merr urdhërin. Këta urdhëra jepen nëpërmjet telefonit të dedikuar, fonogrameve, faksit dhe mesazheve kompjuterike prej instalimeve SCADA të Sistemit Elektroenergjitik.
"Veprim Operativ", është veprimi që ndërmerret nga njësia marrëse e Urdhërit Operativ për zbatimin e urdhërit operativ të lëshuar nga operatorët e Sistemit Elektroenergjitik, si dhe çdo veprim operativ i pa programuar i bërë nga përdoruesit e rrjetit të transmetimit, që ndikon në funksionimin e Sistemit Elektroenergjetik.
"Veprimi përmirësues" nënkupton masën apo veprimin që aktivizohet nga OST-ja manualisht ose automatikisht për të lehtësuar pasojat e shqetësimeve dhe për të mbajtur gjendjen normale apo për tu kthyer në Gjendje Normale të operimit, e cila mund të aplikohet para-apo pas shfaqjes së incidentit, dhe mund të përfshijë shpenzime;
"Urdhër për Sinkronizim", është një Urdhër nga Operatorët e Sistemit Elektroenergjitik, për Gjeneruesit, që të sinkronizojnë njësitë gjeneruese me rrjetin e Sistemit të Transmetimit.

KAPITULLI I

HYRJE DHE DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1. Objekti dhe Qëllimi

1. Kodi i Transmetimit trajton procesin e Planifikimit të Rrjetit të Transmetimit, të Lidhjes së përdoruesve në rrjetin e Transmetimit, të Planifikimit Operacional dhe Skedulimit të përdoruesve/pjesëmarrësve të Tregut të Energjisë Elektrike, të Operimit dhe Dispecerimit të Përdoruesve të rrjetit të Transmetimit, Operimit të Tregut të Energjisë Elektrike dhe balancimit të Sistemit Elektroenergjitik, si në kushte normale ashtu dhe në kushte jo-normale. Këto procese mbulojnë horizonte kohore të ndryshme nga planifikimi afat-gjatë (për 10 vite) deri në planifikimin operacional (deri 1 vit), operimin dhe dispecimin në kohë reale dhe periudhat pas ndodhjes së një ngjarje (avarie).
2. Objektivi i përgjithshëm i këtij Kodi është që të garantojë që kapitujt e këtij Kodi Rrjeti të funksionojnë së bashku dhe në koherencë të plotë me Kodin e Matjes, Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes, Modelin dhe Rregullat e Tregut, me dispozitat e Kodeve të Rrjetit Evropian dhe Manualin Operacional të ENTSO-E.
3. Kodi i Transmetimit ka për qëllim që:
   a) të lejojë që shoqëria OST sh.a të kryejë planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe operimin me efiçencë ekonomike të Sistemit Elektroenergjitik të vendit tonë në përputhje me kërkesat për energji elektrike në Tregun Shqiptar dhe atë Rajonal të Energjisë Elektrike.
   b) të lejojë që shoqëria OST sh.a të plotësojë marrëveshjet dy apo shumë palëshe në lidhje me interkoneksionet dhe transmetimin ndërshtetëror të energjisë elektrike me vendet kufitare apo më gjerë, nëpërmjet rrjetit evropian ENTSO-E.
   c) të eleminojë diskriminimin për përdoruesit e rrjetit të transmetimit/për pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike gjatë procesit relevant për zbatimin e dispozitave të këtij Kodi Rrjeti.

Neni 2. Përmbajtja e Kodit të Transmetimit

1. Kodi i Transmetimit është një akt nënligjor rregullativ për funksionimin normal të Sistemit Elektroenergjitik të vendit. Ai përcakton qartë kufinjtë e pronësisë së aseteve dhe kufijtë e menaxhimit operacional midis kompanisë OST sh.a dhe përdoruesve të rrjetit të transmetimit apo pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, përcakton normat (rregullat, standartet teknike etj.) për operimin dhe zhvillimin e rrjetit të Sistemit të Transmetimit, në përputhje me zhvillimin e Tregut Shqiptar dhe Rajonal të Energjisë Elektrike. Kodi përcakton procedurat e marrëdhënieve ndërmjet shoqërisë "OST" sh.a dhe përdoruesve të rrjetit të transmetimit/pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike.

Neni 3. Miratimi, zbatueshmëria, monitorimi dhe përditësimi i Kodit të Transmetimit

1. Kodi i Transmetimit miratohet nga ERE dhe zbatimi i tij është në monitorim të vazhdueshëm nga ERE. Rishikimi dhe përditësimi i tij do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Kodi i Transmetimit hartohet, përditësohet dhe administrohet nga shoqëria OST sh.a. e cila nga ana e saj do të reflektojë në mënyrë dhe kohë të përshtatshme ndryshimet e kuadrit ligjor që ndikojnë në Kodin e Transmetimit, duke informuar dhe duke ju ofruar përdoruesve të rrjetit të transmetimit mundësinë për të paraqitur pikëpamjet e tyre dhe duke marrë miratimin e ERE-s.
3. Kodi i Transmetimit është i detyrueshëm për OST-në dhe të gjithë përdoruesit e Rrjetit të Transmetimit/pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike.
4. Përdoruesi i rrjetit të Transmetimit që dështon në zbatimin e ndonjë dispozite të Kodit të Transmetimit, informon shoqërinë OST sh.a menjëherë për arsyet e dështimit. Rastet e dështimeve të përsëritura raportohen në ERE nga OST, me propozimin për penalizim sipas legjislacionit në fuqi, deri në de-energjizimin apo shkëputjen e lidhjes së Përdoruesit përkatës nga Rrjeti i Transmetimit.
5. Një Përdorues i Rrjetit të Transmetimit i cili në mënyrë të përsëritur nuk zbaton dispozitat e Kodit të Transmetimit, mban vetë përgjegjësinë dhe pasojat e de-energjizimit apo shkëputjes së lidhjes, që përfshin koston e dëmtimeve, kompensimin e pasojave tek klientët si dhe çdo lloj detyrimi tjetër që rrjedh nga dispozitat e këtij Kodi dhe/apo legjislacioni në fuqi.
6. OST, në rrethana të veçanta të paparashikuara në këtë Kod, mund të veprojë vendosmërisht në zbatim të detyrimeve dhe të drejtave ligjore për të bërë të mundur menaxhimin e drejtë të regjimeve apo situatave teknike-operacionale në Sistemin Elektroenergjetik të vendit, duke marrë në konsideratë dhe zbatuar dispozitat e Kodeve të Rrjetit të ENTSO-E.
7. OST është administrator ligjor i Kodit të Transmetimit.
8. OST duhet të:
   a) analizojë çdo avari të rëndë në rrjet dhe mbështetur në këtë analizë të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme Kodin e Transmetimit,
   b) lëshojë udhëzime për interpretimin dhe zbatimin e Kodit të Transmetimit.
9. OST në rolin e administratorit ligjor të Kodit:
   a) kërkon nga Përdoruesit e Rrjetit të Transmetimit, që planifikimi dhe operimi i aseteve të tyre të bëhet bazuar në zbatimin e dispozitave të Kodit të Transmetimit.
   b) monitoron, inspekton, teston apo mbledh informacionet e nevojshme nga Përdoruesit e Rrjetit të Transmetimit për të mbikëqyrur zbatimin e Kodit të Transmetimit nga këta Përdorues.
   c) përgatit një raport të detajuar vjetor në lidhje me administrimin dhe zbatimin e Kodit të Transmetimit, i cili dërgohet në ERE brenda muajit janar të vitit në vijim, për vitin paraardhës duke përfshirë:
      i. propozimet për rishikimin dhe përditësimin e Kodit të Transmetimit;

ii. prezantimet e shkruara ose kundërshtimet e ngritura nga Përdoruesit e rrjetit gjatë zbatimit të këtij Kodi dhe propozimet e tyre për rishikimin apo përditësimin.

10. OST në zbatimin e detyrimeve të veta sipas Kodit të Transmetimit bazohet në informacionin që japin Përdoruesit e Rrjetit të Transmetimit ose pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike, lidhur me kërkesat dhe qëllimet e tyre. OST nuk mban përgjegjësi për pasojat që rrjedhin nga arsyetimi dhe veprimet e bazuara në informacionet e dhëna nga Përdoruesit e rrjetit të transmetimit në lidhje me kërkesat dhe qëllimet e tyre.

Neni 4. Rrjeti i Sistemit të Transmetimit

1. Rrjeti i Transmetimit administrohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit(OST sh.a), i cili ka licencë për të kryer veprimtarinë ligjore të aktivitetit të transmetimit të energjisë elektrike nëpërmjet rrjetit elektrik të tensionit të lartë (110 kV, 150 kV, 220 kV, 400 kV).
2. Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a), ushtron veprimtarinë e tij si Operator i sistemit të transmetimit dhe operator tregu sipas dispozitave të ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" , Modelit të Tregut dhe Rregullave të Tregut në fuqi.
3. Asetet e administruara nga OST janë:
   a) Të gjithë linjat elektrike ajrore dhe nëntokësore me tension 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV përfshirë pajisjet dhe instalimet komutuese të tyre.
   b) N/Stacionet 400/220/110 kV; 400/220 kV; 400/110 kV; 220/110/TM kV; 220/TM kV dhe zbarat e nënstacioneve 110/TM të Operatorit të Shpërndarjes, deri tek pika e matjes së energjisë elektrike në anën 110 kV të transformatorëve të fuqisë 110/TM të nënstacioneve të Operatorit të Shpërndarjes.
   c) N/Stacionet 220 kV të hidrocentraleve V.Dejes, Koman dhe Fierze, përveç daljeve 220 kV të gjeneratorëve deri tek thikat e zbarave 220 KV, traktin 110 kV/150 kV përfshirë daljen 150 kV të linjës ajrore 150 kV dhe transformatorin ngritës të fuqisë 110/150 kV në N/Stacionin e Hidrocentralit Bistrica 1.

Neni 5. Aksesi reciprok dhe siguria teknike

1. Të gjithë Përdoruesit e Rrjetit të Transmetimit i garantojnë shoqërisë OST sh.a, (specialistëve ose grupeve të specialistëve) të drejtën për hyrjen fizike në objektet e tyre dhe dokumentacionin teknik përkatës për kryerjen e shërbimeve të ndryshme si dhe lehtësira të nevojshme në zbatim të përgjegjësive (të drejtave dhe detyrimeve) të OST së.
2. OST dhe përdoruesit e rrjetit të Sistemit të Transmetimit kanë përgjegjësi për lejimin reciprok në pronësitë përkatëse, sipas një liste personash të autorizuar të rënë dakord, për të hyrë dhe kryer punime në pronësitë reciproke të palëve.
3. OST dhe përdoruesit e rrjetit të Sistemit të Transmetimit përcaktojnë me marrëveshje të veçanta një listë të pajisjeve elektrike në pronësi të njërës Palë, të instaluar në pronësinë e Palës tjetër (p.sh. pajisjet e matjes, të telekomunikacionit, SCADA, kabllot e fuqisë etj.). Në këtë marrëveshje bashkëngjiten planimetritë e pronësisë sipas përshkrimit në Kodin e Lidhjes së këtij Kodi së bashku me rrugët e kalimit.
4. Përdoruesit e rrjetit të Sistemit të Transmetimit janë përgjegjës për sigurinë dhe zbatimin e rregullave të Sigurimit Teknik të punës për punimet në pronësitë e tyre.
5. Puna e kryer mbi pajisjet/grup pajisjesh konsiderohet e mbaruar, kur shërbimet e kryera mbi të dhe masat e sigurisë janë konform normave dhe rregullave të sigurimit dhe shfrytëzimit teknik në fuqi. Vetëm mbas kësaj këto pajisje/grup pajisjesh vihen në punë dhe operim.
6. Të gjithë Përdoruesit e Rrjetit të Transmetimit zbatojnë urdhërat dhe udhëzimet e lëshuara nga OST. Përdoruesit e rrjetit të Sistemit të Transmetimit kërkojnë miratimin nga OST-ja për kryerjen e veprimeve operacionale përkatëse.

Neni 6. Komunikimi ndërmjet OST sh.a dhe Përdoruesve të rrjetit të transmetimit

1. Të gjithë komunikimet ndërmjet shoqërisë OST sh.a dhe Përdoruesve të Rrjetit të Transmetimit/Pjesëmarrësve të tregut të energjisë do të bëhen me shkrim përveç rasteve kur kërkohet komunikim verbal dhe në këto raste këto komunikime verbale do të pasqyrohen me shkrim sa më shpejt. Aty ku Kodi i Transmetimit specifikon dhënien e informacioneve me shkrim ose konfirmim me shkrim, çdo lloj mjeti i transferimit elektronik që lejon marrësin ta ruajë këtë informacion, si posta elektronike, mesazhet kompjuterike të sistemit SCADA, telefaksi, e përmbushin këtë dispozitë të komunikimit me kusht që të garantohet siguria e informacionit dhe ruajtja e fshehtësisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 7. Konfidencialiteti

1. Në përputhje me Kodin e Transmetimit, OST sh.a do të kërkojë dhe do të marrë informacion nga Përdoruesit e Rrjetit të Transmetimit në lidhje me aktivitetet e tyre të biznesit (prodhim, shpërndarje, furnizim ose tregëtim) duke respektuar parimet e konfidencialitetit. OST nuk jep dhe nuk publikon informacionet tek të tretët, pa miratim me shkrim të zotëruesit të informacionit, përveç rasteve kur kjo kërkohet nga dispozitat e Kodit të Transmetimit.
2. Të dhënat dhe informacionet e shkëmbyera për një qëllim të caktuar duhet të përdoren vetëm për atë qëllim, përveç rasteve kur të dyja palët dakortësojnë ndryshe. OST sh.a lirohet prej detyrimeve sipas këtij neni kur të dhënat duhet të publikohen ose nëpërmjet raportimit të rregullt ose me kërkesë nga institucione shtetërore, ERE, institucione të tjera, të bazuar në kuadrin ligjor përkatës. Në këto rrethana OST sh.a duhet të njoftojë palën që i ka dorëzuar të dhënat relevante në çdo rast.
3. Në rastin kur të gjitha pjesët ose një pjesë e ndonjë funksioni të specifikuar në këtë Kod Rrjeti është deleguar nga OST apo një përdorues i rrjetit tek një palë e tretë, OST sha apo përdoruesi i rrjetit do të sigurojë që marrëveshjet e konfidencialitetit të nevojshëm, duke përfshirë detyrimin për sigurimin e aksesit në informacion të nevojshëm për monitorim nga ERE-s, janë paraqitur përpara delegimit.

Neni 8. Mosmarrëveshjet dhe Procedurat për Zgjidhjen e tyre

1. Në rast të ndonjë Mosmarrëveshje ndërmjet Përdoruesve të rrjetit të Transmetimit dhe shoqërisë OST sh.a, në lidhje me interpretimin e ndonjë dispozite të Kodit të Transmetimit, çështja do të zgjidhet duke u bazuar në dispozitat përkatëse për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në këtë Kod.
2. Në rast të konfliktit ndërmjet ndonjë dispozite të Kodit të Transmetimit dhe ndonjë kontrate ose marrëveshje ndërmjet shoqërisë OST sh.a dhe Përdoruesit të Rrjetit të Transmetimit apo pjesëmarrësit të Tregut të Energjisë, dispozitat e Kodit të Transmetimit janë mbizotëruese.
3. Pavarësisht nga arsyet e mosmarrëveshjes, palët në mosmarrëveshje nuk do të pengojnë përmbushjen e funksioneve përkatëse në përputhje me përcaktimet e Kodit të Transmetimit dhe kuadrit përkatës ligjor, si dhe nuk do të ndërmarrin veprime apo do të refuzojnë kryerjen e tyre duke cënuar sigurinë e funksionimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Menjëherë pas lindjes së një mosmarrëveshje, Palët duhet të komunikojnë për arritjen e një zgjidhje, në përputhje me dokumentin që rregullon marrëdhënien dypalëshe (Kontratë/Marrëveshje) dhe me Kodin e Transmetimit.
4. Marrëveshja ndërmjet Palëve që kanë interpretime të ndryshme duhet të zbatohet deri në daljen e vendimit të ERE në lidhje me mosmarrëveshjen.

5. Në rast se mosmarrëveshja ka lindur për probleme të patrajtuara nga Kodi i Transmetimit, çështja do të diskutohet nga Palët, të cilat duhet të arrijnë në Marrëveshje. Nëse Marrëveshja nuk mund të arrihet, Palët formulojnë një marrëveshje pune të përkohshme dhe më pas referojnë çështjen në ERE, nëse çështja nuk mbulohet nga Kodi i Transmetimit. Vendimi i ERE-s pezullon marrëveshjen e punës të përkohshme dhe është i detyrueshëm të zbatohet nga Palët përkatëse.
6. Afati për të arritur një marrëveshje apo për të zgjidhur mosmarrëveshjen e krijuar, përcaktohet nga palët me mirëkuptim.
7. Nëse vendimi i ERE-s nuk i kënaq Palët në mosmarrëveshje, çështja referohet në Gjykatën përkatëse.

Neni 9. Ngjarjet e Paparashikuara

1. Në rrethana apo ngjarje që nuk parashikohen në asnjë dispozitë të Kodit të Transmetimit, OST thërret një takim të menjëhershëm të gjitha Palët që preken nga zgjidhja dhe veprimet që do të ndërmerren në këto rrethana.
2. Nëse në këto raste nuk arrihet asnjë marrëveshje apo rekomandim, OST përcakton përkohësisht veprimet që ndërmerren, pasi të jepen qëndrimet për çështjet e diskutuara nga Palët. OST sa më shpejt që të jetë e mundur referon çështjen në ERE.
3. OST sh.a informon palët që preken nga situata ose ngjarja dhe/apo urdhëron kryerjen e veprimeve në funksion të ruajtjes së sigurisë operacionale të sistemit elektroenergjitik dhe të përmbushjes së funksioneve të saj, në përputhje me rrethanat e krijuara.
4. OST bën transparente dhe informon në kohën dhe mënyrën e përshtatshme Palët dhe në veçanti ERE-në në lidhje me ngjarjet e paparashikuara, veprimet dhe/apo udhëzimet përkatëse, si dhe për rezultatet e analizës të vlerësimit të ngjarjes.

Neni 10. Pavlefshmëria e Pjesëshme

1. Nëse ndonjë nen ose pjesë neni (paragraf ose pikë) i Kodit të Transmetimit bëhet dhe deklarohet e pavlefshme për ndonjë arsye nga një vendim i ERE-së, vlefshmëria e dispozitave të tjera të Kodit të Transmetimit apo pjesës së paprekur të nenit, ngelet në fuqi.

Neni 11. Periudhat e Forcës Madhore

1. Në periudhat e Forcës Madhore si thatësira e tejzgjatur, prurja me plota të mëdha, ndërprerje e furnizimit me lëndë djegëse, luftës, katastrofave natyrore si dhe situatave jonormale të përcaktuara, Këshilli i Ministrave mund të lëshojë direktiva të caktuara për kufizime, kontrolle dhe rregulla të tjera. Nëse këto bien në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi, ato dispozita (nene, paragrafe apo pika të veçanta) të Kodit të Transmetimit, do të trajtohen si përkohësisht të pezulluara për aq kohë sa zgjat Forca Madhore.

Neni 12. Pezullimet e Përkohshme

1. Në rastet kur një përdorues i Rrjetit të Transmetimit nuk mund t'i përmbushë plotësisht dhe/ose pjesërisht kërkesat e Kodit është i detyruar të kërkojë dhe aplikojë menjëherë për pezullim të përkohshëm pranë OST-së, duke informuar edhe ERE-n.
2. Kërkesa/aplikimi për pezullim të përkohshëm, do të përmbajë informacionet e mëposhtme:
   a) Arsyeja për pamundësinë e përmbushjes së kushtit/kërkesës/përcaktimit të Kodit në mënyrë të pjesëshme dhe/apo tërësore;
   b) Kohëzgjatja e pamundësisë së pjesëshme/plotë të përmbushjes së kushtit/kërkesës /përcaktimeve të Kodit të Transmetimit;

c) Vlerësimi i ndikimit të dështimit të përmbushjes së kushtit/kërkesës/përcaktimeve të Kodit të Transmetimit;
d) Data e përafërt e normalizimit të situatës dhe përmbushjes së plotë të kushtit/kërkesës/përcaktimit të Kodit që kërkohet për pezullim të përkohshëm.

3. OST do të marrë në konsideratë përmbushjen e detyrimeve të saj dhe sigurinë operacionale të rrjetit të sistemit të transmetimit si dhe të gjitha faktet e paraqitura nëpërmjet aplikimit.
4. OST do të vendosë brenda 60 ditëve për lejimin ose jo të një pezullimi të përkohshëm, duke specifikuar dhe afatin e vlefshmërisë/kohëzgjatjen e tij, por jo me shumë së 24 muaj, përveç se në rrethana të jashtëzakonshme dhe me miratimin e ERE-së.
5. Në të gjitha rastet pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë/kohëzgjatjes së pezullimit të përkohshëm, subjekti paraqet kërkesë të re, nëse kushtet e mospërmbushjes së pjesëshme/plotë vazhdojnë ende, ose i nënshtrohet një kontrolli/monitorimi nga ana e OST konform përcaktimeve të Kodit të Transmetimit, lidhur me normalizimin e situatës së mëparshme të mospërmbushjes së pjesshme/plotë të dispozitave përkatëse të Kodit të Transmetimit.
6. Në qoftë së një përdorues/palë nuk mundet t'i përmbushë pjesërisht/plotësisht kërkesat e Kodi të Rrjetit dhe dështon në miratimin e një pezullimi të përkohshëm nga OST sha, mundet që të paraqesë një ankimim në ERE.
7. Nëse ERE konfirmon/le në fuqi vendimin e OST-se për refuzimin e pezullimit të përkohshëm të një përdoruesi/pale, atëherë OST aplikon masat si vijon:
   a) Paralajmërim me shkrim i përdoruesit të Rrjetit të Transmetimit për detyrimin e përmbushjes së dispozitave të Kodit të Transmetimit dhe normalizimit të situatës së mospërmbushjes së pjesëshme/plotë brenda një periudhe të arsyeshme, por jo me shumë së 3 muaj në rast se situata nuk përbën rrezik për pronën dhe jetën e të tretëve apo për sigurinë operacionale të Sistemit të Transmetimit;
   b) Nëse afati i përcaktuar sipas pikës a) nuk respektohet, OST lëshon një paralajmërim final për ndërhyrje, në përputhje me Kodin e Transmetimit, për normalizimin e situatës brenda 30 ditëve.
   c) Nëse përdoruesi i Rrjetit të Transmetimit nuk merr masa brenda afateve të përcaktuara më lart atëherë, OST sh.a do të informojë ERE-n dhe do të marrë masat e saj, deri në de-energjizimin dhe shkëputjen e përdoruesit nga rrjeti i Sistemit të Transmetimit.
8. Të gjitha kostot që i shkaktohen të tretëve dhe/apo OST sh.a nga mospërmbushja e pjesëshme/plotë e dispozitave të Kodit të Transmetimit nga një përdorues i rrjetit, që ka dështuar në përftimin e një pezullimi të përkohshëm, përballohen nga vetë përdoruesi.

KAPITULLI II

KODI I PLANIFIKIMIT

Neni 13. Objekti

1. Kodi i Planifikimit specifikon dhe përcakton normat (standartet, kushtet, kriteret, afatet kohore) për planifikimin e zhvillimit të rrjetit të transmetimit nga OST. Përdoruesit e rrjetit të transmetimit bëjnë planifikimin e zhvillimit ose modifikimin e rrjeteve të tyre në koherencë me përgatitjen e planit të zhvillimit afatgjatë dhe afatmesëm të rrjetit të transmetimit të OST-së.
2. Planifikimi sipas dispozitave të Kodit, shkëmbimi i informacionit të nevojshëm për planifikimin, përgjegjësitë për planifikimin dhe zhvillimin e Rrjetit të Sistemit të Transmetimit dhe standardet e përcaktuara në këtë Kod janë të detyrueshme për përdoruesit e rrjetit dhe pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike.
3. Planifikimi i zhvillimi të rrjetit të Sistemit të Transmetimit (pikat e lidhjes në kufinjtë e pronësisë, linjat dhe/ose pajisjet, nënstacionet) dhe atij elektroenergjetik në tërësi merr në konsideratë por pa u kufizuar, faktorët dhe kushtet e mëposhtme:
   a) Rikonfigurimin, rikonstruksionin apo optimizimin e pjesëve të rrjetit ekzistues të Sistemit të Transmetimit; zhvillimin/modifikimin e sistemit/objektit të Përdoruesit të rrjetit; lidhjet e përdoruesve të rinj; zgjerimin, rritjen e kapacitetit dhe ruajtjen e standarteve të sigurisë në përputhje me rritjen e parashikuar të kërkesës për energji elektrike dhe apo futjen në punë të një elementi të ri në sistem
   b) Politikat dhe objektivat e Komunitetit të Energjisë, BE dhe organizatave të tjera me fokus energjinë elektrike, në të cilat Shqipëria aderon apo ka detyrime për respektimin e politikave dhe objektivave;
   c) Planifikimi i zhvillimit të rrjetit të transmetimit duhet të jetë në koordinim me Planin Dhjetë Vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit Evropian ENTSO-E (TYNDP), dokumente të tjera të ENTSO-E, si Planet Rajonale të Investimeve (RgIP), perspektivën e sistemit të transmetimit dhe Parashikimit të Disponueshmërisë (SOAF) .
   d) Efekti kumulativ i një sërë zhvillimesh si këto të përmendura më lart.

Neni 14. Zbatimi i Kodit të Planifikimit

1. Kodi i Planifikimit do të zbatohet qartësisht nga OST dhe Përdoruesit e Rrjetit të Sistemit të Transmetimit aktual dhe të perspektivës si vijon:
   a) Gjeneruesit me njësi gjeneruese të lidhur në rrjetin e Sistemit të Transmetimit, konform këtij Kodi Transmetimi ;
   b) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, OSSH;
   c) Klientët;
   d) Pronarët e linjave dhe interkonjeksioneve;
   e) Furnizuesit;

Neni 15. Kriteret e Planifikimit

1. OST dhe përdoruesit e Rrjetit të Sistemit të Transmetimit do të planifikojnë zhvillimin e rrjetave elektrike të sistemeve/objekteve të tyre në përputhje me kriterin (N-1) të Sigurisë Operacionale, në baza deterministe pa kufizime, justifikime/argumentime financiare, duke marrë në konsideratë modelin më pak të favorshëm të profilit të gjenerimit brenda kufizimeve përkatëse, ndërsa për situata më pak të mundshme (N-2) do të përdoret një model mesatar.

2. Llogaritjet do të kryhen për jetëgjatësi tipike të projektit prej 35 vjetësh, përveç kur diktohet ndryshe nga jetëgjatësia e impiantit apo jetëgjatësia e projektit.
3. Qëndrueshmëria kalimtare nuk duhet të cënohet në kushtet e veprimit me sukses të mbrojtjes pas një defekti/lidhje të shkurtër njëfazore si dhe në kushtet e qarkut të shkurtër tre-fazor apo defekti në zbarë, i çkycur brenda kohës normale të veprimit të mbrojtjes, pa dëmtime në sistemin elektroenergjitik.
4. Kriteret e kostos më të ulët ekonomike do të zbatohen në kushtet kur planifikohet lidhja e përdoruesve të rinj në sistem dhe kur planifikohen investime në drejtim të përmirësimit të besueshmërisë dhe/ose cilësisë së furnizimit për të siguruar arritjen e kufijve apo objektivave të përcaktuara, si dhe për të përcaktuar dhe/ose verifikuar nivelin e dëshiruar të rezervës së rrjetit dhe/ose pajisjeve të tij.
5. Planifikimi do të marrë në konsideratë vlerën e ngarkesës dhe gjenerimit në vendet fqinje, reduktimin e kostove të shërbimeve me cilësi, udhëzimet e rregullatorit, të dhënat historike mbi ndërprerjet, reduktimin e ngarkesës, kufizimet e rrjetit dhe cilësinë e furnizimit për treguesit e papërmbushur.
6. Planifikimi afatgjatë i kryer nga OST do të zbatojë dhe kriteret që lidhen me sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë në ofrimin e shërbimit, të cilat konsistojnë në:
   a) Të drejtën e servitutit/shpronësimit;
   b) Zëvendësimin e aseteve në funksion të planit të menaxhimit të ciklit të jetës së aseteve në përputhje me praktikat e mira të menaxhimit të aseteve;
   c) Projektet e zgjerimit dhe fuqizimit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit të cilat nuk mund të justifikohen me kriterin (N – 1).

Neni 16. Planifikimi i Zhvillimit Afatgjatë (10 vjeçar) i Sistemit të Transmetimit

1. OST harton një Plan afatgjatë 10 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit në konsultim me palët e interesuara dhe e paraqet për miratim në ERE. Ky plan afatgjatë 10 vjeçar i zhvillimit koordinohet dhe me Planin Afatgjatë 10 vjeçar të Rrjetit ENTSO-E (TYNDP), duke zbatuar kriteret dhe metodologjitë e tij për planifikimin afatgjatë të rrjetit të sistemit të transmetimit.
2. Plani afatgjatë 10 vjeçar i zhvillimit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit të OST sh.a. do të përditësohet çdo 2 vjet. Ky përditësim, përveç të tjerash, do të lejojë që përdoruesit e këtij rrjeti të bëjnë planifikimet për zgjerimin dhe zhvillimin e rrjetave (sistemeve/objekteve) të tyre.
3. Çdo Përdorues i rrjetit të Transmetimit duhet ti japë shoqërisë OST sh.a informacionin dhe të dhënat që kanë të bëjnë me sistemin/objektin e tij sipas Shtojcës A.
4. Të dhënat që do të merren nga shoqëria OST sh.a nga përdoruesit e Rrjetit të Transmetimit do të jenë në formatet e përcaktuara në Kodin e Planifikimit.

Neni 17. Planifikimi dhe Zhvillimi i Rrjetit të Sistemit të Transmetimit

1. Planifikimi i gjenerimit, i rrjetit të Sistemit të Shpërndarjes, Klientëve (ngarkesës konsumatore) dhe furnizuesve të energjisë, do të bëhen bazuar në Planin Afatgjatë 10 vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit të Sistemit të Transmetimit.
2. Plani afatgjatë i zhvillimit do të përfshijë parashikimet për kërkesën për energji elektrike, ngarkesën në MW, ngarkesën maksimale dhe minimale në Sistemin Elektroenergjitik, kapacitetet shtesë të gjenerimit, linjat dhe kapacitetet transmetuese, nënstacionet dhe kapacitetet transformuese të tyre, humbjet teknike të energjisë elektrike në rrjetin e Sistemit të Transmetimit dhe parametrat e tjerë të rëndësishëm të Rrjetit të Transmetimit. Plani Afatgjatë përmban dhe planifikimin e zhvillimit të interkonjeksioneve me rrjetin rajonal për nevoja të

eksporteve, importeve, rritjes së sigurisë operacionale, planin e kufizimeve të energjisë elektrike, rritjen e aksesit të Përdoruesve të rrjetit të transmetimit si dhe eficencën e tregut konkurent të energjisë elektrike.

3. OST do të vlerësojë nevojat për energji elektrike bazuar në të dhënat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe klientëve të tjerë të rrjetit të sistemit të transmetimit. Megjithatë OST kryen edhe analiza studimore të caktuara, të përcaktimit të nevojave për energji elektrike dhe ngarkesave bazuar në të dhënat historike që OST i disponon.
4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mbi bazën e analizës së detajuar të ngarkesës për të gjithë kategoritë e klientëve të vet, do të paraqesë në shoqërinë OST sh.a. kërkesat dhe nevojat e tij për zgjerim, zhvillim të rrjetit dhe ngarkesës. Në mënyrë të ngjashme do të veprojnë të gjithë Klientët e tjerë të rrjetit.
5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për dhënien e informacionit të detajuar teknik për çdo përdorues të lidhur në rrjetin e tij dhe që mund të ketë ndikim të veçantë në rrjet.
6. Të dhënat do ti vihen në dispozicion OST-së nga Klientët dhe gjeneruesit në një kohë të arsyeshme që lejon përdorimin e tyre për hartimin e planit afatgjatë. OST duhet të informohet në mënyrën e duhur për çdo ndryshim të konsiderueshëm të të dhënave, në parashikimet e dorëzuara.
7. OST do të vlerësojë humbjet teknike të energjisë elektrike në përqindje dhe në vlerë për rrjetin e Sistemit të Transmetimit në tërësi dhe elemente të veçantë të rrjetit, si më poshtë:
   a) Duke u bazuar në vlerësimin e humbjeve të fuqisë në pikun (max) e ngarkesës në rrjetin e Sistemit të Transmetimit. Ky vlerësim do të kryhet nga analizat dhe studimet e Shpërndarjes së Flukseve të fuqisë me ndihmën e programeve kompjuterike bashkëkohore;
   b) Duke kryer analiza dhe studime pilot në elemente të veçantë të rrjetit të transmetimit dhe me anën e matjes së energjisë elektrike në të dy anët e elementit përkatës të rrjetit konform standarteve dhe rregullave përkatëse të Kodit të Matjes.
8. OST merr në konsideratë edhe dinamikat e zhvillimit ekonomik të vendit (në bazë të parashikimit të rritjes së produktit kombëtar bruto PPB, investimeve, punësimit dhe konsumit), ndryshimin e konsumit të Energjisë Elektrikë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, në mënyrë që të krijojë lidhjen mes zhvillimit të ekonomisë dhe kërkesës për Energji Elektrike.

Neni 18. Planifikimi i Gjenerimit

1. Çdo prodhues i energjisë elektrike duhet të hartojë dhe të paraqesë një plan afatmesëm (çdo 2 vjet) dhe një plan afatgjatë (10 vjeçar) për zhvillimin e rrjetit të sistemit/objektit të tij duke integruar çështje të optimizimit të regjimit operativ të Sistemit Elektroenergjetik.

Neni 19. Planifikimi i Rrjetit të Sistemit të Transmetimit

1. OST harton Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Rrjetit të Sistemit të Transmetimit duke marrë në konsideratë edhe planifikim-zhvillimet në rrjetin e Sistemeve/objektet e Përdoruesve të rrjetit të transmetimit bazuar në:
   a) Studimet për Shpërndarjen e Flukseve të fuqisë;
   b) Studimet dhe analizat për Lidhjet e Shkurtëra në nyjet dhe degët e rrjetit;
   c) Studimet për Qëndrueshmërinë Statike dhe Dinamike të sistemit Elektroenergjitik;
   d) Studimet mbi Energjinë e Mosfurnizuar, për sasinë dhe koston e saj;
   e) Studimet për regjimet optimale të punës në sistemin Elektroenergjitik të vendit;

f) Studimet për regjimin optimal të flukseve tregtare të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit.

2. OST do të përgatisë një plan afatmesëm 2 vjeçar vetëm për zhvillimin e rrjetit të transmetimit (linja elektrike, nënstacione elektrike) për nevoja të aksesit të përdoruesve potencial në rrjetin e transmetimit.
3. OST përgatit skenarë për planifikimin e zhvillimit në bazë të:
   a) Rritjes së kërkesës (pasiguritë në parashikimin e shpërndarjes dhe kërkesës së OSSH dhe klientëve të lidhur në rrjetin e transmetimit);
   b) Vendndodhjes dhe fuqisë së instaluar të gjeneruesve të rinj;
   c) Ndryshimit të kushteve hidrologjike që shkaktojnë ndryshime në importin/eksportin e energjisë elektrike;
   d) Kapaciteteve rajonale tranzit NTC në drejtime të ndryshme të linjave të interkoneksionit;
   e) Integrimit të burimeve të rinovueshme të energjisë.

Neni 20. Planifikimi i Rrjetit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në mënyrë të pavarur do të formulojë planin e tij afatgjatë dhe afatmesëm dhe do ta paraqesë në OST, në koherencë të plotë me horizontet kohore përkatëse duke patur parasysh dhe çështjet e optimizimit të Sistemit Elektroenergjetik.

Neni 21. Koordinimi i Planifikimit të Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit

1. OST do të koordinojë Planifikimin e Përdoruesve të Rrjetit të Transmetimit bazuar në të dhënat e planifikimit në mënyrën dhe horizontet kohore të përshkruara në Kodin e Transmetimit.
2. OST do të verifikoje vlefshmërinë dhe do të modifikojë planet, nëse është e nevojshme, pas studimit dhe analizës së metodologjisë, krahasimit me të dhënat faktike dhe historike dhe në koherencë me metodologjitë e planifikimit afatgjatë të rrjetit ENTSO-E me qëllim konsolidimin dhe paraqitjen e Planit Afatgjatë të integruar për të gjithë përdoruesit e rrjetit dhe pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike.

Neni 22. Miratimi i Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Rrjetit

1. Drafti i Planit të Zhvillimit Afatgjatë të Rrjetit i hartuar nga OST, i paraqitet ERE-s për shqyrtim dhe miratim.
2. Plani i Zhvillimit Afatgjatë i Zhvillimit të Rrjetit do të bëhet i detyrueshëm për zbatim për OST-ne ,të licencuarit, përdoruesit e rrjetit të transmetimit dhe aplikuesit për lidhje në këtë rrjet pas miratimit nga ERE.
3. Modelet, parashikimet dhe konkluzionet kryesore të studimit të OST-së paraqiten në institucionet përkatëse në mënyrë që të integrohen si pjesë e planit të investimit rajonal të EJL (RgIP-Plani i Investimeve Rajonale për Evropën Juglindore), Planin Dhjetëvjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit ENTSO-E (TYNDP).
4. OST do të përgatisë planin e investimeve në rrjetin e Transmetimit, bazuar në planin afatgjatë të zhvillimit.
5. OST sh.a publikon Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit brenda 30 ditëve nga miratimi në ERE në faqen e saj të web .

Neni 23. Të dhëna të Përgjithshme të Planifikimit të siguruara nga OST sh.a.

1. Të dhënat e rrjetit të Sistemit të Transmetimit konsistojnë në paraqitjen e rrjetit të Sistemit të Transmetimit ekzistues dhe rrjetit të Sistemit të Transmetimit të planifikuar për zhvillim në të ardhmen, ashtu si përshkruhet në Planin e Afatgjatë dhe Afatmesëm të Zhvillimit. Të dhëna të tilla përfshijnë:

a) Skemën e planimetrisë të rrjetit të transmetimit të paraqitur në hartën gjeografike të shtetit që tregon elementet ekzistues të rrjetit të Sistemit të Transmetimit dhe ato të planifikuara (të treguara me pika). Harta gjeografike dhe skema e rrjetit (dixhitale apo jo) duhet të jetë me shkallën e duhur për ta lexuar;
b) Skemën elektrike një fazore të rrjetit të Sistemit të Transmetimit që tregon elementët ekzistues të rrjetit dhe ato të planifikuara (të treguara me pika) si dhe pikat përkatëse ku janë lidhur apo do të lidhen Gjeneruesit (Prodhuesit).

2. OST , me kërkesë të Përdoruesit të Rrjetit të Transmetimit jep informacione dhe të dhëna në lidhje me një pjesë të rrjetit të Sistemit të Transmetimit, që t'iu krijojë atyre mundësi, akses për lidhjen dhe përdorimin e rrjetit të Sistemit të Transmetimit.
3. Nëse kërkohet, OST gjithashtu do të ofrojë studimet, raportet dhe analizat e veta mbi gjendjen e pjesës së rrjetit të transmetimit të specifikuar në kërkesën përkatëse.

Neni 24. Kostoja e të dhënave dhe e informacionit

1. OST do të ketë të drejtë t'u kërkojë Përdoruesve të Rrjetit të Transmetimit pagesë për të dhënat apo informacionin për rrjetin e Sistemit të Transmetimit dhe do të informojë Përdoruesin për këtë kosto brenda 15 ditëve pas marrjes së kërkesës specifike nga Përdoruesi i Rrjetit të Transmetimit. Të dhënat e rrjetit të Sistemit të Transmetimit do të jepen brenda 2 muajve pas kërkesës së Përdoruesit, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të dhënave të kërkuara.

Neni 25. E drejta e OST sh.a për rezervim e të dhënave dhe informacionit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit, duke respektuar në çdo rast detyrimet ligjore për dhënien e informacionit, ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe parandalon përhapjen në mënyrë diskriminuese të informacionit për veprimtarinë e tij, me qëllim që të krijojë avantazh tregtar të një palë tjetër.
2. OST do të ketë të drejtë të mbajë të fshehtë çdo të dhënë të rrjetit të Sistemit të Transmetimit, nëse në opinionin e arsyetuar nga OST , nxjerrja apo publikimi i këtyre informacioneve do të ndikojë seriozisht në interesin e aktivitetit të biznesit të shoqërisë OST sh.a. Megjithatë OST do të japë një minimum të dhënash, kur është e qartë që Përdoruesit nuk mund të kryejnë aktivitetin e biznesit të tyre pa këto të dhëna.
3. Deri në datën që hyn në fuqi Marrëveshja e Lidhjes ndërmjet OST-së dhe Përdoruesit të Rrjetit të Transmetimit, të dhënat dhe informacioni i marrë do të trajtohen si konfidenciale dhe nuk do të ekspozohen për Palët e treta.

Neni 26. Planifikimi për përmirësimin dhe modifikimin e pajisjeve të sistemit

1. Planifikimin për përmirësimin e sjelljes së Sistemit Elektroenergjitik egzistues dhe pajisjeve/instalimeve të tij përfshin modifikimin dhe/ose zëvendësimin total të pajisjeve/instalimeve duke kryer një seri punimesh, por pa ndërhyre në pajisjen kryesore.
2. Objektivat e Planeve të tilla që përfshijnë investime të vogla, janë: përmirësimi i sjelljes së pajisjeve, i cilësisë dhe shkallës të sigurisë së furnizimit me energji elektrike, i qëndrueshmërisë statike dhe dinamike të rrjetit, i sigurisë operacionale të sistemit, i kriterit ekonomik, i reduktimit të humbjeve të energjisë elektrike dhe përmirësimit të treguesve të shërbimit të rrjetit të transmetimit, i përmirësimit të standarteve të sigurisë së jetës njerëzore dhe pajisjeve, i përmirësimit mjedisor.
3. Të gjitha Palët në bashkëpunim me me OST-në, identifikojnë zonat ku do të kryhen punët modifikuese duke kryer investime të cilat do të përmirësojnë cilësinë dhe/ose sasinë e

përfitimeve dhe do të zhvillojnë planet për përmirësimin cilësor dhe bashkëkohor të sjelljes së sistemeve/objekteve të tyre.

4. OST do të zhvillojë programe të përmirësimit të regjimit operacional të Sistemit të Transmetimit. Ndërhyrjet përkatëse në zonat ku përmirësime të tilla janë planifikuar përcaktohen nga OST kohë pas kohë.

Neni 27. Afatet Kohore për Planet Dy vjeçare Rinovim & Modifikim të Përdoruesit të Rrjetit të Transmetimit

1. Planet dy vjeçare për Rinovim & Modifikim të Përdoruesve të Rrjetit do të paraqiten në shoqërinë OST sh.a deri me 30 Shtator të çdo viti, për dy vitet pasardhës.
2. Zbatimi i modifikimeve dhe rinovimeve mund të shtyhet me miratim reciprok të palëve. Një palë mund të kërkojë shtyrje afati për arsye teknike ose vështirësi të tjera të qenësishme. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje ndërmjet palëve për programin e modifikimeve & rinovimeve, çështja zgjidhet nga proçedurat e Mosmarrëveshjeve të përshkruar në dispozitat përkatëse të këtij Kodit të Transmetimit.

KAPITULLI III

KODI I LIDHJES

Neni 28. Objekti

1. Kodi i Lidhjes specifikon normat (standartet teknike, kushtet, kriteret, kërkesat teknike, rregullat) dhe afatet kohore në baza jodiskriminuese që duhet të plotësojnë Përdoruesit e Rrjetit të Sistemit të Transmetimit në fazën e aplikimit për një lidhje të re me rrjetin e Sistemit të Transmetimit ose për të modifikuar lidhjet e tyre ekzistuese në këtë rrjet.
2. Kodi i Lidhjes përcakton specifikimet minimale teknike të detyrueshme për Palët, standardet e performancës, dhe kriteret operacionale në pikën e lidhjes për të siguruar mbrojtjen e sistemit të përdoruesve si dhe të Sistemit të Transmetimit në tërësi duke garantuar projektimin, kontrollin dhe operimin e sigurtë dhe të qëndrueshëm.
3. Lidhja me Rrjetin e Sistemin të Transmetimit rregullohet nëpërmjet një Marrëveshje Lidhje mes OST-së dhe palës së interesuar për secilën pikë lidhje në veçanti duke përcaktuar qartë funksionet teknike, kriteret operacionale dhe pronësinë e pajisjeve të lidhura në rrjetin e transmetimit në përputhje me ndarjen përkatëse të përgjegjësive dhe pronësisë;
4. Kodi i Lidhjes zbatohet për të gjithë subjektet që aplikojnë për tu lidhur dhe përdorur rrjetin e sistemit të transmetimit, përfshirë përdoruesit ekzistues të cilët kërkojnë të bëjnë ndryshime në sistemet apo objektet e tyre përkatëse.

Neni 29. Proçedurat e Aplikimit për Lidhje (të re dhe/ose modifikim)

1. Çdo subjekt që kërkon të lidhet në rrjetin e Sistemit të Transmetimit ose çdo përdorues ekzistues që kërkon të modifikojë Lidhjen dhe marrëveshjen ekzistuese të përdorimit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit, duhet të zbatojë kërkesat dhe proçedurat e vendosura në këtë Kod.
2. Subjektet sipas pikës (1) paraqesin një Aplikim për Lidhje në shoqërinë OST sh.a, sipas formularëve përkatës të aplikimit për lidhje të re apo modifikim të lidhjes ekzistuese në rrjetin e transmetimit të hartuar dhe publikuar nga OST, në zbatim të "Rregullores së Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit", në përputhje me nenin 27 të ligjit Nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".
3. Çdo aplikim për lidhje të re ose modifikim të lidhjes ekzistuese do ti nënshtrohet tarifave përkatëse, proçedurave dhe afatet kohore të specifikuara në zbatim të kërkesave të nenit 27, 28 dhe 29 të ligjit Nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".

Neni 30. Dokumentacioni i Përgjithshëm dhe Teknik i Aplikimit për Lidhje;

1. Aplikuesi për lidhje paraqet pranë OST-së informacionin si vijon:
   a) Të dhëna identifikuese dhe të aktiviteti ekonomik/ligjor (emri i shoqërisë, përfaqësuesi ligjor, adresa, telefoni, faksi, e- mail, web e tjera).
   b) Të dhëna të rrjetit të Përdoruesit, Sistemi/Objekti që do të lidhet (njësi gjenerimi, sistem/objekt i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, sistem/objekt klientë/konsumatorë të ndryshëm) duke përfshirë edhe të dhënat koordinative në hartën e rrjetit elektrik të Sistemit të Transmetimit për pikën/vendin e lidhjes.
   c) Deklaratë e shkruar mbi gadishmërinë për të zbatuar në mënyrë korrekte dispozitat e Kodit të Transmetimit

d) Studimin e Lidhjes së Njësive Gjeneruese/Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes/Klientit/Konsumatorit (sipas përkatësisë) dhe të dhënat sipas planifikimit standart të Kodit të Planifikimit;
e) Të dhënat për instalimet dhe pajisjet që gjenerojnë /absorbojnë fuqi reaktive;
f) Të dhënat për fazat përkatëse, sipas studimit tekniko-ekonomik të Përdoruesit, për realizimin e treguesve të projektit investues (horizontet kohore: fazat e projektimit teknik, fazat e zbatimit, kolaudimi-testimi, komisionimi/marrja në dorëzim dhe energjizimi).
g) Listën e dokumentacionit të përgjithshëm dhe teknik që i bashkëlidhet formularit të aplikimit për Lidhje të Re ose për modifikim të lidhjes ekzistuese.

Neni 31. Të dhënat dhe shkëmbimi i informacionit

1. Çdo përdorues i ri ose egzistues i Rrjetit të Sistemit të Transmetimit që dëshiron të ndryshojë fuqinë elektrike të tij apo skemën primare të lidhjes me rrjetin e transmetimit, pas studimeve të planifikimit të publikuara nga OST, mund t'i kërkojë shoqërisë OST sh.a me shumë informacion apo të dhëna.
2. OST do të japë të dhënat e kërkuara kundrejt tarifave të arsyeshme brenda 30 ditëve pas datës së kërkesës zyrtare sipas proçedurave të përcaktuara në këtë Kod.
3. OST mund të refuzojë të japë të dhëna ose informacion, nëse në arsyetimin e vet i konsideron ato konfidenciale/apo të panevojshme për ushtrimin e aktivitetit ligjor të përdoruesit të rrjetit të sistemit të transmetimit që kërkon këto të dhëna.
4. Shkëmbimi i të dhënave dhe informacionit ndërmjet shoqërisë OST sh.a dhe Përdoruesve të rrjetit të transmetimit, duhet të jetë në pajtueshmëri me dispozitat e Kodit të Transmetimit-Kodi i planifikimit.
5. Për nevoja të studimit të "Pranueshmërisë të lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese" në rrjetin e sistemit të transmetimit aplikuesi paraqet të dhënat Standarte të Planifikimit, sipas tabelave të Shtojcës A-Kategoritë dhe të dhënat e planifikimit.

Neni 32. Pika/Vendi Optimal i Lidhjes

1. OST do të miratojë çdo pikë/vendlidhje që teknikisht është më optimali, ku Përdoruesit e Rrjetit të Sistemit të Transmetimit mund të lidhin sistemet/objektet e tyre me këtë rrjet.
   a) Pikat e lidhjes për Gjeneruesit/Prodhuesit do të jenë në rrjetin e transmetimit me tension nominal 110 kV, 220 kV, 400 kV;
   b) Pikat e lidhjes për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes do të jenë në rrjetin e transmetimit me tension nominal 110 kV;
   c) Pikat e lidhjes për Klientin/Konsumatorët do të jenë në rrjetin e transmetimit me tension nominal 110 kV dhe 220 kV.
2. Në qoftë se pas studimit të "Pranueshmërisë së Lidhjes së re apo Modifikimit", rezulton se Lidhja e re duhet të bëhet në rrjetin e Operartorit të Sistemit të Shpërndarjes në tension < 110 kV, atëherë kërkesa për aplikim i kthehet zyrtarisht Aplikuesit.

Neni 33. Procesi dhe etapat e aplikimit

1. Aplikimi për lidhjen e re ose modifikim të lidhjes ekzistuese, me rrjetin e transmetimit fillon me paraqitjen formale pranë OST sh.a. të formatit të aplikimit të përcaktuar në "Rregulloren e Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit" dhe duhet të shoqërohet me dokumentacionin e përshkruar në mënyrë të detajuar në Kodin e Transmetimit/Kodi i Lidhjes.

2. Aplikuesi plotëson aplikimin duke ju referuar të dhënave Standarte të Planifikimit, sipas tabelave të Shtojcës A – "Kategoritë dhe të dhënat e planifikimit" të Kodit të Transmetimit. Kur është e nevojshme nga pikëpamja teknike, OST sh.a mund të përcaktojë kritere/kërkesa teknike shtesë nga ato të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, por në të gjitha rastet do të njoftojë palën tjetër brenda afateve të përcaktuara në këtë Kod dhe në Kodin e Lidhjes.
3. Me marrjen e aplikimit OST sh.a., kryen studimin e "Pranueshmërisë së lidhjes së re ose modifikimit të lidhjes ekzistuese" në rrjetin e sistemit të transmetimit. OST sh.a shqyrton nëse dokumentat e depozituara dhe informacioni i paraqitur nga aplikuesi janë të plota dhe në përputhje me kërkesat e kesaj rregulloreje. OST i komunikon aplikuesit përgjigjen e tij për pranimin ose refuzimin e aplikimit brenda 60 ditëve kalendarike nga data e dorezimit të aplikimit.
4. Në rastet kur në aplikim mungon ndonjë nga dokumentat ose informacionet e parashikuara në këtë rregullore apo nëse OST kërkon të dhëna apo informacion shtesë nga aplikuesi, sipas pikës 2 aplikuesi eshte i detyruar të paraqesë dokumentacionin e kerkuar, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e njoftimit për plotësimin e tij. Në këtë rast afati i pranimit apo refuzimit të aplikimit sipas pikës 3, bëhet 90 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të aplikimit.
5. Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar brenda periudhës së specifikuar në pikën 4 të këtij neni , OST refuzon aplikimin.

Neni 34. Oferta e Lidhjes së Re dhe/apo modifikimit të lidhjes ekzistuese

1. Me paraqitjen e gjithë informacionit të kërkuar nga OST sh.a., kjo e fundit në bazë të studimit të "Pranueshmërisë të lidhjes së re ose modifikimit të lidhjes ekzistuese", brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 4 të nenit 33:
   a. i paraqet aplikuesit Ofertën e Lidhjes duke përcaktuar pikë/vend lidhje ose zgjidhjen që teknikisht është më optimale dhe duke koordinuar teknikisht kërkesat për lidhje me rrjetin të paraqitura nga aplikues të tjerë; ose
   b. në qoftë se pas studimit të "Pranueshmërisë të lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese", rezulton se zgjidhja optimale do të jetë lidhja ne rrjetin e tensionit të mesem, atëherë kërkesa për aplikim i kthehet zyrtarisht aplikuesit me kete argumentim; ose
   c. në rast të një pergjigje negative, njofton aplikuesin për refuzimin e aplikimit, duke dhënë argumentimin përkatës për arsyet e këtij vendimi.
2. Aplikuesi brenda 60 ditëve kalendarike nga marrja e ofertës së Lidhjes, duhet të informojë zyrtarisht OST sh.a., për pranimin ose jo të saj nëpërmjet Deklaratës së Pranimit. Në rast se Oferta e Lidhjes sipas gërmës (a) me sipër nuk pranohet nga aplikuesi ose aplikuesi nuk informon OST sh.a brenda afatit kohor të caktuar, atëherë procesi i aplikimit për lidhjen rifillon nga e para.
3. Nëse aplikuesi e pranon Ofertën e Lidhjes, periudha kohore e vlefshmërisë të ofertës së lidhjes është 18 muaj nga marrja e ofertës së Lidhjes nga Aplikuesi. Në aplikimin e paraqitur në OST sh.a., përdoruesi i rrjetit duhet të ketë paraqitur periudhën kohore të ndërtimit dhe energjizimit të objektit të tij.
4. Pas pranimit të Ofertës për Lidhje nga aplikuesi, në zbatim të studimit të "Pranueshmërisë të lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese" të kryer, OST sh.a. duhet të verifikojë, shqyrtojë dhe vlerësojë të gjithë aplikimin sipas kerkesave të Kodit të Transmetimit/Kodi i Lidhjes sipas pikave me poshtë por pa u kufizuar:
   a) të dhënat e Aplikimit dhe dokumentacionit të përgjithshëm dhe teknik të lidhjes të protokolluara;

b) mundësinë për shfrytëzimin e Kapacitetit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit dhe nëse nuk ekziston kjo mundësi, Aplikuesi do të marrë masa teknike dhe do të investojë vetë deri në mbulimin e plotë të investimit, brenda kushteve teknike të sigurisë të specifikuara në Kodin e Transmetimit dhe të ligjit Nr.43/2015 " Për sektorin e Energjisë elektrike".

c) përcaktimin dhe përzgjedhjen e vendit të Lidhjes së Re në vendin e duhur, sipas shkallës së sigurisë së furnizimit, qëndrueshmërisë statike dhe dinamike, madhësive të lidhjeve të shkurtra 3 dhe 1 fazore, ndikimit në humbjet teknike në rrjetin e transmetimit me lidhjen e re dhe furnizimin me energji elektrike për nevojat vetiake sidomos për rastet e lidhjes së njësive gjeneruese;

d) kostot e lidhjes së Aplikuesit, konform me Nenin 27 dhe 28 të ligjit Nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", dhe Rregullores se Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit" sipas Ofertës së Lidhjes të konsultuar dhe pranuar nga Aplikuesi;

e) plotësimin e të gjitha kushteve dhe standarteve teknike të pikëlidhjes dhe Lidhjes Teknike;

f) zbatimin korrekt të dispozitave të Kodit të Transmetimit.

5. Aplikuesi, brenda 16 muajve nga marrja e Ofertës së lidhjes nga OST sh.a., paraqet kërkesën për lidhjen e Marrëveshjes së lidhjes sipas Marreveshjes Tip të përcaktuar në "Rregulloren e Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit".
6. OST sh.a dhe aplikuesi do të nënshkruajnë Marrëveshjen e Lidhjes së bashku me anekset përkatëse brenda 18 muajve nga marrja e ofertës së Lidhjes, duke patur në konsideratë kushtet dhe kërkesat teknike.

Neni 35. Kushtet dhe kërkesat teknike për pajisjet e Lidhjes së Re apo të Modifikimit

1. Të gjitha impiantet dhe aparaturat në pikën e lidhjes do të jenë në përputhje me standardet relevante shqiptare, ose në mungesë të tyre me standardet ndërkombëtare, në përputhje me Legjislacionin në fuqi duke garantuar në vijueshmëri bashkëpunimin me Përdoruesit e tjerë të rrjetit si dhe operimin dhe mirëmbajtjen me cilësi të lartë teknike të sistemit/objektit të tyre, sipas dispozitave të këtij Kodi dhe Kodeve të Rrjetit evropian ENTSO-E.
2. Lidhjet e reja dhe/apo modifikimet e atyre ekzistuese nuk duhet të shkaktojnë asnjë efekt negativ tek Përdoruesit egzistues të rrjetit të Sistemit të Transmetimit dhe anasjelltas.
3. Kërkesat teknike të pajisjeve për pikëlidhjet dhe lidhjet në rrjetin e Transmetimit janë:
   a) Pajisjet, aparaturat, instalimet dhe kushtet teknike në pikat e Lidhjes duhet të jenë konform me normat, Standartet Kombëtare dhe të rrjetit evropian të transmetimit ENTSO-E, të njëjta për të gjithë përdoruesit dhe sipas kategorive përkatëse të përdoruesve.
   b) Lidhjet ndërmjet instalimeve të Përdoruesit të rrjetit të transmetimit dhe rrjetit të Sistemit të Transmetimit duhet të realizohen nëpërmjet çelësave të fuqisë të aftë për t'u çkycur me veprim të shpejtë, sipas kërkesave dhe standarteve në sistemet elektroenergjitike.
   c) Zgjedhja dhe përcaktimi i aftësive çkyçëse të pajisjeve komutuese dhe qëndrueshmërisë ndaj rrymave të lidhjeve të shkurtra, duhet të jetë brenda vlerave dhe standarteve në fuqi të përcaktuar për secilën pikëlidhje.
   d) Mbrojtjet rele të instalimeve në pikat e lidhjes ndërmjet Rrjetit të Sistemit të Transmetimit dhe Përdoruesit të këtij rrjeti, duhet të plotësojnë qartësisht kërkesat dhe standartet teknike në fuqi, për të reduktuar në minimum teknik ndikimin negativ tek përdoruesit e tjerë të rrjetit të sistemit të transmetimit.

e) Pajisjet e telekomunikacionit në pikat e lidhjes ndërmjet Rrjetit të Sistemit të Transmetimit dhe Përdoruesit të këtij rrjeti, duhet të plotësojnë qartësisht kërkesat dhe standartet teknike të Rrjetit të Sistemit të Transmetimit, për të eliminuar ndikimin negativ dhe në rrjetin e sistemit të transmetimit.
f) Pajisjet që mundësojnë monitorimin dhe kontrollin e Përdoruesve të Rrjetit të Rrjetit të Transmetimit duhet të plotësojnë kërkesat teknike të Rrjetit të Transmetimit në mënyrë për tu standardizuar dhe për t'ju përshtatur logjikës së sistemit SCADA/EMS.

Neni 36. Marrëveshja e Lidhjes

1. Nëse kërkesa për lidhje e Aplikuesit pranohet dhe ky i fundit pranon ofertën e lidhjes, duke patur në konsideratë kushtet dhe kërkesat teknike, OST sh.a dhe Aplikuesi/përdoruesi i rrjetit të transmetimit proçedojnë me nënshkrimin e Marrëveshjes së Lidhjes sipas përcaktimeve në "Rregulloren e Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit".
2. Marrëveshja vendos detyrimin për palët për zbatimin e rregullave, proçedurave, specifikimeve teknike dhe kërkesave për pajisjet dhe instalimet, siç parashtrohet në këtë Kod, si dhe sipas përcaktimeve specifike në Marrëveshjen e Lidhjes relevante.
3. Marrëveshja e Lidhjes ndër të tjera specifikon kushtet e përgjithshme të lidhjes dhe çdo kusht specific teknik dhe financiar të aplikuar për çdo lidhje.
4. Marrëveshjes së Lidhjes i bashkëlidhet dokumentacioni (përfshirë një kopje elektronike) që Aplikuesi paraqet në OST , bashkë me pranimin e Ofertës të Lidhjes, si vijon:
   a) Plan-vendosjen në hartë të linjës elektrike, trasenë dhe planimetrinë e saj në formate të vizatimit A3;
   b) Skemën principale të Centralit, N/stacionit ngritës dhe lidhjes me rrjetin TL (single line diagram);
   c) Skemën principale të mbrojtjes rele dhe matjes (pjesa TL përfshirë tansformatorin TL/TM;
   d) Diagramën e telekomunikacionit dhe lidhja me sistemin SCADA të QKD ;
   e) Diagramin e mbrojtjes rele;
   f) Diagramin e kontroll-monitorimit;
   g) Specifikimet teknike të paisjeve kryesore (pjesa TL dhe tranformatorin TL/TM);
   h) Formularin TIP me të dhëna për HEC,TEC, WEC, PVEC e tjera;
   i) Formularin TIP me të dhënat për linjën e transmetimit;
   j) Formularin TIP me të dhënat për n/stacionin ngritës TM/TL;
   k) Planimetrinë e N/stacionit ngritës TM/TL;
   l) Harta me Planvendosjen e Nënstacionit dhe pika e lidhjes në rrjetin e Transmetimit;
   m) Deklaratën e Gatishmërisë për respektimin e kërkesave të Kodit të Transmetimit;
   n) Deklaratën mbi përgjegjësitë për kontrollin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, për operimin e pajisjeve dhe përgjegjësitë për sigurimin teknik të personelit;
   o) Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifave të lidhjes.

Neni 37. Formulimi i Lejes Teknike të Lidhjes që jepet nga OST.

1. Në përputhje me Kodin e Transmetimit/ Kodi i Lidhjes, "Rregulloren e Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit" dhe

marrëveshjen e lidhjes përkatëse, sipas detajimit dhe afateve të kërkuara në marrëveshje, aplikuesi është i detyruar të paraqesë një raport periodik dhe një certifikatë finale performance të infrastrukturës së tij lidhëse me rrjetin e transmetimit, duke shpjeguar përmbushjen në terma sasiorë dhe cilësorë të kërkesave teknike dhe kritereve operacionale të specifikuara në Kodin e Transmetimit, si dhe të kërkesave shtesë të parashikuara me ligj, marrëveshje bilaterale dhe/ose siç kërkohet nga OST sh.a..

2. Procedura operative e njoftimit për lidhje për çdo përdorues kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse dhe detajohet si vijon:
   a. Njoftimi Operacional i Energjizimit (EON);
   b. Njoftimi Operacional i Ndërmjetëm/përkohshëm (ION),
   c. Njoftimi Operacional Final (FON), dhe
   d. Njoftimi Operacional i Kufizuar (LON).
3. Përdoruesi do të ofrojë asistencën dhe gjithë informacionin e nevojshëm për OST sh.a. për të mbledhur të dhëna për të verifikuar përmbushjen e kërkesave teknike dhe të performancës.
4. Rekomandohet që përdoruesi të këshillohet dhe kontrollojë me OST sh.a. çështje relevante në një fazë të hershme të projektit në mënyrë që të mundësohen korrigjimet e nevojshme para se projekti i realizimit të lidhjes/modifikimit ti nënshtrohet verifikimit të pajtueshmërisë së plotë për efekt të komisionimit dhe energjizimit final të lidhjes.
5. Grupi përkatës i komisionimit të lidhjes së re apo të modifikimit të lidhjes ekzistuese harton Lejen Teknike për lidhjen e re ose modifikimin e cila përmban tërësinë e dokumentacionit teknik si vijon:
   a) Termat dhe kushtet e përgjithshme për treguesit teknik kryesor për elementet e rinj të rrjetit që futen në operim dhe shfrytëzim;
   b) Kushtet specifike teknike për Lidhjen nëse ka;
   c) Pajtueshmërinë me dispozitat e Kodit të Transmetimit;
   d) Plotësimin e kërkesave për monitorimin dhe kontrollin, matjen dhe telematjen, SCADA lokale, ndërfaqja me SCADA/EMS-të Sistemit të Transmetimit dhe sistemin e telekomunikacionit;
   e) Detyrimet e Aplikuesit që të marrë pjesë në Planin e Mbrojtjes dhe të Restaurimit të Sistemit Elektroenergjetik si dhe Planin e Zgjerimit të rrjetit të transmetimit;
   f) Plotësimin e Kërkesave dhe standarteve lidhur me mbrojtjen rele, automatikën dhe koordinimin e saj me mbrojtjet ekzistuese të rrjetit të Sistemit të Transmetimit;
   g) Parametrat vjetore për furnizim/konsum të Energjisë Elektrike;
   h) Kushtet operacionale dhe teknike sipas të cilave Përdoruesi i rrjetit të transmetimit mund të de-energjizohet apo shkëputet nga Rrjeti i Sistemi të Transmetimit;
   i) Plotësimin e kërkesave lidhur me standartet që duhet të plotësojnë pajisjet e lidhjes në pikën e lidhjes.
6. Dokumenti i Lejes Teknike të Lidhjes duhet të lëshohet pas nënshkrimit të "Marrëveshjes së Lidhjes" midis shoqërisë OST sh.a dhe Aplikuesit si përdorues i Sistemit të Transmetimit.
7. "Marrëveshja e Lidhjes " është dokument përbërës i Lejes Teknike të Lidhjes.

Neni 38. Nivelet Nominale dhe të Lejuara të Tensionit

1. Nivelet e tensionit nominal të lejuar, maksimal dhe minimal detajohen si më poshtë në përputhje me Kodin e Sigurisë Operacionale . Këto vlera lejohen për regjimin normal të punës të rrjetit të Sistemit të Transmetimit si dhe pas një kontigjence të listuar në analizat e rrjetit të Sistemit të Transmetimit.

Tensioni nominal i Rrjetit(kV)	Niveli maksimal i lejuar, kV (p.u)	Niveli minimal i lejuar, kV (p.u)
400 kV	420 kV (1.05)	360 kV (0.9)
220 kV	245 kV (1.118)	198 kV (0.9)
150 kV	168 kV (1.118)	135 kV (0.9)
110 kV	123 kV (1.118)	99 kV (0.9)

2. Çdo lidhje e re e instalimeve me rrymë të vazhduar, HVDC, duhet të projektohet në mënyrë që të mos krijojë efekte negative (rezonancë nën-sinkrone, variacione të shpejta të tensionit, harmonika të tensionit dhe ndërhyrje me telekomunikacionin) në pajisjet ekzistuese të lidhura me rrjetin apo efekte negative (pamjaftueshmëri për mundësinë e uljes së tensionit apo input /output i tepërt i fuqisë reaktive) në funksionimin/operimin e rrjetit të Sistemit të Transmetimit.
3. Një lidhje bipolare e instalimeve HVDC duhet gjithashtu të projektohet në mënyrë që rreziku i humbjes për të dy polet, për të njëjtën arsye, të jetë sa më i ulët që të jetë e mundur.

Neni 39. Disbalanca e Tensioneve

1. Disbalanca e tensioneve përcaktohet si:
   a) Diferencë e amplitudave të tensioneve fazore;
   b) Diferencë e këndeve midis fazave nga vlera 120°
2. Tensionet fazore duhet të jenë me amplitudë të barabartë dhe të sfazuar me 120˚. Çdo devijim ndikon në keqfunksionimin e paisjeve rrotulluese, ulje të efiçiencës, vibrime, mbinxehje etj.
3. Kufijtë e lejuar të disbalancës të tensionit në amplitudë dhe në fazë janë:
   a) për rrjetat me tension nominal 400 kV dhe 220 kV: 2% të tensionit nominal dhe këndit të sfazimit 120˚;
   b) për rrjetat me tension nominal 150 kV dhe 110 kV: 3% të tensionit nominal dhe këndit të sfazimit 120˚.

Neni 40. Deformimi nga Harmonikat

1. Për tensionet nominale të rrjetit të Sistemit të Transmetimit 110 kV – 400 kV, deformimi total harmonik duhet të jetë deri 2%;
2. Përdoruesit duhet të marrin masat e nevojshme për kufizimin në maksimum të harmonikave.
3. Në kushtet normale të operimit dhe planifikimit të ndërprerjes në rrjetin e Sistemit të Transmetimit, komponentja maksimale negative e sekuencës së fazës të tensionit fazor në rrjetin e Sistemit të Transmetimit nuk duhet të kalojë 1% për 99.5 % të kohës.

Neni 41. Frekuenca e Sistemit Elektroenergjetik

1. Frekuenca nominale në Sistemin Elektroenergjetik në operim sinkron me rrjetin evropian të transmetimit ENTSO-E është 50 Hz ± 0.05 Hz dhe do të mbahet brenda diapazonit të lejuar siç është detajuar në standardet e rregullimit të frekuencës të Kapitullit VI të Kodit.
2. Impianti i përdoruesit të rrjetit të transmetimit (gjenerues apo klient) duhet të plotësojë kërkesat e standardeve të frekuencës dhe të rregullimit të saj.

Neni 42. Luhatjet (flicker) e Tensionit

1. Nëse luhatja e tensionit e shkaktuar nga klientë të tillë si furrat elektrike me hark, kompresorët, elektromotorë asinkrone të fuqishëm, uzinat e saldimit etj., ndikojnë në

Përdoruesit e tjerë të rrjetit, OST do të kontrollojë dhe monitorojë këtë fenomen në zbarat e tensionit 110 kV dhe 220 kV.

2. Kufijtë e luhatjeve, proçedurat e kontrollit dhe matjes do të bazohen sipas standarteve përkatëse IEC.

Neni 43. Faktori i Fuqisë (cosϕ)

1. Ngarkesat konsumatorë/klientët në rrjetin e Sistemit të Transmetimit duhet të kenë faktor fuqie (cosϕ) sa më afër njësisë 1 (≥ 0.9);
2. Faktori minimal i lejuar i faktorit të fuqisë për OSSH dhe klientët është 0.9 (cosϕ =0.9)
3. Matja e faktorit të fuqisë bëhet në mënyre të vazhdueshme së bashku me matjen e tensionit, në kohë reale, nëpërmjet sistemit SCADA/EMS dhe sistemit të telematjes.
4. OSSH-ja dhe Klientët/Ngarkesat me faktor fuqie më të ulët së vlera e lejuar duhet menjëherë të instalojnë pajisje kompensuese të energjisë reaktive (bateri kondensatore) për përmirësimin e cosϕ.

Neni 44. Kërkesat e Mbrojtjes Rele dhe Koordinimi me Mbrojtjen Rele të Përdoruesit të Rrjetit të Sistemit të Transmetimit

1. Impiantet dhe paisjet elektrike të Përdoruesve të rrjetit të transmetimit nuk do të lidhen ose të vazhdojnë të mbeten të lidhura me rrjetin e Sistemit të Transmetimit, nëse ato nuk janë të pajisur me instalimet e mbrojtjes Rele të nevojshme që përmbushin parimet përkatëse të sigurisë, selektivitetit, shpejtësisë, diferencimit dhe ndjeshmërisë.
2. Në plotësim të këtyre parimeve dhe të rritjes së performancës, mbrojtja rele e instaluar në rrjetin e Sistemit të Transmetimit duhet të koordinojë veprimet e saj në mënyrë të përhershme, në bashkëveprim me mbrojtjen rele të instaluar në instalimet dhe pajisjet e përdoruesit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit. Për këtë qëllim OST dhe Përdoruesit e rrjetit të Sistemit të Transmetimit bashkëveprojnë në çdo kohë në tarimin e mbrojtjes rele dhe përmirësimin e teknologjisë së mbrojtjes rele. Mbrojtja rele e rrjetit të sistemeve/objekteve të Përdoruesve të rrjetit të transmetimit nuk duhet të tarohet dhe të vihet në punë pa u konsultuar rregullisht, në çdo kohë dhe zyrtarisht me shoqërinë OST.
3. Çdo paqartësi, problem dhe mosmarrëveshje mbi tarimet dhe koordinimin e Mbrojtjes Rele të rrjetit të Sistemit të Transmetimit dhe Përdoruesve të këtij rrjeti, do të analizohet dhe zgjidhet në takime bilaterale, të iniciuar nga çdo palë.
4. OST do të jetë përgjegjëse për tarimin e mbrojtjes rele në gjithë rrjetin e Sistemit të Transmetimit 400 kV, 220 kV, 150 kV, 110 kV. OST miraton sistemin e mbrojtjes rele dhe vendos tarimet në elementet e rrjetit të saj në koordinim me rrjetin e Përdoruesit të rrjetit të transmetimit. Përdoruesit e rrjetit të transmetimit nga ana e tyre janë përgjegjës për tarimin e Mbrojtjes Rele në rrjetin, sistemet/objektet e tyre dhe do të koordinojnë tarimet e Mbrojtjes Rele në këto instalimet dhe pajisje, në kufirin pronësor me rrjetin e Sistemit të Transmetimit.
5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përgatisë studime dhe plane për modifikimin e sistemeve të mbrojtjes dhe të automatikës, për instalimin e releve të frekuencës në bashkëveprim me shoqërinë OST sh.a. OST mund të kështillojë modifikime dhe përmirësime të rrjetit të Sistemit të Shpërndarjes, si mirëmbajtje speciale dhe zëvendësim të pjesëve të dobëta, me qëllim që të ulë çkyçjet nga difekte të shpeshta në këtë rrjet dhe rrjedhimisht ndikimet e tyre në rrjetin e Sistemit të Transmetimit.

Neni 45. Kohët Minimale të Tarimit të Mbrojtjes Rele

1. Pas studimeve të planifikuara dhe analizave të Studimeve të Qëndrueshmërisë Statike dhe Dinamike të Sistemit Elektroenergjitik (qëndrueshmërisë përkundrejt kolapsit të tensionit,

qëndrueshmërisë këndore, qëndrueshmërisë përkundrejt frekuencës) që kryhen nga OST dhe në bashkëpunim të vazhdueshëm me përdoruesit e rrjetit të transmetimit, si dhe analizat e performancës së mbrojtjes rele, të pajisjeve primare komutuese të instaluar në rrjetin e Sistemit të Transmetimit, përcaktohet koha minimale kritike e çkyçjes të difektit (koha kritike e pastrimit të difektit në sistemin elektroenergjitik). Madhësitë e kohës kritike minimale të çkyçjes paraqiten në tabelën me poshtë.

2. Këto madhësi ju bëhen të ditura përdoruesve të rrjetit të Sistemit të Transmetimit menjëherë, sa herë që në to bëhen ndryshime vlerash.

Niveli i Tensionit të Rrjetit, kV	Koha e Veprimit të Mbrojtjes Rele + Kohën e çkyçjes së çelësit të fuqisë
400 kV	80 msek
220 kV	110 msek
150 kV, 110 kV	120 msek

Neni 46. Kërkesat për Mbrojtjen Rele të Gjeneruesve

1. Të gjitha njësitë Gjeneruese të lidhur me rrjetin e Sistemit të Transmetimit do të mbrohen nga një sistem mbrojtje rele konform standarteve përkatëse në mënyrë që rrjeti i Sistemit të Transmetimit të mos pësojë dëmtime nga ndonjë difekt apo avari me origjinë nga njësitë Gjeneruese.
2. Në Mbrojtjet Rele të instaluara tek njësitë Gjeneruese dhe Blloku Transformator–Njësi Gjeneruese përfshihen:
   a) Mbrojtje Diferenciale e Bllokut
   b) Mbrojtje Diferenciale e Gjeneratorit
   c) Mbrojtje Maksimale me Bllokim Tensioni Minimal
   d) Mbrojtje nga Mbingarkesa
   e) Mbrojtje nga Lidhja e Shkurtër josimetrike dhe Simetrike
   f) Mbrojtje nga Lidhja me Tokën në Stator
   g) Mbrojtje nga Lidhja me Tokën në Rotor
   h) Mbrojtje nga Mbitensionet
   i) Mbrojtje nga Humbja e Eksitimit
   j) Mbrojtje Nulare e Bllokut Transformator- Njësi gjeneruese
   k) Mbrojtje Renditjes Kundërt Transformator- Njësi Gjeneruese
3. Në vetë Transformatorët e Gjenerimit shtohet:
   a) Mbrojtja Maksimale me/ose pa bllokim të Tensionit Minimal
   b) Mbrojtja Nulare
   c) Mbrojtjet nga dëmtimet e brendshme në transformator
4. Transformatorët që janë të lidhur në bllok (gjenerator-transformator) tarohen së bashku me gjeneratorin në bllok.
5. Transformatorët e nevojave vetiake të Gjeneruesve duhet të jenë të pajisur me:
   a) Mbrojtje Maksimale me bllokim nga tensioni minimal
   b) Mbrojtje çasti
   c) Mbrojtje nga dëmtimet e brendshme në transformator.

Neni 47. Kërkesat e Mbrojtjes Rele për Rrjetin e Sistemit të Transmetimit

1. Linjat elektrike të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV do të kenë Mbrojtje Distancionale dhe Mbrojtje Rezervë (Back-Up). Të gjithë linjat 400 kV, 220 kV do të kenë dy skema mbrojtje distancionale kryesore me operim të shpejtë dhe një mbrojtje rezervë.
2. Është e preferueshme që mbrojtjet kryesore të ushqehen nga burime të ndryshme tensioni dhe rryme.
3. Bazuar në analiza specifike të performancës së mbrojtjes rele, rrjeti i Sistemit të Transmetimit mund të sigurojë mbrojtje rezervë shtesë në linjat elektrike të veçanta.
4. Të gjitha paisjet kompesuese të lidhura me rrjetin e Sistemit të Transmetimit duhet të jenë të pajisur me mbrojtje rele sipas standartit përkatës.
5. Specifikime të tjera teknike për Linjat elektrike 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV janë:
   a) Mbrojtja Distancionale në linjat elektrike 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV mund të jetë statike ose numerike me të paktën 4 zona me veprim të shpejtë;
   b) Mbrojtjet Kryesore 1 dhe 2 në linjat elektrike 400 kV, 220 kV, kanë të njëjtën shpejtësi veprimi dhe preferohen me principe të ndryshme funksionimi;
   c) Kohët e tarimit të zonave duhet të përfshijnë dhe kohët e veprimit të çkyçjes së çelësave;
   d) Koha e veprimit të zonës së parë (bashkë me veprimin e çkyçjes të çelsit) është 80 milisekonda për linjat 400 kV, 110 milisekonda për linjat 220 kV dhe 120 milisekonda për linjat 150 kV dhe 110 kV;
   e) Kohët e zonave të tjera përcaktohen sipas zonës së mbulimit dhe konfiguracionit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit të përllogaritura për çdo regjim për çdo vit. Mbrojtjet e linjave elektrike 400 kV dhe 220 kV pajisen me Automatikën e Kyçjes së Përsëritur (AKP) një fazore dhe tre fazore për linjat 150 kV dhe 110 kV, me kontroll të mungesës së tensionit dhe kontroll të sinkronizimit në të dy skajet e linjës elektrike.
   f) Në varësi të analizave të sigurisë operacionale të Sistemit Elektroenergjitik prej shoqërisë OST sh.a, mbrojtjet Rele kryesore 1 dhe kryesore 2 mund të kenë furnizim DC (rrymë të vazhduar operative) nga instalime baterish akumulatore të ndryshme.
6. Në kërkesat e Mbrojtjes Rele për Auto dhe Transformatorët e Fuqisë në Sistemin Elektroenergjitik përfshihet Mbrojtja Diferenciale dhe mbrojtjet (teknologjike) të tjera nga dëmtimet e brendëshme (Mbrojtja gazore, Mbrojtje nga Temperatura e Pështjellave, Mbrojtje nga Temperatura e Vajit dhe Mbrojtje nga Zjarri).

Neni 48. Tokëzimi

1. Për të rritur efiçencën dhe selektivitetin, performancën në tërësi të Mbrojtjes Rele në rrjetin e Sistemit të Transmetimit, rëndësi të veçantë ka tokëzimi i pështjellave të anës primare të transformatorëve të fuqisë me tension 400 kV/ TM kV, 220 kV/TM kV, 150/TM kV, 110/TM kV. Sistemi i tokëzimit studiohet, analizohet dhe përcaktohet nga OST. Statusi i tokëzimit dhe madhësia e rezistencës të tokëzimit i përcaktuar nga studimet përkatëse të shoqërisë OST sh.a është e detyrueshme të respektohet nga të gjithë përdoruesit e rrjetit të transmetimit në rrjetin, sistemet/objektet e tyre.

Neni 49. Kërkesa të mbrojtjes rele në linjat me tension 35-20 kV.

1. Linjat elektrike të tensionit të mesëm 35 kV-20 kV mbrohen me Mbrojtje të Rrymës Maksimale, Mbrojtje Çasti dhe Mbrojtje të Difekteve me Tokën të drejtuara (nulare). Tarimet e Mbrojtjes Rele në linjat e tensionit të mesëm të shoqërisë të Sistemit të Shpërndarjes apo të klientëve/konsumatorëve do të përcaktohen nga këta Përdorues të rrjetit të Sistemit të Transmetimit në bashkëpunim me shoqërinë OST sha.

2. Në sistemet/objektet e rrjetit të OSSH dhe klientëve/konsumatorëve të rrjetit të Sistemit të Transmetimit, transformatorët e fuqisë në nënstacionet elektrike pajisen me Mbrojtje Diferenciale, Mbrojtje të Rrymës Maksimale të Drejtuar dhe Mbrojtje Rele për Difektet me Tokën.

Neni 50. Kërkesat e Mbrojtjes Rele të Zbarave të Nënstacioneve Elektrike

1. Zbarat e nënstacioneve elektrike të nivelit të tensionit 400 kV, 220 kV, 150 kV, 110 kV, mbrohen me mbrojtje Diferenciale gjatësore dhe tërthore. Zbarat pajisen gjithashtu me Mbrojtje nga Refuzimi i Veprimit të Çelësit i të gjithë trakteve përkatëse të zbarës.

Neni 51. Mbrojtja nga Zjarri e Instalimeve dhe Paisjeve Elektrike

Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri për instalimet dhe paisjet elektrike dhe rregullat e zbatimit të tij, duhet të jenë në përputhje me specifikimet, standartet, rregulloret dhe dispozitat ligjore në fuqi të Mbrojtjes kundra Zjarrit.

Neni 52. Të dhënat për Mbrojtjen Rele të Përdoruesve të Rrjetit të Transmetimit

1. Të dhënat për mbrojtjen rele të kërkuara nga OST, prej Përdoruesve të rrjetit të Sistemit të Transmetimit, janë si më poshtë:
   a) Tipet, specifikimet dhe tarimet e të gjitha releve dhe sistemeve të mbrojtjes rele të instaluar në njësitë Gjeneruese, bllokun Gjenerator-transformator, transformatorët e nënstacionit ngritës, transformatorët e nevojave vetiake si dhe paisjet e nevojave vetiake kryesore.
   b) Tipet, specifikimet dhe tarimet e të gjitha releve, të instaluara në gjithë transformatorët e fuqisë të nënstacioneve të Operatorit të Shpërndarjes dhe të Klientëve të rrjetit të transmetimit 220/TM kV dhe 110 kV/TM kV.
   c) Tipet, specifikimet dhe tarimet e releve të mbrojtjeve të instaluara në të gjithë zbarat 110 kV, 150 kV, 220 kV, 400 kV dhe linjat 35-400 kV në pronësi të përdoruesve të rrjetit të sistemit të transmetimit.
   d) Të dhënat e kërkuara për përcaktimin e rrymave të lidhjeve të shkurtra në çdo pikë lidhje të re apo egzistuese të përdoruesit të rrjetit të sistemit të transmetimit në bazë të planifikim-zhvillimit të vet, si dhe aftësitë çkyçëse për lidhjet e shkurtra të paisjeve komutuese në kufinjtë teknik dhe pronësor të tyre me rrjetin e Sistemit të Transmetimit.

Neni 53. Kërkesa për lidhjen me rrjetin të moduleve të reja gjeneruese.

1. Pragu i fuqisë minimale që një modul gjenerues të lidhet në rrjetin e sistemit të transmetimit do të jetë 15 MW për tension në pikën e lidhjes me rrjetin 110 kV dhe 50 MW për tension në pikën e lidhjes me rrjetin 220 kV .

2. Një modul gjenerues duhet të jetë i aftë të mbetet i lidhur me rrjetin dhe të operojë brenda diapazonit të frekuencës dhe periudhave të kohës të specifikuara më poshtë:

Diapazoni i frekuencës	Periudha e kohës për operim
47.5 Hz – 48.5 Hz	Jo më pak se 30 minuta
48.5 Hz – 49.0 Hz	Jo më pak se 50 minuta
49.0 Hz – 51.0 Hz	Pa kufizim kohe
51 Hz – 51.5 Hz	Jo më pak se 30 minuta

3. Njësitë e Reja të Gjenerimit duhet të zbatojnë në mënyrë korrekte dispozitat e këtij Kodi.
4. Njësitë Gjeneruese të tipit "me pikë lidhje në shpërndarje dhe/ose transmetim " do të jenë në gjendje të furnizojnë prodhimin nominal të fuqisë aktive me një vlerë të faktorit të fuqisë nga 0.85 induktiv deri në 0.95 kapacitiv. Të gjitha njësitë Gjeneruese duhet të jenë në gjendje të punojnë qëndrueshëm në të gjitha pikat e kurbës së aftesisë.
5. Koefiçenti (Kc) i Lidhjes së Shkurtër të Njësive Gjeneruese do të jetë ≥ 0.5.
6. Njësitë Gjeneruese duhet të jenë në gjendje të furnizojnë me fuqi aktive nominale rrjetin e transmetimit edhe kur frekuenca e sistemit Elektroenergjitik është në kufijtë nga 49.5 Hz deri në 50.5 Hz. Të gjitha njësitë gjeneruese të lidhura me rrjetin e sistemit të transmetimit duhet të jenë në gjendje të furnizojnë me fuqi aktive, në varësi të ndryshimit të frekuencës në sistem.
7. Njësitë Gjeneruese duhet të kenë Rregullatorë Automatik të Shpejtësisë RASH dhe Rregullator Automatik Tensioni RAT. Mundësia e tarimit të statizmit të RASH të jetë nga 2 deri në 12%.
8. Njësitë Gjeneruese duhet të kenë pështjellën e statorit të lidhur në yll dhe të gatshme për tokëzim. Tokëzimi i pikës së yllit në këto njësi përcaktohet nga studimet dhe analizat për qëllime të mbitensioneve dhe dimensionimit të paisjeve të rrjetit të Sistemit të Transmetimit, që përcaktojnë faktorin e lidhjes me tokën. Duhet që faktori i lidhjes me tokën të jetë ≤ 1.4. Gjeneruesit duhet të zbatojnë pa vonesë urdhërin e dhënë nga OST sh.a për statusin e tokëzimit të yllit të statorit në njësinë përkatëse gjeneruese, sa here që ky status duhet të ndryshojë.
9. Njësitë Gjeneruese Hidrike duhet të jenë të afta të vazhdojnë operimin e qëndrueshëm për çdo ngarkesë 40% deri 105% të fuqisë nominale aktive të njësisë gjeneruese.
10. Çdo njësi Gjeneruese dhe Gjeneruesit në tërësi pajisen me sistemin kompjuterik SCADA dhe të telematjes. Gjeneruesi i siguron shoqërisë OST sh.a nëpërmjet SCADA të instaluar në njësitë/objektin e tij parametrat e operimit që do të kërkohen nga OST, në zbatim të dispozitave të Kodit të Transmetimit dhe të Marrëveshjes së Lidhjes.
11. Çdo njësi Gjeneruese duhet të ketë aftësitë e mëposhtme:
    a) Të gjenerojë fuqi aktive dhe të operojë me parametra normal për frekuenca të Sistemit Elektroenergjitik në diapazonin 49.5 Hz – 50.5 Hz.
    b) Të mbetet e sinkronizuar me Sistemin Elektroenergjitik për frekuenca në Sistem në diapazonet: 47.5 Hz – 48.5 Hz dhe 50.5 Hz – 52.5 Hz për një kohë prej 60 minutash.
    c) Të mbetet e sinkronizuar me Sistemin Elektroenergjitik për frekuenca në Sistem në diapazonet 47.0 Hz – 47.5 Hz për një kohë prej 20 sekonda. Kjo kërkohet për çdo herë që frekuenca është nën 47.5 deri 47.0 Hz.
    d) Të mbetet e sinkronizuar me Sistemin Elektroenergjitik për frekuenca në Sistem në diapazonet 52.5 Hz – 53 Hz për një kohë prej 5 sekonda. Kjo kërkohet për çdo herë që frekuenca është mbi 52.5 deri 53 Hz.
    e) Të mbetet e sinkronizuar me Sistemin Elektroenergjitik gjatë ndryshimit të frekuencës në Sistem në vlera me të mëdha dhe të barabarta me 0.5 Hz/sek.

f) Të vazhdojë operimin në minimumin e specifikuar të Gjenerimit të fuqisë aktive sipas pasaportës teknike të njësisë gjeneruese, brenda vlerave 49.8 Hz – 51.0 Hz.
g) Të mbetet e sinkronizuar në sistemin elektroenergjitik gjatë ndryshimit të nivelit të tensionit në pikën e lidhjes në sistem nga 0.85 p.u-0.90 p.u për 60 minuta dhe për vlera të tensionit nga 1.118 p.u -1.15 p.u për së paku 20 minuta.
h) Të vazhdojë operimin në përputhje me Kurbën e Aftësisë së Fuqisë të specifikuar sipas pasaportës teknike të njësisë gjeneruese për çdo rast konkret që kërkohet për mbajtjen e niveleve të tensionit, në zbatim të dispozitave të Kodit të Transmetimit .
i) Çdo njësi gjeneruese duhet të mbetet e sinkronizuar gjatë prishjes së balancës gjenerim – ngarkesë sipas standarteve IEC 60034-1 .
j) Aftësia për Rritjen/Uljen e Gjenerimit: jo me i vogël së 1.5% të fuqisë aktive nominale/për minutë, kur njësia gjeneruese është në kushte normale operimi.
k) Fuqia e përgjithshme e njësive gjeneruese pa rregullim (të frekuencës dhe tensionit) të lidhur me rrjetin e sistemit të transmetimit nuk duhet të jetë më e madhe së 5% e pikut vjetor të ngarkesës të sistemit Elektroenergjitik.
l) Për njësitë gjeneruese pa rregullim përjashtohet kërkesa për madhësinë e gjenerimit min. dhe max.

12. Çdo njësi gjeneruese egzistuese (e teknologjisë së vjetër) duhet minimalisht të jetë e aftë të japë fuqinë aktive nominale për faktor të fuqisë cosϕ në kufijtë nga +0,85 në dhënie (injektim) në -0,95 në marrje (absorbim) të njësisë gjeneruese.

13. Çdo njësi gjeneruese (me teknologji bashkëkohore) duhet të jetë e aftë të japë fuqinë aktive nominale për faktorë të fuqisë cos φ në kufijtë nga +0,9 në dhënie (injektim) në -0,95 në marrje (absorbim) të njësisë gjeneruese, në përputhje me kurbën e Aftësisë së fuqisë reaktive.

14. Për të gjitha rastet e implementimit të paisjeve dhe teknologjive të reja në fushën e gjenerimit të energjisë elektrike, sidomos në prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë elektrike, të cilat nuk janë parashikuar në këtë Kod të Rrjetit të Transmetimit, OST do ti trajtojë çështjet dhe problemet përkatëse në ERE, për diskutim dhe miratim prej saj për çdo rast.

15. OST detyron Gjenerues (Prodhuesit) të veçantë të instalojnë Sistem Stabilizatorësh të Fuqisë (PSS) pas studimesh të detajuara që ajo kryen. Kostoja e këtyre instalimeve/modifikimeve përballohet nga Gjeneruesit në bazë të kërkesës së arsyetuar të kompanisë OST sh.a, për rritjen e shkallës të sigurisë të furnizimit dhe cilësisë së shërbimit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit.

16. Kërkesa për PSS specifikohet në Marrëveshjen e Lidhjes.

Neni 54. Kërkesat për Telekomunikacionin dhe Sistemin SCADA/EMS.

1. Impiantet dhe pajisjet elektrike të Përdoruesve të rrjetit të sistemit të transmetimit nuk do të lidhen ose të vazhdojnë të mbeten të lidhur me rrjetin e Sistemit të Transmetimit, nëse ato nuk janë të pajisur me instalimet e telekomunikacionit si dhe ndërfaqen për lidhjen me Sistemin SCADA/EMS të OST sh.a, duke përmbushur kërkesat e nevojshme për sigurinë dhe operimin normal të rrjetit të sistemit të transmetimit.
2. Në plotësim të këtyre kushteve të nevojshme teknike, pajisjet e telekomunikacionit si dhe ndërfaqja me sistemin SCADA/EMS të OST sh.a, të lidhur në rrjetin e Sistemit të

Transmetimit duhet të parametrizohen në mënyrë që të jenë kompatibël me rrjetin e telekomunikacionit dhe sistemin SCADA/EMS të OST.

3. Pajisjet e telekomunikacionit si dhe ndërfaqja me sistemin SCADA/EMS të OST sh.a, të Përdoruesve të rrjetit të sistemit të transmetimit nuk duhet të parametrizohen dhe të vihet në punë pa u konsultuar rregullisht, në çdo kohë dhe zyrtarisht me OST.
4. OST do të jetë përgjegjëse për kontrollin e parametrizimit dhe funksionimit të pajisjeve të telekomunikacionit si dhe të ndërfaqes me sistemin SCADA/EMS të OST.
5. OST miraton pajisjet e telekomunikacionit si dhe ndërfaqen me sistemin SCADA/EMS të OST-së, që Përdoruesi do të instalojë. Gjithashtu vendos parametrat dhe detajet teknike në përputhje me vendin dhe kushtet e lidhjes në rrjetin e sistemit të transmetimit.
6. Përdoruesit e rrjetit të sistemit të transmetimit janë përgjegjës për parametrizimin e pajisjeve të telekomunikacionit në të dy anët e ndërfaqësimit dhe integrimin e tyre në rrjetin e telekomunikacionit të OST.
7. Përdoruesit e rrjetit të sistemit të transmetimit janë përgjegjës për parametrizimin e ndërfaqeve me sistemin SCADA/EMS të OST, në të dy anët e ndërfaqësimit.

Neni 55. Kërkesat e Telekomunikacionit për Rrjetin e Sistemit të Transmetimit

1. Linjat e telekomunikacionit midis objektit të Përdoruesit dhe rrjetit të telekomunikacionit të OST-së në nënstacionet ku do lidhen do kenë ndërfaqe me OST si dhe integrim të paisjeve dhe funksioneve të komunikimit me rrjetin ekzistues të telekomunikacionit të OST-së.
2. Lidhja me rrjetin e telekomunikacionit të OST sh.a, duhet të jetë redundante, me përjashtim të rasteve kur Përdorues – Gjeneruesi ka kapacitet të vogël gjenerimi, për të cilin impakti në rrjetin e sistemit të transmetimit është jo i dëmshëm për funksionimin normal të tij si dhe e ka të pamundur lidhjen me rrjetin e telekomunikacionit të OST, për shkak të pozicionit dhe vendit të lidhjes me rrjetin e sistemit të transmetimit.
3. Pajisjet që Përdoruesi duhet të instalojë në objektin e tij si dhe në nënstacionet ku do lidhet dhe që do kenë ndërfaqe me rrjetin e telekomunikacionit të OST duhet të jenë kompatibel me pajisjet e rrjetit të telekomunikacionit të OST, si dhe në përputhje me kërkesat dhe standartet e saj. Ato duhet të jenë të ngjashme në arkitekturë dhe në funksionimin e tyre me pajisjet e rrjetit të telekomunikacionit të OST sh.a, në mënyrë që të ruhet standartizimi dhe performanca e rrjetit të telekomunikacionit të OST.
4. Në rastin kur linja e tensionit të lartë ka të instaluar OPGW, pra Përdoruesi mund të lidhet me anë të fibrave optike me rrjetin e telekomuniakcionit të OST sh.a, atëherë ai duhet të furnizojë dhe instalojë OPGW për të përmbushur funksionet e komunikimit me OST. Instalimi i OPGW do të bëhet sipas specifikimeve që përshtaten me atë pjesë të rrjetit.
5. Përdoruesi duhet të instalojë pajisje telekomunikacioni multiplekser për lidhjen me fibrat optike, furnizim me 48 VDC (rrymë të vazhduar) nga instalime baterish akumulatore, pajisje telefonike, pajisje Teleaksioni (Teleprotection) si dhe pajisje komunikimi të dhënash (DATA) për të përmbushur funksionet e komunikimit me OST. Instalimi i pajisjeve do të bëhet sipas specifikimeve që përshtaten me atë pjesë të rrjetit.
6. Ne rastin kur nuk linja e tensionit të lartë nuk ka të instaluar OPGW, pra Përdoruesi nuk mund të lidhet me anë të fibrave optike me rrjetin e telekomunikacionit të OST sh.a, atëherë ai duhet të furnizojë dhe instalojë pajisje telekomunikacioni Power Line Carrier të frekuencës së lartë, pajisjet primare përkatëse, furnizim me 48 VDC (rrymë të vazhduar) nga instalime baterish akumulatore, pajisje telefonike, pajisje Teleaksioni (Teleprotection) si dhe pajisje komunikimi të dhënash (DATA) për të përmbushur funksionet e komunikimit me OST-në. Instalimi i pajisjeve do të bëhet sipas specifikimeve që përshtaten me atë pjesë të rrjetit.

7. Përdoruesi i rrjetit të sistemit të transmetimit para instalimit të pajisjeve duhet të paraqesë për aprovim pranë OST–së:
   a) Projektin dhe skemën e lidhjes me rrjetin e telekomunikacionit të OST.
   b) Specifikimet e pajisjeve që do të instalojë dhe dokumentacionin e tyre.
8. Lidhja e Përdoruesit të rrjetit të sistemit të transmetimit do të bëhet në varësi të skemës së lidhjes elektrike që është parashikuar. Kjo për shkak të impaktit në rrjetin ekzistues të telekomunikacionit.

Neni 56. Kërkesat e Sistemit SCADA/EMS për Rrjetin e Sistemit të Transmetimit

1. Përdoruesi duhet të instalojë pajisje (sisteme kontrolli) për mbledhjen e të dhënave në objekte si dhe nëse do të jetë e nevojshme në nënstacionet ku do lidhet, pajisje të cilat duhet të kenë ndërfaqe me sistemin SCADA/EMS të OST-së. Gjithashtu ai duhet të bëjë integrimin e pajisjeve dhe realizimin e ndërfaqësimit me sistemin SCADA/EMS dhe sistemin lokal të kontrollit të nënstacionit ku lidhet (nëse ka një të tillë).
2. Pajisjet që Përdoruesi duhet të instalojë në objektin e tij si dhe në nënstacionet ku do lidhet dhe që do kenë ndërfaqe me sistemin SCADA/EMS të OST-së, duhet të jenë kompatibël me pajisjet e rrjetit SCADA të OST, si dhe në përputhje me kërkesat dhe standartet e OST. Ato duhet të jenë të ngjashme në arkitekturë dhe në funksionimin e tyre me pajisjet e vendosura për të njëjtin funksion në nënstacionet e tjera të OST, në mënyrë që të ruhet standartizimi dhe performanca e sistemit SCADA/EMS e OST-së.
3. Përdoruesi i rrjetit të Sistemit të Transmetimit para realizimit të ndërfaqësimit me sistemin SCADA/EMS duhet të paraqesë për aprovim pranë OST-së kërkesën për tu lidhur me sistemin SCADA/EMS ku bashkëngjitur kësaj kërkese duhet të paraqesë Skemën njëfazore të Nënstacionit, listën e të dhënave të disponueshme për tu monitoruar dhe Skemën e lidhjes me sistemin SCADA .

KAPITULLI IV

KODI I PLANIFIKIMIT OPERACIONAL DHE SKEDULIMIT

Neni 57. Subjekti dhe fushëveprimi

1. Kodi i Planifikimit Operacional përcakton kërkesat minimale operative të planifikimit dhe skedulimit për të siguruar një përgatitje koherente dhe të koordinuar të operimit në kohë reale të sistemit të transmetimit si dhe për të mbështetur koordinimin e operimit në zonën sinkrone Europiane.
2. Kodi gjithashtu mbështet zhvillimin e metodologjive të operimit të Sistemit për të lehtësuar rritjen e pritshme të gjeneruesve me burime të rinovueshme të lidhur në sistem.
3. OST dhe të gjithë përdoruesit, duhet të respektojnë kërkesat e nevojshme për të parashikuar kushtet e operimit në kohë reale të Sistemit dhe për të zhvilluar masat përkatëse të nevojshme për të ruajtur sigurinë operacionale, cilësinë dhe stabilitetin e sistemit në interkoneksion dhe për të mbështetur funksionimin efikas të tregut të energjisë elektrike.
4. Ky Kod synon:
   a) përcaktimin e horizonteve të përbashkëta kohore, metodologjive dhe parimeve për të lejuar kryerjen e koordinuar të analizave të sigurisë operacionale, analizat e mjaftueshmërisë për të mbajtur sigurinë operacionale dhe për të mbështetur funksionimin efikas të tregut të energjisë elektrike; dhe

b) përcaktimin e kushteve për të koordinuar planet e disponueshmërisë, duke lejuar punimet e kërkuara për asetet përkatëse.

5. Për qëllim të këtij Kodi, OST do të klasifikojë modulet gjeneruese si të tipit "me pikëlidhje në rrjetin e transmetimit" dhe "me pikëlidhje ne rrjetin e shpërndarjes". Njësitë e Kërkesës (Konsumit) do të klasifikohen sipas kritereve të përcaktuara nga ENTSO-E. Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit, në kontekstin e këtij Kodi janë sipas përcaktimit të bërë në Nenin 108 (5) pikat (a),(b),(c) dhe (d):

Neni 58. Dispozita të përgjithshme për modelin e rrjetit individual dhe të përbashkët

1. OST do të krijojë modele individuale rrjeti për bashkimin në modelin e përbashkët të rrjetit në përputhje me objektivat e këtij Kodi për secilin prej afateve të mëposhtme:
   a) Viti në avancë, në përputhje me Nenin 60 dhe Nenin 62;
   b) Java në avancë, kur është relevante, në përputhje me nenin 63;
   c) D-1, në përputhje me Nenin 64; dhe
   d) Brenda ditës, kur është e aplikueshme në përputhje me Nenin 67(3)(c).
2. Kur OST krijon një model individual rrjeti për një afat kohor në përputhje me këtë Kod, OST do të sigurojë që modeli individual i rrjetit është në përputhje me kërkesat e përcaktuara sipas këtij dokumenti.
3. Modelet individuale të rrjetit të përshkruara në Nenin 60 (1) do të përfshijnë të dhënat e përshkruara në Nenin 118 (3) si dhe kufijtë termike të elementeve të sistemit të transmetimit.
4. Formimi i modelit të përbashkët për zonën sinkrone Evropiane do të bëhet në përputhje me objektivat e këtij Kodi bazuar në:
   a) skenarë ose parashikime të siguruara në përputhje me Nenin 59, 64 dhe kur është relevante me Nenin 63;
   b) modelet individuale të rrjetit të zhvilluara në përputhje me Nenet 60, 62, 64, dhe kur është relevante Nenin 63; dhe
   c) dispozitat e rëna dakord në përputhje me Nenin 61(1) dhe 64(1).

Neni 59. Skenarët e vitit në avancë

1. Sipas rregullave të ENTSO-E, çdo vit OST në bashkëpunim me OST-të e tjera të zonës sinkrone, do të krijojnë një listë të përbashkët të skenarëve kundrejt të cilëve do të vlerësohet nga OST-të funksionimi i sistemeve të ndërlidhura. Këto skenarë do të lejojnë identifikimin dhe vlerësimin e ndikimit në sigurinë e funksionimit të sistemit të transmetimit të ndërlidhur. Këto skenarë do të përfshijë variablat e mëposhtëm:
   a) kërkesën;
   b) kushtet që kanë të bëjnë me kontributin e burimeve të rinovueshme të energjisë;
   c) pozicionet e përcaktuara të importit / eksportit, përfshirë rakordimin e vlerave referencë të cilat lejojnë bashkimin e modelit të rrjetit; dhe
   d) modelin e gjenerimit duke e konsideruar parkun e prodhimit plotësisht në dispozicion.
2. Këto skenarë do të përcaktohen duke marrë parasysh:
   a) modelet tipike të shkëmbimit ndërkufitar për nivele të ndryshme të konsumit dhe të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe gjenerimit konvencional;
   b) probabilitetin e ndodhjes së skenarëve;
   c) potencialin për devijimet e mundshme nga kufijtë e sigurisë operative që lidhen me çdo skenar; dhe
   d) sasinë e energjisë së gjeneruar dhe të konsumuar nga objektet e gjenerimit të energjisë dhe objektet e ngarkesës të lidhur në rrjetet e shpërndarjes.

Neni 60. Modelet individuale të rrjetit për vitin në avancë

1. Në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Nenin 61(1), OST do të krijojë një model individual rrjeti të vitit në avancë për secilin prej skenarëve të përcaktuar në përputhje me Nenin 59, duke përdorur vlerësimet e saj më të mira për variablat e përcaktuara në Nenin 59(1), dhe do ta bëjë atë disponibël përmes platformës së të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E.
2. Kur hartohen modelet individuale të rrjetit në përputhje me Nenin 60(1), OST do të:
   a) Rakordojë fluksin e parashikuar të energjisë në interkonektorët DC, me OST-të e lidhura direkt; dhe
   b) Balancojë shumën e mëposhtme për çdo skenar:
      i. shkëmbimet neto të interkoneksioneve AC;
      ii. fluksin e vlerësuar të energjisë në interkonektorët DC;
      iii. kërkesën, duke përfshirë një vlerësim të humbjeve; dhe
      iv. gjenerimin.
3. Gjatë zhvillimit të modeleve individuale të rrjetit sipas Nenit 60(1), OST do të sigurojë që prodhimi i energjisë shumatore (agregate) për objektet e gjenerimit të energjisë që lidhen me rrjetin e shpërndarjes janë:
   a) në përputhje me të dhënat strukturore të parashikuara në kërkesat e Nenit 120, 122, 125 dhe 128 të Kodit;
   b) në përputhje me skenarët e përcaktuar në Nenin 59; dhe
   c) të diferencuara sipas llojit të burimit primar të energjisë.

Neni 61. Modelet e përbashkëta të rrjetit për vitin në avancë

1. OST do të zbatojë procedurën e ENTSO-E lidhur me dispozitat që kanë të bëjnë me mbledhjen e modeleve individuale të rrjetit për vitin në avancë të përmendura në këtë pikë të këtij neni në formimin e modelit të bashkuar të rrjetit dhe ruajtjen e tij. Këto dispozita mbulojnë elementet e mëposhtëm:
   a) formati i të dhënave;
   b) procedurën për të trajtuar modifikime të topologjisë së rrjetit ose rregullimet operacionale;
   c) afatet për mbledhjen, bashkimin dhe ruajtjen e modeleve individuale të rrjetit të vitit në avancë në modele të përbashkët rrjeti;
   d) kontrolli i cilësisë së setit të dhënave;
   e) një procedurë për përmirësimin e modelit;
   f) detyrat që duhet të kryhen në nivel rajonal, në zonën sinkrone; dhe
   g) kërkesat për platformën e të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E.
2. OST do t'i japë OST-ve që kërkojnë, në përputhje me Nenin 68, informacionin shtesë mbi modifikimet e topologjisë së rrjetit ose rregullimet operative në mënyrë të tillë që të japë një përfaqësim të saktë të sistemit për të mundësuar kryerjen e analizës së plotë të sigurisë operacionale.

Neni 62. Përditësime të modelit të përbashkët të rrjetit të vitit në avancë

1. Kur OST e konsideron një ndryshim të variablave të përdorur për krijimin e modeleve individuale të rrjetit të përmendur në Nenin 60(1), të rëndësishëm në lidhje me sigurinë operacionale, OST do përditësojë modelet individuale të rrjetit të vitit në avancë dhe do t'i transmetojë në platformën e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E.
2. Kur bëhen ndryshime për një model individual të rrjetit në përputhje me Nenin 62 (1), Funksioni i Bashkimit (ENTSO-E) do të krijojë një model të përbashkët të vitit në avancë, të përditësuar.

Neni 63. Modelet individuale dhe të përbashkëta të rrjetit të javës në avancë

1. Kur dy ose më shumë OST e konsiderojnë të nevojshëm për koordinimin e analizës së sigurisë operative, do të përcaktojnë skenarët më përfaqësues për të analizuar sigurinë operacionale të sistemit të transmetimit për horizontin kohor të javës në avancë.
2. Kur është e aplikueshme, OST do të krijojë ose përditësojë modelin individual të rrjetit për javën në avancë në përputhje me skenarët sipas Nenit 63(1),dhe do t'i bëje ato disponibël për funksionin e bashkimit në ENTSO-E.

Neni 64. Modelet e rrjetit për ditën në avancë (D-1) dhe brenda ditës

1. OST do të zbatojë proçedurën e ENTSO-E lidhur me dispozitat që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe bashkimin e modeleve individuale të rrjetit për D-1 dhe brenda ditës , në modele të përbashkëta të rrjetit. Këto dispozita përfshijnë elementet e mëposhtme:
   a) formatin e të dhënave;
   b) intervalet/fragmentimi kohor;
   c) një procedurë për të trajtuar ndryshimin e topologjisë së rrjetit apo rregullimet operative në mënyrë që të menaxhojë sigurinë operacionale;
   d) afatet në përputhje me ndërmarrjen e veprimeve përmirësuese dhe procesin e llogaritjes së kapaciteteve;
   e) besueshmëria dhe cilësia e kontrollit të të dhënave, duke përfshirë modelet individuale të rrjetit, si dhe modelet e bashkuara të rrjetit në përputhje me pikat 4, 5 dhe 6 të këtij neni;
   f) një procedurë për përmirësimin e modelit;
   g) detyrat që duhet të kryhen në nivel rajonal, zonë sinkrone, dhe duke përfshirë skedulet kohore për detyra të ndryshme në të gjitha horizontet kohore; dhe
   h) specifikimet e hapsirës së të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E.
2. OST do të krijojë dhe të japë, me anë të platformës së të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E, modelet individuale të rrjetit të saj për D-1 dhe brenda ditës në përputhje me dispozitat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni .
3. Modelet individuale të rrjetit të përmendura në pikën (1) dhe (2) të këtij neni duhet të përmbajnë të paktën variablat e mëposhtme:
   a) parashikimet e kërkesës dhe gjenerimit të përditësuara;
   b) për objektet e gjenerimit të energjisë të lidhura me rrjetin e shpërndarjes, shumatore të fuqisë aktive të diferencuara sipas llojit të burimit primar të energjisë në përputhje me të dhënat e siguruara sipas Nenit 113, 116 dhe 117 të Kodit të Sigurisë Operacionale;
   c) topologjinë e sistemit të transmetimit; dhe
   d) veprimet përmirësuese të propozuara për menaxhimin e kufizimeve.
4. OST do të vlerësojë saktësinë e variablave të përmendur në pikën (3) më lart, të përdorura për të ndërtuar modelet e saj individuale të rrjetit, duke e krahasuar atë me vlerat aktuale dhe zbatimin e parimeve të përcaktuara në përputhje me Nenin 68(1)(f).
5. Nëse OST konsideron saktësinë e variablave të përmendur në pikën (3) të jenë të pamjaftueshme në lidhje me sigurinë operacionale si rezultat i vlerësimit në përputhje me pikën 4 të këtij neni, OST do të kryejë analizën e përcaktimit të shkaqeve të pasaktësisë. Nëse shkaqet varen nga proçeset e OST për krijimin modeleve individuale të rrjetit, OST do të përshtasë proceset në mënyrë që të krijoje rezultate më të sakta. Nëse shkaqet varen nga variablat e përmendur në pikën 3 të këtij neni , të ofruara nga pjesmarrës të tjerë, OST dhe ofruesit do të përdorin të gjitha mjetet ekonomikisht efikase dhe të mundshme në dispozicion nën kontrollin e tyre për të përmirësuar këto parashikime.
6. Për modelet e përbashkëta të rrjetit në D-1 dhe brenda ditës , OST do të kontrollojë të paktën sa vijon:

a) koherencën e statusit të lidhjeve të interkonjeksioneve;
b) devijimet e tensionit mbi kriteret e përcaktuara në përputhje me pikën (1) të këtij neni, për elementët e sistemit të transmetimit që gjenden në zonën e observimit të OST-ve të tjera;
c) koherencën e mbingarkesave tranzitore të pranueshme të interkonjeksioneve; dhe
d) injektimet ose tërheqjet e fuqisë aktive dhe reaktive, të papranueshme.

Neni 65. Analizat e sigurisë operacionale në Planifikimin Operacional

1. OST do të kryejë analiza të koordinuara të sigurisë operacionale të paktën në horizontet kohore të mëposhtme:
   a) Viti në avancë;
   b) Java në avancë, kur është e aplikueshme sipas Nenit 63;
   c) Dita në avancë, D-1; dhe
   d) Brenda ditës.
2. OST do të kryejë analiza të sigurisë operative për secilin nga horizontet kohore të përcaktuara në pikën (1) të këtij neni, në situatën (N) duke simuluar çdo kontingjencë nga lista e kontingjencave të OST-së, në përputhje me Nenin 114 të Kodit, dhe duke verifikuar se kufijtë e sigurisë operative të përcaktuara në përputhje me nenin 109(5), 109(6) dhe 109(8) të Kodit, në situatën (N-1) nuk janë tejkaluar.
3. Kur simulon çdo kontingjencë në përputhje me pikën (2) të këtij neni, OST do të marrë parasysh aftësitë e përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit siç përcaktohen nga Neni 109 deri 116 të këtij Kodi.
4. OST do të koordinojë me OST-të fqinje analizat e sigurisë operacionale në përputhje me nenin 113(3) dhe 114(3) të Kodit, dhe në përputhje me Nenin 68 të këtij Kodi, për të verifikuar që kufijtë e sigurisë operacionale që ndikojnë në zonën e saj të përgjegjësisë nuk janë tejkaluar.
5. OST do të përdorë si minimum modelet e bashkuara të rrjetit të përshkruara në Nenin 61,62, 64, dhe kur është relevante Nenin 63 për të kryer analizat e sigurisë operacionale të përmendura në Nenin 66 dhe Nenin 67.

Neni 66. Analiza të sigurisë operative të vitit në avancë deri në dhe duke përfshirë javën në avancë

1. OST do të kryejë analizat e sigurisë operative për të vlerësuar së kufijtë e sigurisë operacionale në zonën e përgjegjësisë nuk janë tejkaluar, duke marrë parasysh të gjitha kontingjencat nga lista e saj e kontingjencave dhe duke përdorur modelet e bashkuara të rrjetit të zbatueshme të përshkruara në Nenet 58 deri 64 dhe informacionin përkatës siç përshkruhet në Nenin 69.
2. OST do të kryejë analiza të sigurisë operacionale referuar pikës(1) të këtij neni, në përputhje me metodologjinë e koordinimit dhe proçeset e përshkruara në Nenin 68(1)(g) me qëllim të zbulimit të paktën të kufizimeve të mëposhtme:
   a) flukset e energjisë dhe tensionet mbi kufijtë e sigurisë operacionale;
   b) shkelje e kufijve të stabilitetit në sistemin e transmetimit nëse është e aplikueshme në bazë të Nenit 116(4) dhe 116 (5) të Kodit; dhe
   c) shkelja e limiteve të qarkut të shkurtër të sistemit të transmetimit nëse është e aplikueshme sipas Nenit 112(3) të Kodit të Sigurisë Operacionale.
3. Kur, si rezultat i analizës operacionale të sigurisë të përmendur në pikën(1) dhe (2) të këtij neni, OST zbulon kufizimet e mundshme, atëherë do të përgatisë, nëse është e aplikueshme,

me OSSH-në ose përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit, veprime përmirësuese për të zgjidhur kufizimet. Nëse këto masa nuk janë në dispozicion, kjo do të konsiderohet ndërprerje (për remont) mospërputhëse dhe një proçes koordinimi do të iniciohet në përputhje me Nenin 82 dhe Nenin 88 .

Neni 67. Analiza e sigurisë operacionale D-1, brenda ditës dhe afër kohës reale

1. Për ditën në avancë D-1 dhe brenda ditës, OST do të kryejë analiza të sigurisë operacionale për vlerësimin nëse kufijtë e sigurisë operacionale të zonës së përgjegjësisë nuk janë tejkaluar. Ajo do të marrë parasysh të gjitha kontingjencat nga lista e saj e kontingjencave, me qëllim të zbulimit të kufizimeve të mundshme dhe për të përcaktuar me OST-të e prekura, dhe nëse është e aplikueshme, me OSSH-në ose përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit, veprimet e duhura korrigjuese.
2. OST do të monitorojë parashikimet e kërkesës dhe gjenerimit dhe do të vazhdojë për të përditësuar analizat e sigurisë operacionale kur këto parashikime çojnë në devijim të rëndësishëm të kërkesës apo gjenerimit.
3. Në ndërmarrjen e analizave në përputhje me Nenin 67(1), OST do të marrë parasysh:
   a) të dhënat në dispozicion të gjenerimit dhe konsumit të përditësuara;
   b) devijimin e mundshëm të rëndësishëm në kërkesë ose gjenerim për shkak të parashikimit të pasigurt të motit;
   c) rezultatet e proceseve të tregut për D-1 dhe ndërditor; dhe
   d) rezultatet e detyrave të skedulimit të përshkruara nga Neni 99 deri 101 i këtij Kodi.
4. Për ditën në avancë D-1 dhe brenda ditës, nëse janë zbuluar kufizime, OST do të vlerësojë, në përputhje me parimet e koordinimit të përcaktuara në Nenin 68 dhe 69, efektivitetin e veprimeve të përbashkëta korigjuese dhe efikasitetin tekniko-ekonomik të veprimeve të përbashkët korigjuese.
5. Afër kohës reale, kur kryen analiza të sigurisë operacionale në zonën e observimit, OST do të bëjë vlerësimin e situatës (bazuar në të dhënat e sistemit SCADA).

Neni 68. Metodologjia për koordinimin e analizave të sigurisë operacionale

1. OST do të zbatojë metodologjinë e standardizuar 'Manualin Operacional' të ENTSO-E për zonën sinkrone Evropiane, për analizën e sigurisë operacionale. Aplikimi i kësaj metodologjie do të përfshijë së paku:
   a) Metodën për vlerësimin e ndikimit të elementëve të jashtëm;
   b) Metodën për përcaktimin e zonës së observimit;
   c) Pragun e influencës së kontingjencave, mbi të cilin kontingjencat e elementeve të rrjetit të jashtëm konsiderohen si kontingjenca të jashtme, dhe përfshihen në listën e kontingjencave të OST-së përkatëse;
   d) Parimet e vlerësimit të riskut të përbashkët, duke përfshirë të paktën, kontingjencat e përshkruara në Nenin 114 të Kodit:
      i. Probabilitetin shoqërues;
      ii. Mbingarkesat kalimtare të pranueshme; dhe
      iii. Impaktin e kontingjencave;
   e) Parimet për përzgjedhjen e veprimeve të duhura korrigjuese të përbashkëta;
   f) Parimet për vlerësimin e marzhit të sigurisë, që kanë të bëjnë me pasigurinë e parashikimit të gjenerimit dhe kërkesës, duke marrë parasysh të paktën kufirin e besueshmërisë.
   g) Metodologjitë dhe proceset për kryerjen e koordinuar të vlerësimit të stabilitetit dinamik në përputhje me Kodin.

Neni 69. Marrëveshja për koordinimin e sigurisë operacionale

1. OST do të jetë pjesë e marrëveshjes shumëpalëshe për rajonin e Evropës Juglindore, në të cilën ka ndikim operacional shumëpalësh që rezulton nga:
   a) ndërvarësitë elektrike midis zonave të përgjegjësisë duke përfshirë por pa u kufizuar në flukset, profilet e tensionit, transformatorët e zhvendosjes fazore dhe HVDC që ndikojnë njëra-tjetrën;
   b) efektet e rrjedhës së flukseve nga ndryshimet në modelet e gjenerimit; ose
   c) integrimin e elementeve të rrjetit të një OST-je në zonën e observimit dhe listën e kontingjencave të OST-së tjetër.
2. OST do të sigurojë konsistencën dhe efikasitetin e koordinimit të analizave të sigurisë operacionale brenda marrëveshjes shumëpalëshe të përmendur ne pikën(1) më lart. Kjo marrëveshje do të mbulojë të paktën :
   a) procedurat udhëheqëse dhe vendim-marrëse që do të miratohet nga ana e OST-ve pjesëmarrëse;
   b) proceset e përbashkëta për:
      i. ndarjen e informacionit mbi kontingjencat e jashtme në listën e kontingjencave që ndikojnë në zonën e përgjegjësisë të çdo OST-je;
      ii. vlerësimi i devijimeve nga kufijtë e sigurisë operacionale dhe pasojat, në përputhje me metodologjinë e përmendur në Nenin 68(1);
      iii. marrja në konsideratë e informacionit në lidhje me gamën e pasigurive në lidhje me gjenerimin dhe/ose kërkesën dhe probabilitetin shoqërues të tij;
      iv. shkëmbimin e informacionit të disponueshëm të veprimeve përmirësuese të përbashkëta para-avari dhe pas-avari; dhe
      v. përgatitja dhe aktivizimi i veprimeve përmirësuese të përbashkëta më të përshtatshme.
   c) identifikimi i numrit dhe përditësimi i frekuencës së modeleve ndërditore të rrjetit, të nevojshme për të rivlerësuar sigurinë operacionale;
   d) mjetet kompatibile për kryerjen e proceseve të përbashkëta të përcaktuara në pikën (2)(b) të këtij neni ;
   e) identifikimin e ndonjë detyre në kuadër të proceseve të përbashkëta të përmendura në pikën(2)(b)tëkëtij neni, që delegohet;
   f) proceset për shqyrtimin e përmbajtjes ose perimetrin e marrëveshjes shumëpalëshe në qoftë së ka rezultuar kështu nga analizat e ndikimit në përputhje me qasjen e përbashkët të përmendur në Nenin 68(1);
   g) grup të dhënash shtesë, sipas nevojës, përfshirë ato të përshkruara nga Neni 58 deri 64, duke përfshirë:
      i. Tarimet e mbrojtjes apo skemat e mbrojtjes së sistemit;
      ii. Diagrama njëpolare dhe konfigurimi i nënstacioneve;
      iii. Modele shtesë të rrjetit për të përfaqësuar situata të veçanta;
   h) informatat e nevojshme në lidhje me gamën e pasigurive në lidhje me gjenerimin dhe/ose kërkesën dhe probabilitetin e saj të lidhur, për çdo model individual rrjeti.

Neni 70. Kordinimi i ndërprerjeve - Rajoni i Koordinimit të Ndërprerjeve

1. OST do të koordinojë procesin e planifikimit të ndërprerjeve (të daljes nga puna të elementeve të Sistemit për mirëmbajtje) brenda zonës së vet të përgjegjësisë.
2. OST do të jetë pjesë e marrëveshjes shumëpalëshe për rajonin e Evropës Juglindore, në të cilën ka ndikim operacional shumëpalësh, dhe brenda të cilit statusi i disponueshmërisë të aseteve kryesore do të koordinohet dhe monitorohet.

Neni 71. Procedura e Koordinimit Rajonal

1. OST-të pjesmarrëse në rajonin e koordinimit të ndërprerjeve do të përcaktojnë:
   a) Frekuencën, fushë-veprimin dhe tipin e koordinimit i cili do të zhvillohet të paktën për horizontin kohor të vitit në avancë dhe javës në avancë;
   b) marrëveshjen për të siguruar pjesëmarrjen e Qendrës së Sigurisë Operacionale që vepron në Rajon, në procesin e koordinimit të ndërprerjeve ;dhe
   c) procedurat për vlefshmërinë e planeve të disponueshmërisë të elementëve përkatës të rrjetit për vitin në avancë, nga të gjitha OST-të pjesmarrëse të Rajonit të Koordinimit të Ndërprerjeve.
2. OST do të marrë pjesë në procesin e koordinimit të ndërprerjeve të Rajonit në përputhje me pikën(1).
3. OST do t'i sigurojë të gjitha OST-ve të Rajonit të saj, të gjithë informacionin përkatës në dispozicion të saj, të infrastrukturës në lidhje me sistemin e transmetimit, rrjetin e shpërndarjes, njësitë gjeneruese, ose objektet e kërkesës që ndikojnë në operimin e zonës së përgjegjësisë të një OST-je tjetër.
4. OST do të sigurojë për OSSH-në dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit të lidhur në rrjetin e transmetimit, që gjenden në zonën e saj të përgjegjësisë, të gjithë informacionin në dispozicion të saj në projektet e infrastrukturës të rrjetit të transmetimit, që kanë ndikim në operimin e rrjetit të shpërndarjes dhe/ose në objektet e përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit.

Neni 72. Metodologjia për Vlerësimin e Rëndësisë së Aseteve për Procesin e Koordinimit të Ndërprerjeve

1. OST do të aplikojë metodologjinë e standardizuar të ENTSO-E për zonën sinkrone evropiane, për vlerësimin e njësive gjeneruese kryesore, objektet e kërkesës dhe elementet e rrjetit që gjenden në Sistemin e Transmetimit ose në rrjetin e shpërndarjes, për Proçesin e Koordinuar të Ndërprerjeve.
2. Metodologjia referuar në pikën e mësipërme, do të përfshijë proçedurën e përcaktimit të masës së ndikimit në statusin e disponueshmërisë të njësisë gjeneruese, objekteve të kërkesës dhe elementëve të rrjetit që gjenden në Sistemin e Transmetimit, ose në rrjetin e shpërndarjes, në zonën e përgjegjësisë të OST-ve pjesmarrëse në procesin e koordinimit të ndërprerjeve. Kjo procedurë do të bazohet në:
   a) Analizat e sigurisë operative që përdorin modele rrjeti të përbashkëta të përcaktuara;
   b) Analiza e ndjeshmërisë së flukseve nëpërmjet rrjetit të interkonektuar;dhe
   c) Një prag për analizën e ndjeshmërisë së flukseve, të standartizuar për zonën sinkrone Evropiane.
3. Metodologjia që përmendet në Nenin 72 (1) do të jetë në përputhje me metodat për vlerësimin e ndikimit të elementëve të jashtëm, siç përmendet në Nenin 68 (1)(a).

Neni 73. Lista Relevante e Njësive Gjeneruese dhe Objekteve të Kërkesës.

1. OST do të zbatojë metodologjinë e përcaktuar në pajtim me Nenin 72 për të vlerësuar rëndësinë e njësive gjeneruese dhe objekteve të kërkesës për procesin e koordinimit të ndërprerjeve.
2. OST do të krijojë një listë të vetme të njësive gjeneruese kryesore dhe objekteve kryesore të kërkesës për procesin e koordinuar të ndërprerjeve, e cila do të përmbajë vetëm Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit.
3. Lista e njësive gjeneruese të rëndësishme dhe objekteve të rëndësishme të kërkesës, do të përmbajë ata përdorues të rrjetit për të cilët statusi i disponueshmërisë ndikon në të paktën në

një nga zonat e tjera të përgjegjësisë në një nivel përtej pragut të përcaktuar në metodologjinë e përcaktuar në përputhje me Nenin 72 dhe për të cilën zbatohet pika (2) e këtij neni.

4. OST do të informojë Entin Rregullator të Energjisë për listën e përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit, dhe për çdo njësi gjeneruese dhe objekt kërkese të përfshirë në listë, OST do të:
   a) Informojë pronarët e njësive gjeneruese dhe të objekteve të kërkesës të lidhur në rrjetin e transmetimit, për përfshirjen e tyre në listë;
   b) Informojë OSSH-në mbi njësitë gjeneruese dhe objektet e kërkesës të lidhur në rrjetin e shpërndarjes, për përfshirjen e tyre në listë.

Neni 74. Ri-vlerësimi i Listës Relevante të Njësive Gjeneruese dhe Objekteve të Kërkesës

1. Para 1 korrikut të çdo viti kalendarik, OST do të ri-aplikojë metodologjinë e përcaktuar në pajtim me Nenin 72, për vlerësim të relevancës së njësisë gjeneruese dhe objekteve të kërkesës për procesin e koordinimit të ndërprerjeve.
2. Kur, sipas vlerësimit në pikën e mësipërme, OST identifikon nevojën për të rinovuar listën e njësive gjeneruese dhe objekteve të kërkesës, atëherë njofton OST-të e Rajonit të koordinimit të ndërprerjeve, dhe bën përditësimin e listës sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 75. Lista e Elementeve Relevante të Rrjetit

1. OST do të zbatojë metodologjinë e përcaktuar në pajtim me Nenin 72 për vlerësimin e relevancës së elementeve të rrjetit të transmetimit dhe të rrjetit të shpërndarjes, për Procesin e Koordinimit të Ndërprerjeve.
2. OST do të krijojë një listë të vetme të elementeve relevante të rrjetit për Procesin e Koordinimit të Ndërprerjeve.
3. Lista e elementeve relevante të rrjetit do të përmbajë:
   a) të gjithë elementet e rrjetit që gjënden në Sistemin e Transmetimit ose në Rrjetin e Shpërndarjes që lidhin Zonat e Përgjegjësisë;
   b) të gjithë elementet e rrjetit që gjenden në Sistemin e Transmetimit ose në Rrjetin e Shpërndarjes, për të cilët statusi i disponueshmërisë ndikon në një Zonë tjetër Përgjegjësie në nivelin përtej pragut të përcaktuar në metodologjinë e përcaktuar sipas Nenit 72;
   c) të gjithë Elementet Kritikë të Rrjetit.
4. Lista e Elementeve të Relevante të Rrjetit do të përmbajë llojet e informacionit që sigurohet nga çdo OST në Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operativ të ENTSO-E, duke përfshirë të paktën:
   a) arsyen për çdo status pa-disponueshmërie të Elementëve Relevant të Rrjetit;
   b) kushtet specifike që nevojiten të përmbushen para ekzekutimit të statusit të pa-disponueshmërisë të Elementit Relevant të Rrjetit;dhe
   c) kohën e duhur për rivendosjen e Elementit Relevant të Rrjetit në shërbim nëse është e nevojshme për të ruajtur sigurinë operacionale.
5. OST, si të gjitha OST-të Koordinatore të Ndërprerjeve, do të bëjë të disponueshme listën e Elementëve Relevante të Rrjetit në portalin e të Dhënave të Planifikimit Operativ të ENTSO-E.
6. OST do të informojë Entin Rregullator të Energjisë për listën e Elementeve Relevante të Rrjetit, dhe për çdo Element Relevant të Rrjetit të përfshirë në listë, OST do të:
   a) Informojë pronarët dhe/ose operatorët e Elementeve Relevante të Rrjetit të lidhur në rrjetin e transmetimit, për përfshirjen e tyre në listë;
   b) Informojë OSSH-në mbi Elementet Relevante të Rrjetit të lidhur në rrjetin e shpërndarjes, për përfshirjen e tyre në listë.

Neni 76. Ri-vlerësimi i Listës së Elementeve Relevante të Rrjetit

1. Para 1 korrikut të çdo viti kalendarik, OST do të ri-aplikojë metodologjinë e përcaktuar në pajtim me Nenin 72, për vlerësim të relevancës së elementeve të rrjetit, për proçesin e koordinimit të ndërprerjeve.
2. Kur, sipas vlerësimit në pikën e mësipërme, OST identifikon nevojën për të rinovuar listën e Elementeve Relevante të Rrjetit, atëherë njofton OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve, dhe bën përditësimin e listës sa më shpejt të jetë e mundur, duke e bërë gjithashtu të disponueshme listën e Elementeve Relevante të Rrjetit në portalin e të Dhënave të Planifikimit Operativ të ENTSO-E.

Neni 77. Caktimi i Agjentëve të Ndërprerjeve të Planifikuara

1. Për çdo aset relevant, pronari (përdoruesi i rrjetit) do të sigurojë që është caktuar një agjent i planifikimit të ndërprerjeve.
2. OST është (caktohet) Agjent i Planifikimit të Ndërperjeve për çdo Element Relevant të Rrjetit që operohet nga ana e saj si Koordinuese e Ndërprerjeve.

Neni 78. Trajtimi i Aseteve Relevante të lokalizuara në Rrjetin e Shpërndarjes

1. Për Asetet Relevante që gjënden në rrjetin e shpërndarjes, OST do të koordinojë planifikimin e ndërprerjeve me OSSH-në, në rrjetin e së cilës ato janë të lidhura.

Neni 79. Dispozita të Përgjithshme mbi Planin e Disponueshmërisë

1. Planet e Disponueshmërisë do të përmbajnë një status disponueshmërie të veçantë për çdo Aset Relevant, me një nivel detajimi me bazë orare.
2. Për shkëmbimin e Planeve të Disponueshmërisë ndërmjet palëve, statuset e disponueshmërisë mund të agregohen në nivele më të ulëta të detajiimit, nëse bihet dakord nga palët që e shkëmbëjnë këtë informacion.
3. Për periudhat e kohës kur skedulimi i gjenerimit dhe i konsumit i janë paraqitur OST-së në përputhje me Nenin 100, planet e disponueshmërisë do të jenë të detajuara në kohë në përputhje me skedulet e gjenerimit dhe ato të konsumit.
4. Statuset e Disponueshmërisë do të jenë në një nga tre gjendjet si me poshtë:
   a) I disponueshëm: aseti relevant është i aftë dhe i gatshëm për ofrimin e shërbimit edhe nëse është ose jo në operim;
   b) I pa-disponueshëm: aseti relevant nuk është i aftë dhe i gatshëm për ofrimin e shërbimit;
   c) Në testim: aftësia e asetit relevant po testohet për ofrimin e shërbimit.
5. Statusi i disponueshmërisë "testim" do të përdoret vetëm nëse ka ndikim të rëndësishëm në Sistemin e Transmetimit dhe do të kufizohet në kohë:
   a) ndërmjet lidhjes fillestare dhe komisionimit final të asetit relevant; dhe
   b) menjëherë pas periudhës së mirëmbajtjes së asetit relevant.

Neni 80. Plani Tregues i Disponueshmërisë në terma afatgjatë

1. Dy vite para së të fillojë proçesi i koordinimit të vitit në avancë, OST do të vlerësojë planin tregues të disponueshmërisë për asetet relevante, të siguruara nga agjentët e Planifikimit të Ndërprerjeve.
2. Pas këtij vlerësimi, OST do të japë komentet paraprake duke përfshirë pa-pajtueshmëritë e ndërprerjeve të diktuara, për të gjithë agjentët e planifikimit të ndërprerjeve të ndikuar nga këto pa-pajtueshmëri.
3. OST do të përsërisë këtë vlerësim çdo 12 muaj, deri në fillimin e proçesit të koordinimit të vitit në avancë.

Neni 81. Dhënia e Propozimeve të Planeve të Disponueshmërisë për Vitin në Avancë.

1. Para 1 gushtit të çdo viti kalendarik, për çdo aset relevant, agjenti përkatës, do të propozojë në OST ose në OSSH një plan disponueshmërie për asetet e tij relevante, për vitin kalendarik pasues.
2. Ndërmjet 1 Gushtit dhe 1 Dhjetorit, të gjithë agjentët e planifikimit të ndërprerjeve, referuar pikës së mësipërme, do të kenë të drejtën të iniciojnë ndryshime në planet e disponueshmërisë të propozuar, duke dërguar kërkesën për ndryshime në OST.
3. OST do të trajtojë kërkesat për ndryshime, pasi të jetë finalizuar procesi i koordinimit të vitit në avancë, në këtë mënyrë:
   a) duke respektuar radhën me të cilën është bërë kërkesa për ndryshim; dhe
   b) duke ndjekur një procedurë në pajtim me Nenin 88(2).

Neni 82. Koordinimi i Statusit të Disponueshmërisë të Aseteve Relevante për Vitin në Avancë, me Agjentët e Koordinimit të Ndërprerjeve të Përdoruesve të Rrjetit

1. OST do të vlerësojë, nëse për vitin në avancë, shfaqen pa-pajtueshmëri nga planet e disponueshmërisë të propozuara në përputhje me Nenin 81.
2. Në rastet kur janë zbuluar pa-pajtueshmëri të ndërprerjeve, OST dhe të gjithë agjentët e planifikimit të ndërprerjeve të prekur, do të koordinojnë planet e tyre të disponueshmërisë. Për këtë, OST do të:
   a) informojë çdo agjent të ndërprerjeve të planifikuara, për kushtet që duhet të përmbushen për të lehtësuar pa-pajtueshmëritë e ndërprerjeve të zbuluara;
   b) ketë të drejtë të kërkojë që një ose më shumë agjentë të planifikimit të ndërprerjeve të paraqesin një alternativë të planit të disponueshmërisë, që përmbush kushtet; dhe
   c) përsërisë vlerësimin në pajtim me pikën (1) të këtij neni për të përcaktuar nëse mbeten ende pa-pajtueshmëri të ndërprerjeve.
3. Në rastin kur, pas kërkesës së OST-së, nuk paraqitet ndonjë plan alternativ disponueshmërie që çliron të gjitha pa-pajtueshmëritë e ndërprerjeve, atëherë OST do të përcaktojë një plan të tillë alternativ të disponueshmërisë. Në këtë rast OST do të:
   a) të marrë parasysh ndikimin e raportuar nga agjentët e ndërprerjeve të planifikuara, të prekur;
   b) sigurohet që ndryshimet në planet alternative të disponueshmërisë janë të limituara në atë çfarë është e domosdoshme për të lehtësuar pa-pajtueshmëritë e ndërprerjeve; dhe
   c) të informojë Entin Rregullator të Energjisë, OSSH-në dhe agjentët e prekur të ndërprerjeve, për planin e disponueshmërisë të përcaktuar, dhe arsyet që motivuan adoptimin e këtij plani.

Neni 83. Koordinimi i Statusit të Disponueshmërisë të Aseteve Relevante për Vitin në Avancë, me OSSH-në

1. OST do të koordinojë statusin e disponueshmërisë me OSSH-në për elementet relevante të rrjetit që lidhin zonat e tyre të përgjegjësisë, për të cilat OST ka përgjegjësinë e koordinimit të ndërprerjeve, me OST-të e tjera të rajonit të Koordinimit të Ndërprerjeve, në pajtim me parimet e mëposhtme:
   a) minimizimin e ndikimit në treg, ndërkohë që ruan sigurinë operative;dhe
   b) përdor si bazë planet e disponueshmërisë të propozuara për asetet relevante të përcaktuara në pajtim me Nenin 81 dhe 82.

2. OST dhe OSSH do të planifikojnë statusin e disponueshmërisë të elementeve relevante të rrjetit, për të cilat ata janë agjentë të planifikimit të ndërprerjeve, dhe që nuk ndërlidhin zonat e tyre të përgjegjësie, në pajtim me parimet e mëposhtme:
   a) minimizimin e ndikimit në treg, ndërkohë që ruan sigurinë operative;dhe
   b) përdor si bazë planet e disponueshmërisë të propozuara për asetet relevante të përcaktuara në pajtim me Nenin 81 dhe 82, dhe statusin e disponueshmërisë të elementeve relevante të rrjetit që ndërlidhin zonat e tyre të përgjegjësisë të përcaktuara në pajtim me pikën (1) të këtij neni.
3. Në rastet e papajtueshmërive të ndërprerjeve, OST ka të drejte të propozojë ndryshime në planet e disponueshmërisë të aseteve relevante të lidhura në rrjetin e shpërndarjes, dhe fillon koordinimin me OSSH-në për çdo rast të pa-pajtueshmërisë.
4. Në rastin kur OSSH ka qenë e pa-aftë të planifikojë pa-disponueshmërinë e statusit të disponueshmërisë të ndonjë elementi relevant të rrjetit, OSSH njofton OST-në. Në këtë rast, OST dhe të gjithë Agjentët e Planifikimit të Ndërprerjeve, do të përdorin të gjitha mjetet efiçente dhe të mundshme ekonomikisht që kanë nën kontroll në përputhje me kuadrin ligjor, për të planifikuar pa-disponueshmerinë e statusit të disponueshmërisë të elementit relevant të rrjetit.
5. Në rast se, duke zbatuar dispozitat e pikes (4) të këtij neni, pa-disponueshmëria e Statusit të Disponueshmërisë të elementit relevant të rrjetit, nuk është planifikuar, dhe nëse sipas mendimit të arsyetuar të OST-së, mosplanifikimi i pa-disponueshmërisë së këtij Statusi Disponibiliteti do të cënonte Sigurinë Operative, atëherë OST do të:
   a) ndërmarrë veprime të tilla siç ajo e konsideron të nevojshme për të planifikuar këtë pa-disponueshmeri të Statusit të Disponueshmërisë, duke marrë parasysh ndikimin e raportuar nga Agjentet e ndikuar të Planifikimit të Ndërprerjeve;
   b) njoftojë për këto veprime të gjitha palët e ndikuara; dhe
   c) informojë Autoritetin Rregullator, OSSH-në dhe Agjentët e Planifikimit të Ndërprerjeve të prekur nga veprimet e marra, situatën që diktoi ndërmarrjen e këtyre veprime dhe arsyetimin për përdorimin e veprimeve të përzgjedhura.
6. OST do të përfshijë të gjithë informacionin në dispozicion për kushte të rrjetit që duhet të përmbushen, dhe veprimet përmirësuese që duhet të ndërmerren, para ekzekutimit të padisponueshmërisë së Statusit të Disponueshmërisë të elementit relevant të rrjetit, në Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operacional të ENTSO-E, së bashku me informacionin mbi Planin e Disponueshmërisë.

Neni 84. Dispozita të Planit paraprak të Disponueshmërisë për Vitin në Avancë

1. Para 1 Nëntorit të çdo viti kalendarik, OST do të sigurojë Planet paraprake të Disponueshmërisë për të gjithë asetet relevante të rrjetit për vitin pasues kalendarik, për të gjitha OST-të Koordinatore të Ndërprerjeve, nëpërmjet të dhënave të publikuara në Portalin e ENTSO-E për të dhënat e Planifikimit Operativ.
2. Para 1 Nëntorit të çdo viti kalendarik, për çdo Aset Relevant të lokalizuar në rrjetin e shpërndarjes, OST do t'i sigurojë OSSH-së planin paraprak të disponueshmërisë për vitin në avancë, për çdo aset relevant të lidhur në këtë rrjet.
3. Planet e Disponueshmërisë referuar në dy pikat e mësipërme, do të përmbajnë të paktën informacionin e listuar në Nenin 75(4).

Neni 85. Vlefshmëria e Planeve të Disponueshmërisë për Vitin në Avancë brenda Rajonit të Koordinimit të ndërprerjeve

1. OST do të analizojë nëse shfaqen pa-pajtueshmëri të ndërprerjeve në zonën e saj të përgjegjësisë, kur kombinohen të gjitha Planet paraprake të Disponueshmërisë të rajonit.
2. Në rastin kur identifikohen papajtueshmëri të ndërprerjeve që ndikojnë planin e disponueshmërisë për asetet relevante, OST do të koordinohet me Agjentet e Planifikimit të Ndërprerjeve në fjalë, OSSH-në dhe/ose OST-të e tjera Koordinatore të Ndërprerjeve për të gjetur një zgjidhje.
3. Pasi të gjendet një zgjidhje për çdo papajtueshmëri të ndërprerjeve, OST do të validojë Planin e Disponueshmërisë të vitit në avancë, për të gjitha elementet relevante të rrjetit në përputhje me procedurën e përcaktuar në Nenin 71(1)(c).

Neni 86. Plani Final i Disponueshmërisë për Vitin në Avancë

1. Para 1 Dhjetorit të çdo viti kalendarik, OST do të:
   a) finalizojë procesin e koordinimit vjetor të Aseteve Relevante; dhe
   b) përditësoje planin paraprak të disponueshmërisë për vitin në avancë, të Aseteve Relevante, në Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operativ të ENTSO-E.
2. Para 1 Dhjetorit të çdo viti kalendarik, për çdo Aset Relevant, OST do t'i konfirmojë Agjentit përkatës të Planifikimit të Ndërprerjeve, planin e disponueshmërisë për vitin në avancë, për këtë Aset Relevant.
3. Para 1 Dhjetorit të çdo viti kalendarik, për çdo Aset Relevant që gjendet në rrjetin e shpërndarjes, OST do t'i sigurojë OSSH-së Planin e përditësuar të Disponueshmërisë për vitin në avancë.
4. Planet e Disponueshmërisë të përmendura në Nenin 86(2) dhe 86(3), duhet të përmbajnë të paktën informacionin e listuar në Nenin 75(4).

Neni 87. Procesi i Koordinimit në rast të identifikimit të Papajtueshmërisë së Ndërprerjeve

1. OST do të drejtojë procesin e koordinimit të Aseteve Relevante në zonën e saj të përgjegjësisë, me të gjithë Agjentët e Planifikimit të Ndërprerjeve të përfshirë në procesin e koordinimit, në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar në fuqi.
2. OST do të përdorë të gjitha mjetet në dispozicion të saj, sipas kuadrit ligjor të aplikueshëm, për të gjetur një zgjidhje për pa-pajtueshmëritë e ndërprerjeve të zbuluara.
3. Ky nen zbatohet për çdo proces të koordinimit që iniciohet në përputhje me zbulimin e pa-pajtueshmërive të ndërprerjeve në bazë të Nenit 85 dhe 88.

Neni 88. Përditësimi i Planit të Disponueshmërisë për vitin në avancë

1. Pas përfundimit të proçesit të koordinimit në përputhje me Nenin 86, dhe para ekzekutimit në kohë reale, të gjithë Agjentet e Planifikimit të Ndërprerjeve do të kenë të drejtë të iniciojnë një përshtatje të Planit të Disponueshmërisë të koordinuar.
2. Çdo Agjent i Planifikimit të Ndërprerjeve që inicion një adaptim të planit të disponueshmërisë të aseteve relevante nën përgjegjësinë e tij, do të dërgojë në OST një kërkesë për ndryshim. OST do të ndjekë procedurën e mëposhtme:
   a) Merr kërkesën për ndryshim;
   b) vlerëson sa më shpejt të jetë praktikisht e arsyeshme, nëse shfaqen papajtueshmëri të ndërprerjeve si rezultat i këtij ndryshimi në Planin e koordinuar të Disponueshmërisë të Aseteve Relevante;
   c) në rastin e zbulimit të pa-pajtueshmërive të ndërprerjeve, inicion një proces koordinimi duke përfshirë OSSH-në dhe gjithë Agjentët e Planifikimit të Ndërprerjeve, për asetet relevante, statusi i disponueshmërisë të të cilave është prekur;

d) nxjerr një vendim të motivuar mbi kërkesën për ndryshim, në fund të proçesit të koordinimit, duke validuar (pranuar) kërkesën për ndryshim, kur nuk ka pa-pajtueshmëri të ndërprerjeve ose nuk mbeten pa-pajtueshmëri të ndërprerjeve pas koordinimit, dhe refuzon kërkesën për ndryshim kur jo të gjitha pa-pajtueshmëritë e ndërprerjeve të diktuara mund të zgjidhen pas koordinimit;
e) inkorporon ndryshimin e vlerësuar në Planin e Disponueshmërisë të koordinuar dhe njofton të gjitha palët e prekura; dhe
f) përditëson ndryshimin e validuar në Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operativ të ENTSO-E.

3. Kur OST inicion një adoptim të Planit të Disponueshmërisë të kordinuar, të elementëve relevantë të rrjetit, do të ndjekë procedurën e mëposhtme:
   a) vlerëson sa më shpejt të jetë e mundur nëse shfaqen pa-pajtueshmëri të ndërprerjeve, si rezultat i këtij ndryshimi në Planin e Disponueshmërisë të koordinuar të Aseteve Relevante;
   b) dërgon një kërkesë për ndryshim në të gjitha OST-të Koordinatore të Ndërprerjeve të Rajonit, dhe raporton për pa-pajtueshmëritë e ndërprerjeve të zbuluara;
   c) merr parasysh pa-pajtueshmëritë e ndërprerjeve shtesë, që bëhen nga OST-të e Rajonit të Koordinimit, në lidhje me kërkesën për ndryshim;
   d) në rastin kur zbulohen pa-pajtueshmëri të ndërprerjeve, inicion një proces koordinimi ku përfshin Agjentët e Ndërprerjeve të Planifikuara, OSSH-në dhe OST-të e Rajonit, për asetet relevante të cilave ju është prekur statusi i disponueshmërisë;
   e) merr një vendim të arsyetuar për kërkesën për ndryshim për të gjitha palët që janë të ndikuara nga përshtatja e Planit të Disponueshmërisë, në fund të proçesit të koordinimit, vlerëson kërkesën për ndryshim kur nuk janë zbuluar pa-pajtueshmëri të ndërprerjeve në fund të proçesit të koordinimit, dhe refuzon kërkesën për ndryshim kur nuk mund të evitohen të gjitha pa-pajtueshmëritë e ndërprerjeve pas koordinimit;
   f) përfshin ndryshimin e vlerësuar në Planin e Disponueshmërisë të koordinuar dhe njofton të gjitha palët e prekura; dhe
   g) përditëson ndryshimin e validuar në Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operativ të ENTSO-E.
4. Në rastin kur OST zbulon së pa-pajtueshmëri të ndërprerjeve, shfaqen në pajtim me Nenin 66(3), atëherë OST do të iniciojë procesin e koordinimit duke përfshirë Agjentët e Planifikimit të Ndërprerjeve, OSSH-në dhe OST-të e Rajonit, për Asetet Relevante, statusi i disponueshmërisë të të cilëve preket.

Neni 89. Detajimi i Statusit Testim të Aseteve Relevante

1. Agjenti i planifikimit të ndërprerjeve të Asetit Relevant për të cilin është deklaruar statusi i disponueshmërisë 'testim', do t'i sigurojë OST-së dhe OSSH-së nëse aseti relevant është i lidhur me rrjetin e shpërndarjes, sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë së një muaj para fillimit të testit, informacionin me:
   a) Një plan testimi të detajuar;
   b) Një skedulim të gjenerimit ose konsumit në varësi të asetit relevant; dhe
   c) Ndryshimet në topologjinë e Sistemit të Transmetimit ose të Rrjetit të Shpërndarjes nëse aseti relevant në fjalë është element relavant i rrjetit.
2. Agjenti i planifikimit të ndërprerjeve të Asetit Relevant për të cilin është deklaruar statusi i disponueshmërisë 'testim', do t'i sigurojë OST-së dhe OSSH-së nëse aseti relevant është i lidhur me rrjetin e shpërndarjes, të dhëna të përditësuara të informacioit të kërkuar në pikën (1) të këtij neni sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur.

3. Informacionin e marrë sipas dy pikave të mësipërme, për asetet relevante që kanë deklaruar statusin e testimit, OST do t'ja bëjë me dije të gjitha OST-ve të Rajonit, bazuar në kërkesën e tyre.
4. Në rast së aseti relevant referuar pikës (1) ose pikës (2) është element relevant i rrjetit që lidh dy zona përgjegjësie, OST-të përkatëse të dy zonave të përgjegjësisë do të koordinojnë me qëllim sigurimin e informacionit në përputhje me pikën(1) ose (2) të këtij neni.

Neni 90. Proceset për Trajtimin e Ndërprerjeve të Detyruara

1. OST do të vendosë dhe menaxhojë një proces koordinimi për të siguruar statusin e disponueshmërisë 'në dispozicion ose jo' për asetet relevante në zonën e saj të përgjegjësisë, në rastin e ndërprerjeve të detyruara dhe nëse rrezikohet siguria operative. Procesi do të:
   a) përdoret vetëm në rastet kur të gjitha përpjekjet për të rënë dakord për një zgjidhje të negociuar kanë përfunduar; dhe
   b) sigurojë, për aq sa të jetë e mundur, që respektohen kufijtë teknike të aseteve relevante.
2. Në rastin e ndërprerjes së detyruar të një aseti relevant, agjenti përkatës i planifikimit të ndërprerjeve, do të informojë OST-në ose OSSH-në në varësi të pikës së lidhjes, sa më shpejt të jetë e mundur për:
   a) shkakun e ndërprerjes së detyruar;
   b) kohëzgjatjen e pritshme të ndërprerjes së detyruar; dhe
   c) nëse mundet, ndikimin e ndërprerjes së detyruar në statusin e disponueshmërisë të aseteve relevante nën përgjegjësinë e tij.
3. Kurdo që OST dikton që një ose disa ndërprerje të detyruara të përmendura në Nenin 90(2) kanë potencial të çojnë Sistemin e Transmetimit jashtë gjendjes normale, OST do të informojë agjentin përkatës për kohën maksimale të mundshme, në të cilën Siguria Operative mund të mbahet pa asetin(et) e çkycur. Agjenti i asetit përkatës do të informojë OST-në për mundësinë e respektimit të kohës së dhënë, ose pa-mundësinë dhe justifikimin për devijimin nga kjo kohë.
4. Pas të gjitha përditësimeve në Planin e Disponueshmërisë për shkak të ndërprerjeve të detyruara, dhe në përputhje me kohën e përcaktuar në (Rregulloren e Transparencës dhe sigurimit të informacionit në tregun e energjisë), OST do të përditësojë me informacionet më të fundit Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operativ të ENTSO-E.

Neni 91. Ekzekutimi i Planit të Disponueshmërisë në kohë reale

1. Çdo pronar/operator i njësive gjeneruese do të sigurojë që njësitë gjeneruese relevante nën përgjegjësinë e tij, të cilat janë deklaruar të disponueshme janë gati të prodhojnë energji në përputhje me kapacitet teknike të tyre kur nevojiten për mbajtjen e sigurisë operative, përveç rasteve të ndërprerjeve të detyruara.
2. Çdo pronar/operator i njësive gjeneruese do të sigurojë që njësitë gjeneruese relevante nën përgjegjësinë e tij, të cilat janë deklaruar të pa-disponueshme, nuk prodhojnë energji.
3. Çdo pronar objekti kërkese do të siguroj që të gjitha objektet e kërkesës nën përgjegjësinë e tij nuk konsumojnë energji elektrike.
4. Çdo pronar i elementeve relevante të rrjetit, do të sigurojë që të gjithë elementet e rrjetit nën përgjegjësinë e tij, që janë të deklaruar të disponueshëm, janë të gatshëm të transmetojnë energji në përputhje me kapacitetet teknike të deklaruara, kur nevojiten për të mbajtur sigurinë operative, përveç rasteve të ndërprerjeve të detyruara.
5. Çdo pronar i elementeve relevante të rrjetit, do të sigurojë që të gjithë elementet e rrjetit nën përgjegjësinë e tij, që janë të deklaruar të pa-disponueshëm, nuk transmetojnë energji.

6. Nëse aplikohen kushte të veçanta të rrjetit, për ekzekutim e një statusi pa-disponueshmërie të elementit relevant të rrjetit, në pajtim me këtë pikë të nenit, OST ose OSSH në varësi të pikës së lidhjes, do të vlerësojnë nëse këto kushte janë përmbushur para ekzekutimit në kohë-reale të stakimit të elementit. Nëse jo, dalja nga puna e elementit nuk ekzekutohet.
7. Me kërkesë të OST-së, para ekzekutimit të stakimit të asetit relevant i cili e vendos Sistemin e Transmetimit jashtë gjendjes normale, çdo palë e përfshirë në manovrime, do të vonojë stakimin e elementit në përputhje me udhëzimet e OST-së për respektimin e limiteve të sigurisë teknike dhe operative.
8. Me kërkesë të OST-së, para ekzekutimit të testit të planifikuar të asetit relevant i cili e vendos Sistemin e Transmetimit jashtë gjendjes normale, çdo palë e inkluduar në manovrime, do të vonojë fillimin e testimit në përputhje me udhëzimet e OST-së për respektimin e limiteve të sigurisë teknike dhe operative.

Neni 92. Parashikimet për vlerësimin e Mjaftueshmërisë

1. OST do të bëjë çdo parashikim që përdoret në analizat e mjaftueshmërisë të zonës së përgjegjësisë në përputhje me Nenin 93 ose 96, të disponueshëm për të gjitha OST-të e tjera nëpërmjet Portalit të të Dhënave të Planifikimit Operativ të ENTSO-E.

Neni 93. Analiza e Mjaftueshmërisë në Zonën e Përgjegjësisë

1. Kur kryhen analiza të mjaftueshmërisë në zonën e përgjegjësisë, OST do të vlerësojë mundësinë e plotësimit të kërkesës totale të vendit, duke konsideruar shumën e gjenerimit me aftësinë importuese ndërkufitare, me skenarë të ndryshëm operacionalë duke marre parasysh nivelin e kërkuar të rezervave të fuqisë aktive, në përputhje me Kapitullin VI të Këtij Kodi.
2. Kur kryhet analiza e mjaftueshmërisë në përputhje me pikën (1) të nenit, OST do të:
   a) përdorë planet më të fundit të disponueshmërisë dhe të dhënat më të fundit të disponueshme për:
      i. aftësinë e njësive gjeneruese në përputhje me Nenin 120(5), Nenin 122 dhe 123 të Kodit, dhe statuset e disponueshmërisë të tyre; dhe
      ii. kapacitetet ndër-kufitare;
   b) marrë në konsideratë:
      i. kontributin e gjenerimit nga burimet e rinovueshme të energjisë; dhe
      ii. kërkesën për energji elektrike;
   c) vlerësoje probabilitetin dhe kohëzgjatjen e mundshme të mungesës së mjaftueshmërisë.
3. Sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur, OST do të informojë:
   a) ERE-në dhe kur është e aplikueshme, çdo palë të ndikuar, kur diktohet mungesa e mjaftueshmërisë brenda zonës së përgjegjësisë; dhe
   b) të gjitha OST-të nëpërmjet Portalit të të Dhënave të Planifikimit Operativ të ENTSO-E, kur gjenerimi brenda zonës së përgjegjësisë është i pamjaftueshëm për të plotësuar kërkesën.

Neni 94. Perspektiva e Mjaftueshmërisë së Gjenerimit dhe Metodologjia

1. OST do të aplikojë metodologjinë e përcaktuar nga ENTSO-E për vlerësimin e perspektivës së mjaftueshmërisë së gjenerimit për periudhat verë – dimër, ku përfshihet:
   a) kriteri i përdorur për të përcaktuar skenarët operacionale nga zona e përgjegjësisë, duke konsideruar probabilitetin e ndodhjes së tyre;
   b) metodën për të vlerësuar mjaftueshmërinë çdo zonë përgjegjësie në përputhje me Nenin 93 duke konsideruar skenarët pan-Evropiane;

c) kapacitetin ndërkufitar për shkëmbimet e energjisë;
d) të dhënat që shkëmbehen ndërmjet OST-ve; dhe
e) kushtet për rishikim të metodologjisë së përcaktuar.

2. OST do të kryejë parashikimin e mjaftueshmërisë së gjenerimit verë – dimër, para 21 Majit dhe 21 Nëntorit të çdo viti respektiv kalendarik.

Neni 95. Mjaftueshmëria e Zonës së Përgjegjësisë për javën në avancë

1. Me kryerjen e parashikimit të mjaftueshmërisë së gjenerimit për stinën përkatëse verë, dimër në përputhje me Nenin 94, për javën në avancë, OST do të monitorojë ndryshimet mbi statusin e disponueshmërisë të njësive gjeneruese, mbi vlerësimin e kërkesës, mbi vlerësimin e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe mbi kapacitetet ndërkufitare.
2. OST do të kryejë një përditësim të vlerësimit të mjaftueshmërisë në zonën e përgjegjësisë në përputhje me Nenin 93, kur i konsideron ndryshimet e vërejtura sipas pikës (1) me lart të këtij neni, të rëndësishme për mbajtjen e nivelit të mjaftueshmërisë.

Neni 96. Mjaftueshmëria e Zonës së Përgjegjësisë në D-1 dhe brenda ditës

1. OST do të kryejë analiza të mjaftueshmërisë në zonën e saj për ditën në avancë dhe brenda ditës, duke përdorur:

   a) Skedulimet e Pjesmarrësve të Tregut;
   b) Parashikimin e Kërkesës;
   c) Parashikimin e Gjenerimit nga Burimet e Energjisë së Rinovueshme;
   d) Rezervat e fuqisë aktive në pajtim me të dhënat e siguruara në përputhje me Nenin 122 të Kodit ;
   e) Kapacitetet ndërkufitare;
   f) Aftësitë e Njësive Gjeneruese në përputhje me të dhënat e siguruara në pajtim me Nenin 120 , 122 dhe 128 të Kodit dhe Statuseve të tyre të Disponueshmërisë; dhe
   g) Aftësitë e Njësive të Kërkesës të menaxhueshme në përputhje me të dhënat e siguruara sipas Nenit 129 dhe 130 të Kodit dhe Statuseve të Disponueshmërisë të tyre.

2. OST do të vlerësojë:

   a) nivelin maksimal të kapacitetit importues dhe eksportues në përputhje me mjaftueshmërinë e Zonës së Përgjegjësisë;
   b) kohëzgjatjen e pritshme të mungesës potenciale të mjaftueshmërisë; dhe
   c) energjinë e pritshme të pafurnizuar në mungesë të mjaftueshmërisë.

3. Nëse mjaftueshmëria nuk përmbushet në përputhje me analizat referuar pikës (1) të këtij neni, OST do të informojë ERE-në dhe autoritetet përkatëse kombëtare, duke i siguruar një analizë të shkaqeve të mungesës së mjaftueshmërisë sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 97. Shërbimet Ndihmëse

1. OST do të monitorojë disponueshmërinë e shërbimeve ndihmëse.
2. Të paktën për Fuqinë Aktive dhe Reaktive, në mënyrë autonome ose të koordinuar me OST-të e tjera, OST do të:

   a) dizenjojë dhe vendosë procedura për prokurimin e shërbimeve ndihmëse;
   b) monitorojë në bazë të të dhënave në pajtim me Nenin 131 të Kodit, nëse niveli dhe vend-ndodhja e kapaciteteve të disponueshme të shërbimeve ndihmëse lejon përmbushjen e kushteve të sigurisë operative;
   c) menaxhon procedurat e dizenjuara në pajtim me Nenin 97(2)(a); dhe

d) përdor të gjitha mjetet e mundshme që kontrollohen nga ajo, për të prokuruar nivelin e kërkuar të shërbimeve ndihmëse.

3. OST do të bëjë publike nivelin e kërkuar të rezervave të fuqisë aktive.
4. Nëse OST do të vendosë të shkëmbejë rezervat e fuqisë aktive me zona të tjera kontrolli, atëherë ajo do të vendosë një ose më shumë procedura në përputhje me Kapitullin VI të këtij Kodi.
5. OST do të komunikojë nivelin e disponueshëm të shërbimeve ndihmëse të fuqisë aktive, me OST-të e tjera, me kërkesë të tyre.

Neni 98. Shërbimet Ndihmëse të Fuqisë Reaktive

1. OST do të vlerësojë në të gjitha stadet e planifikimit operativ, nëse burimet e fuqisë reaktive të disponueshme janë të mjaftueshme për të garantuar sigurinë operative të Sistemit të Transmetimit, në përputhje me Nenin 109 të Kodit .
2. Me qëllim rritjen e eficencës në operimin e elementëve të Sistemit të Transmetimit, OST do të monitorojë:

   a) kapacitetet e disponueshme të fuqisë reaktive të objekteve gjeneruese;
   b) kapacitet e disponueshme të fuqisë reaktive të objekteve të kërkesës të lidhur në sistemin e transmetimit;
   c) kapacitet e disponueshme të fuqisë reaktive të OSSH-së;
   d) pajisjet e disponueshme të lidhura në transmetim të dedikuara për të ofruar fuqi reaktive; dhe
   e) raportin fuqisë aktive dhe reaktive në ndërfaqen midis Sistemit të Transmetimit dhe Rrjetit të Shpërndarjes.

3. Kur niveli i shërbimeve ndihmëse të fuqisë reaktive nuk është i mjaftueshëm për mbajtjen e Sigurisë Operative, OST do të:

   a) informojë OST-të fqinje;
   b) përgatit veprime përmirësuese për aktivizim të tyre në përputhje me Nenin 109 (9) të Kodit.

Neni 99. Krijimi i Proceseve të Skedulimit

1. Për çdo Objekt Gjenerues dhe Kërkese për të cilët zbatohen kërkesat për skedulim në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore rregullatore, pronari/operatori përkatës do të sigurojë që është caktuar një Agjent i Skedulimit. Çdo pjesmarrës Tregu dhe Operator i bashkimit (çiftimit) të Tregut, për të cilët zbatohen kërkesat për skedulim në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore rregullatore, do të caktojnë Agjentin e Skedulimit respektiv.
2. OST do të përcaktojë dispozitat e nevojshme për të procesuar skedulimet e siguruara nga Agjentet e Skedulimit, në pajtim me kornizën rregullatore kombëtare të zbatueshme.
3. Kur një Zonë Skedulimi mbulon më shumë se një Zonë Përgjegjësie, OST-të përgjegjëse për këto Zona Përgjegjësie do të bien dakord së cila prej tyre do të operojë Zonën e Skedulimit.

Neni 100. Njoftimi i Skedulimeve në Zonën e Skedulimit

1. Çdo Agjent Skedulimi brenda Zonës së Skedulimit, përveç Agjenteve të Skedulimit të Operatorit të Bashkimit të Tregut, do t'i paraqesin OST-së Skedulet e mëposhtme:

   a) Skedulet e Gjenerimit;
   b) Skedulet e Konsumit;

c) Skedulet e transaksioneve të brendëshme tregtare; dhe
d) Skedulet e transaksioneve të jashtme tregtare.

2. Çdo Agjent Skedulimi i Operatorit të bashkimit të tregut do t'i paraqesë Skedulimet në OST-të, që operojnë një Zonë Skedulimi të përfshirë në çiftimin e tregut, në pajtim me kornizën ligjore kombëtare të aplikueshme. Këto Skedule përfshijnë:

a) Pozicionin neto në lidhje me Zonën e Skedulimit;
b) Skedulet e transaksioneve të jashtme tregtare, si:
   i. shkëmbime shumëpalëshe ndërmjet Zonës së Skedulimit dhe një grupi tjetër të Zonave të Skedulimit; ose
   ii. shkëmbime dypalëshe ndërmjet Zonës së Skedulimit dhe një Zone tjetër Skedulimi;

   siç kërkohet nga OST-të në fjalë.

c) Skedulet tregtare të brendëshme ndërmjet agjentëve të skedulimit të Operatorëve të çiftimit të tregut dhe agjentëve të skedulimit të Operatorëve të Nominuar të Tregut të Energjisë, nëse kërkohet nga OST-të në fjalë.

3. Para adoptimit të Skedulit të jashtëm të OST-së, të gjitha OST-të e përfshira do të bien dakord për përmbajtjen e një skeduli të tillë të jashtëm të OST-së.

Neni 101. Koherenca e Skedulimeve

1. OST do të zhvillojë dhe zbatojë një proces për të siguruar balancën e brendëshme në zonën e saj, për Skedulet e Gjenerimit, Skedulet e Konsumit, Skedulet e jashtme komerciale tregëtare, dhe Skedulet e jashtme të OST-së.
2. Çdo Agjent Skedulimi i Operatorit të çiftimit të tregut do të ndjekë procesin e përshkruar më lart, dhe do t'i sigurojë OST-ve të inkluduara vlerat e skedulimit të jashtëm komercial tregëtar për çdo Zonë Skedulimi të përfshirë në çiftimin e tregut në formën e skeduleve të jashtme neto, të agreguara.

Neni 102. Ofrimi i informacionit për OST-të e tjera

1. OST do të kalkulojë dhe ofrojë çdo OST-je që e kërkon, informacionin me:

a) Skedulet e jashtme neto të agreguara; dhe
b) Pozicionin neto të zonës AC, kur Zona e Skedulimit është e ndërlidhur me Zonat e tjera të Skedulimit nëpërmjet linjave të transmetimt AC.

2. Kur kërkohen për krijimin e Modeleve të Përbashkëta të Rrjetit, në përputhje me Nenin 64(2), OST do t'i sigurojë OST-ve që e kërkojnë, informacionin me:

a) Skedulet e Gjenerimit; dhe
b) Skedulet e Konsumit.

Neni 103. Dispozita të Përgjithshme për Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operacional të ENTSO-E

1. ENTSO-E do të implementojë dhe administrojë një Portal të Dhënave të Planifikimit Operacional për të ruajtur të gjithë informacionin relevant për planifikimin operativ.
2. OST do të jetë përgjegjëse për siguriminin dhe përditësimin e informacionit përkatës në këtë portal. OST do të ketë akses në të gjithë informacionin që përmban Portali i të Dhënave të Planifikimit Operativ.

Neni 104. Modelet Individuale të Rrjetit, Modelet e Bashkuara të Rrjetit dhe Analizat e Sigurisë Operative.

1. Portali i të Dhënave Operative të ENTSO-E do të ruajë Modelet Individuale të Rrjetit dhe informacionin respektiv relevant për të gjitha horizontet kohore të përcaktuara në këtë Kod .
2. Informacioni mbi Modelet Individuale të Rrjetit në Portalin e të Dhënave të ENTSO-E do të lejojë bashkimin dhe formimin e Modelit të Përbashkët të rrjetit të zonës sinkrone, nëpërmjet përdorimit të Funksionit të Bashkimit.
3. Të gjitha Modelet e Përbashkëta do të bëhen të disponueshme në Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operativ të ENTSO-E.
4. Për periudhën kohore Viti në Avancë, do të bëhet i disponueshëm në Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operativ, informacioni i mëposhtëm:
   a) Përshkrimi i skenarëve të përmendur në Nenin 59;
   b) Modelet Individuale të Rrjetit për viti në avancë dhe për skenarët e përcaktuar në përputhje me Nenin 60; dhe
   c) Modeli i Përbashkët i Rrjetit për vitin në avancë, për skenarët e përcaktuar në Nenin 61.
5. Për horizontet kohore D-1 dhe ndërditore, do të bëhet i disponueshëm në Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operativ, informacioni i mëposhtëm:
   a) Modelet Individuale të Rrjetit për D-1 dhe ndërditore, në përputhje me kohën e detajuar të përcaktuar sipas Nenin 64;
   b) Shkëmbimet e skeduluara në rastet relevante të kohës për Zonën e Skedulimit;
   c) Modelet e Përbashkëta të Rrjetit për D-1 dhe ndërditore në përputhje me detajimin e kohës të përcaktuar sipas Nenit 64; dhe
   d) Një listë e përgatitur dhe rakorduar të Veprimeve Përmirësuese, para dhe pas-avari, e identifikuar për tu përballur me kufizimet ndër-kufitare të Zonës së Përgjegjësisë.

Neni 105. Procesi i Kordinimit të Ndërprerjeve

1. Portali i të Dhënave të ENTSO-E do të ketë një modul për ruajtjen dhe ndarjen e informacionit përkatës për Procesin e Kordinimit të Ndërprerjeve.
2. Ky informacion do të përfshijë së paku:
   a) Statusin e Disponueshmërisë të Elementeve Relevante të Rrjetit së paku informacionin e përshkruar në përputhje me Nenin 75(4);
   b) Statusin e Disponueshmërisë të Njësive Gjeneruese Relevante; dhe
   c) Statusin e Disponueshmërisë të Objekteve Relevante të Kërkesës, si dhe kohën e ndërprerjes, kushtet specifike për kryerjen e ndërprerjeve dhe kohën e kërkuar për të rivendosur shërbimin, nëse është e nevojshme për të mbajtur Sigurinë Operative.

Neni 106. Mjaftueshmëria e Sistemit

1. Portali i të Dhënave të Planifikimit Operativ të ENTSO-E do të ruajë të gjithë informacionin relevant për analizat e kordinuara të Mjaftueshmërisë.
2. Ky informacion do të përfshijë së paku:
   a) të dhënat e mjaftueshmërisë së sistemit për stinën në avancë, të siguruara nga çdo OST;
   b) raport të analizës së mjaftueshmërisë të zonës sinkrone Evropiane, për stinën në avancë;
   c) parashikimet e përdorura për mjaftueshmërinë në linjë me Nenin 92; dhe
   d) informacion për mungesë të mjaftueshmërisë në pajtim me Nenin 93(3)(b).

Neni 107. Treguesit e Performancës

1. OST do të kontribuojë në raportin vjetor të zhvilluar në përputhje me shkallën e përbashkët të klasifikimit të incidenteve, të adoptuar nga ENTSO-E .
2. Ky raport do të përfshijë rezultatet e monitorimit të kualitetit të Indikatorëve të mëposhtëm të Performancës, relevante për planifikimin operativ:

   a) Indikatori OPS 1A – një tregues për numrin e ngjarjeve në të cilat një incident i përfshirë në listën e kontingjencave ka çuar në degradim të kushteve të operimit të sistemit;
   b) Indikatori OPS 1B – një tregues për numrin e ngjarjeve të konsideruara nga OPS 1A në të cilat një degradim i kushteve të operimit të sistemit, ka ndodhur si rezultat i mos-përputhjes së papritur të parashikimit të Kërkesës ose të Gjenerimit;
   c) Indikatori OPS 2A – një tregues për numrin e ngjarjeve në të cilat ka pasur një degradim në kushtet e operimit të sistemit, për shkak të një kontingjence jashtë rangut;
   d) Indikatori OPS 2B - një tregues për numrin e ngjarjeve të konsideruara nga OPS 2A në të cilat një degradim i kushteve të operimit të sistemit, ka ndodhur si rezultat i mos-përputhjes së papritur të parashikimit të Kërkesës ose të Gjenerimit; dhe
   e) Indikatori OPS 3 – një tregues për numrin e ngjarjeve që kanë çuar në degradim të kushteve të operimit të sistemit për shkak të mungesës së rezervave të fuqisë aktive.

3. Për OPS 1A, OPS 1b, OPS 2A, OPS 2B dhe OPS 3, treguesi do të regjistrojë vetëm ngjarjet që çojnë në degradim të kushteve të operimit të sistemit, të renditur si Shkalla e 1, Shkalla 2, ose Shkalla 3, në përputhje me Shkallët e Sigurisë Operative të përcaktuara në Nenin 132(3) të Kodit.

KAPITULLI V

KODI I SIGURISË SË OPERIMIT

Neni 108. Subjekti dhe fushëveprimi

1. Kodi i Sigurisë së Operimit përcakton kërkesat dhe parimet minimale për sigurinë operative, nevojat teknike për sigurinë e punës në kohë reale, sigurinë e furnizimit dhe arritjen e qëllimit kryesor për të mbajtur në operim të vazhdueshëm Sistemin Transmetues Shqiptar të ndërlidhur me Sistemin Evropian të Transmetimit (zona sinkrone e Evropës Kontinentale).
2. OST menaxhon dhe ushtron përgjegjësitë e saj bazuar në kërkesat dhe parimet e sigurisë operative duke garantuar funksionimin e Sistemit në nivel të lartë të koordinimit, besueshmërisë, cilësisë dhe stabilitetit.
3. Kodit i Sigurisë së Operimit përcakton kuadrin teknik të harmonizuar dhe të qëndrueshëm, duke përfshirë zbatimin e të gjitha proceseve të nevojshme të kërkuara për sigurinë e operimit, duke marrë parasysh sistemin aktual dhe pritshmëritë për rritjen e shpejtë të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe ndikimin e tyre në operimin e Sistemit.
4. Kodi i Sigurisë së Operimit është i detyrueshëm për të gjithë pjesmarrësit në tregun e energjisë elektrike, si në situata normale ashtu edhe në ato emergjente. Me tej, Kodi identifikon dispozitat e përgjithëshme relevante me situatën Emergjente, Rënie të Sistemit, Restaurimin dhe koordinimin e sistemit operativ në një mënyrë të përbashkët dhe koherente në gjithë zonën sinkrone.
5. Për qëllim të këtij Kodi, OST do ti klasifikojë modulet e gjenerimit sipas tipit "me pikëlidhje në rrjetin e shpërndarjes" dhe "me pikëlidhje në rrjetin e transmetimit" .
   Njësitë e Kërkesës (Konsumit) do të klasifikohen sipas kritereve të përcaktuara në ENTSO-E. Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit, në kontekstin e këtij Kodi janë:
   a) Modulet ekzistuese dhe të reja Gjeneruese të tipit "me pikëlidhje në rrjetin e shpërndarjes " dhe të tipit " me pikëlidhje në rrjetin e transmetimit" sipas kritereve të ENTSO-E.
   b) Objektet ekzistuese dhe të reja të Kërkesës të lidhura në rrjetin e Transmetimit në bazë të kritereve të përcaktuara nga ENTSO-E dhe të gjitha objektet (e mëdha) ekzistuese dhe të reja të lidhur në rrjetet e shpërndarjes;
   c) Objektet Konsumatore të konsiderueshme dhe Agregatorët , në rastin kur ata ofrojnë menaxhim të ngarkesës direkt me OST;
   d) Agregatorët Ridispecues dhe ofruesit e fuqisë aktive rezervë sipas kapitullit VI të këtij Kodi.
6. Në zbatimin e kërkesave teknike dhe të tjera të përcaktuara në këtë Kod, OST duhet të jetë në përputhje me praktikat më të mira të industrisë.

Neni 109. Gjendjet e Sistemit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit gjatë operimit në kohë reale duhet të dallojë 5 gjendje të sistemit, bazuar në limitet e sigurisë operative sipas Nenit 111 dhe 113, duke respektuar analizën e kontingjencave sipas Nenit 114 dhe menaxhimin e frekuencës sipas Nenit 110. Sa më sipër Operatori Sistemit të Transmetimit do të aplikojë kriteret e mëposhtme për klasifikim:
   a) Gjendje Normale:

i. Tensioni dhe flukset e fuqisë janë brenda limiteve të sigurisë operative të përcaktuara në Nenin 111 dhe 113 në përputhje me Nenin 109(5) dhe frekuenca është brenda kufijve të frekuencës për gjendjen normale siç definohet në Kodin për Rregullimin Fuqi-Frekuence dhe Rezervat;
ii. Rezervat e fuqisë aktive dhe reaktive janë të mjaftueshme për të përballuar kontingjencat që bëjnë pjesë në listën e kontingjencave të përcaktuar sipas Nenit 114;dhe
iii. Operimi i zonës së vet të përgjegjësisë është dhe do të mbetet në limitet e sigurisë operative edhe pas një kontingjente të përcaktuar në listën e kontingjencave sipas Nenit 114 dhe pas efektit të veprimeve përmirësuese.

b) Gjendje Alarmi
i. Tensioni dhe flukset e fuqisë janë në limitet e sigurisë operative të përcaktuar në Nenet 111 dhe 113 në përputhje me Nenin 109(5); dhe
ii. Të paktën një nga kriteret e mëposhtme plotësohet:
a) Kërkesat e rezervës së fuqisë aktive nuk plotësohen në mungese të më shumë së 20% të sasisë së kërkuar të: rezervës primare (FCR), ose sekondare (FRR), ose terciare (RR) sipas dimensionimit në Nenin 165,168 dhe 170 për më shumë së 30 min. dhe pa asnjë mënyrë për ti zëvendësuar;
b) Frekuenca është brenda kufijve të lejuar për gjendjen e alarmit të përcaktuar në Nenin 148;
c) Të paktën një rast në listën e rasteve të përcaktuar sipas Nenit 114 mund të sjelle devijime nga limitet e sigurisë operative edhe pas efekteve të veprimeve përmirësuese.

c) Gjendja Emergjencës:
i. ka të paktën një devijim nga limitet e lejuara të sigurisë operative dhe kohës të përcaktuar në Nenin 111 dhe 113 në përputhje me Nenin 109(5); ose
ii. frekuenca është jashtë kufijve të lejuar të frekuencës për gjendjen normale dhe jashtë kufijve të lejuar të frekuencës për gjendjen e alarmit siç përcaktohet në Kodin e Kontrollit Fuqi Frekuence; ose
iii. të paktën një masë e planit të mbrojtjes është aktivizuar; ose
iv. ka një humbje të plotë të gjithë mjeteve të përcaktuara sipas në pikën (15) të këtij neni për me shume së 30 min.

d) Gjendja e rënies së plotë të sistemit (black-out):
i. Humbje e me shume së 50% të ngarkesës në zonën e përgjegjësisë të OST; ose
ii. Mungesë totale e tensionit për të paktën 3 min. në zonën e përgjegjësisë të OST dhe aktivizim i masave të rivendosjes.

e) Rivendosja:
i. Implementohen procedura që të sjellin frekuencën, tensionin dhe parametra të tjerë operacionalë brenda limiteve të lejuara të sigurisë operative të përcaktuar në Nenin 110, 111 dhe 113 në përputhje me Nenin 109(5); dhe
ii. Përdoruesit lidhen me rrjetin sipas urdhërave dhe renditjes të përcaktuar nga OST, në varësi të aftësive teknike dhe fizibilitetit të aseteve të rrjetit të transmetimit dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit të cilët janë gjenerues.

Në mënyrë që të përcaktohet gjendja e Sistemit, OST do të kryejë në kohë reale analizën e kontingjencave, të paktën çdo 15 min, duke monitoruar parametrat përkundrejt kritereve dhe kushteve të përcaktuara sipas Nenit 109(1), duke marre parasysh efektet e masave përmirësuese dhe masat e planit të mbrojtjes së Sistemit.

3. OST do të monitorojë në kohë reale parametrat e mëposhtëm në zonën e përgjegjësisë duke u bazuar në telemetrinë dhe matjet në kohë reale në zonën e saj të observimit, duke marrë parasysh të dhënat strukturore dhe në kohe reale të përcaktuara nga Neni 117 deri 130:

   a) Flukset e fuqisë aktive dhe reaktive;
   b) Tensionin në zbara;
   c) Frekuencën dhe gabimin e kontrollit të rivendosjes së frekuencës në zonën e vet të LFC;
   d) Rezervën e fuqisë aktive dhe reaktive; dhe
   e) Gjenerimin dhe konsumin.

4. OST do të përdorë të gjitha mjetet e mundshme me evidencë ekonomike në mënyrë që të mbajë sistemin e transmetimit në gjendje normale. Për këtë arsye OST do të planifikoje veprime përmirësuese në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Planifikimit dhe Skedulimit të detajuara nga Neni 57 deri 117 dhe t'i implementojë ato kur është e nevojshme, në linjë me parashikimet e pikës (12) të këtij neni.
5. Për çdo element të sistemit të transmetimit, përpara vendosjes në punë, OST do të përcaktojë limitet e sigurisë operative:

   a) Limitet e tensionit sipas Nenit 111
   b) Limitet e rrymës së lidhjes shkurtër sipas Nenit 112; dhe
   c) Limitet e rrymës në përputhje me limitin termik duke përfshirë dhe mbingarkesën e lejuar tranzitore.

6. Në përcaktimin e limiteve të sigurisë operative, OST do të marrë parasysh aftësitë e kërkuara për përdoruesit e rëndësishëm, si nga ana e gjenerimit ashtu edhe nga ana e kërkesës, në mënyrë që tensioni dhe frekuenca të jenë brenda diapazoneve të gjendjes normale dhe asaj të alertit duke mos sjellë stukimin e tyre.
7. Në rastin e ndryshimeve të ndonjë pajisje apo elementi të sistemit të transmetimit OST do të vali dojë dhe përditësojë aty ku lind nevoja limitet e sigurisë operative.
8. Për çdo interkonektor OST do të koordinojë me OST-në tjetër përkatëse për përcaktimin e limiteve të sigurisë operative duke përfshire: limitet e rrymës në përputhje me limitin termik, mbingarkesën e lejuar tranzitore dhe diapazonet e tensionit të përcaktuar sipas Nenit 111 (12).
9. Gjatë operimit në kohë reale, n.q.s. Sistemi i Transmetimit ndodhet në gjendje alarmi, OST do të koordinojë me OST-të fqinje me të cilat ka marrëveshje disa palëshe, me Operatorin e Shpërndarjes dhe përdoruesit e rëndësishëm të lidhur direkt në sistemin e transmetimit:

   a) Implementimin e masave përmirësuese para-avari të cilat janë të nevojshme për rikthimin në gjendje normale dhe për të parandaluar përhapjen e gjendjes së alarmit jashtë kufijve të përgjegjësisë; dhe
   b) Identifikimin e masave korigjuese pas-avari të cilat duhen implementuar në rastin e kontingjencave.

10. Gjatë operimit në kohë reale, n.q.s. Sistemi i Transmetimit ndodhet në gjendje emergjence, OST do të koordinojë me OST-të fqinje me të cilat ka marrëveshje, me Operatorin e Shpërndarjes dhe përdoruesit e rëndësishëm të cilët janë të përfshirë në planin e mbrojtjes dhe të rivendosjes, implementimin e masave të planit të rivendosjes të cilat janë të nevojshme për rikthimin e sistemit në gjendje alarmi ose normale, dhe për të parandaluar përhapjen e gjendjes së emergjencës jashtë zonës së saj të përgjegjësisë.
11. Gjatë operimit në kohë reale, n.q.s. Sistemi i Transmetimit nuk është në gjendje normale dhe gjendja e tij klasifikohet si e mundshme për tu zgjeruar më tej kufijve, atëherë OST duhet të:

a) Informojë të gjitha OST-të për gjendjen e sistemit të saj të transmetimit nëpërmjet një instrumenti IT për shkëmbim informacioni në nivel pan-Evropian;
b) Të japë informacione shtesë për elementet e sistemit të transmetimit të cilët janë pjesë e zonës së observueshme të OST-ve të tjera përkatëse; dhe
c) Koordinojë masat korigjuese me OST-të me të cilat ka marrëveshje disa palëshe në përputhje me Nenin 69 të Kodit.

12. Gjatë operimit në kohë reale ose gjatë planifikimit operativ, gjatë përgatitjes dhe implementimit të masave përmirësuese duke përfshirë dhe ri-dispecerimin ose ri-shkëmbimin ndërmjet dy zonave, ose një masë nga plani i rivendosjes i cili ka ndikim në OST-të e tjera, OST duhet të bashkëpunojë me OST-të e tjera që të vlerësojë impaktin e masave përmirësuese ose masës të planit të rivendosjes brenda dhe jashtë zonës së përgjegjësisë së saj dhe të koordinojë me OST-të me të cilat ka marrëveshje disa palësh në përputhje me Nenin 69 të Kodit.
13. Gjatë përgatitjes së masave përmirësuese, duke përfshirë ri-dispecerimin, ri-shkëmbimin ose një masë nga plani i mbrojtjes, në rast të implikimeve reciproke, OST do të bashkëpunojë me Operatorin e Shpërndarjes dhe përdoruesit e rëndësishëm që janë të lidhur në sistemin e transmetimit. Paraprakisht, OST do të bashkëpunojë me Operatorin e Shpërndarjes të përfshirë në masat korigjuese ose në masën e planit të mbrojtjes, për të vlerësuar impaktin e masave korigjuese në rrjetin e shpërndarjes, dhe do të bashkëpunojë me Operatorin e Shpërndarjes në përzgjedhjen e masave korigjuese dhe masën e planit të mbrojtjes i cili përmirëson sigurinë operative për të gjitha palët e përfshira. Operatori i Shpërndarjes do të japë të gjithë informacionin e nevojshëm për këtë bashkëpunim.
14. Gjatë implementimit të masave përmirësuese ose të një mase të planit të mbrojtjes, Operatori i Shpërndarjes dhe çdo përdorues i rëndësishëm me pikë lidhje në Sistemin e Transmetimit duhet të ekzekutojnë pa vonesa instruksionet e dhëna nga OST për të mbajtur sigurinë operative të sistemit të transmetimit. Në qoftë së OST nuk instrukton përdoruesin e rëndësishëm të lidhur me rrjetin e shpërndarjes, atëherë Operatori i Shpërndarjes do t'i komunikojë përdoruesit të rëndësishëm, instruksionet e OST-së.
15. OST do të përgatisë/projektojë sistemin e saj në mënyre që të sigurojë disponueshmërinë, besueshmërinë dhe redundancën për elementet e mëposhtëm, të cilat janë të nevojshëm për operimin e Sistemit:

a) Pajisje për monitorimin e gjendjes së sistemit të transmetimit, duke përfshirë dhe aplikacione për vlerësimin e tij;
b) Pajisje për kontrollin e elementeve komutues;
c) Pajisje për komunikimin me qendrat e tjera dispeçer të OST-ve fqinje;
d) Aplikime për analizën e sigurisë operative.

Operatori i Shpërndarjes dhe përdoruesit e rëndësishëm të cilët janë të përfshirë në balancim, shërbime ndihmëse, planin e mbrojtjes, planin e rivendosjes ose dërgimin e të dhënave në kohe reale sipas Nenit 121, 124, 127, 128, 129, dhe 130, OST, OSSH dhe përdoruesit e rëndësishëm do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë për sigurimin e disponueshmërisë, besueshmërinë dhe redundancën e pajisjeve dhe aplikacioneve të mësipërme.

16. OST do të adaptojë një plan biznesi për vazhdueshmërinë e operimit të pajisjeve ose aplikacioneve kritike, duke parashikuar mirëmbajtjen, zëvendësimin dhe zhvillimin e pajisjeve dhe aplikacione kritike. Ky plan do të rishikohet të paktën një herë në vit dhe do të përditësohet sipas nevojës ose duke qenë në linjë me ndryshimet në pajisjet, aplikacionet dhe

kushtet e operimit të Sistemit. Plani do t'i bëhet i njohur dhe do të kooperohet me OSSH dhe përdoruesit e rëndësishëm, deri në masën që ata janë të përfshirë.

17. OST do të përgatisë një plan konfidencial sigurie që përmban një vlerësim të riskut të aseteve kritike në zotërim ose në operim nga OST, përfshirë skenarë të riskut fizik ose kibernetik bashkë me një vlerësim të impakteve të mundshme. OST do të ketë të organizuar logjistikën dhe masa të tjera fizike të cilat mbulojnë rezultatet e vlerësimit të riskut. Plani duhet të rishikohet në mënyrë të rregullt për të kufizuar impaktin e rreziqeve dhe për të siguruar operimin e rrjetit të OST-së, të sistemeve IT të saj, dhe lidhjen me rrjetin Evropian të transmetimit. Këto rishikime mund të çojnë në ngritjen e procedurave për kontroll të aksesit, trajnime, procese alarmi, procedura parandaluese, plane rivendosje dhe kundër masa të tjera.

Neni 110. Menaxhimi frekuencës

1. OST do të kontribuojë në strukturën e kontrollit fuqi-frekuencë sipas kërkesave për kualitetin e frekuencës duke përcaktuar parametrat dhe kushtet për rezervat e fuqisë aktive siç jepen në Kapitullin VI të këtij Kodi.
2. Në rastet kur frekuenca është jashtë kufijve të devijimit të qëndrueshëm të frekuencës, por brenda diapazonit 49 - 51 Hz, si të gjitha OST-të e zonës sinkrone, OST do të aplikojë veprime përmirësuese në vazhdimësi të procedurave të koordinuara ndërmjet OST-ve të zonës sinkrone në mënyrë që të rikthehet frekuenca brenda diapazonit të kufijve të devijimit të qëndrueshëm.
3. Në rastet kur frekuenca është jashtë diapazonit 49 – 51 Hz, OST do të aplikojë masa të planit të mbrojtjes në vazhdimësi të procedurave të koordinuara ndërmjet OST-ve të zonës sinkrone në mënyrë që të rikthehet frekuenca brenda afateve të kohës të koordinuar.
4. Përdoruesit e rëndësishëm gjenerues duhet të qëndrojnë të lidhur me rrjetin, të paktën brenda diapazoneve të frekuencës dhe kohës të përcaktuar si më poshtë :
   - pa kufizim kohe në frekuencë nga 49.0 Hz-51.0Hz;
   - jo me pak se 30 minuta për frekuencë nga 47.5Hz- 48.5Hz;
   - për frekuence nga 48.5 – 49 Hz të qëndrojnë të lidhur me rrjetin, por jo më pak se koha për 47.5 Hz – 48.5 Hz;
   - 30 minuta për frekuencë nga 51.0Hz-51.5Hz
5. Duke qenë në gjendje emergjence, frekuenca e sistemit mund të tejkalojë diapazonin 49 – 51 Hz., OST duhet të marrë në konsideratë që përdoruesit e rëndësishëm mund të stakohen nga rrjeti pas periudhave kohore të përcaktuara më lart duke marrë parasysh planifikimin e masave korigjuese dhe masave të planit të rivendosjes.
6. Çdo përdorues i rëndësishëm me pikë lidhje direkt me sistemin e transmetimit do të adoptojë kritere dhe kushte (rregulla operimi) duke përfshirë kërkesat për leje për tu ri – sinkronizuar, të përcaktuara nga OST për ri-sinkronizim. Ri-sinkronizimi mund të bëhet vetëm me miratimin e Operatorit të Sistemit në QDS.
7. Operatori i Shpërndarjes do të adoptojë kritere dhe kushte (rregulla operimi) duke përshirë kërkesat për leje për tu ri-sinkronizuar, të përcaktuara nga OST për ri-sinkronizim të përdoruesit të rëndësishëm me pikë lidhje në rrjetin e tij të shpërndarjes. Gjithashtu, Operatori i Shpërndarjes duhet të sigurojë që kriteret dhe kushtet janë rënë dakort me përdoruesit e rëndësishëm me pikë lidhje direkt në rrjetin e shpërndarjes.
8. Operatori i Shpërndarjes duhet që në mënyrë automatike të shkëputet nga rrjeti në vlera të caktuara të frekuencës me hapa të paracaktuara të fuqisë aktive, të përcaktuara nga OST.

Gjithashtu, gjeneruesit në mënyrë automatike duhet të shkëputen nga rrjeti në vlera të caktuara frekuence, të përcaktuara nga OST.

9. OST duke u mbështetur në parashikimet e pikave të mësipërme 110(6), 110(7) dhe 110(8) do të koordinojë veprimet përmirësuese që janë të lidhura me frekuencën, duke bashkëpunuar me OST-të e zonës sinkrone dhe duhet të sigurojë koordinimin e nevojshëm me Operatorin e Shpërndarjes.
10. OST do të operojë zonën e vet të rregullimit fuqi-frekuencë me rezerve aktive të mjaftueshme për të dy drejtimet, rritje dhe ulje, e cila mund të përfshijë rezervë të ndarë ose të shkëmbyer me OST-të fqinje, në mënyrë që të përballohen disbalancat kërkesë / furnizim brenda zonës së rregullimit fuqi-frekuencë. OST do të kontrollojë gabimin e kontrollit të rivendosjes së frekuencës sipas përcaktimit në Kapitullin VI të këtij Kodi në mënyrë që të arrihet cilësia e kërkuar e frekuencës brenda zonës sinkrone në bashkëpunim me OST-të e zonës sinkrone.
11. OST do të monitorojë në kohë reale gjenerimin, skedulet e shkëmbimit, flukset e fuqisë, injektimet dhe tërheqjet në pikat nyje dhe parametrat e tjerë në zonën e vetë të rregullimit fuqi-frekuencë të cilat janë relevante për të parandaluar devijimet e frekuencës dhe kur është e nevojshme të merren masa të përbashkëta për të limituar efektet negative në balancën ndërmjet gjenerimit dhe kërkesës në koordinim me OST-të e tjera të zonës sinkrone.
12. OST do të aktivizojë, ose të përgatisë kushtet e nevojshme për të siguruar aktivizimin e rezervës së fuqisë aktive në periudha kohore të përcaktuara sipas kapitullit VI të këtij Kodi në mënyrë që të mbajë:

    a) Shkëmbimin e skeduluar të fuqisë aktive në zonën e vetë të rregullimit fuqi-frekuence,
    b) Frekuencën e sistemit dhe gabimin e kontrollit të rivendosjes së frekuencës.

13. Në rast të shkëmbimit të skeduluar ose ndarjes së rezervës, OST-ja dhënëse, ajo marrëse dhe ajo tranzituese (kur është rasti) duhet të kryejnë një analizë operative të sigurisë dhe të adaptojnë masat e nevojshme për të siguruar që flukset e fuqisë nuk rrezikojnë limitet e sigurisë operative, gjatë shkëmbimit të rezervave ose aktivizimit të rezervës.
14. OST ka të drejtë të përdorë masa shtesë për të rritur cilësinë e frekuencës së sistemit sipas dispozitave të Kodit të Rregullimit Fuqi-Frekuencë dhe Rezervave.

Neni 111. Kontrolli i Tensioni dhe Menaxhimi i Energjisë Reaktive

1. Kushtet e tensionit në sistemin e transmetimit janë të lidhura direkt me situatën e energjisë reaktive në nyjet e sistemit. Për të kompensuar për një konsum të tepërt të energjisë reaktive, OST duhet të sigurohet që prodhuesit më efikase dhe efektive të gjenerojnë/absorbojnë mjaftueshëm energji reaktive, përveç fuqisë reaktive nga burime të tjera të instaluara në Sistemin e Transmetimit ose në Objektet e Kërkesës. OST duhet të sigurojë gjithashtu një ekuilibër të vazhdueshëm dhe lokalisht të mjaftueshëm të fuqisë reaktive, që të jetë në gjendje për të ruajtur nivelet e duhura të tensionit. Në këtë kontekst, qëllimi i kontrollit të tensionit dhe të menaxhimit të energjisë reaktive është për të siguruar që:

    a) Nivelet e tensionit, flukset e energjisë reaktive dhe burimet e energjisë reaktive monitorohen, kontrollohen dhe mbahen në kohë reale brenda kufijve të Sigurisë Operative, me qëllim mbrojtjen e pajisjeve të Sistemit të Transmetimit dhe sigurimin e stabilitetit të tensionit;
    b) Rezerva adekuate e menjëhershme e fuqisë reaktive është në dispozicion në gjeneratorët në punë, në reaktorët dhe kapacitorët, në mënyrë që të sigurojë funksionimin teknik të gjithë sistemit energjetik, dhe të jetë në gjendje për të rivendosur gjendje normale pas avarive.

Për këtë qëllim, është vendosur të bëhet monitorim permanent on-line dhe i shkëmbimit të informacionit që realizohet nga OST-të në zonat përkatëse të observimit.
Në përputhje me Nenin 109(4), OST do të përdorë të gjitha mjetet e mundshme të disponueshme dhe ekonomikisht efikase, nën kontrollin e saj për të ruajtur nivelin e tensioneve në gjendje të qëndrueshme brenda kufirit të Limitit të Sigurisë Operative të Sistemit të Transmetimit, si në gjendje normale ashtu edhe pas ndodhjes së një kontingjence, siç është specifikuar në tabelën e mëposhtme, në linjë me standartin e zonës sinkrone të Evropës Kontinentale.

Niveli i tensionit	Diapazoni i lejuar i luhatjes	Kohëzgjatja
110 dhe 220 kV	0.90 pu – 1.118 pu	Pa limit
400 kV	0.90 pu – 1.05 pu	Pa limit

Për nivelet e tensioneve poshtë 110 kV, OST do të rakordohet për zbatueshmërinë e kufirit të tensionit me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Përdoruesit e Rrjetit të lidhur direkt në Sistemin e Transmetimit.

2. OST mund të pajtohet me një diapazon më të gjerë të tensionit ose limitimin e kohës së operimit në pikat e lidhjes së OSSH dhe Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit, duke respektuar dispozitat e Nenit 109(8).
3. Gjeneruesit e tipit " me pikëlidhje në transmetim" do të qëndrojnë të lidhur të paktën brenda kufijve të tensionit dhe kufizimit të kohës , të përcaktuar nga OST ne funksion të sigurisë operacionale. Gjeneruesit e tjerë të lidhur në rrjetin e transmetimit do të deklarojnë në OST, aftësinë e tyre të diapazonit të tensionit dhe kohëzgjatjen që ata janë në gjendje të operojnë të lidhur me rrjetin. OST mund të kërkojë ndryshime të aftësisë së këtyre njësive gjeneruese, nëse kjo është e nevojshme për ruajtjen e Sigurisë Operative .
4. Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit që janë objekte konsumatore, nuk do të shkëputen nga rrjeti për shkak të një shqetësimi, brenda kufijve të tensionit si me poshtë:

   - pakufizim kohe per tension nga 0.9 pu-1.05pu;
   - sipas afatit të përcaktuar ne bashkëpunim me OST fqinje per tension nga 1.05 pu – 1.0875 pu,
   - per 60 minuta per tension nga 1.0875 pu deri 1.10 pu

   Të gjithë Përdoruesit e tjerë ,objekte konsumatore, do të informojnë OST-në në lidhje më aftësitë e tyre në lidhje me kërkesat ndaj qëndrueshmërisë së tensionit duke deklaruar në këtë mënyrë diapazonin e tensionit dhe kohën që mund të përballojnë pa u stakuar nga rrjeti. OST mund të kërkojë ndryshime të aftësisë së këtyre objekteve, nëse kjo është e nevojshme për ruajtjen ë Sigurisë Operative .

5. Nëse tensioni në një Pikë Lidhjeje në Sistemin e Transmetimit është jashtë kufirit të treguar në tabelë, OST do të aplikojë kontrollin e tensionit dhe menaxhimin e fuqisë reaktive në mënyrë që të rivendoset tensioni brenda kufijve të tabelës dhe afatit të kërkuar sipas pikes 3 dhe 4 të këtij neni.
6. Në Gjendje Emergjente, në qoftë së tensionet në pikat e lidhjes së gjenerueve të tipit " me pikëlidhje në Transmetim" tejkalojnë kufijtë e tabelës, OST do të ketë parasysh se përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit mund të shkëputen pas afatit të kërkuar ne piken 3 dhe 4 të këtij neni

7. Për përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit që nuk janë subjekt të pikave të mësipërme , OST do të ketë parasysh në Analizën e Sigurisë Operative vlerat e tensionit në të cilën secili prej përdoruesve të rëndësishëm mund të shkëputet nga rrjeti.
8. OST do të implementojë dispozitat e Nenit 111(1) dhe 111(7), në mënyrë të koordinuar në nivelin e Zonës Sinkrone ku është e lidhur.
9. OST do të sigurojë rezervën e fuqisë reaktive, në volum të mjaftueshëm dhe reagim në kohë, në mënyrë që të mbajë tensionin në zonën e përgjegjësisë brenda Limitit të Sigurisë Operative, në kufijtë e treguar në tabelë.
10. Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit që janë objekte konsumatore, në mënyrë automatike ose manuale, duhet të shkëputen nga rrjeti në tensione të specifikuara dhe në afat kohor të përcaktuar nga OST ose nga OSSH, nëse objekti është i lidhur në rrjetin e shpërndarjes. OST duke zbatuar këtë dispozitë do të respektojë marrëveshjen e saj shumë–palëshe të konkluduar në pajtim me Nenin 69 të Kodit si dhe do të sigurojë koordinimin me përfshirjen e OSSH-së.
11. Në përputhje me Nenin 109(8), OST në bashkëpunim me OST-të e ndërlidhura, do të përcaktojë tensionet dhe/ose limitet e fluksit të fuqisë reaktive në këto interkoneksione, në mënyrë që të përdorë burimet e energjisë reaktive në mënyrë sa më efektive si dhe për të siguruar kontrollin adekuat të tensionit.
12. OST do të koordinojë Analizën e Sigurisë Operative me OST-të e tjera në përputhje me marrëveshjen shumë-palëshe të konkluduar në përputhje me Nenin 69 në mënyrë që të sigurojë respektimin e Limiteve të Sigurisë Operative të tensionit në kufijtë e zonës si dhe brenda zonës së përgjegjësisë.
13. OST do të përcaktojë pikat e punës të fuqisë reaktive, diapazonin e faktorit të fuqisë dhe pikat e punës të tensionit, për të bërë kontrollin e tensionit , të cilat do të mbahen nga Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit ose nga OSSH, duke respektuar dispozitat e Nenit 109(13). Nga ana tjetër OSSH do të jetë në gjendje të përcaktojë udhëzimet e kontrollit të tensionit për Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit të lidhur me Rrjetin e Shpërndarjes në mënyrë që të respektojë udhëzimet e OST-së.
14. OST ka të drejtë të përdorë të gjitha resurset e Fuqisë Reaktive në Pikat e Lidhjes me Sistemin e Transmetimit, për të siguruar një menaxhim efektiv të Fuqisë Reaktive dhe mirëmbajtjen e tensioneve brenda limiteve të sigurisë së operimit të përcaktuara në këtë Kod .
15. OST do të operojë ose drejtojë veprimin e burimeve të fuqisë reaktive në zonën e saj të përgjegjësisë, përfshirë bllokimin e kontrollit automatik të tensionit/kontrollin e fuqisë reaktive të transformatorëve, në mënyrë për të ruajtur Limitet e Sigurisë Operative dhe për të parandaluar kolapsin e tensionit të Sistemit të Transmetimit.
16. OST do të koordinojë dhe përcaktojë veprimet e kontrollit të tensionit me OSSH, Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit me pikë lidhje direkte me Sistemin e Transmetimit dhe me OST-të fqinje. OST në koordinim me OSSH do të drejtojnë Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit të lidhur në rrjetin e shpërndarjes, për veprimet e tyre në ndjekje të udhëzimeve të kontrollit të tensionit, nëse kjo është e rëndësishme për tensionin dhe menaxhimin e fuqisë reaktive të Sistemit të Transmetimit.
17. OST do të mbajë kufijtë e tensionit, dhe OSSH dhe Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit që janë objekte konsumi do të mbajnë faktorin e fuqisë ose fuqinë reaktive në pikat e lidhjes, në kufijtë e specifikuar në Nenin 111(13) .
18. Nëse përkeqësimi i tensionit rrezikon sigurinë e operimit ose kërcënon të zhvillohet në kolaps tensioni, si në situatën N ose në atë (N-1), OST ka të drejtë të instruktojë OSSH-në dhe Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit me lidhje direkte me Sistemin e Transmetimit, për të bllokuar rregullimin automatik të tensionit dhe kontrollin e fuqisë reaktive të transformatorëve, ose për të ndjekur udhëzimet e tjera të kontrollit të tensionit. Si pasojë e këtyre masave të

drejtuara nga OST, OSSH mund të ketë shkëputje të konsiderueshme të përdoruesve që janë objekte konsumatore, në mënyrë që të shmanget rreziku i kolapsit në Sistemin e Transmetimit. Kjo është pjesë e Planit të Mbrojtjes.

Neni 112. Menaxhimi i rrymave të lidhjeve të shkurtra

1. Në përputhje me Nenin 109(5), OST do të përcaktojë rrymën maksimale të lidhjeve të shkurtra në të cilën aftësia nominale e çelësave dhe pajisjeve të tjera komutuese tejkalohet, si dhe minimumin e rrymës së lidhjes së shkurtër për funksionimin e duhur të pajisjeve të mbrojtjes. OST do të zbatojë masa operative për parandalimin dhe lehtësimin e devijimit nga limitet e rrymës së lidhjes së shkurtër.
2. Në përputhje me Nenin 109(4), OST do të përdorë të gjitha mjetet e mundshme dhe ekonomikisht efikase të disponueshme nën kontrollin e saj, për të ruajtur rrymën e lidhjes së shkurtër brenda kufijve të përcaktuara në Nenin 112(1) për kontingjencat e listës së kontigjencave, në çdo kohë dhe për të gjitha pajisjet e mbrojtjes. Shmangie nga këto kushte lejohen vetëm gjatë sekuencave të çkycjes.
3. OST do të bëjë kalkulimin e rrymave të lidhjes së shkurtër dhe të fuqisë, sipas të dhënave më të mira në dispozicion dhe qasjes praktike të saj ose sipas standarteve ndërkombëtare të pranuara.
4. Kur vlerësohet pajtueshmëria me kufijtë e përcaktuara sipas Nenit 112(1), OST do të marrë në konsideratë kushtet operative që japin nivelin më të lartë të mundshëm të rrymave të lidhjes së shkurtër, duke konsideruar gjithashtu edhe kontributin e lidhjes së shkurtër nga sistemet e tjera të transmetimit, ose nga rrjeti i shpërndarjes.
5. OST do të kryejë llogaritjet e lidhjes të shkurtër, për të vlerësuar ndikimin e OST-ve direkt të ndërlidhura, dhe të rrjetit të shpërndarjes, në nivelin e rrymës të lidhjes së shkurtër. Në rastin kur këto rrjeta kanë ndikim në nivelet e rrymës së lidhjes së shkurtër, duhet të modelohen në llogaritjet e lidhjes së shkurtër në sistemin e transmetimit.

Neni 113. Menaxhimi i Shpërndarjes së Flukseve

1. OST do të përcaktojë Limitet e Sigurisë Operative për shpërndarjen e flukseve në çdo element të Sistemit të Transmetimit në zonën e vet të përgjegjësisë, në pajtim me Nenin 109(5) dhe 109(8).
2. OST do të mbajë flukset e fuqisë aktive brenda kufijve të sigurisë operative të përcaktuara, në përputhje me Nenin 109(5), në rastin kur sistemi është në gjendje normale dhe pas ndodhjes së një kontingjence nga lista e kontigjencave të përcaktuara sipas Nenit 114(1).
3. OST do të kryejë analizën e sigurisë operative bazuar në parashikime dhe në operim në kohë reale për zonën e saj të observimit. OST do të koordinojë analizat e sigurisë operative me OST-të e tjera në përputhje me marrëveshjet shumë-palëshe të konkluduara sipas Nenit 69 të Kodit, për të siguruar respektimin e kufijve të sigurisë operative për shpërndarjen e flukseve në zonën e saj të përgjegjësisë.
4. OST ka të drejtë të përdorë ri-dispeçimin për përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit, të disponueshëm, të lidhur në rrjetin e transmetimit ose në rrjetin e shpërndarjes, për të ruajtur Sigurinë Operative.
5. Në situatën (N-1) në gjendje normale, OST do të mbajë shpërndarjen e flukseve brenda mbingarkesave kalimtare të lejuara, duke përgatitur dhe ekzekutuar veprimeve përmirësuese përfshirë ri-dispeçerimin, që do të zbatohen brenda kohës së lejuar për mbingarkesat kalimtare të pranueshme.

Neni 114. Analiza e kontingjencave dhe trajtimi

1. OST do të përcaktojë listën e kontigjencave duke përfshirë kontingjencat e brendëshme dhe të jashtme, në zonën e saj të observimit, për të cilat do të kontrollohet nëse ndonjë prej këtyre kontingjencave rrezikon sigurinë operative në zonën e përgjegjësisë të OST-së. Lista e kontingjencave duhet të paktën të përfshijë kontingjencat e zakonshme dhe mund të përfshijë kontingjencat jo të zakonshme, të përcaktuara ne piken (5) të këtij neni.
2. Me qëllimin identifikimin e kontingjencave të cilat rrezikojnë sigurinë operative në zonën e përgjegjësisë dhe për të identifikuar veprimet e nevojshme përmirësuese, OST do të kryejë analizat e kontingjencave në zonën e vet të observimit, gjatë fazës së planifikimit operacional dhe në operimin në kohë reale.
3. OST do të kryejë analizat e kontingjencave bazuar në parametrat periodikë të operimit në kohë reale, sipas Nenit 109(2) sipas dispozitave të përcaktuara në këtë Kod. OST do të sigurojë që devijimet e mundshme nga limitet e sigurisë operative në zonën e përgjegjësisë, që janë identifikuar nga analiza e kontingjencës nuk e rrezikojnë sigurinë operative të sistemit të transmetimit ose të sistemeve fqinje të ndërlidhura.
4. OST do të vlerësojë rreziqet që lidhen me efektet e mundshme të kontingjencave dhe do të përgatisë veprimet përmirësuese pas testimit të çdo kontingjence nga lista e kontingjencave, dhe do të vlerësojë nëse mund të mbajë sistemin e transmetimit brenda limiteve të sigurisë operative në situatën (N-1). Pika e fillimit për analizat e kontingjencave në situatën – N do të jetë situata korrente e përditësuar me topologjinë e sistemit të transmetimit duke përfshirë ndërprerjet e planifikuara. Në rastin e situatës -(N-1) e shkaktuar nga një ndërprerje e paplanifikuar, OST do të zbatojë veprimet përmirësuese në mënyrë që të sigurohet rivendosja e sistemit të transmetimit në limitet e sigurisë operative sa më shpejtë që është e mundur dhe kjo situatë N-1) do të konsiderohet një situatë e re (N).
5. OST do të përfshijë kontingjencat e brendëshme dhe të jashtme në listën e kontingjencave. Kontingjencat e jashtme do të përcaktohen në përputhje me metodologjinë e zhvilluar në përputhje me dispozitat e Kodit. OST do të diferencojë kontingjencat e zakonshme, të jashtëzakonshme dhe ato jashtë diapazonit, duke konsideruar probabilitetin e ndodhjes së tyre. Në trajtimin e klasifikimit të kontingjencave, OST do të zbatojë parimet e mëposhtme:

   a) OST do të klasifikojë kontingjencat për zonën e saj të përgjegjësisë;
   b) kur dhe për sa kohë që kushtet rrisin ndjeshëm probabilitetin e kontingjencës së jashtëzakonshme, OST do të përfshijë edhe këto kontingjenca në listën e kontingjencave. OST do të përcaktojë veprimet përmirësuese të nevojshme për të ruajtur sistemin e transmetimit brenda kufijve të sigurisë operative, ose për të zbutur ndikimin e kontingjencave të jashtëzakonshme deri sa të jetë praktikisht të arsyeshme dhe ekonomikisht efikase;
   c) kur dhe për sa kohë kushtet e jashtëzakonshme do të rrisin probabilitetin e kontigjencave jashtë diapazonit, OST do të përdorë të gjitha mjetet ekonomikisht efikase dhe mjetet e mundshme në dispozicion nën kontrollin e saj për të përgatitur veprimet përmirësuese, për të zbutur ndikimin e këtyre kushteve shumë të jashtëzakonshme;
   d) OST do të përcaktojë kontingjencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme bazuar në topologjinë e përditësuar të Sistemit;
   e) në mënyrë që të konsiderohen kontingjencat e jashtëzakonshme me ndikim të lartë në sistemin e transmetimit apo në sistemet e transmetimit fqinje, ose me një probabilitet të larte të shfaqjes, OST do të përfshijë këto kontingjenca në listën e kontingjencave, e cila do të rivlerësohet kur është e nevojshme dhe do të përshtatet në rastin e ndryshimeve të konsiderueshme të kushteve operative;

f) OST do të kontribuojë në zhvillimin e një metodologjie të përbashkët dhe të kritereve për koordinim, dhe për aq sa është teknikisht e realizueshme dhe ekonomikisht efikase, harmonizimin e parimeve kryesore për krijimin e listës së kontingjencave për të gjithë zonën sinkrone.

6. OST do të përgatisë veprimet përmirësuese duke përfshirë ri-dispeçerimin, në pajtim me Nenin 109(12) dhe 109(13), ose ri-skedulimin ndërkufitar (tregtimin në drejtim të kundërt) për tu përballuar me çdo kontingjencë nga lista e kontigjencave, për të cilën devijimi potencial nga limitet e sigurisë operative është identifikuar në përputhje me Nenin 109(5).
7. Për çdo ndryshim relevant në operimin në kohë reale ose në topologjinë e sistemit të transmetimit, OST do të rivlerësojë kontigjencat nga lista e saj e kontigjencave duke marrë parasysh Nenin 114(5), në gjendje normale dhe do të axhustojë përgatitjen e veprimeve përmirësuese.
8. OST do të aplikojë veprimet përmirësuese pas identifikimit të kontingjecës gjatë analizave të kontingjentesh, për të cilat ka një rrezik për të mos qenë në gjendje për të përballuar në mënyrë efikase dhe në kohën e duhur, kushtet që do të krijoheshin pas ndodhjes së kësaj kontingjence.
9. Nëse pas një kontingjence, sistemi i transmetimit nuk është në përputhje më kriterin – (N-1), OST do të iniciojë veprimet përmirësuese për të rimarrë pajtueshmërinë me kriterin - (N-1) sa më shpejt që është e mundur. Nëse ka një risk që pas kontingjencës, përhapja e shqetësimit të përfshijë OST-të e ndërlidhura, atëherë OST do të iniciojë veprimet përmirësuese sa më shpejt që praktikisht të jetë e mundur. Mosplotësimi i kriterit (N-1) është i pranueshëm:

   a) gjatë sekuencave të çkyçjeve;
   b) për sa kohë që ka vetëm pasoja lokale brenda zonës së përgjegjësisë të OST-së;
   c) gjatë periudhës së kohës së nevojshme për aktivizimin e veprimeve përmirësuese.

10. OST do të sigurojë që zona e observimit që përdoret për analizat e kontingjencës, është e bazuar mbi të dhëna mjaftueshmërisht të sakta në kohë reale, për të lejuar konvergjencën e llogaritjeve të shpërndarjes së flukseve.
11. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit, që janë Gjenerues të tipit "me pikë lidhje në shpërndarje "ose të tipit "me pikëlidhje në transmetim", duhet të japin të gjithë informacionin për analizat e kontingjencave të kërkuara nga OST-ja, duke përfshirë të dhënat e parashikimit dhe ato në kohë reale, me grumbullimin (agregimin) e mundëshëm të të dhënave, sipas Nenit 128(3).
12. OST do të koordinojë analizat e kontingjencës në koherencë me listat e kontigjencës, të paktën të OST-ve që përfshihen në zonën e saj të observimit, dhe në përputhje me marrëveshjet shumë-palëshe të konkluduara, në përputhje me Nenin 69 të Kodit. OST do të bashkëpunojë me OST-të e tjera nga zona e saj e observimit dhe do të japë të gjithë informacionin për analizat e kontigjencës, duke përfshirë të dhënat e parashikuara dhe ato në kohë reale sipas dispozitave nga Neni 117 deri Nenin 130.
13. OST do të kontribuojë në krijimin e Modelit të Rrjetit të Përbashkët (rajonal). Ky kontribut do të përfshijë të dhënat për Modelin e Rrjetit të Përbashkët në përputhje me përmbajtjen dhe afatet kohore të përcaktuara sipas dispozitave nga Neni 117 deri Neni 130.
14. OST do të informojë OST-të nga zona e saj e observimit, për kontingjencat e jashtme të konsideruara në listën e saj të kontigjencave.
15. OST do të informojë dhe koordinoje me OST-të përkatëse, para së të implementohet ndonjë ndryshim i rëndësishëm në topologjinë e rrjetit në zonën e përgjegjësisë, që përfshin elemente të sistemit të transmetimit, që janë kontingjenca të jashtme të listës së kontingjencave të OST-ve të tjera.

Neni 115. Mbrojtja

1. OST do të instalojë pajisjet e mbrojtjes së nevojshme dhe pajisjet rezervë të mbrojtjes në Sistemin e Transmetimit të saj, në mënyrë që të mbrojë elementët e sistemit me efikasitet dhe efektivitet, dhe të koordinuar me mbrojtjen e pajisjeve të Përdorueseve të Rëndësishëm të Rrjetit, nga efektet e avarive në Sistemin e Transmetimit.
2. OST, të paktën çdo pesë vjet, do të shqyrtojë dhe të analizoje konceptet dhe strategjinë e mbrojtjes, dhe kur është e nevojshme do të përshtasë funksionet mbrojtjes për të siguruar funksionimin e duhur të mbrojtjes dhe ruajtjen e sigurisë operative. Pas çdo operimi të mbrojtjes që ka impakt jashtë zonës së saj të përgjegjësisë, OST do të vlerësojë nëse sistemi i mbrojtjes në Zonën e saj të Përgjegjësisë punoi sipas planit dhe duhet të ndërmarrë veprime korrigjuese nëse është e nevojshme.
3. OST do të operojë mbrojtjen e sistemit të transmetimit të saj me tarime (set-point) që sigurojnë besueshmëri, shpejtësi dhe selektivitet të pastrimit të avarisë (l.sh.), duke përfshirë mbrojtjen rezervë për pastrimin e l.sh. në rast të mosfunksionimit të sistemit kryesor të mbrojtjes.
4. OST do të instalojë mbrojtjen e nevojshme dhe pajisjet rezervë të mbrojtjes brenda sistemit të saj të transmetimit më qëllimin për të parandaluar në mënyrë automatike përhapjen e avarive, të cilat mund të rrezikojnë sigurinë e operimit të sistemeve fqinje të ndërlidhura.
5. OST do të koordinojë më OST-të e ndërlidhura për tarimet e mbrojtjes për interkonektorët, dhe do të informojë e koordinojë me ato, më përpara së të ndryshojë parametrat.
6. Në rastet kur përdoren skema speciale të mbrojtjes së Sistemit (SyPS), OST do të:
   a) kryejë analiza në mënyrë që të sigurojë që çdo SyPS vepron në mënyrë selektive, të besueshme dhe efektive. Në analizën e SyPS, OST duhet të vlerësojë pasojat për Sistemin e Transmetimit në rast të funksionimit të pasaktë të SyPS duke marrë parasysh ndërveprimin me OST-të e prekura;
   b) verifikojë se SyPS ka një besueshmëri të krahasueshme me sistemin e mbrojtjes të përdorur në mbrojtjen primare të elementeve të sistemit të transmetimit;
   c) operojë sistemin e transmetimit me SyPS brenda limiteve të sigurisë operative të përcaktuar, në përputhje me Nenin 109(5) dhe 109(6); dhe
   d) koordinojë funksionet e SyPS, principet e aktivizimit dhe tarimet me OST-të e ndërlidhura, me OSSH-në dhe Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit me pikat e lidhjes direkte me Sistemin e Transmetimit.
7. OST do të përcaktojë skemën e shkarkimit automatik nga ulja e frekuencës (SHAF) me parime të përbashkëta dhe në koordinim me OSSH-në dhe OST-të e Zonës Sinkrone. Çdo ndryshim i kushteve apo konfigurimit të SHAF do të implementohet pas informimit dhe rakordimit me OSSH dhe Forumin e OST-ve të Zonës Sinkrone.
8. OST do të përcaktojë dhe zbatojë veprimet në rastet e mbi-frekuencës, në bashkëpunim me gjeneruesit e lidhur me rrjetin e transmetimit dhe në koordinim me OST-të e Zonës Sinkrone.

Neni 116. Menaxhimi i Qëndrueshmërisë Dinamike

1. OST do të monitorojë gjendjen dinamike të Sistemit të Transmetimit në termat e tensionit, frekuencës dhe stabilitetit të këndit të rotorit, me studime off-line me matje në zonë të gjerë, apo qasje të tjera në përputhje me pikën 5 të këtij neni duke përfshirë shkëmbimin e të dhënave relevante më OST-të e tjera nëse është e nevojshme, në mënyrë që të jetë në gjendje për të marrë masat e nevojshme korrigjuese kur siguria operative e sistemit është në rrezik.

2. OST do të sigurojë, në rastin e problemeve të qëndrueshmërisë për shkak të shuarjes së dobët të oshilimeve ndërzonale që prekin disa OST, që të koordinohet me analizat e stabilitet dinamik, që kryhet në nivelin e Zonës Sinkrone, sa me shpejt të jetë e mundur praktikisht.
3. OST do të kryejë studime për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë Dinamike (VQD), në mënyrë që të identifikohen kufijtë e qëndrueshmërisë dhe problemet e mundshme të stabilitet në sistemin e transmetimit. Studimet e VQD do të koordinohen ndërmjet OST-ve në Zonën Sinkrone dhe do të bëhen për të gjithë ose pjesë të rëndësishme të Zonës Sinkrone. Këto studime mund të jenë off-line.
4. Kur OST identifikon një ndikim të mundshëm të përbashkët të tensionit, këndit të rotorit ose stabilitetit të frekuencës më sistemet e tjera të ndërlidhura, OST do të kontribuojë në koordinimin e qasjeve ndaj VQD, duke përfshirë sigurimin e të dhënave të nevojshme për VQD, përgatitjen e veprimeve të përbashkëta përmirësuese duke përfshirë procedurat e bashkëpunimit ndërmjet OST-ve të nevojshme për të lehtësuar oshilimet në zonë të gjerë.
5. Për të vendosur qasje për VQD, OST do të zbatojë rregullat e mëposhtme:
   a) në qoftë së në lidhje me listën e kontigjencave, limitet e gjendjes së qëndrueshme janë arritur para limiteve të stabilitetit, OST do të bazojë VQD-në e saj vetëm në studimet e stabilitetit off-line që kryen në fazën e planifikimit operativ afat gjatë;
   b) në qoftë se gjatë planifikimit të ndërprerjeve, në lidhje me listën e kontingjentesh, limitet e gjendjes së qëndrueshme dhe limitet e stabilitetit janë të afërta me njëri – tjetrin ose limitet e stabilitetit arrihen para limiteve të gjendjes së qëndrueshme, OST do të kryejë VQD-në një ditë përpara fazës së planifikimit operativ ndërsa kushtet e ndërprerjes mbeten. OST do të përgatisë veprimet përmirësuese që do të përdoren në operimet në kohë reale nëse është e nevojshme; dhe
   c) nëse rrjeti është në situatën N në lidhje me listën e kontingjentesh dhe limitet e stabilitetit janë arritur para limiteve të gjendjes së qëndrueshme, OST duhet të kryejë VQD në të gjitha fazat e planifikimit operativ, dhe të ri-vlerësojë limitet e qëndrueshmërisë, sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur, pas zbulimit të çdo ndryshimi të rëndësishëm të kushteve të operimit.
6. Nëse VQD tregon shkelje të limiteve të stabilitetit, OST do të zbatojë masa përmirësuese që përfshijnë edhe gjeneruesit, për të mbajtur sistemin e transmetimit të qëndrueshëm.
7. OST do të sigurojë që koha e pastrimit të l.sh., për l.sh. që mund të çojnë në përhapjen e paqëndrueshmërisë në sistem, është më e vogël së koha kritike e pastrimit të l.sh. e llogaritur nga OST në studimin e saj të vlerësimit të qëndrueshmërisë dinamike.
8. Në lidhje me inercinë minimale të kërkuar për Zonën Sinkrone, OST si të gjitha OST-të nga Zona Sinkron do të zhvillojë dhe të zbatojë metodologjinë për përcaktimin e inercisë minimale të nevojshme për të ruajtur sigurinë operative dhe për të parandaluar shkeljen e limiteve të qëndrueshmërisë të identifikuara në pajtim me pikën 3 të këtij neni. OST ka të drejtë të përcaktojë dhe të vendosë në operim inercinë minimale në zonën e vet të përgjegjësisë, sipas metodologjisë së përcaktuar dhe për të siguruar rezultatet e kërkuara nga ky nen.

Neni 117. Kërkesa të përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave

1. OST do të përdorë të dhënat dhe informacionin më të mire në dispozicion, në mënyrë që të pasqyrojë sa më shumë që të jetë e mundur gjendjen reale dhe të parashikuar në sistemin e transmetimit.

2. OST do të minimizojë pasaktësitë dhe paqartësitë dhe do të sigurojë në vazhdimësi cilësi të lartë të të dhënave dhe informacionit të përdorur.
3. OST ka të drejtë të marrë informacionin që kërkohet për analizat e sigurisë operacionale, lidhur me pikat e mëposhtme, dhe siç është detajuar më tej nga Neni 118 deri 130:

   a) gjenerimi;
   b) konsumi;
   c) skedulimet;
   d) pozicionet e balancës;
   e) remontet e planifikuara dhe topologjitë e nënstacioneve; dhe
   f) parashikimet e veta.

   Ky informacion do të jetë i konvertueshëm në çdo nyje "burim (injektuese)" dhe "ngarkesë (konsumatore)" të modelit të Sistemit të Transmetimit dhe duhet të respektojë kërkesat e përshkruara në Kod për t'u mbledhur në një model të përbashkët të rrjetit.
4. OST do të përcaktojë fushë-veprimin e shkëmbimit të të dhënave me përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit të përcaktuar në këtë kapitull, sipas kategorive të mëposhtme:

   a) të dhëna strukturore;
   b) skedulimin dhe të dhënat e parashikimit;
   c) të dhënat në kohë reale;
   d) udhëzimet individuale nga OST ose OSSH.

5. OST do të zbatojë udhëzimin e ENTSO-E (të miratuar nga të gjitha OST-të e zonës sinkrone) në lidhje me kërkesat kryesore organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave, të publikuar në faqen e internetit të ENTSO-E që përfshin çështjet e mëposhtme:

   a) detyrimet ndërmjet OST-ve për të komunikuar pa vonesë tek të gjithë OST- të fqinje çdo ndryshim në parametrat e mbrojtjes, kufijtë termike dhe kapacitetet teknike në linjat e interkoneksionit ndërmjet zonave të tyre përgjegjësisë;
   b) detyrimet e OSSH-ve të lidhur direkt me Sistemin e Transmetimit që të informojnë brenda afateve kohore të miratuara OST-të e tyre për çdo ndryshim në fushën e të dhënave dhe informacionit dhe përmbajtjen nga ky Kodi Rrjeti;
   c) detyrimet për OSSH-të e afërta dhe/ose ndërmjet OSSH-së "downstream" dhe OSSH-së "upstream" të informojnë njëra-tjetrën brenda afateve kohore të miratuara për çdo ndryshim në fushën e të dhënave dhe informacionit të cilat janë të përcaktuara në Nenin 117 deri 130 të këtij Kodi ;
   d) detyrimet e përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit për të informuar OST-të ose OSSH-të e tyre brenda afateve kohore, në lidhje me çdo ndryshim në formën dhe përmbajtjen e të dhënave relevante nga ky Kapitull i këtij Kodi Rrjeti;
   e) përmbajtjet e detajuara të informacionit dhe të dhënave referuar këtij kapitulli si dhe në koherencë me dispozitat e shkëmbimit të të dhënave në Kodet e tjera të Rrjetit dhe në legjislacionin e BE. Këto përcaktime të detajuara duhet të përfshijnë por nuk duhet të kufizohen në: parimet kryesore, tipin e të dhënave, mjetet e komunikimit, formatet dhe standardet që duhet të aplikohen, koha dhe përgjegjësitë;
   f) koha e vendosur dhe periodiciteti për të dhënat dhe informacionin që do të ofrohen nga OSSH-të dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit, për t'u përdorur nga sistemet e OST-ve në afate kohore të ndryshme, përfshirë shpeshtësinë e shkëmbimit të informacionit për të dhënat në kohë reale, të dhënat e planifikuara dhe përditësimin e të dhënave strukturore; dhe

g) formatet e raportimit të të dhënave dhe informacioneve të referuara në këtë kod dhe në një mënyrë koherente me dispozitat e shkëmbimit të të dhënave në Kodin e Transmetimit.

6. OST dhe OSSH do të bashkëpunojnë në mënyrë që të përcaktojnë dhe të bien dakord mbi proceset efektive për sigurimin dhe menaxhimin e shkëmbimit të të dhënave midis tyre, duke përfshirë sigurimin e të dhënave të lidhura me rrjetin e shpërndarjes dhe të përdorueseve të rëndësishëm të lidhur në këtë rrjet. Shkëmbime të tilla do të udhëhiqen nga parimet e efikasitetit dhe proporcionalitetit.
7. Të dhënat në lidhje me instalimet e autorizuara në rrjet në pikën e lidhjes me Sistemin e Transmetimit duhet të jenë në dispozicion për përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit dhe OSSH që janë të lidhur në atë pikë lidhje.
8. OST dhe OSSH do të bien dakord mbi fushë-shtrirjen e saktë të informacionit shtesë në lidhje me instalimet në rrjet të komisionuara, për t'u shkëmbyer në çdo rast. OST do ta bëjë këtë informacion të disponueshëm për OSSH-në ose përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit në zonën e saj të përgjegjësisë.
9. OST mund t'i delegojë një Qendre Koordinimi të Sigurisë Rajonale (RSCI) disa nga detyrat që duhet të kryejë në përputhje me këtë Kod, duke mbajtur përgjegjësinë e plotë dhe detyrimet si një OST. Në një rast të tillë, OST duhet të informojë OST-të e tjera, në lidhje me këtë delegim, në mënyrë që këto qendra koordinimi të sigurisë rajonale mund të marrin të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për të kryer detyrat që i janë besuar atyre.

Neni 118. Shkëmbimi i të dhënave Strukturore të parashikuara ndërmjet OST-ve

1. OST do të shkëmbejë me OST-të fqinje informacion strukturor, lidhur me zonën e observimit, duke përfshirë të paktën:
   a) Topologjinë e nënstacioneve dhe të dhëna të tjera përkatëse sipas nivelit të tensionit;
   b) Linjat e transmetimit;
   c) Transformatorët lidhës me OSSH, dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit, objekte konsumatore dhe objekte gjenerimi;
   d) Maksimumin dhe minimumin e fuqisë aktive dhe reaktive të përdorueseve të rëndësishëm të Rrjetit që janë Module Gjenerimi;
   e) Transformatorët e ndryshimit të fazës;
   f) Linjat e tensionit të lartë DC;
   g) Reaktorët, kapacitorët dhe kompensatorët statikë VAR; dhe
   h) Limitet e sigurisë operative të përcaktuara nga çdo OST, sipas Nenit 109(5).
2. OST do të shkëmbejë me OST-të fqinje pikat e punës (tarimet) e mbrojtjes së linjave të cilat janë përfshirë si kontingjenca të jashtme në listat e kontingjencave të OST-ve fqinje në mënyrë që të lejojë koordinimin e mbrojtjes midis Sistemeve të ndryshme të Transmetimit.
3. Në mënyrë që të mbështesë analizën e koordinuar të sigurisë operacionale dhe krijimin e modeleve të përbashkëta të rrjetit, OST do të shkëmbeje me OST-të e tjera në përputhje me dispozitat e Kodit të Planifikimit, të paktën të dhënat e mëposhtme:
   a) topologjinë e Sistemit të Transmetimit 220 kV e lart, për zonën e përgjegjësisë;
   b) një model ose një ekuivalente të Sistemit të Transmetimit me tension nën 220 kV me ndikim të rëndësishëm në sistemin e saj të transmetimit; dhe

c) shumën totale të parashikuar nga burimi primar i energjisë "burim (injektuese)" dhe "ngarkesë (konsumatore)" në çdo nyje të Sistemit të Transmetimit për afate kohore të ndryshme. Këto të dhëna duhet të korrespondojnë me parashikimin më të mirë në dispozicion në nivel OST-je. Situata që rezulton nga parashikimi në Sistem duhet të jetë sa më reale dhe sa më e saktë të jetë e mundur.

4. Në mënyrë që të mbështesë llogaritje të koordinuara të Qëndrueshmërisë Dinamike (AQD), OST, kur kërkohet në përputhje me Nenin 116(2), do të shkëmbejë me OST-të e tjera brenda Zonës sinkrone të dhënat e nevojshme për AQD. Për përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit që janë gjenerues, OST duhet të sigurojë të dhënat e nevojshme të paktën për:

a) parametrat elektrike të gjeneratorëve të rrymës alternative të përshtatshme për Analizën e Qëndrueshmërisë Dinamike(AQD), duke përfshirë inercinë totale;
b) modelet e mbrojtjes;
c) gjeneratorët me rryme alternative dhe forcën lëvizëse primare;
d) përshkrim i transformatorëve ngritës;
e) minimumin dhe maksimumin e energjisë reaktive;
f) modelet e rregullatorit të tensionit dhe shpejtësisë; dhe
g) modelet e sistemit të eksitimit dhe të lëvizësit primar, të përshtatshme për luhatje të mëdha.

Lidhur me rregullimin e tensionit (ndryshimin e ancafkave), përshkrimin e transformatorëve ngritës me rregullim nën ngarkesë, OST do të sigurojë të dhënat e nevojshme për:

a) tipin e rregullimit; dhe
b) diapazonin e rregullimit të tensionit.

Sa i përket linjave HVDC dhe pajisjeve FACTS, OST duhet të sigurojë të dhënat e nevojshme për modelet dinamike të pajisjes dhe rregullimin e saj të përshtatshëm për luhatje të madhe.

Neni 119. Shkëmbimi i të dhënave në kohë reale ndërmjet OST-ve

1. Në përputhje me Nenin 109(11)(a), OST do të shkëmbejë me OST-të e tjera në Zonën Sinkrone të dhënat e nevojshme mbi gjendjen e Sistemit të Transmetimit duke përdorur mjetet IT për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale në nivel pan-Evropian, duke përfshirë:

a) frekuencën;
b) kontrolli i gabimit të rivendosjes së frekuencës ose një parametër ekuivalent;
c) matjet e fuqisë aktive të shkëmbyer midis zonave LFC;
d) injektimin shumator të gjenerimit;
e) gjendjen e Sistemit në përputhje me Nenin 109(1);
f) vlera e vendosur në rregullatorin e restaurimit të frekuencës; dhe
g) shkëmbimin e energjisë nëpërmjet Linjave të Interkoneksionit Virtuale.

2. OST do të shkëmbejë me OST-të nga zona e saj e observimit, të dhënat e mëposhtme nga Sistemi i Transmetimit:

a) topologjinë aktuale të nënstacioneve;
b) fuqinë aktive dhe reaktive në traktin (daljen) e linjës, duke përfshirë transmetimin, shpërndarjen dhe linjat që lidhin përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit;

c) fuqinë aktive dhe reaktive në traktin (daljen) e transformatorit, duke përfshirë transmetimin, shpërndarjen dhe transformatorët lidhës të përdorueseve të rëndësishëm të rrjetit;
d) fuqinë aktive dhe reaktive në traktin (daljen) e objektit të fuqisë gjeneruese;
e) pozicionet e rregullimit (ancafkave) të transformatorëve, duke përfshirë transformatorët e rregullimit fazor;
f) tensionin e matur ose të vlerësuar të zbarave;
g) fuqinë reaktive në daljen e reaktorit, kondensatorit ose nga një kompensator statik VAR; dhe
h) kufizimet e aftësisë furnizuese të fuqisë aktive dhe reaktive, në lidhje me zonën e observimit.

Neni 120. Shkëmbimi i të dhënave strukturore ndërmjet OST dhe OSSH brenda zonës së përgjegjësisë të OST-së

1. OST do të përcaktojë zonën e observimit të rrjetit të shpërndarjes të lidhur në transmetim, që është e rëndësishme për të përcaktuar me saktësi dhe në mënyrë efikase gjendjen e Sistemit, bazuar në metodologjinë e zhvilluar në bazë të dispozitave të Kodit të Planifikimit Operacional dhe Skedulimit.
2. Në rastet kur një rrjet i shpërndarjes (pjesë e tij) nuk është i lidhur (direkt) në Transmetim, por ndikimi elektrik i tij konsiderohet si i rëndësishëm nga OST për të patur një pasqyrë sa më të qartë të sjelljes së sistemit, të tilla rrjete shpërndarjeje do të përcaktohen nga OST-ja si pjesë e zonës së observimit e përcaktuar sipas pikës(1) të këtij neni.
3. OSSH do t'i sigurojë OST-së informacionin strukturor lidhur me zonën e observimit referuar në pikat (1) dhe (2) më lart, duke përfshirë, por jo kufizuar në:
   a) nënstacionet sipas tensionit;
   b) linjat që lidhin nënstacionet nga a) më sipër;
   c) transformatorët e nënstacioneve nga a) më sipër;
   d) përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit; dhe
   e) reaktorët dhe kapacitorët e lidhur me nënstacionet nga a) më sipër.
4. OSSH do të sigurojë OST-në me informacione strukturore të përditësuar në lidhje me elementet e zonës së observimit referuar në pikat (1) dhe (2) më lart, periodikisht, së paku çdo gjashtë muaj.
5. OSSH duhet t'i sigurojë OST-së informacionin mbi kapacitetin total të gjeneruesve të tipit "me pikëlidhje në shpërndarje", burimin primar të energjisë së tyre, dhe informacionin përkatës në lidhje me sjelljen e tyre të frekuencës.

Neni 121. Shkëmbimi i të dhënave në kohë reale ndërmjet OST dhe OSSH

1. OSSH do t'i sigurojë në kohë reale OST-së informacionin lidhur me zonën e observimit referuar në Nenin 120(1) dhe 120(2), i përbërë nga:
   a) Topologjia aktuale e nënstacioneve;
   b) Fuqinë aktive dhe reaktive në traktin e linjës;
   c) Fuqinë aktive dhe reaktive në traktin e transformatorit;
   d) Fuqinë aktive dhe reaktive të injektuar në traktin e objektit gjenerues;
   e) Pozicionet e ancafkave të transformatorëve të lidhur me Sistemin e Transmetimit;
   f) Tensionet e zbarave;

g) Fuqinë reaktive në traktin e reaktorit dhe kondensatorit;
h) Të dhënat më të mira në dispozicion për gjenerimin e agreguar në zonën e OSSH; dhe
i) Të dhënat më të mira në dispozicion për konsumin e agreguar në zonën e OSSH.

Neni 122. Shkëmbimi i të dhënave strukturore ndërmjet OST-së, pronarëve të interkonektoreve apo linjave të tjera dhe Moduleve të Gjenerimit të lidhur direkt me Sistemin e Transmetimit

1. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit që është pronar dhe operon një modul gjenerimi të tipit "me pikëlidhje në transmetim ", duhet të sigurojë për OST-në, të paktën të dhënat e mëposhtme:

   a) të dhënat e përgjithëshme të modulit të gjenerimit, duke përfshirë kapacitetin e instaluar dhe burimin primar të energjisë;
   b) të dhëna për aftësinë e turbinës dhe gjeneratorit, përfshirë kohën për lëshimin në gjendje të ftohtë dhe të ngrohtë;
   c) të dhënat për llogaritjen e lidhjeve të shkurtëra;
   d) të dhënat e bllok-transformatorëve;
   e) të dhëna për rezervën e mbajtjes së frekuencës (rezerva e rregullimit primar) sipas përcaktimit dhe kërkesave të të dhëna nga Neni 143 deri 189 për objektet e gjenerimit që e ofrojnë ose mundësojnë këtë shërbim;
   f) të dhëna për rezervën e rivendosjes së frekuencës (rezerva e rregullimit sekondar), sipas përcaktimit dhe kërkesave të Nenit 169 për modulet e gjenerimit të fuqisë që marrin pjesë në këtë shërbim;
   g) të dhëna për rezervën zëvendësuese (rezerva e rregullimit terciar) për modulet e gjenerimit të fuqisë që marrin pjesë në këtë shërbim;
   h) të dhënat e nevojshme për rivendosjen (ri-lëshimin);
   i) të dhënat dhe modelet e nevojshme për kryerjen e simulimeve dinamike;
   j) të dhënat e mbrojtjes; dhe
   k) aftësia e kontrollit të tensionit dhe fuqisë reaktive.

2. OST mund t'i kërkojë çdo pronari të një objekti të gjenerimit që operon një modul gjenerimi të fuqisë me lidhje direkte në Sistemin e Transmetimit, të sigurojë të dhëna të mëtejshme të nevojshme për Analizën e Sigurisë Operacionale.
3. Çdo pronar interkonektori ose linje HVDC do t'i sigurojë OST-së, të paktën të dhënat e mëposhtme:

   a) të dhënat e projektit të instalimit;
   b) të dhënat e transformatorëve;
   c) të dhënat për filtrat dhe bateritë e filtrave;
   d) të dhënat e kompensimit reaktiv;
   e) aftësia e kontrollit të fuqisë aktive;
   f) aftësia e kontrollit të fuqisë reaktive dhe tensionit;
   g) mënyra e prioritetit operacional aktive ose reaktive, nëse ekziston;
   h) modelet dinamik për simulimet dinamike;
   i) të dhënat e mbrojtjes; dhe
   j) aftësia për të punuar me nivele tensioni më të ulta.

4. Çdo pronar interkonektori ose linje AC do t'i sigurojë OST-së, të paktën të dhënat e mëposhtme:

a) të dhënat e projektit të instalimit;
b) parametrat elektrike; dhe
c) mbrojtjet e linjës.

Neni 123. Shkëmbimi i të dhënave të skeduluara ndërmjet OST-së, pronarëve të interkonektorit apo linjave të tjera dhe moduleve gjeneruese të lidhur direkt me Sistemin e Transmetimit

1. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit i cili është pronar dhe/ose operon me një modul gjenerimi të lidhur drejtpërdrejt me Sistemin e Transmetimit do të njoftojë OST-në, mbi bazën e "Një-Ditë-Përpara" dhe "Brenda-Ditës" për fuqinë e tij aktive dhe sasinë e rezervave të fuqisë aktive dhe disponueshmërinë e saj, si dhe pa vonesë, brenda afateve kohore të përcaktuara, duhet të informoje për pa-disponueshmërinë e planifikuar ose kufizimet mbi aftësinë prodhuese.
2. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit i cili është pronar dhe/ose operon me një modul gjenerimi të lidhur drejtpërdrejt me Sistemin e Transmetimit do të njoftojë OST-në, për çdo parashikim të kufizimit të aftësisë kontrolluese të fuqisë reaktive.
3. Çdo pronar i një interkonektori AC ose linje tjetër, do t'i sigurojë OST-së të dhënat mbi skedulimin e padisponueshmërisë ose kufizimet mbi fuqinë aktive.

Neni 124. Shkëmbimi i të dhënave në kohë-reale ndërmjet OST-së, pronarëve të interkonektorit apo linjave të tjera dhe moduleve gjeneruese të lidhur direkt me Sistemin e Transmetimit

1. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit i cili është pronar dhe/ose operon me një modul gjenerimi të lidhur drejtpërdrejt me Sistemin e Transmetimit, duke përfshirë dhe ngarkesën e tij vetjake, do t'i sigurojë OST-së në kohë reale informacionin e mëposhtëm:
   a) pozicionin e çelësave në pikën e lidhjes, ose një tjetër pikë ndërveprimi të rënë dakord me OST-në;
   b) fuqinë aktive dhe reaktive në pikën e lidhjes, ose një tjetër pikë ndërveprimi të rënë dakord me OST-në;
   c) fuqinë aktive dhe reaktive të rrjetit, në rast së objekti i gjenerimit ka konsum tjetër përveç atij të nevojave vetjake.
2. Çdo pronar interkonektori ose linje tjetër, AC ose HVDC, që operon në zonën e përgjegjësisë të OST-së, do t'i sigurojë OST-së në kohë reale të dhënat e mëposhtme për pikën e lidhjes:
   a) pozicionin e çelësave;
   b) statusin e operimit; dhe
   c) fuqinë aktive dhe reaktive.

Neni 125. Shkëmbimi i të dhënave strukturore ndërmjet OST, OSSH dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit sipas Nenit 108(5)(a) dhe 108(5)(d) të lidhur me rrjetin e shpërndarjes

1. Sipas përcaktimeve të bëra në Nenin 108(5)(a) dhe 108(5)(d) çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit dhe çdo pronar i një objekti gjenerimi, të lidhur me rrjetin e shpërndarjes, do t'i sigurojë OST-së dhe/ose OSSH-së, të paktën të dhënat e mëposhtme:

a) Të dhënat e përgjithshme për modulet e gjenerimit, duke përfshirë kapacitetin e instaluar dhe burimin primar të energjisë ose llojin e karburantit;
b) Të dhënat për rezervën e mbajtjes së frekuencës (rezerva e rregullimit primar) për objektet gjeneruese të cilat e ofrojnë ose mundësojnë këtë shërbim;
c) Të dhënat për rezervën e rivendosjes së frekuencës (rezerva e rregullimit sekondar) për prodhuesit që marrin pjesë në këtë shërbim;
d) Të dhënat për rezervën zëvendësuese për modulet gjeneruese që marrin pjesë në këtë shërbim;
e) Të dhënat e mbrojtjes;
f) Mundësinë e kontrollit të fuqisë reaktive;
g) Mundësinë e kontrollit në distancë të çelësave;
h) Të dhënat e nevojshme për kryerjen e simulimit dinamik; dhe
i) Nivelin e tensionit dhe vendndodhjen e çdo moduli gjenerues.

Organizimi i shkëmbimit të të dhënave do të përcaktohet në përputhje me kërkesat kryesore organizative, rolet dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga Neni 117(6) deri 117(8).

2. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit që përmendet në Nenin 153(1), do të informojë OST-në dhe/ose OSSH-në ku edhe ka pikën e lidhjes, brenda afatit të rënë dakord por para komisionimit të parë ose përpara çdo ndryshimi në instalimin ekzistues, rreth çdo ndryshimi në fushëveprimin dhe përmbajtjen e të dhënave në bazë të Nenit 125(1). Organizimi i shkëmbimit të të dhënave do të përcaktohet në përputhje me kërkesat kryesore organizative, rolet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Nenin 117(5).

Neni 126. Shkëmbimin i të dhënave të skeduluara ndërmjet OST, OSSH dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit sipas nenit 108(5)(a) dhe 108(5)(d) të lidhur me rrjetin e shpërndarjes

1. Sipas përcaktimeve të bëra në Nenin 108(5)(a) dhe 108(5)(d) çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit që është pronar i një objekti gjenerues të lidhur me rrjetin e shpërndarjes, do t'i sigurojë OST-së dhe/ose OSSH-së, skedulimin e padisponueshmërisë, kufizimin mbi fuqinë aktive dhe skedulimin e parashikuar të fuqisë aktive që do të prodhohet. Organizimi i shkëmbimit të të dhënave do të përcaktohet në përputhje me kërkesat kryesore organizative, rolet dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga Neni 117(6) deri tek 117(8).
2. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit që është pronar i një objekti gjenerues, sipas Nenit 108(5)(a) dhe 108(5)(d) , do t'i sigurojë OST-së dhe/ose OSSH-së, informacionin mbi çdo kufizim të parashikuar mbi mundësinë e kontrollit të fuqisë reaktive. Organizimi i shkëmbimit të të dhënave do të përcaktohet në përputhje me kërkesat kryesore organizative, rolet dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga Neni 117(6) deri tek 117(8)

Neni 127. Shkëmbimin i të dhënave në kohë-reale ndërmjet OST, OSSH dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit sipas Nenin 108(5)(a) dhe 108(5)(d) të lidhur me rrjetin e shpërndarjes

1. Sipas përcaktimeve të bëra në Nenin 108(5)(a) dhe 108(5)(d) çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit që është pronar i një objekti gjenerues, të lidhur me rrjetin e shpërndarjes, do t'i sigurojë në kohë-reale OST-së dhe/ose OSSH-së informacionin e mëposhtëm:

   a) Statusin e pajisjeve komutuese dhe çelësave në pikën e lidhjes; dhe
   b) Flukset e fuqisë aktive dhe reaktive, rrymën, dhe tensionin në Pikën e Lidhjes.

   Organizimi i shkëmbimit të të dhënave do të përcaktohet në përputhje me kërkesat kryesore organizative, rolet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Nenin 117(6) deri 117(8).

2. OST do të përcaktojë në koordinim me OSSH-në, nëse dhe cilët përdorues të rëndësishëm të rrjetit mund të përjashtohen nga dërgimi i të dhënave në kohë reale që i shkojnë direkt OST-së. Të dhënat e këtyre përdoruesve do t'i sigurohen OST-së në kohë reale nga ana e OSSH-së në një formë të përmbledhur (agregate).

Neni 128. Shkëmbimi i të dhënave në përputhje me Nenin 108(5)(a) dhe 108(5)(d) ndërmjet OST, OSSH dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit të lidhur në rrjetin e shpërndarjes

1. OSSH do të sigurojë për OST-në informacionin e specifikuar në Nenin 125, 126 dhe 127, kur dhe në masën e kërkuar nga OST-ja.
2. Për përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit të shpërndarjes, OST do të vërë në dispozicion të OSSH-së informacionin e specifikuar në Nenet 125, 126 dhe 127 siç kërkohet nga OSSH.
3. Sipas përcaktimeve të bëra në të Nenin 108(5)(a) dhe 108(5)(d) , OST mund të kërkojë të dhëna të mëtejshme nga çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit i lidhur me rrjetin e shpërndarjes i cili është pronar i një objekti gjenerues, në qoftë së kjo është e nevojshme për analiza të sigurisë operative dhe vlefshmërinë e modeleve të rrjetit.

Neni 129. Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST-së dhe Objekteve Konsumatore të lidhur drejtpërdrejt me Sistemin e Transmetimit

1. Objektet Konsumatore të lidhura me Sistemin e Transmetimit do ti sigurojnë OST-së të dhënat e mëposhtme:

   a) të dhënat elektrike për transformatorët e lidhur me Sistemin e Transmetimit;
   b) karakteristikat e ngarkesës së objektit konsumator; dhe
   c) karakteristikat e kontrollit të Fuqisë Reaktive.

2. Çdo objekt konsumator i lidhur me Sistemin e Transmetimit, si minimum, do t'i komunikojë OST-së, skedulimin e konsumit aktiv dhe parashikimin e konsumit reaktiv në bazën e "Një-Ditë-Përpara" dhe "Brenda-Ditës", duke përfshirë çdo ndryshim të këtyre skedulimieve apo parashikimeve.
3. Çdo objekt konsumator i lidhur me Sistemin e Transmetimit, do t'i komunikojë OST-së çdo kufizim për parashikimin mbi aftësinë e kontrollit të fuqisë reaktive.
4. Çdo objekt konsumator i lidhur me Sistemin e Transmetimit i cili merr pjesë në grupin e konsumatorëve rregullues, do të informojë OST-në në lidhje me minimumin dhe maksimumin e fuqisë që mund të kufizohet.
5. Çdo objekt konsumator i lidhur drejtpërdrejt me Sistemin e Transmetimit, do t'i komunikojë në kohë reale OST-së informacionin e mëposhtëm:

   a) fuqinë aktive dhe reaktive në pikën e lidhjes; dhe
   b) minimumin dhe maksimumin e fuqisë që do të mund të kufizohet.

6. Çdo objekt konsumator i lidhur drejtpërdrejt me Sistemin e Transmetimit do t'i përshkruajë OST-së luhatjen e niveleve të tensionit sipas dispozitave të Nenit 111.

Neni 130. Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST-së dhe Objekteve Konsumatore të lidhura në Rrjetin e Shpërndarjes ose Agregatorëve

1. Kërkesat e mëposhtme do të përcaktohen nga OST në koordinim me OSSH. Çdo përdorues i rëndësishëm i cili është objekt konsumator, i lidhur me rrjetin e shpërndarjes dhe merr pjesë në

grupin e Konsumatorëve Rregullues, jashtë grupimit agregator, do t'i komunikojë në kohë reale OST-së dhe/ose nëpërmjet OSSH-së të dhënat e mëposhtme:

a) minimumin dhe maksimumin e fuqisë aktive në dispozicion për rregullimin e ngarkesës, dhe kohëzgjatjen maksimale dhe minimale të përdorimit të mundshëm të kësaj fuqie për rregullimin e ngarkesës;
b) parashikimin e fuqisë aktive të pakufizuar (të sigurtë) që është disponibël për çdo rregullim të mundshëm të ngarkesës;
c) fuqinë aktive dhe reaktive në kohë reale në pikën e lidhjes; dhe
d) konfirmimin së janë aplikuar vlerat aktuale të vlerësuara të reagimit (përgjigjes) të ngarkesës.

2. Kërkesat e mëposhtme do të përcaktohen nga OST në koordinim me OSSH. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit që është Agregator dhe që merr pjesë në rregullimin e ngarkesës, do t'i komunikojë OST-së dhe/ose nëpërmjet OSSH-së, për ditën përpara (D-1) dhe brenda ditës, në kohë reale, në emër të të gjithë grupit të konsumatorëve që përfshin (agregon) sa më poshtë:

a) minimumin dhe maksimumin e fuqisë aktive në dispozicion për rregullimin e ngarkesës, dhe kohëzgjatjen maksimale dhe minimale të ndonjë aktivizimi të mundshëm të urdhërit për rregullim ngarkesë, në një zonë të caktuar gjeografike të përcaktuar nga OST dhe OSSH;
b) parashikimin e fuqisë aktive të pakufizuar që është për çdo nivel të planifikuar për rregullim ngarkesë, në një zonë të caktuar gjeografike të përcaktuar nga OST dhe OSSH;
c) fuqinë aktive dhe reaktive në kohë reale; dhe
d) konfirmimin së janë aplikuar vlerat aktuale të vlerësuara të reagimit (përgjigjes) të ngarkesës.

Neni 131. Përgjegjësitë e përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit

1. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit me pikë lidhje direkt me Sistemin e Transmetimit, do të sigurojnë se impiantet e tyre janë në përputhje me kërkesat e Kodit të Transmetimit, të cilat janë mjaft të rëndësishme për lidhjen dhe ndërveprimin e tyre me Sistemin e Transmetimit. Kjo pajtueshmëri duhet të ruhet përgjatë gjithë kohës punës së impiantit.
2. Para inicimit të ndonjë modifikimi, çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit do të njoftojë OST-në ose OSSH-në, në varësi të pikës së lidhjes që ai ka, në lidhje me çdo ndryshim të planifikuar të kapaciteteve të tij teknike, i cili mund të ketë ndikim në pajtueshmërinë e tij me kërkesat e Kodit të Transmetimit.
3. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit duhet të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur OST-në ose OSSH-në, me të cilin ai ka pikën e lidhjes, në lidhje me ndonjë çrregullim operacional të objekteve të tij, të cilët mund të kenë një ndikim në pajtueshmërinë e tij me kërkesat e Kodit të Transmetimit.
4. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit duhet të njoftojë OST-në ose OSSH-në, me të cilin ai ka pikën e lidhjes, për kryerjen e çdo testimi të parashikuar, për oraret e tyre si dhe procedurat që do të ndiqen, në mënyrë që të lejojë OST-në ose OSSH-në të vlerësojnë dhe të zbusin kur është e nevojshme, rreziqet që mund të ketë Sistemi i Transmetimit ose i Shpërndarjes; në mënyrë që të verifikohet paraprakisht përputhshmëria e impiantit të përdoruesit të rëndësishëm të rrjetit me kërkesat e Kodit të Transmetimit.
5. OST ose OSSH, në të cilin përdoruesi i rëndësishëm i rrjetit ka pikën e lidhjes, miraton testet e parashikuara, apo edhe oraret e procedurat e testimit, përpara inicimit të tyre.

6. Përdoruesi i rëndësishëm i rrjetit duhet t'i mundësojë pjesëmarrjen në teste të tilla OST-së ose OSSH-së në të cilën ai ka pikën e lidhjes. Më tej, OST ose OSSH do të ketë të drejtën për të regjistruar performancën e këtyre impianteve.
7. Në rastin kur përdoruesi i rëndësishëm i rrjetit ka pikën e lidhjes me OSSH-në dhe ndërvepron vetëm me rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me piken (1) deri ne (6) të këtij neni, OST ka të drejtën që të kërkojë çdo rezultat të pajtueshmërisë së këtyre testimeve, nëse kjo është e rëndësishme për sigurinë operacionale të Sistemit të Transmetimit.
8. Me kërkesë të OST-së ose të OSSH-së, përdoruesi i rëndësishëm i rrjetit do të kryejë teste dhe simulime në çdo kohë, përgjatë kohëzgjatjes së punës të objektit, në veçanti pas ndonjë defekti në impiantet e tyre, modifikimi ose zëvendësim të ndonjë pajisjeje e cila mund të ketë një ndikim të konsiderueshëm në përmbushjen e kërkesave të Kodit të Transmetimit, si dhe mundësinë për të arritur disponueshmërinë e deklaruar ose dispozitat fizike kontraktuale lidhur me shërbimet e ndihmëse.
9. Agregatorët e përfshirë në rregullimin e ngarkesës direkt me OST, Agregatorët e përfshirë në procesin e ri-dispeçerimit si dhe kontributorët në rezervën e fuqisë aktive, do të sigurojnë së impiantet në zotërim të tyre janë në përputhje me kërkesat e Kodit të Transmetimit.

Neni 132. Përgjegjësitë e OST dhe OSSH

1. OST është përgjegjëse për sigurinë operacionale në zonën e vet të përgjegjsisë në aspektin e:
   a) përdorimit të mjeteve brenda zonës së vet të përgjegjësisë, duke përfshirë operimin në kohë reale, planifikimin operacional, zhvillimin dhe shpërndarjen e aseteve dhe dhënien e zgjidhjeve për parandalimin dhe riparimin e defekteve;
   b) përdorimit të mjeteve të mundësuara përmes bashkëpunimit me palët e tjera të interesit, duke përfshirë këtu ri-dispeçimin ose ri-skedulimin dhe menaxhimin e kongjestioneve, rezervave operative dhe shërbimeve të tjera ndihmëse;
   c) respektimit të rregullave të ENTSO-E mbi shkallën e klasifikimit të incidenteve ;
   d) identifikimit, vlerësimit dhe implementimit të përmirësimeve të nevojshme të mjeteve, bazuar në këtë nen pika (1)(a) dhe 132(1)(b), ose inicimit të amendamenteve të Kodit me qëllim ruajtjen e sigurisë operacionale;
   e) identifikimit, vlerësimit dhe implementimit të përmirësimeve të nevojshme të mjeteve, bazuar në Nenin 132(1)(a), përfshirë zhvillimin dhe implementimin e shërbimeve të reja ndihmëse dhe implementimin e strukturave të reja në kuadër të shkëmbimit të informacioneve dhe të të dhënave, ku bashkëpunimi me palët e tjera të interesit është i nevojshëm dhe kërkohet në mënyrë që të ruhet siguria operacionale.
2. OST do të kontribuojë në raportimet vjetore të zhvilluara në përputhje me shkallën e klasifikimit të incidenteve të përbashkëta, të adoptuara nga ENTSO-E . Formati dhe përmbajtja e këtij raporti vjetor, përfshin shtrirjen gjeografike të incidentit të rapotuar, ndërvarësitë ndërmjet zonave të përgjegjësisë të OST-ve si dhe informacionin relevant të bazuar në të kaluarën, i cili do të aprovohet nga ACER. Raporti vjetor duhet të përmbajë të gjithë mbarëvajtjen e sigurisë operacionale sipas treguesve të klasifikuar me shkallë nga 1 deri në 3:
   a) Numrin e stakimeve (në avari) të elementeve të transmetimit, në vit;
   b) Numri i stakimeve të agregatëve të prodhimit të energjisë elektrike në vit;
   c) Energjinë e pafurnizuar për shkak të stakimeve, në vit;
   d) Kohëzgjatja e të qenit në gjendje operative, jashtë gjendjes normale;
   e) Kohëzgjatja dhe numri i eventeve në të cilat është identifikuar mungesa e rezervës rregulluese;

f) Devijimi i tensionin kur ai tejkalon kufijtë e lejuar, në gjendje emergjence;
g) Devijimi frekuencës në Zonën Sinkrone;
h) Numri i rasteve të ndarjes së Sistemit ose i rënieve të pjesëshme të tij; dhe
i) Numri i rënieve totale të Sistemit që përfshin dy ose më shumë OST.

Raporti vjetor duhet të përmbajë shpjegime të shkaqeve të incidenteve të ndodhura, të cilat cënojnë sigurinë operacionale të shkallës 2 dhe 3, sipas Nenit 132(3).

3. Renditja sipas cënimit të Sigurisë Operacionale, në raportin vjetor, klasifikohet sipas shkallëve të mëposhtme, mbështetur në Nenin 132(1)(d) dhe 132(1)(e):

a) Shkalla 1, kur ndonjë avari primare mund të ketë ndikim të lartë të sigurisë së sistemit dhe/ose ndikim të lartë në tregun e energjisë elektrike, pasojat e të cilit mund të shkaktojnë një cënim të dukshëm të standardeve për të paktën dy Operatorë të Sistemit të Transmetimit;
b) Shkalla 2, kur ndonjë avari primare mund të çojë në degradimin e qëndrueshmërisë së sistemit, me nevojën për të aktivizuar të paktën një nga masat e Planit të Mbrojtjes së Sistemit;
c) Shkalla 3, kur ka rënie totale të Sistemit në zonën e përgjegjësisë, për më shumë se një OST;

4. OST ose OSSH do të vlerësojë (duke qenë prezent kur është e nevojshme), në çdo kohë, proçesin e pajtueshmërisë së testimeve të impianteve të përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit, me kërkesat e Kodit të Transmetimit.
5. OST ose OSSH, ku përdoruesi i rëndësishëm i rrjetit ka pikën e lidhjes, ka të drejtën të bëjë vlerësimin e përputhshmërisë së përdoruesit të rëndësishëm të rrjetit, me kërkesat e Kodit të Transmetimit, inputet ose outputet e pritshme, si dhe detyrimeve kontraktuale të Shërbimeve Ndihmëse.
6. OST ose OSSH, ku përdoruesi i rëndësishëm i rrjetit ka pikën e lidhjes, do të bëjë publike listën e informacioneve dhe dokumentacionit që duhet të sigurohet, së bashku me kërkesat që duhet të përmbushen nga përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit, në kuadër të testimeve të pajtueshmërisë. Kjo listë duhet së paku të përfshijë informacionet, dokumentet dhe kërkesat e mëposhtme:

a) të gjithë dokumentacionin dhe certifikatat e pajisjeve që do të ofrohen nga përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit;
b) detaje mbi të dhënat teknike të objekteve të përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit e me rëndësi për funksionimin e Sistemit;
c) kërkesat për modelet e vlerësimit të stabilitetit dinamik; dhe
d) studime të realizuara nga përdorues të rëndësishëm të rrjetit të cilat demostrojnë rezultatet e pritshme mbi vlerësimet e stabilitetit dinamik, aty ku është mundur të aplikohet.

7. OST ose OSSH, kur është e mundur, duhet të bëjë disponibël publikisht, alokimin e përgjegjësive të përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit, lidhur me testimin e pajtueshmërisë dhe monitorimin.
8. OST do të kryejë analizat e nevojshme dhe planifikimin duke përdorur modelin e rrjetit të zonës sinkrone ose të një pjese të tij, për të siguruar që testimet në zonën e saj të përgjegjësisë të kryhen në mënyrë të tillë që të minimizohet ndikimi në sigurinë e operimit të Sistemit të interkonektuar, si dhe të përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit.

9. OST do t'i sigurojë OST-ve fqinje informacionin lidhur me testimin, të paktën sipas marrëveshjes shumëpalëshe të konkluduar në përputhje me Kodin e Planifikimit Operacional dhe Skedulimit. I njëjti informacion do t'i sigurohet gjithashtu edhe OSSH-së.
10. OST do të përpilojë një listë me përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit, objekte gjenerimi apo konsumi, me prioritet të lartë, lidhur me kushtet e ndarjes nga rrjeti dhe të ri-energjizimit të tyre.
11. OSSH është përgjegjëse për cilësinë, besueshmërinë dhe sigurinë në rrjetin e saj të shpërndarjes.

Neni 133. Testimi i përbashkët dhe përgjegjësitë e analizës së incidenteve

1. OST, OSSH dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit me pikë lidhje direkte në sistemin e transmetimit, duhet të monitorojnë zonat e tyre të përgjegjësisë, dhe mund të kryejnë testime operacionale kur është e nevojshme si dhe mund të marrin pjesë në analizimin e ngjarjeve në mënyrë që:
   a) të sigurojnë funksionimin në mënyrë korrekte të elementeve të Sistemit të Transmetimit, të rrjetit të shpërndarjes dhe objekteve të përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit;
   b) të mirëmbajnë dhe zhvillojnë procedurat operacionale;
   c) të sigurojnë përmbushjen e detyrimeve mbi shërbimet ndihmëse;
   d) të trajnojnë stafin;
   e) të marrin informacion mbi performancën e sistemit dhe pajisjeve të tij në kushte të ndryshme pune, duke përfshirë këtu:
   i. teste që përfshijnë zbatimin e kontrolluar të variacionit të frekuencës ose tensionit, me qëllim grumbullimin e informacioneve mbi sjelljen e sistemit;
   ii. testimin e procedurave standarde në gjendje emergjence dhe në rivendosje.
2. OST do të ketë sigurinë operacionale të Sistemit të Transmetimit dhe zonën përkatëse të përgjegjësisë, si shqetësimin kryesor, gjatë fazës së testimit. Çdo testim mund të shtyhet ose të ndërpritet për shkak të kushteve apo një situate të pa-planifikuar të sistemit, e vlerësuar kjo nga OST, ose për arsye sigurie të personelit dhe/ose pajisjeve, sipas vlerësimit të bërë nga OSSH apo përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit.
3. Në rast të përkeqësimit të gjendjes së Sistemit, në kohën po kryhet testimi, OST ka të drejtën ta ndërpresë menjëherë testimin. Nëse OST ose një përdorues i rëndësishëm i rrjetit është duke kryer një testim, i cili influencon një OST tjetër fqinje, gjendja e së cilës ndryshon nga normale në gjendje alarmi ose emergjence, atëherë me kërkesën e kësaj të fundit, OST apo përdoruesi i rëndësishëm i rrjetit që po kryen testimin, duhet ta ndërpresë menjëherë atë.
4. OST, OSSH dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit, dhe OST me OST-të fqinje, do të shkëmbejnë çdo të dhënë të nevojshme për kryerjen e analizave të plota të incidenteve, me shtrirje lokale apo të zgjeruar, dhe për të lehtësuar analizat e Sistemit.
5. OST do të sigurojë se rezultatet e testimeve të kryera si dhe analizat e incidenteve janë:
   a) të përfshira në një proçes trajnimi dhe certifikimi;
   b) të përdoren si të dhëna hyrëse për proçeset e kërkim zhvillimit të ENTSO-E; dhe
   c) të përdoren për përmirësimin e proçedurave operacionale përfshirë këtu dhe proçedurat e emergjencës dhe rivendosjes.

Neni 134. Hartimi i Planit të Mbrojtjes së Sistemit

1. OST do të hartojë Planin e Mbrojtjes së sistemit në konsultim me OSSH-së, Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit, dhe OST-të fqinje.
2. Kur dizenjon Planin e Mbrojtjes Sistemit, OST do të marrë parasysh, së paku:
   a) kufinjtë e Sigurisë Operacionale;
   b) sjelljen dhe aftësinë e ngarkesës dhe gjenerimit;
   c) nevojat specifike të Përdoruesve të Rëndësishëm të Rrjetit me përparësi të lartë në pajtim me Nenin 132(10) të Kodit ;
   d) karakteristikat e Rrjetit të OST dhe OSSH-së
3. Në hartimin e Planit të Mbrojtjes Sistemit, OST do të respektojë parimet e mëposhtme:
   a) ndikimi për Përdoruesit e Sistemit të jetë minimal;
   b) masat të jenë ekonomikisht efiçente;
   c) të aktivizohen vetëm masat e nevojshme; dhe
   d) masat nuk do të rrezikojnë Sigurinë Operative të Sistemit ose të Sistemeve të Transmetimit të Interkonektuara.
4. Plani i Mbrojtjes Sistemit do të përfshijë së paku :
   a) Skemat e Mbrojtjes Sistemit përfshijnë së paku:
      i. skemën e kontrollit automatik nga nën-frekuenca
      ii. skemën e kontrollit automatik nga mbi-frekuenca dhe;
      iii. skemën e kontrollit automatik nga kolapsi Tensionit
   b) Procedura e Planit të Mbrojtjes Sistemit, përfshin së paku:
      i. procedurën e menaxhimit të devijimit të Frekuencës;
      ii. procedurën e menaxhimit të devijimit të Tensionit;
      iii. procedurën e menaxhimit të flukseve;
      iv. asistence për procedurën e Fuqisë Aktive;
      v. procedurën e çkycjes manuale të Kërkesës.
5. OST do të përcaktojë së paku në proçedurat e saj të Planit të Mbrojtjes së sistemit:
   a) kushtet nën të cilat aktivizohet procedura, në pajtim me Nenin 135;
   b) grupi i masave përkatëse;
   c) udhëzimet që lëshohen nga OST për Planin e Mbrojtjes Sistemit; dhe
6. OST do të njoftojë Entin Rregullator dhe autoritetet e tjera kompetente për së paku elementet e mëposhtëm të Planit të Mbrojtjes Sistemit:
   a) objektivat që synohen të arrihen, përfshirë fenomenet që do menaxhohen ose situatat që do zgjidhen;
   b) kushtet që çojnë dhe nxitin masat e Planit të Mbrojtjes;
   c) parimin e përgjithshëm për çdo masë, duke shpjeguar se si secila masë kontribuon në objektivat e mbrojtjes sistemit dhe kush do ti implementojnë këto masa; dhe
   d) afatet për implementimin e masave.
7. Në hartimin e Planit të Mbrojtjes së Sistemit, OST duhet të :
   a) listojë masat që do zbatohen në instalimet e saj.
   b) listojë masat që do të implementohen nga OSSH;

c) identifikojë Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit që do implementojnë masat në instalimet e tyre, dhe ti listojë masat që do implementohen nga këto Përdorues të Rëndësishëm të Rrjetit;
d) listojë masat që do zbatohen nga përdoruesit relevante të rrjetit; dhe
e) identifikojë afatet e zbatimit për masat e listuara.

Neni 135. Implementimi i Planit të Mbrojtjes së Sistemit

1. OST do të zbatojë dhe mirëmbajë masat e Planit të Mbrojtjes të cilat do të implementohen në Sistemin e Transmetimit.
2. OST do të njoftojë:

   a) OSSH-në për masat, përfshirë afatet për zbatim, të cilat do të zbatohen mbi:
      i. instalimet e tyre në pajtim me Nenin 134(7) dhe/ose
      ii. instalimet e Përdoruesit të Rëndësishëm të Rrjetit të identifikuar në Pajtim me Nenin 134(7) të lidhur në Sistemin e Shpërndarjes; dhe/ose
      iii. Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit të identifikuar në pajtim me Nenin 134(7) për masat të cilat do të zbatohen në instalimet e tyre, përfshirë afatet për implementim.

3. OSSH do të njoftojë Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit, për masat e Planit të Mbrojtjes së Sistemit që ata duhet të zbatojnë në instalimet e tyre, përfshirë afatet për implementim, përveç nëse OST tashmë i njofton ata në pajtim me Kodin e Transmetimit .
4. OSSH dhe Përdoruesi i Rëndësishëm i Rrjetit duhet të :

   a) zbatojë masat e dhëna si njoftim asaj/atij, dhe konfirmojë këtë zbatim si dhe do të njoftojë OST-në,
   b) mirëmbajë masat e implementuara në instalimet e saj.

Neni 136. Aktivizimi i Planit të Mbrojtjes së Sistemit

1. OST do të aktivizojë procedurat e Planit të Mbrojtjes në koordinim me OSSH dhe Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit të identifikuar në pajtim me Nenin 134(7).
2. Përveç masave të aktivizuara automatikisht të Planit të Mbrojtjes, OST do të aktivizojë procedurën e Planit të Mbrojtjes së Sistemit kur:

   a) sistemi është në Gjendje Emergjence për shkak të së paku një devijimi nga Limitet e Sigurisë Operacionale dhe kohëve në pajtim me Nenin 109 (1) të kodit dhe s'ka të disponueshme masa përmirësuese për të rivendosur sistemin në Gjendje Normale; ose
   b) në pajtim me analizat e sigurisë operacionale, siguria operacionale e Sistemit të Transmetimit kërkon aktivizimin e një mase të Planit të Mbrojtjes përveç veprimeve përmirësuese të disponueshme.

3. OST do të koordinohet me OST-të e tjera që ndikohen nga aktivizimi i masave të Planit të Mbrojtjes së Sistemit .

Neni 137. Plani i Rivendosjes

1. Plani i Rivendosjes hartohet nga OST-ja në konsultim me të gjithë përdoruesit e rrjetit të transmetimit .

2. Plani i rivendosjes si për rënie të pjesëshme ose të plotë të tij, zbatohet nga OST-ja dhe gjithë Përdoruesit e rrjetit të transmetimit.
3. Operatori i Sistemit është përgjegjës për ndjekjen në kohë të proçedurave sipas planit të rivendosjes, për rënie të pjesëshme ose totale të SE. Këto proçedura dhe urdhëra dokumentohen në librin e shërbimit operativ dhe pasqyrohen në një proces-verbal të veçantë.
4. OST-ja në përgatitjen e Planit të Rivendosjes kërkon koordinimin e integruar edhe të detyruar të Përdoruesve të rrjetit të transmetimit.
5. Stafet operative të Përdoruesve të rrjetit të transmetimit duhet të zbatojnë urdhërat sipas proçedurave të rivendosjes, të urdhëruara nga Operatori i Sistemit.
6. Operatori i Sistemit është përgjegjës për drejtimin e përgjithshëm të proçesit të rivendosjes së SE, përmes koordinimit me të gjithë përdoruesit e rrjetit të Sistemit të Transmetimit dhe qendrat koordinuese të Rajonit të rrjetit ENTSO-E, në përputhje me kërkesat e Kodit të Transmetimit.
7. Gjeneruesit janë përgjegjës për nisjen e proçedurave të tyre të planifikuara të startimit (black start) dhe me urdhër nga Operatori i Sistemit realizojnë sinkronizimin e njësive të tyre gjeneruese.

Neni 138. Proçedurat e Ristartimit

1. Gjendja ekzistuese e ngjarjes apo avarisë p.sh.disponueshmëria e njësive gjeneruese, linjave të transmetimit dhe nënstacioneve, si dhe e ngarkesës në tërësi, përcaktojnë proçesin që do të zbatohet në rast të një rënie të plotë ose të pjesëshme të Sistemit Elektroenergjitik.
2. Qendra Kombëtare Dispeçer me Qendrat Dispeçer Rajonale koordinojnë veprimet për të përcaktuar shtrirjen e ngjarjes apo avarisë, pra për të përcaktuar llojin e rënies së sistemit elektroenergjitik (i pjesëshëm dhe në ç'pjesë, apo i plotë).
3. Operatori i Sistemit udhëzon të gjithë përdoruesit e rrjetit të transmetimit për situatën dhe ndjek strategjinë e përshkruar me poshtë, bazuar në gjendjen pas ngjarjes apo avarisë.
4. Përdoruesit e rrjetit të transmetimit ndjekin e zbatojnë udhëzimet dhe urdhërat e Operatorit të Sistemit. Urdhërat jepen nëpërmjet kanaleve të telekomunikimit, në radhë të pare nëpërmjet rrjetit të telekomunikimit të OST të destinuar vetëm për veprimet operative.

Neni 139. Kontrolli, Mbikqyrja, Testimi

1. Kontrolli, mbikqyrja dhe testimi duhet të kryhen në përputhje me proçedurat për:
   a) Kontrollin dhe mbikqyrjen e të gjithë përdoruesve të rrjetit të transmetimit (Njësitë Gjeneruese, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Klientët e lidhur me rrjetin e sistemit të transmetimit) për të verifikuar parametrat e operimit.
   b) Testimin e njësive gjeneruese për të verifikuar përputhueshmërinë e parametrave dhe sistemeve teknologjike të tyre, në përputhje me deklaratat dhe të dhënat e tyre.
   c) Testimin e sistemeve/objekteve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Klientëve të rrjetit të transmetimit, për të verifikuar përputhueshmërinë e parametrave dhe sistemeve teknologjike të tyre, në përputhje me deklaratat e tyre.
   d) Testimin e Ofruesve të Shërbimit të Restaurimit dhe të Mbrojtjes
2. Qëllimi i këtij neni është të shqyrtojë nëse:
   a) Njësitë gjeneruese të Gjeneruesit operojnë në përputhje me parametrat teknike të deklaruar si dhe të gadishmërisë së tyre.

b) Sistemet/objektet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Klientit të rrjetit të transmetimit të operojnë në përputhje me parametrat teknike të deklaruar si dhe të gatishmërisë së tyre.

3. Veprimet e kontrollit, mbikqyrjes dhe testimit kryhen nga OST-ja kur:

a) Njësitë Gjeneruese gjatë operimit operojnë me parametra jashtë atyre të deklaruar;
b) Sistemet/objektet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Klientit të rrjetit të transmetimit operojnë me parametra jashtë atyre të deklaruar;
c) Një përdorues i rrjetit të Sistemit të Transmetimit nuk zbaton urdhërat apo udhëzimet e Operatorit të Sistemit, ose dështon në zbatimin e urdhërave të tij.

Neni 140. Testimi i Aftësive për t'ju përgjigjur kërkesave të OST

1. Testimi i kapacitetit të gjenerimit dhe absorbimit të fuqisë reaktive të njësive gjeneruese:

a) OST mund të kërkojë testimin e Njësive gjeneruese një here në vit me qëllim që të evidentojë nëse Njësia Gjeneruese respekton aftësinë gjenerim/absorbim të fuqisë reaktive;
b) Testimi kërkohet nga OST-ja dhe periudha e realizimit të tij miratohet edhe nga Operatori i Sistemit ;
c) OST duhet të njoftojë Gjeneruesin për qëllimin e testimit 48 ore përpara.
d) Nëse nga testimi i Njësisë Gjeneruese rezulton që parametrat e testuar nuk përgjigjen i parametrave të deklaruar atëherë Gjeneruesi duhet të përgatisë për OST brenda 5 ditëve një raport të detajuar, duke specifikuar arsyet dhe masat që duhen marrë.
e) Nëse devijimet janë të mëdha dhe të pakorrigjueshme, propozohet rishikimi i marrëveshjes midis OST dhe Gjeneruesit.

2. Testimi i aftësisë për Rezervën Primare FCR dhe Sekondare FRR (LFC):

a) Testimi i aftësisë për të venë në dispozicion Rezervën Primare FCR dhe Sekondare FRR (LFC) kryhet në mënyrë të detyrueshme nga OST-ja.
b) Ky testim kryhet në mënyrë periodike në kohë reale nga Operatori i Sistemit nëpërmjet instalimeve SCADA dhe të telematjes, në korrelacion me veprimtarinë e kontrollit dhe mbikqyrjes për operimin e njësive generuese.
c) Në qoftë se nga testimi i njësisë gjeneruese rezulton që parametrat e testuar për këto rezerva nuk i përgjigjen parametrave të deklaruar, atëherë gjeneruesi duhet të përgatisë për OST brenda 5 ditëve një raport të detajuar, duke specifikuar arsyet dhe masat që duhen marrë.
d) Nëse devijimet janë të mëdha dhe të pakorrigjueshme, propozohet rishikimi i marrëveshjes midis OST dhe Gjeneruesit.

Neni 141. Testimi i Aftësive të Startimit të Njësisë Gjeneruese

1. Testimi i aftësisë së startimit të njësive gjeneruese bëhet në mënyrë të detyrueshme një herë në vit për çdo njësi gjeneruese të Gjeneruesit, me qëllim që të evidentojë nëse Njësia Gjeneruese respekton aftësinë e startimit të shpejtë sipas parametrave të deklaruar.
2. Testimi kërkohet nga OST vetëm gjatë kohës në të cilën Njësia Gjeneruese është deklaruar në gjendje gatishmërie.
3. OST duhet të njoftojë Gjeneruesin për qëllimin e testimit 48 ore përpara.

4. Në qoftë se nga testimi i njësisë gjeneruese rezulton që parametrat e testuar nuk i përgjigjen parametrave të deklaruar, atëherë Gjeneruesi duhet të përgatisë për OST brenda 5 ditëve një raport të detajuar, duke specifikuar arsyet dhe masat që duhen marrë.
5. Nëse devijimet janë të mëdha dhe të pakorrigjueshme, propozohet rishikimi i marrëveshjes midis OST dhe Gjeneruesit.

Neni 142. Testimi i Aftësive për Pjesëmarrje në Rivendosjen e SE

1. OST i kërkon testim Njësive gjeneruese të listuar në Planin e Rivendosjes së SE, pas një avarie. Testimi bëhet një herë në vit me qëllim evidentimin e faktit nëse Njësia Gjeneruese ka mundësinë e startimit, konform kërkesave të Planit të Rivendosjes së SE.
2. Testimi mund të kryhet në një nga mundësitë e mëposhtme:
   a) Startimin e njësive gjeneruese (Black-Start) nga një burim i pavarur i energjisë elektrike (p.sh. Grup Diesel);
   b) Startimin e njësive gjeneruese nga nevojat vetiake të Gjeneruesit (regjim house-load);
3. OST duhet të njoftojë Gjeneruesin për qëllimin e testimit 7 ditë kalendarike përpara.
4. Në qoftë së nga testimi i Njësisë Gjeneruese rezulton që parametrat e testuar nuk i përgjigjen parametrave të deklaruar atëherë Gjeneruesi duhet të përgatisë për OST brenda 5 ditëve një raport të detajuar, duke specifikuar arsyet dhe masat që duhen marrë.
5. Nëse devijimet janë të mëdha dhe të pakorrigjueshme, propozohet rishikimi i marrëveshjes midis OST dhe Gjeneruesit.

KAPITULLI VI

KODI I KONTROLLIT FUQI-FREKUENCË DHE REZERVAVE

Neni 143. Subjekti dhe Fushëveprimi

1. Kodi i Kontrollit Fuqi-Frekuencë dhe Rezervave jep sigurinë e veprimeve në lidhje me stabilitetin e frekuencës së sistemit, duke siguruar:
   a) harmonizimin e objektivave të kualitetit të frekuencës së Sistemit;
   b) harmonizimin e proceseve të kontrollit dhe procedurave operacionale;
   c) harmonizimin e kërkesave minimale teknike për organizimin e ofrimit të rezervës nga ana e OST-ve;
   d) harmonizimin e kërkesave minimale teknike për njësitë dhe grupet e sigurimit të rezervës; si dhe
   e) harmonizimin e procedurave lidhur me shkëmbimet ndërkufitare, ndarjen dhe aktivizimin e rezervave të fuqisë aktive brenda zonës sinkrone, për përmirësimin e efikasitetit të përgjithshëm të operimit.
2. Ky Kod përcakton kërkesat minimale dhe principet për kontrollin fuqi-frekuencë dhe rezervat, të zbatueshme për OST, OSSH dhe Furnizuesit e Rezervës.
3. Ky Kod synon në:
   a) Arritjen dhe mbajtjen e një niveli të kënaqshëm të kualitetit të frekuencës dhe përdorimin eficent të Sistemit dhe resurseve;
   b) Sigurimin e sjelljes koherente dhe të koordinuar të Sistemit në operimin në kohë reale; dhe
   c) Përcaktimin e kërkesave të përbashkëta dhe principeve për FCR, FRR dhe RR; përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për shkëmbimin ndërkufitar, ndarjen, aktivizimin dhe dimensionimin e rezervave.
4. Asnjë veprim në përmbushjen e këtij Kodi nuk do të pengojë implementimin e aplikacioneve të reja, në përputhje me praktikat e mira të industrisë.

Neni 144. Marrëveshja Operacionale e Zonës Sinkrone

1. OST do të jetë nënshkruese e Marrëveshjes Operacionale të OST-ve të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale.

Neni 145. Marrëveshja Operacionale e Bllokut LFC

1. OST është aktualisht zonë kontrolli dhe bllok kontrolli. Me zhvillimet e pritshme rajonale, OST do të jetë pjesë e Marrëveshjes Operacionale të OST-ve të bllokut të Evropës Juglindore,për blloqet e zonës sinkrone.

Neni 146. Marrëveshja për Netimin e Imbalancës

1. Me krijimin e kushteve të përshtatshme për pjesëmarrje, OST do të jetë pjesë e Marrëveshjes për netimin e imbalancës, që do të nënshkruhet me OST-të fqinje, në përputhje me termat të cilet do të përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e çdo OST-je pjesmarrëse.

Neni 147. Marrëveshja për Ndarjen dhe/ose Shkëmbimin e Rezervave

1. Me krijimin e kushteve të përshtatshme për ndarjen ose shkëmbimin e rezervës së fuqisë aktive të FRR dhe/ose RR, OST do të bëjë një Marrëveshje me OST-të pjesmarrëse në këtë aktivitet ndërkufitar për ndarjen ose shkëmbimin e rezervës, në përputhje me termat të cilat do të përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e çdo OST-je pjesmarrëse.

Neni 148. Parametrat target (objektiv) të Kualitetit të Frekuencës

1. Parametrat përcaktues të kualitetit të frekuencës janë:
   a) Frekuenca nominale;
   b) Diapazoni i standardit (të devijimit të lejuar) të frekuencës;
   c) Devijimi maksimal i çastit i frekuencës;
   d) Devijimi maksimal i qëndrueshëm i frekuencës;
   e) Koha për rivendosjen e frekuencës;
   f) Koha e lëshimit (dhënies së sinjalit) për gjendje alarmi.
2. Frekuenca nominale është 50 Hz.
3. Vlerat e parametrave përcaktues të kualitetit të frekuencës, jepen në Tabelën 1.

Diapazoni i standardit të frekuencës	Devijimi maksimal i çastit i frekuencës	Devijimi maksimal i qëndrueshëm i frekuencës	Koha për rivendosjen e frekuencës	Koha për aktivizimin e gjendjes alarmit
±50 mHz	800 mHz	200 mHz	15 min	5 min

Tabela 1: Parametrat përcaktues të kualitetit të frekuencës.

4. Parametri objektiv i kualitetit të frekuencës do të jetë numri maksimal i minutave jashtë diapazonit të standardit të frekuencës gjatë një viti. Për zonën sinkrone të Evropës Kontinentale, vlera e tij e parazgjedhur (që nuk duhet të tejkalohet) është 15 000 minuta.
5. Parametrat përcaktues të kualitetit të frekuencës (3) dhe parametri objektiv i kualitetit të frekuencës (4), do të kenë vlerat e parazgjedhura të mësipërme, vetëm nëse OST-të e zonës sinkrone bien dakord për modifikimin e këtyre vlerave.

Neni 149. Procesi i aplikimit të kriterit dhe kriteri i vlerësimit të kualitetit të frekuencës.

1. Procesi i aplikimit të kriterit do të përfshijë:
   a) mbledhja e të dhënave të vlerësimit të kualitetit të frekuencës; dhe
   b) kalkulimi i kriterit të vlerësimit të kualitetit të frekuencës.
2. Kriteri i vlerësimit të kualitetit të frekuencës do të përfshijë:
   a) për operimin në gjendje normale apo alerti, për një periudhë 1-mujore; për një grup të dhënash që përmban vlerat mesatare të devijimit (ACE) të bllokut LFC për intervale kohore me një gjatësi të barabartë me kohën për të rivendosur frekuencën (15 min):
      i. vlerën mesatare;
      ii. devijimin standard;
      iii. vlerën korresponduese të percentile për 1- ,5-,10-, 90-,95- dhe 99-percentile;
      iv. numri i intervaleve kohore, kur devijimi e kalon masën e 60% të kapacitetit rezervë FRR (të rregullimit sekondar).

Neni 150. Procesi i grumbullimit dhe dërgimit të të dhënave

1. Procesi i grumbullimit dhe dërgimit të të dhënave do të përfshijë:
   a) Matjen e frekuencës së Sistemit;
   b) Kalkulimin e të dhënave për vlerësimin e kualitetit të frekuencës; dhe
   c) Dërgimin e të dhënave për vlerësimin e kualitetit të frekuencës, në qendrën koordinative monitoruese të zonës sinkrone.
2. Të dhënat e vlerësimit të kualitetit të frekuencës do të jenë:
   a) Të dhënat e frekuencës së çastit;
   b) Të dhënat e devijimit të frekuencës së çastit;
   c) Të dhënat e devijimit të çastit të gabimit ACE në MW;
3. Saktësia e matjes të frekuencës së çastit do të jetë 1 mHz.
4. OST si monitoruese e bllokut të saj LFC, do t'i dërgojë monitoruesit të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale, të dhënat për vlerësimin e kualitetit të frekuencës, në formatin dhe periodicitetin e kërkuar nga ana e tyre.

Neni 151. Informacioni mbi reagimin e gjenerimit dhe ngarkesës

1. Në përputhje me Nenin 117(3) dhe 117(4) të Kodit të Sigurisë Operacionale, OST ka të drejtë të kërkojë informacionin e nevojshëm nga Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit, për monitorimin e sjelljes së ngarkesës dhe gjenerimit në lidhje me disbalancat. Ky informacion mund të përfshijë:
   a) Pikën e vendosur të punës të fuqisë aktive në kohë reale dhe për operimin e mëtejshëm (për orët në vazhdim), të regjistruar me stampim kohe; dhe
   b) Prodhimin total të fuqisë aktive, të regjistruar me stampim kohe.

Neni 152. Struktura Bazë

1. OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë në Marrëveshjen Operacionale të Zonës së tyre Sinkrone, strukturën e kontrollit fuqi-frekuencë. Çdo OST është përgjegjëse për implementimin dhe operimin në përputhje me këtë strukturë të kontrollit fuqi-frekuencë.
2. Struktura e Kontrollit Fuqi-Frekuencë përfshin:
   a) Strukturën e procesit të aktivizimit; dhe
   b) Strukturën e procesit të përgjegjësisë.

Neni 153. Struktura e Procesit të Aktivizimit

1. Struktura e procesit të aktivizimit përfshin:
   a) Një proces të mbajtjes së frekuencës FCP, sipas Nenit 155; dhe
   b) Një proces të restaurimit të frekuencës FRP, sipas Nenit 156.
2. Struktura e procesit të aktivizimit mund të përfshijë:
   a) Një proces të zëvendësimit të rezervës RRP, sipas Nenit 157;
   b) Një proces të netimit të disbalancës, sipas Nenit 158;
   c) Një proces të aktivizimit ndërkufitar të FRR, sipas Nenit 159;
   d) Një proces të aktivizimit ndërkufitar të RR, sipas Nenit 160;
   e) Një proces të kontrollit të kohës, sipas Nenit 181.

Neni 154. Struktura e Procesit të Përgjegjësisë

1. Kur definohet struktura e procesit të përgjegjësisë, OST-të e zonës sinkrone do të marrin në konsideratë kriteret e mëposhtme:
   a) Madhësinë e zonës sinkrone dhe inercisë së saj totale, natyrale dhe sintetike;
   b) Strukturën e rrjetit dhe/ose topologjinë e tij; dhe
   c) Sjelljen e ngarkesës, gjenerimit dhe HVDC.
2. OST do të monitorojë dhe kalkulojë vazhdimisht në kohë reale fuqinë aktive që shkëmbehet me zonën e saj të monitorimit (kontrollit).
3. OST për zonën/bllokun e saj LFC, do të:
   a) monitorojë vazhdimisht devijimin ACE;
   b) implementojë dhe operojë proceset për FCP dhe FRP;
   c) bëjë të gjitha përpjekjet për plotësimin e parametrave target të devijimit ACE siç përcaktohen në Marrëveshjen Operacionale të OST-ve të gjithë zonës sinkrone;
   d) ketë të drejtë të implementojë një ose disa nga proceset referuar Nenit 153(2);
   e) plotësojë rregullat e dimensionimit për FCR, FRR dhe RR, siç jepen në Nenin 165, 168 dhe 170.
4. OST ka të drejtë të formojë apo të inkludohet në një bllok LFC me një ose disa prej OST-ve fqinje, duke plotësuar të gjitha kërkesat e këtij kodi për bllokun LFC.

Neni 155. Procesi i Mbajtjes së Frekuencës (FCP), (Rregullimi Primar)

1. Objektivi i kontrollit të FCP është stabilizimi i frekuencës me anë të aktivizimit të FCR;
2. Karakteristika e përgjithshme për aktivizimin e FCR në Zonën Sinkrone do të reflektojë një rënie në mënyrë monotone të aktivizimit të FCR në funksion të devijimit të frekuencës.

Neni 156. Procesi i Restaurimit të Frekuencës (FRP), (Rregullimi Sekondar)

1. Objektivi i kontrollit të FRP është:
   a) Rregullimi i devijimit ACE drejt vlerës zero, brenda kohës së restaurimit të frekuencës;
   b) Zëvendësimi progresiv i rezervës FCR të aktivizuar, nëpërmjet aktivizimit të rezervës për FRR.
2. FRCE është:
   a) Gabimi i kontrollit të zonës (ACE) të një zone LFC, kur ka më shumë së një zonë LFC në një zonë sinkrone; ose
   b) Devijimi i frekuencës kur një zonë LFC korrespondon me bllokun LFC dhe Zonën Sinkrone.
3. Devijimi ACE i zonës LFC do të kalkulohet sipas formulës: $ACE = \Delta P + K*\Delta F$, ku ΔP paraqet diferencën e fuqisë aktive të matur në interkonektorët (realë dhe virtualë) me fuqinë aktive të skeduluar sipas program kontrollit (programi komercial + programi kompensimit); K është faktori që paraqet pjerrësinë e karakteristikës fuqi-frekuencë të zonës përkatëse, dhe ΔF paraqet diferencën e frekuencës së çastit me frekuencën nominale apo atë të vendosur në kontrollorin sekondar.
4. Vlera e pikës së punës (setpoint) për FRR automatike do të kalkulohet nga një kontrollor i vetëm i restaurimit të frekuencës që operohet nga OST brenda zonës së saj LFC. Kontrollori i restaurimit të frekuencës do të:
   a) Jetë një pajisje kontrolli automatike e dizenjuar për reduktimin e ACE drejt vlerës zero;

b) Operohet në qark të mbyllur me ACE si input dhe vlerën e setpoint për aktivizimin e FRR si output;
c) Ketë natyrë (sjellje) proporcional-integrale; dhe
d) Ketë një algoritëm të kontrollit i cili nuk lejon termin integral të kontrolluesit proporcional-integral të akumulojë gabimin e kontrollit dhe tejkalimin e targetit.

5. Vlera e setpoint për aktivizim manual të FRR do të lihet në diskrecion të OST-së për zonën e saj të LFC.

Neni 157. Procesi i Zëvendësimit të Rezervës (RRP), (Rregullimi Terciar)

1. Objektivi i kontrollit të RRP është plotësimi i qëllimeve të mëposhtme:
   a) Rivendosja progresive e FRR të aktivizuar;
   b) Suportimi i aktivizimit të FRR.
2. Vlera e setpoint për aktivizimin e RR do të përcaktohet nga OST për zonën e saj të LFC.

Neni 158. Procesi i Netimit të Disbalancës

1. Objektivi i kontrollit të procesit të netimit të disbalancës është reduktimi i sasisë së aktivizimit të njëkohshëm të FRR në drejtime të kundërta, për pjesmarrës të ndryshëm në zonën LFC (kur kjo përbëhet nga dy ose më shumë OST), nëpërmjet shkëmbimit të ndërsjelltë të disbalancës. OST do të ketë të drejtën të implementojë procesin e netimit të disbalancës me zonat e tjera LFC brenda të njëjtit bllok ose ndërmjet blloqeve të ndryshme.
2. Procesi i netimit të disbalancës do të implementohet në mënyrë të tillë që nuk do të ndikojë:
   a) Në stabilitetin e FCP të zonës sinkrone;
   b) Në stabilitetin e FRP dhe RRP të çdo zone LFC që operohet nga OST-të pjesmarrëse ose të ndikuara; dhe
   c) Në sigurinë e operimit.

Neni 159. Procesi i aktivizimit ndërkufitar të FRR

1. Objektivi i kontrollit të procesit të aktivizimit ndërkufitar të FRR është mundësimi i një OST-je të kryejë procesin FRP me anë të shkëmbimit të fuqisë për rivendosjen e frekuencës, ndërmjet zonave LFC. OST do të ketë të drejtën të implementojë procesin e aktivizimit ndërkufitar të FRR me zonat/blloqet fqinje, duke konkluduar një Marrëveshje të aktivizimit ndërkufitar të FRR.
2. Procesi i aktivizimit ndërkufitar të FRR do të implementohet në mënyrë të tillë që nuk do të ndikojë:
   a) Në stabilitetin e FCP të zonës sinkrone;
   b) Në stabilitetin e FRP dhe RRP të çdo zone LFC që operohet nga OST-të pjesmarrëse ose të ndikuara; dhe
   c) Në sigurinë e operimit.

Neni 160. Procesi i aktivizimit ndërkufitar të RR

1. Objektivi i kontrollit të procesit të aktivizimit ndërkufitar të RR është mundësimi i një OST-je të kryejë procesin RRP me anë të shkëmbimit të fuqisë për zëvendësimin e rezervës, ndërmjet zonave LFC. OST do të ketë të drejtën të implementojë procesin e aktivizimit ndërkufitar të RR me zonat/blloqet fqinje, duke konkluduar një Marrëveshje të aktivizimit ndërkufitar të RR.

2. Procesi i aktivizimit ndërkufitar të RR do të implementohet në mënyrë të tillë që nuk do të ndikojë:
   a) Në stabilitetin e FCP të zonës sinkrone;
   b) Në stabilitetin e FRP dhe RRP të çdo zone LFC që operohet nga OST-të pjesmarrëse ose të ndikuara; dhe
   c) Në sigurinë e operimit.

Neni 161. Kërkesa të Përgjithëshme për Proceset e Kontrollit Ndërkufitar

1. OST-të që marrin pjesë në një shkëmbim ose ndarjen e FRR dhe/ose RR do të zbatojnë një proces të aktivizimit ndërkufitar të FRR dhe/ose të RR.
2. OST do të jetë pjesë e Marrëveshjes Operacionale të Zonës Sinkrone në të cilën përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e OST-ve që implementojnë një proces të netimit të disbalancës, një proces të aktivizimit ndërkufitar të FRR dhe/ose të RR, ndërmjet zonave LFC të blloqeve të ndryshme LFC.
3. OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të: (i) netimit të disbalancës, (ii) aktivizimit ndërkufitar të FRR dhe/ose të RR, do të përcaktojnë në një Marrëveshje Operimi rolet dhe përgjegjësitë e OST-ve, duke përfshirë por jo kufizuar në:
   a) ofrimin e të gjitha të dhënave të nevojshme për:
      i. llogaritjen e kapacitetit që do të shkëmbehet duke respektuar kufijtë e sigurisë operacionale;
      ii. analizat e sigurisë operacionale në kohë reale, nga OST-të pjesmarrëse dhe ato të ndikuara.
   b) përgjegjësinë për të llogaritur shkëmbimin e energjisë; dhe
   c) zbatimin e procedurave operative për të garantuar sigurinë e punës.

Neni 162. Njoftimi i OST-ve

1. OST-të që duan të implementojnë një proces netimi të disbalancës, një aktivizim ndërkufitar të FRR, një proces aktivizimi ndërkufitar të RR për shkëmbimin ose ndarjen e rezervave, do të dërgojnë një njoftim, tre muaj në avancë, për të gjitha OST-të e Zonës Sinkrone. Njoftimi duhet të përmbajë:
   a) OST-të e përfshira;
   b) sasinë e pritshme të shkëmbimit të energjisë për shkak të procesit të netimit të disbalancës, procesit të aktivizimit ndërkufitar të FRR ose procesit të aktivizimit ndërkufitar të RR;
   c) llojin e rezervës dhe sasinë e shkëmbimit ose ndarjes së rezervave; dhe
   d) afati kohor i shkëmbimit ose ndarjes së rezervave.
2. Kur një proces i netimit të disbalancës, i aktivizimit ndërkufitar të FRR ose i aktivizimit ndërkufitar të RR, implementohet për zona LFC të cilat nuk janë pjesë e të njëjtit bllok LFC, atëherë çdo OST e zonës sinkrone të përfshirë ka të drejtë të deklarohet, duke njoftuar të gjitha OST-të e zonës sinkrone, si OST e ndikuar, në bazë të analizave të Sigurisë Operative, brenda një muaji pas njoftimit.

Neni 163. Infrastruktura

1. OST në bashkëpunim me OST-të fqinje, do të konsiderojnë infrastrukturën teknike të nevojshme për të zbatuar dhe për të operuar një ose më shumë procese të renditura në Nenin 153, si kritike sipas Kodit të Sigurisë Operacionale.
2. Në Marrëveshjen Operacionale, OST-të do të përcaktojnë kërkesat minimale për disponueshmërinë, besueshmërinë dhe redundancën e infrastrukturës teknike të përmendur në pikën (1) më lart, duke përfshirë por jo kufizuar në:
   a) precizionin, rezolucionin, disponueshmërinë dhe redundancën e matjes së fuqisë aktive në interkonektorët realë dhe virtualë;
   b) disponueshmërinë dhe redundancën e sistemeve dixhitale të kontrollit;
   c) disponueshmërinë dhe redundancën e infrastrukturës së komunikimit; dhe
   d) protokollet e komunikimit.
3. Për zonën e saj LFC, OST duhet:
   a) të sigurojnë një cilësi të mjaftueshme dhe disponueshmërinë e llogaritjes së devijimit ACE;
   b) të kryejë në kohë reale monitorimin e cilësisë së llogaritjes të ACE;
   c) të marrë masa në rast të një llogaritje të gabuar të ACE; dhe
   d) të kryejë një monitorim ex-post të cilësisë së llogaritjes së ACE duke krahasuar vlerat e saj me vlerat reference, të paktën një herë në vit.

Neni 164. Gjendjet e Sistemit që lidhen me Frekuencën e Sistemit

1. OST do të shkëmbejë të dhëna në kohë reale, me OST-të e Zonës Sinkrone, nëpërmjet rrjetit elektronik (EH) të ENTSO-E, në përputhje me Nenin 119 të Kodit, për:
   a) Gjendjen e Sistemit të Transmetimit, siç përcaktohet në Nenin 109 të Kodit;
   b) Të dhënat e matjeve në kohë reale të ACE.
2. Monitorimi i Zonës Sinkrone do të përcaktojë gjendjen e sistemit në lidhje me frekuencën, referuar Nenit 109 të Kodit, dhe sipas kufijve të frekuencës së sistemit, të përcaktuara në pikat (3) dhe (4).
3. Për gjendjen normale, limitet e frekuencës së sistemit janë përmbushur kur:
   a) Devijimi i frekuencës në gjendje të qëndrueshme është brenda intervalit standard të frekuencës; ose
   b) Devijimi i frekuencës në gjendje të qëndrueshme është jo më i madh se 50% e devijimit maksimal të frekuencës në gjendje të qëndrueshme, për një periudhë kohore jo më të gjatë se koha për të rivendosur frekuencën; ose
   c) Devijimi i frekuencës në gjendje të qëndrueshme është jo më i madh së devijimi maksimal i frekuencës në gjendje të qëndrueshme, për një periudhë kohore jo më të gjatë së koha për sinjalizimin e gjendjes së alertit.
4. Për gjendjen e alertit, limitet e frekuencës së sistemit janë përmbushur kur:
   a) vlera absolute e devijimit të frekuencës në gjendje të qëndrueshme nuk është më e madhe së devijimi maksimal të frekuencës në gjendje të qëndrueshme; dhe
   b) limitet e frekuencës në gjendje normale nuk janë plotësuar.
5. Monitorimi Zonës Sinkrone do të sigurojë që të gjitha OST-të të informohen në rast së devijimi i frekuencës së sistemit plotëson një nga kriteret për gjendjen e alertit.
6. OST do të zbatojë rregullat e përbashkëta të përcaktuara në Marrëveshjen Operacionale të Zonës Sinkrone, për operimin e kontrollit fuqi-frekuencë në gjendje normale dhe gjendje alerti.

7. OST do të zvogëlojë devijimin ACE të bllokut të saj, me aktivizimin e rezervave të fuqisë aktive dhe nëse është e nevojshme me zbatimin e veprimeve, siç përcaktohet në pikën (8).
8. OST do të përcaktojë procedura operative për rastin e shterimit të rezervave FRR ose RR, sipas të cilave OST do të ketë të drejtë të kërkojë ndryshime në prodhimin Fuqisë Aktive ose në konsumin e Njësive Konsumatore.
9. OST do të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të shmangur devijimet ACE që vazhdojnë për më shumë së koha për të rivendosur frekuencën.

Neni 165. Dimensionimi i FCR

1. Të gjitha OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë kapacitetin FCR të nevojshëm për zonën sinkrone, dhe ndarjen e FCR të kërkuar për secilën OST si obligim fillestar për sigurimin e FCR.
2. OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë në Marrëveshjen Operacionale, rregullat e dimensionimit duke respektuar kriteret e mëposhtme:
   a) Kapaciteti FCR i kërkuar për zonën sinkrone duhet të paktën të mbulojë incidentin referencë të zonës sinkrone, bazuar në një analizë deterministike dhe duke respektuar parametrat e përcaktimit të kualitetit të frekuencës; dhe
   b) OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë një mënyrë të dimensionimit të FCR mbi bazën e parimit të mbulimit të disbalancës së mbetur në zonën sinkrone që ka të ngjarë të ndodhë sipas një probabilitet prej një herë në 20 vjet.
3. Madhësia e incidentit referencë përcaktohet duke respektuar kushtet e mëposhtme:
   a) Incidenti referencë do të jetë vlera absolute e disbalancës më të madhe që mund të rezultojë nga një ndryshim i menjëhershëm i fuqisë aktive të një ose dy moduleve të gjenerimit; ose
   b) Një ose dy interkonektorë HVDC të lidhur me të njëjtën nyje elektrike; ose
   c) Humbja maksimale e menjëhershme e konsumit të energjisë për shkak të stakimit të një ose dy pikave të lidhjes.
4. Ndarja e kapacitetit FCR e kërkuar për çdo OST si obligim fillestar, bazohet në shumën e gjenerimit neto dhe konsumit të zonës përkatëse, pjesëtuar me shumën e gjenerimit neto dhe konsumit të Zonës Sinkrone për një periudhë prej një viti.

Neni 166. Kërkesat Teknike Minimale të FCR

1. OST do të sigurojë që rezerva FCR të plotësojë karakteristikat e mëposhtme të listuara për zonën sinkrone të Evropës Kontinentale, që aplikohen për të gjitha njësitë gjeneruese që sigurojnë FCR, dhe në përputhje me kërkesat përkundrejt gjeneruesve, si në tabelën e mëposhtme:

Saktësia minimale e matjes së frekuencës	10 mHz, ose standardi industrial nëse është më i mirë
Efekti maksimal i kombinuar i pa-ndjeshmërisë inherente dhe zonës së vdekur që lihet enkas në aparatin drejtues të çdo njësie gjeneruese, siguruese e rezervës FCR.	10 mHz
Koha e aktivizimit të plotë të rezervës FCR	30 sec
Devijimi i frekuencës për aktivizimin e plotë të rezervës FCR.	±200 mHz

2. OST ka të drejtën të caktojë kërkesa shtesë për njësitë siguruese të FCR, brenda diapazonit të përcaktuar në kodin e kërkesave përkundrejt gjeneruesve, dhe të lidhjes së njësive konsumatore, bazuar në argumente teknike të tilla si shpërndarja gjeografike e njësive gjeneruese dhe atyre konsumatore siguruese të FCR, për garantimin e sigurisë operacionale. Siguruesit e FCR duhet të sigurojnë që monitorimi i aktivizimit të FCR për njësitë e tyre, është i mundëshëm.
3. Çdo njësi siguruese e FCR, mund të lidhet vetëm me një OST, pra mund t'i shërbejë vetëm një OST-je.
4. OST do të implementojë një proces parakualifikimi të FCR, për të vlerësuar përmbushjen e kërkesave teknike dhe disponueshmërinë e siguruesve potencialë të FCR. Ky proces duhet të përfshijë të paktën një rivlerësim në rast të ndryshimit të kërkesave apo pajisjeve dhe një rivlerësim periodik brenda kuadrit kohor të paktën pesë vjet.
5. OST do të sigurojë që aktivizimi i saj i FCR është në përputhje me kërkesat e zonës sinkrone.
6. OST do të monitorojë kontributin e saj në procesin FCP dhe aktivizimin e rezervës FCR, duke respektuar detyrimin e saj në lidhje me FCR për çdo njësi apo grup të sigurimit të FCR. Çdo sigurues i rezervës FCR duhet të vendosë në dispozicion të OST-së të paktën informacionin e mëposhtëm:
   a) statusin me stampim kohe, që tregon nëse FCR është në punë ose jo (on / off);
   b) të dhënat (me stampim kohe) të fuqisë aktive, të nevojshme për të verifikuar aktivizimin e FCR. Këto të dhëna do të përfshijnë, por nuk limitohen, në regjistrimin e fuqisë aktive të çastit;
   c) lëshimin (droop) të aparatit drejtues për modulet gjeneruese të tipit "me pikëlidhje në shpërndarje dhe /ose të lidhur në transmetim".

Me kërkesë të OST-së, çdo sigurues i FCR duhet ta bëjë këtë informacion të disponueshëm në kohë reale me një rezolucion kohor prej të paktën 10 sekonda.
Me kërkesë të OST-së, çdo sigurues i FCR duhet të bëjë disponibël të dhënat për instalimet teknike, të cilat janë pjesë e të njëjtës njësi siguruese të FCR, në rast së është e nevojshme për verifikimin e qartë të aktivizimit të FCR.

Neni 167. Sigurimi i Kapacitetit FCR

1. OST do të sigurojë disponueshmërinë e të paktën detyrimit të saj për FCR, në përputhje me Nenin 165(4), dhe 172.
2. OST-të e Zonës Sinkrone do të përcaktojë të paktën një herë në vit madhësinë e Faktorit K (K-Factor) duke marrë parasysh faktorët, përfshirë por jo kufizuar në:
   a) Kapacitetin e rezervës FCR, pjestuar me devijimin maksimal të frekuencës në gjendje të qëndrueshme;
   b) auto-kontrollin e gjenerimit; dhe
   c) vetë-rregullimin e ngarkesës duke marrë parasysh kontributin në përputhje me kodin e lidhjes së ngarkesës.
3. Ndarja e Faktorit K, do të bazohet në:
   a) Detyrimin fillestar të OST-së për FCR, pjestuar me kapacitetin FCR të zonës sinkrone;
   b) Sasia e kapacitetit FCR të siguruar nga njësitë ose grupet me pikë lidhje brenda zonës LFC.
4. Siguruesi i FCR duhet të garantojë disponueshmërinë e vazhdueshme të FCR, me përjashtim të ndonjë ndërprerje të detyruar të njësisë ofruese të FCR, gjatë periudhës kohore në të cilën ai është i detyruar të japë rezervën FCR.

Çdo sigurues i FCR duhet të informojë OST-në pa vonesë, në lidhje me çdo ndryshim në disponueshmërinë aktuale të ofrimit të FCR apo të një pjese të saj

5. OST do të sigurojë, ose do të kërkojë nga ofruesit e saj të FCR për tu siguruar që humbja e një njësie siguruese të FCR nuk rrezikon sigurinë e punës së sistemit, duke bërë:
   a) Shpërndarjen e FCR në mënyrë të tillë që njësia më e madhe siguruese e FCR të mos kalojë 5% të kapacitetit FCR të kërkuar për Zonën Sinkrone; dhe
   b) Zëvendësimin e njësisë siguruese të FCR që është bërë e padisponueshme për shkak të një ndërprerje të detyruar, sa më shpejt të jetë e mundur teknikisht dhe sipas kushteve që do të përcaktohen nga OST.
6. Një njësi ose grup siguruese e rezervës FCR:
   a) me një rezervuar të energjisë që nuk e kufizon aftësinë siguruese të FCR, do të aktivizojë FCR-në e saj për aq kohë sa vazhdon devijimi i frekuencës;
   b) me një rezervuar të energjisë që kufizon aftësinë siguruese të FCR, duhet të aktivizojë FCR-në e saj për aq kohë sa vazhdon devijimi i frekuencës, nëse rezerva e saj e energjisë nuk shteron.

   Një njësi siguruese e FCR me një rezervuar të energjisë që kufizon aftësinë siguruese të FCR, duhet të jetë në gjendje për të aktivizuar plotësisht FCR-në e saj në mënyrë të vazhdueshme, për një periudhë kohore prej jo më pak së 30 minuta, dhe duhet të marrë masat e duhura për të siguruar rimëkëmbjen e rezervuarit të energjisë, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë së brenda 2 orëve.

Neni 168. Dimensionimi i FRR

1. Rregullat e dimensionimit të FRR përfshijnë të paktën kërkesat e mëposhtme:
   a) OST do të përcaktojë kapacitetin e kërkuar FRR për bllokun e saj LFC, bazuar në të dhënat historike të njëpasnjëshme që përfshijnë vlerat historike të disbalancimit të bllokut LFC. Periudha e konsideruar me këto të dhëna do të jetë përfaqësuese dhe përfshin të paktën një vit të plotë duke përfunduar jo më herët së 6 muaj para llogaritjes;
   b) OST do të përcaktojë e kapacitetin FRR në mënyrë të tillë që të jetë i mjaftueshëm për të respektuar parametrat target të devijimit ACE, për periudhën e konsideruar historike të kohës bazuar së paku në një metodologji probabilistike. Në këtë metodologji, kufizimet lidhur me marrëveshjet e mundshme për ndarjen apo shkëmbimin e rezervave, për shkak të shkeljeve të mundshme të sigurisë operative dhe kërkesave të disponueshmërisë së FRR, do të merren parasysh;
   c) OST do të përcaktojë raportin ndërmjet kapacitetit që aktivizohet në mënyrë automatike aFRR, kapacitetit që aktivizohet në mënyrë manuale mFRR, kohën e aktivizimit të plotë të aFRR, kohën e aktivizimit të plotë të mFRR; në mënyrë të tillë që kërkesa (b) të mund të përmbushet. Për këtë, koha e aktivizimit të plotë të aFRR dhe koha e aktivizimit të plotë të mFRR, duhet që më së shumti të jetë sa koha për rivendosjen e frekuencës.
   d) OST do të përcaktojë madhësinë e incidentit dimensionues, i cili përfaqëson disbalancën më të madhe që mund të rezultojë nga një ndryshim i menjëhershëm i fuqisë aktive të një moduli të vetëm gjenerimi, nga një objekt i vetëm konsumi, nga një interkonektor HVDC ose nga stakimi i një linje AC brenda bllokut LFC.
   e) OST do të përcaktojë kapacitetin pozitiv të FRR, të tillë që të mos jetë më i vogël së incidenti dimensionues pozitiv i bllokut LFC; dhe kapacitetin negativ të FRR, të tillë që të mos jetë më i vogël së incidenti dimensionues negativ i bllokut LFC;

f) OST do të përcaktojë e kapacitetin FRR dhe kufizimet e mundshme gjeografike për shpërndarjen e tij brenda bllokut LFC, dhe kufizimet e mundshme gjeografike për ndonjë shkëmbim ose ndarje të rezervave me blloqe të tjera LFC, duke respektuar plotësimin e kërkesave të sigurisë operacionale;
g) OST do të sigurojë që kapaciteti pozitiv/negativ FRR ose një kombinim i kapacitetit FRR dhe RR është i mjaftueshëm për të mbuluar disbalancat pozitive/negative të bllokut LFC, në të paktën 99% të kohës bazuar në të dhënat historike siç përcaktohet në pikën (a);
h) OST do të lejohet për të reduktuar kapacitetin pozitiv/negativ FRR të bllokut LFC, që rezultojnë nga procesi i dimensionimit të FRR, duke konkluduar një Marrëveshje për ndarjen e FRR me blloqe të tjera LFC, në përputhje me dispozitat e Nenit nga 172 deri 180 të këtij Kodi. Reduktimi i kapacitetit pozitiv/negativ FRR të bllokut LFC është:
   i. i limituar në diferencën, nëse është pozitive, ndërmjet madhësisë së incidentit dimensionues pozitiv/negativ dhe kapacitetit FRR që kërkohet për të mbuluar disbalancat pozitive/negative të bllokut LFC në 99% të kohës bazuar në të dhënat historike, e përcaktuar në (a); dhe
   ii. asnjëherë nuk duhet të kalojë 30% të madhësisë së incidentit dimensionues pozitiv/negativ.

2. Kur blloku LFC do të përbëhet nga më shumë së një OST, atëherë OST-të e bllokut do të përcaktojë në Marrëveshjen Operacionale shpërndarjen specifike të përgjegjësive midis OST-ve të zonave LFC për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në pikën e mësipërme.

Neni 169. Kërkesat Teknike Minimale të FRR

1. Kërkesat teknike minimale të FRR do të jenë:
   a) çdo njësi ose grup i sigurimit të FRR do të jetë i lidhur vetëm me një OST lidhëse të rezervës;
   b) një njësi ose grup i sigurimit të FRR do të aktivizojë rezervën FRR në bazë të setpoint-it të marrë nga OST instruktuese e rezervës;
   c) OST instruktuese do të jetë OST lidhëse e rezervës, ose OST që do të përcaktohet në Marrëveshjen e shkëmbimit të rezervës ndërmjet OST-ve, në përputhje me dispozitat e Nenit 174;
   d) një njësi ose grup i sigurimit të FRR, për rezervën automatike aFRR do të ketë një vonesë të aktivizimit automatik të rezervës jo më shumë së 30 sekonda;
   e) ofruesi i FRR do të sigurojë që monitorimi i aktivizimit të FRR për çdo njësi është i mundur. Për këtë siguruesi i FRR duhet të jetë në gjendje të furnizojë OST-në lidhëse me matjet në kohë reale në pikën e lidhjes apo në një pikë tjetër të rakorduar me OST-në lidhëse, per:
      i. skedulimin e prodhimit të fuqisë aktive, me stampim kohe,
      ii. fuqinë aktive të çastit, me stampim kohe.
   f) një njësi ose grup i sigurimit të FRR, për rezervën automatike/manuale duhet të jetë në gjendje të aktivizojë komplet rezervën brenda kohës së plotë të aktivizimit automatik/manual të FRR;
   g) siguruesi i FRR duhet të përmbushë kërkesat e disponueshmërisë të rezervës FRR.
2. OST-ja lidhëse e rezervës, përcakton kërkesat teknike për lidhjen e njësisë ose grupit të sigurimit të FRR, për të siguruar së ofrimi i FRR është i mundur të bëhet në një mënyrë të rregullt dhe të sigurtë.

3. OST do të zbatojë një parakualifikim të FRR për të vlerësuar përmbushjen e kërkesave teknike minimale sipas pikës (1), kërkesat e disponueshmërisë të FRR dhe kërkesat e lidhjes sipas pikës (2), nga njësitë ose grupet e mundshme të sigurimit të FRR. Ky proces duhet të përfshijë të paktën një rivlerësim në rast ndryshimi të kërkesave apo pajisjeve dhe një rivlerësim periodik brenda kuadrit kohor të paktën pesë vjet.
4. Çdo furnizues i FRR duhet të:
   a) të sigurojë që njësia ose grupi i tij i sigurimit të FRR plotëson kërkesat teknike minimale, kushtet e disponueshmërisë dhe kërkesat e lidhjes sipas pikave të mësipërme;
   b) të informojë OST-në, pa vonesa të panevojshme, për ndonjë reduktim të disponueshmërisë aktuale të ofrimit të rezervës nga njësia apo grupi i tij FRR.
5. OST do të sigurohet që furnizuesit e saj të FRR, monitorohen lidhur me plotësimin e kërkesave teknike minimale, kërkesave të disponueshmërisë dhe të lidhjes së FRR.

Neni 170. Dimensionimi i RR

1. Rregullat e dimensionimit të RR do të përfshijë të paktën kërkesat e mëposhtme:
   a) Kapacitet i mjaftueshëm pozitiv/negative të RR për të rivendosur sasinë e kërkuar të FRR positive/negative;
   b) Kapacitet i mjaftueshëm RR, nëse merret parasysh për dimensionimin e kapacitetit FRR për respektimin e kualitetit target të ACE, për periudhën e konsideruar të kohës, bazuar në konsideratat teorike; dhe
   c) Respektimi i sigurisë operacionale brenda bllokut LFC për të përcaktuar kapacitetin RR.
2. OST do të lejohet për të reduktuar kapacitetin pozitiv/negativ RR të bllokut LFC, që rezultojnë nga procesi i dimensionimit të RR, duke konkluduar një Marrëveshje për ndarjen e RR me blloqe të tjera LFC, në përputhje me dispozitat e Nenit nga 171 deri 180. Reduktimi i kapacitetit pozitiv/negativ RR të bllokut LFC do të limitohet në:
   a) në mënyrë që të garantojë së ai ende mund të përmbushë objektivat e cilësisë së ACE-së tij;
   b) në mënyrë që të garantojë së siguria operacionale nuk rrezikohet; dhe
   c) në mënyrë që të sigurojë së reduktimi i kapacitetit pozitiv/negativ RR nuk duhet të tejkalojë asnjëherë kapacitetin e mbetur RR pozitiv/negative të bllokut LFC.
3. Kur blloku LFC do të përbëhet nga më shumë së një OST, atëherë OST-të e bllokut do të përcaktojë në Marrëveshjen Operacionale shpërndarjen specifike të përgjegjësive midis OST-ve të zonave LFC për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në pikën e mësipërme.

Neni 171. Kërkesat Teknike Minimale të RR.

1. Kërkesat teknike minimale për njësitë ose grupet e sigurimit të RR do të jenë:
   a) çdo njësi ose grup i sigurimit të RR do të jetë i lidhur vetëm me një OST lidhëse të rezervës;
   b) një njësi ose grup i sigurimit të FRR do të aktivizojë rezervën RR në bazë të setpoint-it të marrë nga OST instruktuese e rezervës;
   c) OST instruktuese do të jetë OST lidhëse e rezervës, ose OST që do të përcaktohet në Marrëveshjen e shkëmbimit të rezervës ndërmjet OST-ve, në përputhje me dispozitat e Nenit 174;
   d) një njësi ose grup i sigurimit të RR, duhet të aktivizojë komplet rezervën e tij brenda kohës së aktivizimit të përcaktuar nga OST instruktuese;
   e) një njësi ose grup i sigurimit të RR, duhet të de-aktivizojë rezervën RR sipas setpoint-it të marrë nga OST instruktuese;

f) ofruesi i RR do të sigurojë që monitorimi i aktivizimit të RR për çdo njësi është i mundur. Për këtë siguruesi i RR duhet të jetë në gjendje të furnizojë OST-në lidhëse me matjet në kohë reale në pikën e lidhjes apo në një pikë tjetër të rakorduar me OST-në lidhëse, për:
   i. skedulimin e prodhimit të fuqisë aktive, me stampim kohe,
   ii. fuqinë aktive të çastit, me stampim kohe.
g) siguruesi i RR duhet të përmbushë kërkesat e disponueshmërisë të rezervës RR.

2. OST-ja lidhëse e rezervës, përcakton kërkesat teknike për lidhjen e njësisë ose grupit të sigurimit të RR, për të siguruar së ofrimi i RR është i mundur të bëhet në një mënyrë të rregullt dhe të sigurtë.
3. OST do të zbatojë një proces parakualifikimi të RR për të vlerësuar përmbushjen e kërkesave teknike dhe të disponueshmërisë të RR, nga njësitë ose grupet e mundshme të sigurimit të RR. Ky proces duhet të përfshijë të paktën një rivlerësim në rast ndryshimi të kërkesave apo pajisjeve dhe një rivlerësim periodik brenda kuadrit kohor të paktën pesë vjet.
4. Çdo furnizues i RR duhet të:
   a) të sigurojë që njësia ose grupi i tij i sigurimit të RR plotëson kërkesat teknike minimale dhe kushtet e disponueshmërisë të RR; dhe
   b) të informojë OST-në, pa vonesa të panevojshme, për ndonjë reduktim të disponueshmërisë aktuale të ofrimit të rezervës nga njësia apo grupi i tij RR.
5. OST do të sigurohet që furnizuesit e saj të RR, monitorohen lidhur me plotësimin e kërkesave teknike minimale, kërkesave të disponueshmërisë dhe të lidhjes së RR.

Neni 172. Shkëmbimi i FCR brenda një zone sinkrone

1. Shkëmbimi i FCR brenda një zone sinkrone është i lejuar në pajtim me dispozitat dhe kufizimet e këtij neni. Shkëmbimi i FCR mbështetet në transferimin e obligimit të FCR të OST-së marrëse të rezervës, në OST-në dhënëse (lidhëse) të rezervës, për kapacitetin e konsideruar FCR.
2. OST-të e përfshirja në shkëmbimin e FCR brenda një zone sinkrone duhet të sigurojnë që të respektojnë kufijtë dhe kërkesat për shkëmbimin e FCR brenda zonës sinkrone siç përcaktohet në tabelën e mëposhtme:

Zona Sinkrone	Shkëmbimi i FCR lejohet ndërmjet:	Limitet për shkëmbimin e FCR
Zona Sinkrone e Evropës Kontinentale	OST-ve të blloqeve LFC fqinje	- OST-të e bllokut LFC do të sigurohen që të paktën 30% e totalit të kombinuar të detyrimit të tyre fillestar për FCR, sipas Nenit 165(1), është siguruar fizikisht brenda bllokut LFC; dhe - Sasia e kapacitetit FCR, e vendosur fizikisht në një bllok LFC, si rezultat i shkëmbimit të FCR me blloqe të tjera LFC, do të kufizohet maksimalisht në: o 30% të totalit të kombinuara të detyrimeve fillestare të FCR, sipas Nenit 165(1), të OST-ve të bllokut LFC në të cilat kapaciteti FCR është i lidhur fizikisht; dhe o 100 MW të kapacitetit FCR.

	OST-ve në të njëjtin bllok LFC	- OST-të që përbëjnë një bllok LFC do të përcaktojnë në Marrëveshjen Operacionale kufijtë e brendshëm për shkëmbimin e FCR midis zonave LFC të bllokut në mënyrë që: ○ Të shmangin kongjestionin e brendshëm në rastin e aktivizimit të FCR; ○ Të sigurojnë një shpërndarje të kapacitetit FCR në rastin e ndarjes së rrjetit; dhe ○ Të shmangin cënimin e stabilitetit të procesit FCP dhe të Sigurisë Operacionale.

3. Në rast të shkëmbimit të FCR, OST-ja lidhëse e rezervës dhe OST-ja marrëse e rezervës do të kryejnë një proces njoftimi, sipas Nenit 162.
4. Çdo OST, lidhëse e rezervës, ,marrëse ose e ndikuar, e përfshirë në shkëmbimin e FCR, ka të drejtë të refuzojë shkëmbimin e FCR në rast së shkëmbimi do të rezultojë në shkelje të limiteve të Sigurisë Operative kur aktivizohet shkëmbimi i kapaciteteve FCR.
5.Çdo OST e prekur, duhet të verifikojë që kapaciteti marxhinal i besueshmërisë së tij, është i mjaftueshëm për të akomoduar flukset që rezultojnë nga aktivizimi i kapaciteteve FCR, subjekt i shkëmbimit të FCR.
6.OST lidhëse e rezervës është përgjegjëse për kërkesat sipas Nenit 166 dhe 167 në lidhje me kapacitetin FCR subjekt i shkëmbimit të FCR.
7.Njësia ose grupi i sigurimit të FCR është përgjegjëse për aktivizimin e FCR, vetëm përkundrejt OST-së lidhëse të rezervës së saj.
8. OST-të e përfshira do të sigurojnë që shkëmbimi i FCR nuk pengon asnjë OST për të përmbushur kërkesat e rezervës sipas dispozitave të Nenit 167.

Neni 173. Ndarja e FCR brenda një zone sinkrone

a. Është e ndaluar për një OST për të kryer ndarjen e FCR me OST-të e tjera të Zonës së saj Sinkrone në mënyrë që të përmbushë detyrimin e vet të FCR dhe për të reduktuar shumën totale të FCR të Zonës Sinkrone siç përcaktohet në përputhje me Nenin 165(1).

Neni 174. Kërkesa të Përgjithëshme për Shkëmbimin e FRR dhe RR brenda një zone sinkrone

1. Të gjitha OST-të e Zonës Sinkrone do të përcaktojnë në Marrëveshjen Operacionale, rolet dhe përgjegjësitë e OST-së, lidhëse të rezervës, marrëse të rezervës, dhe OST-ve të ndikuara për shkëmbimin e FRR dhe / ose RR.
2. Në rast të shkëmbimit të FRR / RR, OST-ja lidhëse e rezervës dhe OST-ja marrëse e rezervës do të kryejnë një proces të njoftimit, sipas Nenit 162.
3. OST-ja lidhëse e rezervës dhe OST-ja marrëse e rezervës, të përfshirë në shkëmbimin e FRR / RR do të përcaktojnë në Marrëveshjen e Shkëmbimit të FRR ose RR, rolet dhe përgjegjësitë e tyre, duke përfshirë por jo kufizuar në:
   a) Përgjegjësinë e OST-së instruktuese të rezervës për kapacitetin subjekt të shkëmbimit të FRR / RR;
   b) Sasinë e kapacitetit FRR / RR subjekt të shkëmbimit të FRR / RR;
   c) Zbatimin e procesit të aktivizimit ndërkufitar të FRR / RR sipas Nenit 159 dhe 160;

d) Kërkesat teknike minimale në lidhje me procesin e aktivizimit ndërkufitar të FRR / RR, ku OST-ja lidhëse e rezervës nuk është OST-ja instruktuese e rezervës;
e) zbatimin e parakualifikimit të kapacitetit FRR / RR subjekt të shkëmbimit të FRR / RR, sipas Nenit 169(3) dhe 171(3);
f) përgjegjësinë për të monitoruar përmbushjen e kërkesave teknike dhe të disponueshmërisë për kapacitetin FRR / RR subjekt të shkëmbimit të FRR / RR, sipas Nenit 169(5) dhe 171(5); dhe
g) Procedurat për të siguruar që shkëmbimi i FRR / RR nuk çon në shkeljen e kufijve të sigurisë operative.

4. Çdo OST, lidhëse e rezervës, marrëse e rezervës ose OST e ndikuar, të përfshirë në shkëmbimin e FRR / RR, ka të drejtë të refuzojë shkëmbimin e FRR / RR në rast së shkëmbimi do të çojë në shkeljen e kufijve të sigurisë operacionale, kur aktivizohet kapaciteti subjekt i shkëmbimit të FRR / RR.
5. OST-të e përfshira do të sigurojnë që shkëmbimi i FRR / RR nuk e ndalon asnjë OST nga përmbushja kërkesave të rezervës sipas rregullave të dimensionimit të FRR ose RR.
6. Të gjitha OST-të e një blloku LFC do të përcaktojnë në Marrëveshjen Operacionale të bllokut LFC, rolet e tyre dhe përgjegjësitë si OST lidhëse e rezervës, marrëse e rezervës ose OST e ndikuar, për shkëmbimin e FRR dhe/ose RR me OST-të e blloqeve të tjera LFC.

Neni 175. Kërkesa të Përgjithëshme për Ndarjen e FRR dhe RR brenda një zone sinkrone

1. Të gjitha OST-të e Zonës Sinkrone do të përcaktojnë në Marrëveshjen Operacionale, rolet dhe përgjegjësitë e OST-së, lidhëse të rezervës, marrëse të rezervës, dhe OST-ve të ndikuara për ndarjen e FRR dhe / ose RR.
2. Në rast të ndarjes të FRR / RR, OST-ja kontrolluese e aftësisë siguruese të rezervës dhe OST-ja kontrolluese e aftësisë marrëse të rezervës do të kryejnë një proces të njoftimit, sipas Nenit 162.
3. OST-ja kontrolluese e aftësisë marrëse dhe OST-ja kontrolluese e aftësisë siguruese të përfshirë në ndarjen e FRR / RR do të përcaktojnë në Marrëveshjen e Ndarjes të FRR ose RR, rolet dhe përgjegjësitë e tyre, duke përfshirë por jo kufizuar në:
   a) Sasinë e kapacitetit FRR / RR subjekt të ndarjes së FRR / RR;
   b) Zbatimin e procesit të aktivizimit ndërkufitar të FRR / RR sipas Nenit 159 dhe 160;
   c) Procedurat për të siguruar që aktivizimi i kapacitetit, subjekt i ndarjes së FRR/RR nuk çon në shkeljen e kufijve të sigurisë operative.
4. Çdo OST, kontrolluese e aftësisë siguruese të rezervës, kontrolluese e aftësisë marrëse të rezervës ose OST e ndikuar, të përfshirë në ndarjen e FRR / RR, ka të drejtë të refuzojë ndarjen e FRR / RR në rast së ndarja do të çojë në shkeljen e kufijve të sigurisë operacionale, kur aktivizohet kapaciteti subjekt i ndarjes së FRR / RR.
5. Në rast të ndarjes së FRR / RR, OST-ja kontrolluese e aftësisë siguruese do të bëjë disponibël për OST-në kontrolluese të aftësisë marrëse, pjesë të kapacitetit të vet FRR / RR e nevojshme për të përmbushur kërkesat e veta të rezervës për FRR dhe/ose RR që rezultojnë nga rregullat e dimensionimit të FRR / RR sipas Nenit 168 dhe 170. OST-ja kontrolluese e aftësisë siguruese mund të jetë:
   a) OST instruktuese e rezervës për kapacitetin FRR / RR, subjekt i ndarjes së FRR / RR; ose
   b) OST-ja që ka akses në kapacitetin e saj FRR / RR subjekt i ndarjes së FRR / RR nëpërmjet implementimit të një procesi të aktivizimit ndërkufitar të FRR / RR si pjesë e një Marrëveshje Shkëmbimi të FRR / RR.

6. OST-ja kontrolluese e aftësisë siguruese do të mbetet përgjegjëse për tu përballuar me incidentet dhe disbalancat në rast së kapaciteti FRR / RR subjekt i ndarjes së FRR / RR nuk është disponibël për shkak të:
   a) kufizimeve për restaurimin e frekuencës ose shkëmbimit të fuqisë zëvendësuese, e lidhur me sigurinë operacionale;
   b) përdorimit të pjesshëm ose të plotë të kapacitetit FRR / RR nga OST-ja kontrolluese e aftësisë siguruese të rezervës.
7. OST-të e bllokut LFC do të përcaktojnë në Marrëveshjen Operacionale, rolet dhe përgjegjësitë e tyre, si OST-ja kontrolluese e aftësisë siguruese, OST-ja kontrolluese e aftësisë marrëse dhe OST-të e prekura, për ndarjen e FRR dhe RR me OST-të e blloqeve të tjera.

Neni 176. Shkëmbimi i FRR brenda një zone sinkrone

1. Shkëmbimi i FRR brenda zonës sinkrone është i lejuar në pajtim me dispozitat e këtij neni dhe të Nenit 174. OST-të e përfshira në shkëmbimin e FRR brenda zonës sinkrone do të sigurojnë që të respektohen kërkesat dhe kufizimet siç definohet në tabelën e mëposhtme:

Zona Sinkrone	Shkëmbimi i FRR lejohet ndërmjet:	Limitet për shkëmbimin e FRR
Zona Sinkrone e Evropës Kontinentale	OST-ve të blloqeve LFC fqinje	OST-të e bllokut LFC do të sigurohen që të paktën 50% e totalit të kapacitetit të tyre të kombinuar FRR që rezulton nga rregullat e dimensionimit, dhe para çdo reduktimi për shkak të ndarjes së FRR sipas Nenit 168, mbetet e vendosur brenda bllokut LFC.
	OST-ve në të njëjtin bllok LFC	OST-të që përbëjnë një bllok LFC do të përcaktojnë në Marrëveshjen Operacionale kufijtë e brendshëm për shkëmbimin e FRR midis zonave LFC të bllokut në mënyrë që: ○ Të shmangin kongjestionin e brendshëm për shkak të aktivizimit të kapacitetit FRR subjekt i shkëmbimit; ○ Të sigurojnë një shpërndarje të njëjtë të kapacitetit FRR në rastin e ndarjes së rrjetit; dhe ○ Të shmangin cënimin e stabilitetit të procesit FRP dhe të Sigurisë Operacionale.

Neni 177. Ndarja e FRR brenda një Zone Sinkrone

1. Çdo OST e bllokut LFC do të ketë të drejtë të kryejë ndarjen e FRR me blloqe të tjera LFC, brenda limiteve të përcaktuara nga rregullat e dimensionimit të FRR në Nenin 168, duke respektuar dispozitat e Nenit 175.

Neni 178. Shkëmbimi i RR brenda një Zone Sinkrone

1. Shkëmbimi i RR brenda zonës sinkrone është i lejuar në pajtim me dispozitat e këtij neni dhe të Nenit 174. OST-të e përfshira në shkëmbimin e RR brenda zonës sinkrone do të sigurojnë që të respektohen kërkesat dhe kufizimet për shkëmbimin e RR siç definohet në tabelën e mëposhtme:

Zona Sinkrone	Shkëmbimi i RR lejohet ndërmjet:	Limitet për shkëmbimin e RR
Zona Sinkrone e Evropës Kontinentale	OST-ve të blloqeve LFC fqinje	OST-të e bllokut LFC do të sigurohen që të paktën 50% e totalit të kapacitetit të tyre të kombinuar RR që rezulton nga rregullat e dimensionimit, dhe para çdo reduktimi për shkak të ndarjes së RR sipas Nenit 170, mbetet e vendosur brenda bllokut LFC.
	OST-ve në të njëjtin bllok LFC	OST-të që përbëjnë një bllok LFC do të përcaktojnë në Marrëveshjen Operacionale kufijtë e brendshëm për shkëmbimin e RR midis zonave LFC të bllokut në mënyrë që: ○ Të shmangin konxhestionin e brendshëm për shkak të aktivizimit të kapacitetit RR subjekt i shkëmbimit; ○ Të sigurojnë një shpërndarje të njëjtë të kapacitetit RR në rastin e ndarjes së rrjetit; dhe ○ Të shmangin cënimin e stabilitetit të procesit RRP dhe të Sigurisë Operacionale.

Neni 179. Ndarja e RR brenda një Zone Sinkrone

1. Çdo OST e bllokut LFC do të ketë të drejtë të kryejë ndarjen e RR me blloqe të tjera LFC, brenda limiteve të përcaktuara nga rregullat e dimensionimit të RR në Nenin 170, duke respektuar dispozitat e Nenit 175.

Neni 180. Procesi i Aktivizimit Ndërkufitar për FRR dhe RR

1. Aktivizimi i kapacitetit ndërkufitar për FRR dhe RR, ndërmjet OST-ve të së njëjtës zonë sinkrone, është i lejuar në akordancë me dispozitat e Nenit 159 dhe 160.

Neni 181. Procesi i kontrollit të kohës

1. Procesi i kontrollit të kohës elektrike të një zone sinkrone do të përdoret për të siguruar që vlera mesatare e frekuencës së sistemit është e barabartë me frekuencën nominale.
2. OST-të e zonës sinkrone përcaktojnë në Marrëveshjen Operacionale metodologjinë për të korrigjuar devijimin kohës elektrike, që do të përfshijë:
   a) diapazonin kohor brenda të cilit devijimi i kohës elektrike do të ruhet, me anë të përpjekjeve të arsyeshme të OST-ve;
   b) rregullimet e setpoint-it të frekuencës për të kthyer devijimin e kohës elektrike në zero;
   c) rakordimin e përbashkët të veprime për të rritur ose ulur frekuencën mesatare të sistemit me anë të rezervave të fuqisë aktive.

3. Kur është e aplikueshme, OST-të e zonës sinkrone caktojnë një OST, që do të:
   a) Monitorojë devijimet e kohës elektrike;
   b) kalkulojë rregullimet setpoint-it të frekuencës;
   c) koordinojë veprimet e procesit të kontrollit të kohës.

Neni 182. Njësitë e Sigurimit të Rezervës të Lidhur me Rrjetin e OSSH-së

1. OST dhe OSSH do të bashkëpunojnë duke bërë përpjekje të arsyeshme për të lehtësuar dhe për të mundësuar livrimin rezervave të fuqisë aktive nga njësitë ose grupet e sigurimit të rezervës të lidhura në rrjetin e shpërndarjes.
2. OSSH lidhëse e rezervës, do ta shqyrtojë kërkesën e një njësie ose grupi të sigurimit të rezervës të lidhur në rrjetin e saj të shpërndarjes, brenda 2 muajve pas dhënies së njoftimit dhe të gjithë informacionit të kërkuar, duke përfshirë:
   a) nivelet e tensionit dhe pikat e kyçjes të njësive apo grupeve të sigurimit të rezervës;
   b) llojin e rezervës së fuqisë aktive;
   c) kapacitetin maksimal të rezervës që jepet nga njësia apo grupi në secilën pikë lidhëse; dhe
   d) shkalla maksimale (shpejtësia) e ndryshimit të fuqisë aktive për njësinë apo grupin e sigurimit të rezervës.
3. Gjatë parakualifikimit të njësisë ose grupit të sigurimit të rezervës, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, OSSH ka të drejtë për të vendosur limite apo të përjashtojë livrimin e rezervës së fuqisë aktive të lidhur në rrjetin e saj të shpërndarjes, në bashkëpunim me OST-në dhe në mënyrë jo diskriminuese dhe transparente bazuar në argumente teknike të tilla si shpërndarja gjeografike e njësisë ose grupit të sigurimit të rezervës.
4. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, OST do të rakordojë me OSSH-në mbi procedurën dhe metodologjinë për shkëmbimin e informacionit të kërkuar në lidhje me parakualifikimin dhe livrimin e rezervës së fuqisë aktive.

Neni 183. Informacioni mbi Marrëveshjen Operacionale

1. OST do të informojë ERE-në dhe autoritetin përkatës kombëtar, për përmbajtjen e Marrëveshjes Operacionale të Zonës Sinkrone të saj, jo më vonë së një muaj para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.
2. OST-të e bllokut LFC (kur blloku përbëhet nga më shumë se një OST) do të njoftojnë Entet Rregullatore Përkatëse për përmbajtjen e Marrëveshjes Operacionale të bllokut të tyre LFC, jo më vonë se një muaj para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

Neni 184. Informacioni mbi Kualitetin e Frekuencës

1. Kurdo që vlerat e modifikuara janë të përcaktuara në përputhje me Nenin 148(5), OST-të e Zonës Sinkrone duhet t'i bëjnë disponibël ENTSO-E për publikim, jo më vonë se një muaj para hyrjes në fuqi, vlerat e miratuara të parametrave të mëposhtëm:
   a) Parametrat e përcaktimit të kualitetit të frekuencës; dhe
   b) Parametrat target të kualitetit të frekuencës.
2. Metodologjia e përdorur për të përcaktuar rrezikun e shterimit të rezervës FCR, do të bëhet disponibël në ENTSO-E për publikim, nga OST-të e Zonës Sinkrone, jo më vonë se tre muaj para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Operacionale, ku kjo metodologji bën pjesë.

3. Monitoruesi i Zonës Sinkrone do t'i bëjë disponibël ENTSO-E për publikim, rezultatet e procesit të kriterit të aplikimit, jo më vonë se tre muaj pas periudhës së fundit të matjes me stampim kohe, dhe të paktën katër herë në vit. Këto rezultate duhet të përfshijnë të paktën:
   a) vlerat e kriterit të vlerësimit të cilësisë së frekuencës, të llogaritur për Zonën Sinkrone dhe për çdo bllok LFC brenda Zonës Sinkrone, në përputhje me Nenin 149;
   b) rezolucionin e matjes, saktësinë e matjes dhe metodën e llogaritjes të përcaktuar në përputhje me Nenin 150.

Neni 185. Informacioni mbi Strukturën e Kontrollit Fuqi-Frekuencë

1. OST-të e Zonës Sinkrone do të bëjnë disponibël në ENTSO-E, jo më vonë së tre muaj para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Operacionale, të dhënat e mëposhtme:
   a) të dhëna mbi strukturën e procesit të aktivizimit të Zonës Sinkrone, duke përfshirë të paktën informacionin mbi zonat e përcaktuar të monitorimit, zonat LFC, blloqet LFC dhe OST-të e tyre; dhe
   b) informacion mbi strukturën e procesit të përgjegjësisë në Zonën Sinkrone, duke përfshirë të paktën informacionin mbi proceset e përcaktuara të renditura në Nenin 153.
2. OST-të që zbatojnë një proces të netimit të disbalancës duhet të publikojë informacionin lidhur me këtë proces në përputhje me legjislacionin kombëtar. Ky informacion duhet të përfshijë të paktën listën e OST-ve pjesëmarrëse dhe datën e fillimit të procesit të netimit të disbalancimit.

Neni 186. Informacioni mbi FCR

1. Mënyra e dimensionimit të FCR në përputhje me Nenin 165, do të bëhet disponibël në ENTSO-E për publikim, nga OST-të e Zonës Sinkrone, jo më vonë së një muaj para zbatimit të saj.
2. Shuma totale kapacitetit FCR për Zonën Sinkrone dhe ndarja e kapacitetit FCR të nevojshme për secilën OST, të përcaktuara në përputhje me Nenin 165, si detyrimi fillestar i FCR, do të bëhet disponibël në ENTSO-E për publikim, nga OST-të e Zonës Sinkrone, jo më vonë së një muaj para zbatimit të saj.
3. Karakteristikat e rezervës FCR të përcaktuara në përputhje me Nenin 166 dhe kërkesa shtesë për grupet e sigurimit të FCR, do të bëhen disponibël në ENTSO-E për publikim, nga OST-të e Zonës Sinkrone, jo më vonë së tre muaj para zbatimit të tyre.

Neni 187. Informacioni mbi FRR

1. OST si bllok LFC, do të bëjë disponibël në ENTSO-E për publikim, kërkesat e disponueshmërisë të FRR, kërkesat për kontrollin e cilësisë dhe kërkesat teknike për lidhjen të përcaktuara në përputhje me Nenin 169, jo më vonë së tre muaj para zbatimit të tyre.
2. OST si bllok LFC, do të bëjë disponibël në ENTSO-E për publikim, rregullat e dimensionimit të FRR të përcaktuara për bllokun e saj, në përputhje me Nenin 168, jo më vonë së tre muaj para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Operacionale në të cilën këto rregulla janë të përfshira.
3. OST-të e Zonës Sinkrone do të bëjnë disponibël në ENTSO-E për publikim, një perspektivë të kapaciteteve FRR për çdo bllok LFC për vitin e ardhshëm, jo më vonë së data 30 Nëntor të çdo viti.
4. OST-të e Zonës Sinkrone do të bëjnë disponibël në ENTSO-E për publikim, kapacitetet aktuale FRR të çdo blloku LFC për tremujorin e kaluar, jo më vonë së 30 ditë pas përfundimit të tremujorit.

Neni 188. Informacioni mbi RR

1. OST si bllok LFC, që operon procesin e zëvendësimit të rezervës, do të bëjë disponibël në ENTSO-E për publikim, kërkesat e disponueshmërisë të RR dhe kërkesat teknike për lidhjen të përcaktuara në përputhje me Nenin 171, jo më vonë së tre muaj para zbatimit të tyre.
2. OST-të e Zonës Sinkrone do të bëjnë disponibël në ENTSO-E për publikim, një perspektivë të kapaciteteve RR për çdo bllok LFC për vitin e ardhshëm, jo më vonë së data 30 Nëntor e vitit korent.
3. OST-të e Zonës Sinkrone do të bëjnë disponibël në ENTSO-E për publikim, kapacitetet aktuale RR të çdo blloku LFC për tremujorin e kaluar, jo më vonë së 30 ditë pas përfundimit të tremujorit.

Neni 189. Informacioni mbi Ndarjen dhe Shkëmbimin

1. OST-të e Zonës Sinkrone do të bëjnë përmbledhje vjetore të marrëveshjeve për ndarjen e FRR dhe për ndarjen e RR për çdo bllok LFC, në dispozicion të ENTSO-E, si pjesë e materialit për botim të kërkuar nga Neni 187(3) dhe 188(2). Këto përmbledhje duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:
   a) identitetin e blloqeve LFC ndërmjet të cilave ekziston një marrëveshje për ndarjen e FRR ose RR; dhe
   b) reduktimin e realizuar të FRR dhe RR për çdo marrëveshjeje për ndarjen e respektivisht FRR ose RR.
2. OST-të e secilit vend do të publikojnë informacion mbi shkëmbimin e FCR, FRR dhe RR në përputhje me legjislacionin kombëtar.

KAPITULLI VII

KODI I OPERIMIT TË TREGUT DHE RREGULLAT E MATJES

Neni 190. Bashkëpunimi midis OST dhe OT

1. Për kryerjen e funksioneve të menaxhimit të sistemit, për nevoja të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operatori i Tregut do të përgatisë dhe përcjellë informacionin përkatës të nevojshëm për Operatorin e Sistemit të Transmetimit.

Neni 191. Funksionimi dhe Operimi sipas Roleve në Modelin e Tregut

1. Në përputhje me ligjin nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe Modelin e Tregut OST sh.a. funksionon si një shoqëri e pavarur shtetërore që kryen këto funksione:
   a) Operimin e Rrjetit të Transmetimit (pronësinë mbi rrjetin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin);
   b) Operimin e Sistemit në përputhje me kërkesat e Direktivës 2009/72 / KE, duke përfshirë dispecerimin;
   c) Ofrimin i shërbimit të lidhjes për të gjithë përdoruesit e sistemit të lidhur me rrjetin e transmetimit nëpërmjet procedurave jo-diskriminuese;
   d) Përcaktimin e kushteve për t'u bërë Palë Përgjegjëse Balancimi dhe Ofrues i Shërbimit të Balancimit;
   e) Zbatimin e proceseve të Llogaritjes së Koordinuar të Kapaciteteve në përputhje me kërkesat në tregjet e organizuara;
   f) Operimin e Tregut të Balancimit me funksionet si vijon:
      i. Parashikimin dhe blerjen e shërbimeve ndihmëse, të ndara në energjinë balancuese dhe rezervat e balancimit, nga të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Balancimit në afatet kohore javore, në ditën në avancë dhe në kohë reale me bazë tregun.
      ii. Ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme balancuese, duke aktivizuar rregullimin në rritje ose në ulje (kapacitetet) nga rezervat balancuese të prokuruara dhe / ose rezervat shtesë balancuese të ofertimit në treg për balancimin e energjisë.
      iii. Te blejë energji për humbjet në transmetim në ditën ne avance në treg të organizuar. Për periudhën kalimtare para aktivizimit të Tregut të Ditës ne Avance, OST sh.a. mund të aplikojë edhe procedura të prokurimit javor.
      iv. Të marrë kompensim për shërbimet e tij balancuese, duke siguruar asnjanësinë financiare në baza mujore, nëpërmjet shlyerjes së disbalancave bazuar në një mekanizëm të shlyerjes së disbalancave, duke siguruar stimujt e duhur për pjesëmarrësit e tregut që të jenë të balancuar në kohë reale dhe afërsisht në kohë reale. Mekanizmat e çmimeve të disbalancave pasqyrojnë devijimet ndërmjet prodhimit, energjisë që tregtohet dhe konsumin e të gjitha Palëve Përgjegjëse të Balanacimit dhe të çdo Pale Përgjegjëse Balancimi, mekanizëm i cili bazohet në një sistem të çmimit të vetëm i cili penalizon devijimet në të dy drejtimet.
      v. Të menaxhojë mbledhjen e të dhënave të matjes të matura për të kryer një menaxhim efikas të disbalancave të energjisë dhe shlyerjes.

vi. Çmimi i disbalancave të energjisë do të vendoset në bazë të kostos reale për OST sh.a. për të balancuar sistemin për periudhën e dhënë që mbulon rezervat e balancimit dhe energjinë dhe çmimi i disbalancave që do të paguhet nga Palët Përgjegjëse për Balancimin do të bazohet në këtë çmim. Tarifat, termat dhe kushtet e aksesit në sistemin e transmetimit do të rregullohen nga ERE-ja.

Neni 192. Detyrimet e Pjesëmarrësve të Tregut kundrejt OST dhe OT

1. Në përputhje me Modelin e Tregut, Rregullat e Tregut dhe Kodet, përveç detyrimeve të përcaktuara në licencat përkatëse dhe/apo rregulla të tjera çdo pjesëmarrës i tregut ka detyrim si vijon:
   a) Të paraqesin për OST dhe Operatorin e Tregut informacionin e kërkuar në përputhje me këtë Kod dhe me Rregullat e Tregut në fuqi;

Neni 193. Rregullat e Matjes

1. Rregullat për matjen e energjisë elektrike përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e OST dhe të gjithë përdoruesve të sistemit të transmetimit dhe pjesëmarrësit në tregun e energjisë, me qëllim:
   a) Matjen e të gjithë flukseve hyrëse / dalëse të energjisë elektrike në rrjet,
   b) Leximet e matësave, dhe marrjen e të dhënave nga matësat e energjisë elektrike;
   c) Përpunimi i të dhënave dhe shpërndarja për shlyerjet në tregun e energjisë.
2. Rregullat përcaktojnë kërkesat teknike për transformatorët, matësat e energjisë elektrike dhe pajisjet ndihmëse në të gjitha pikat e lidhjes me sistemin e transmetimit ose interkoneksionit, si dhe të përcaktojë të gjitha të dhënat e nevojshme që kanë të bëjnë me një pikë të veçantë matje.
3. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për veprimtarinë matëse dhe shërbimin e leximit të matësve në rrjet në përputhje me ndarjen e pronësisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit sikurse është përcaktuar me ligj.
4. Dispozitat e këtyre rregullave zbatohen për pikat matëse në të gjitha vendet e ofrimit të energjisë elektrike në objektet e transmetimit të OST, apo në objektet e Sistemit të Transmetimit të përdoruesve të lidhur direkt, d.m.th të ndërlidhur me sistemin e transmetimit.
5. Dispozitat e këtyre rregullave zbatohen edhe për pikat matëse në 400/220 kV, 400/110 kV dhe traktet e transformatorëve 220/110 kV, në anën e tensionit të mesëm brenda rrjetit të transmetimit.
6. Energjia elektrike e hedhur në rrjet ose e furnizuar të klientët fundorë matet nëpërmjet pajisjeve matëse, në përputhje me parashikimet e Kodeve të Rrjetit dhe Kodin e Matjes, si dhe në legjislacionin në fuqi për metrologjinë.
7. OST duhet të marrë masa që matësi dhe/ose sistemi matës duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë", Nenin 76, pika 3 në lidhje me vulën, vulosjen dhe klasën e saktësisë.

Neni 194. Instalimi i një pikë matje

1. Nëse të gjitha parakushtet teknike janë përmbushur, pika matëse vendoset në pikën e livrimit/ofrimit të tensionit.
2. Aty ku pika e livrimit dhe pika e matjes nuk janë në të njëjtin nivel tensioni, ose në qoftë se ata janë në të njëjtin nivel tensioni, por ata janë larg nga njëri-tjetri aq sa humbjet e energjisë në mes tyre nuk mund të neglizhohen, është e nevojshme të përdoren faktor korrigjues të aplikuar për të dhënat e matjes për vlerën e humbjeve të energjisë nga pika e livrimit deri në pikën e matjes (e transferuar në pikën e livrimit). Përdorimi i faktorit korrektues kryhet gjatë procesit të shlyerjes dhe është pjesë përbërëse e saj.
3. Faktori i korrigjimit përcaktohet nga OST bazuar në specifikimin teknik të pajisjes, llogaritjes së humbjeve në mes pikës së livrimit dhe pikës matëse nën kushte mesatare operacionale. Faktori korrigjimit është përcaktuar në:
   a) Vendimin e lidhjes së objektit të përdoruesit fundor apo gjeneruesit;
   b) Kontrata për interkoneksionit e Sistemit të Transmetimit/shpërndarjes;
   c) Marrëveshjen Operacionale për objektet e përdoruesit fundor ose gjeneratorët, kur faktori i korrigjimit është ndryshuar gjatë operimit të objektit;
   d) Kontratën për akses në sistemin e transmetimit.

4. Mënyra dhe kushtet e ndryshimit të faktorit korrektues administrohet mes OST dhe përdoruesve të Sistemit të Transmetimit.

5.Në çdo pikë matje, pajisjet matëse përfshijnë:
   a) Transformatorët matës;
   b) Matësat e energjisë elektrike do të jenë dy, kryesor dhe kontrollues.;
   c) Qarqet elektrike të matjes dhe ndihmëse;
   d) Pajisjet e komunikimi dhe ndihmëse;
   e) Boksi i terminalit të matjes dhe kabineti i matjes.

6.Aksesi në matje dhe vulosja e sistemit matës duhet të kryhet nga OST në përputhje me përcaktimet ligjore dhe duke zbatuar rregullat si vijon:
   a) Pajisjet e matjes dhe pajisjet përkatëse të komunikimit do të vendosen në një kabinet të dedikuar dhe të sigurt të vendosura në një zonë lehtësisht të arritshme, të lirë nga pengesat, dhe të ndriçuar mirë sipas nevojës edhe me ndriçim artificial nga përdoruesi i rrjetit që kërkon të lidhet në Sistemin Transmetimit.
   b) Kabineti do të jetë në përputhje me rekomandimet e prodhuesit të matjes për kushtet mjedisore dhe projektimi i tij duhet të paktën të përfshijë mbrojtje nga lagështia dhe pluhuri dhe nga dëmtimi fizik, duke përfshirë dridhjet dhe të sigurojë kontroll të duhur të temperaturës.
   c) Kabineti do të jetë i pajisur me çelës dhe kapak transparent dhe i vulosur nga OST. OST kontrollon vulosjen kohe pas kohe në përputhje me procedurat përkatëse praktike. Vula mund të thyhet/hapet vetëm nga OST ose me miratimin e OST.
   d) Qasja e pajisjeve të brendshme të matjes, qarqet dhe pajisjeve të lidhur të komunikimit behet vetëm me miratim të OST sipas udhëzimeve të përcaktuara nga OST.
   e) Përdoruesit do ti lejojnë OST ose përfaqësuesve të saj, të drejtat e hyrjes, kalimit dhe qëndrimit mbi çdo pjesë të pronës së përdoruesve në masën e nevojshme për qëllime të kryerjes së funksioneve sipas Kodi të Rrjetit të Transmetimit. Përdoruesit do të bëjë të gjitha rregullimet e arsyeshme dhe do të ofrojnë të gjitha lehtësirat e nevojshme për OST ose përfaqësuesve të saj në ushtrimin e këtyre të drejtave.
   f) Te drejtat në përputhje me pikën më sipër do të përfshijë edhe të drejtën për të përdorur automjete, impiante, makineri për mirëmbajtje apo materiale të tjera që mund të

kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga OST për kryerjen e funksioneve të saj në lidhje me matjen në kuadër të kodit.

7.Pajisjet e matjes në pikën e lidhjes do të mirëmbahen nga OST në praninë e përdoruesit. Të gjitha rezultatet e testimit, programet e mirëmbajtjes dhe të dhënat e vulosjes do të mbahen gjate gjithë periudhës që pajisjet janë në pune dhe për pesë vjet pas daljes së tyre nga inventari i aseteve. Të dhënat e pajisjeve dhe të dhënat e testimeve do t'u vihen në dispozicion palëve të interesuara në përputhje me kriteret e konfidencialitetit.

8.OST do të riparojë sistemin e matjes sapo të jetë praktike nëse një sistem matje nuk funksionon si duhet ose kërkon mirëmbajtje. OST do të faturojë si është e përshtatshme për shërbimet e matjes të ofruara.

9.Pas çdo ndërhyrje në sistemin matës për arsye të mirëmbajtjes së planifikuar apo në rast defekti, si dhe në mënyrë periodike, sipas nevojës, do të kryhet verifikimi i matjes në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë", neni 77.

Neni 195. Aksesi në të dhënat e matjes

1. Qasje e drejtpërdrejtë në të dhënat e matjes në matës nëpërmjet komunikimit në distance dhe lokal është i lejuar vetëm për personat e autorizuar të OST me qëllim konfigurimin, mirëmbajtjen, vlefshmërinë, marrjen dhe zëvendësimin e të dhënave dhe për përdoruesit e të dhënave të matjes. Përdoruesit e të dhënave të matjes janë:
   a) Përdoruesi i Sistemit të Transmetimit apo përfaqësuesit i tij i autorizuar për qëllim të vëzhgimit dhe mbledhjes së të dhënave të matjes të lidhur me pikën e tij të matjes;
   b) Furnizuesit e përdoruesve të Sistemit të Transmetimit;
   c) Personat e tjerë përgjegjës në pajtim me ligjet dhe rregulloret.
2. OST është përgjegjës për organizimin dhe dhënien e aksesit në të dhënat e matjes dhe për përcaktimin e të drejtave të aksesit të përdoruesit, duke pasur parasysh sigurinë e të dhënave lokale në objekt dhe në bazën e të dhënave të matjes.
3. OST duhet të delegojë të drejtën e aksesit në distance të të dhënave të matjes me anë të përcaktimit të listës së përdoruesve të autorizuar të të dhënave të matjes me qëllim parandalimin e konflikteve midis palëve të autorizuara. OST do të shpërndajë diapazonin/hapsirën kohore për qasje në të dhënat e matjes duke marre në konsideratë nevojat për marrjen e të dhënave nga OST dhe përdoruesit e tjerë të të dhënave matëse në përputhje me parimin e mosdiskriminimit.
4. Mosrespektimi i dispozitave që rregullojnë hapsirën e ndarë kohore për qasje në të dhënat e matjes do të rezultojë në anullimin e të drejtave për qasje në to.
5. Me kërkesë të përdoruesit të të dhënave të matjes, OST jep akses të drejtpërdrejtë në matës në pikat e matjes duke lejuar qasje në portën përkatëse të komunikimit të matësit për lexim lokal dhe në distancë të matësit si vijon:
   a) Në përgjithësi, nëpërmjet portës së komunikimit IR sipas IEC 62056-21;
   b) Përmes portës seriale të komunikimit dhe protokollin DLMS sipas IEC 62056-42 / 46/53/61/62.
   OST mund ti japë përdoruesit të të dhënave të matjes të drejtën për të kryer leximin e matësave, të sigurojë fjalëkalimet për qasje në matje dhe dritaren/hapsirën kohore për komunikim të tillë.

6. Është obligim i përdoruesit të të dhënave të matjes të përdori software të licencuar, aplikime për komunikimin në distancë dhe transferimin e të dhënave nga matësit, si dhe për të përdorur fjalëkalimet ekskluzive për vetë-lexim të ofruara nga OST.
7. OST duhet të garantojë sigurinë e të dhënave të regjistruara në nivel lokal në matësa, si dhe sigurinë e bazës së të dhënave të matjes dhe regjistrat brenda matësave.
8. OST nuk ka autorizim për të ndryshuar të dhënat e regjistruara në vend në matësa, përveç gjatë periudhës të testimit të matësave dhe kontrollit të instalimit (vetëm për periudhën e kohëzgjatjes së testimit). Për çdo ndërhyrje në terren të matësave të energjisë elektrike përgatitet një raport i cili duhet të përmbajë të dhënat e energjisë elektrike të paregjistruar ose të regjistruar gabimisht.
9. Në çdo rast në lidhje me askesin e të dhënave të matjes dhe të telematjes do të respektohen kërkesat si vijon:
   a) Të dhënat zyrtare të matjes do të vihet në dispozicion nga OST për përdoruesit e autorizuar siç përcaktohet nga kodi ose rregullatori në një format të rënë dakord mes palëve.
   b) OST do të publikojë të gjitha formatet në të cilat ajo mund të sigurojë të dhëna për përdoruesit. Të gjitha formatet do të hartohen/modifikohen me negocim mes OST dhe përdoruesve përkatës. OST do të ruajë të gjitha të dhënat e konsumatorëve në një bazë të dhënash qendrore duke siguruar që baza e të dhënave është e ruajtur dhe e përditësuar vazhdimisht.
   c) OST do të sigurojë të dhëna të matjes sipas kërkesës së palëve të interesuara në format jo standard kundrejt kostove përkatëse të cilat mbulohen nga pala e interesuar.
   d) OST do të administrojë skedulet kohore të aksesit të bazës së të dhënave të matjes si dhe specifikimet e kërkesave të sigurisë.
   e) Të dhënat e matjes për përdorim në tregtimin e energjisë dhe faturim përbëjnë informacion konfidencial.
10. OST duhet të zbatojë procedurën në vijim në lidhje me rakordimin e matjes:
   a) OST do të bëjë rregullimet e nevojshme për të lexuar nga distanca vlerat kumulative të energjisë çdo muaj për qëllime kontrolli.
   b) Nëse vlera kumulative të energjisë nuk janë në dispozicion apo nuk mund të merren nga distanca, atëherë OST do të marrë leximet manualisht çdo muaj për qëllimet e mësipërme.
   c) Brenda tri javëve të leximit manual të matjes, OST do të përgatisë një deklaratë rakordimi të matjes në të cilën ajo do të regjistrojë dallimin në mes dy leximeve të njëpasnjëshme të matjes manuale dhe do ta krahasojë atë me energjinë totale të regjistruara për të njëjtën periudhë kohore.
   d) Nëse vërehet ndonjë dallim ndërmjet leximit manual dhe lexim të regjistruar elektronikisht prej më shumë së 0.1% ky informacion do të theksohet dhe referohet për kontroll të mëtejshëm.
   e) Nëse si rezultat i kontrollit të mësipërm, mospërputhja konfirmohet, atëherë OST do të informojë përdoruesin përkatës dhe do të marre masat e duhura për të trajtuar situatën në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe rregullatore.
   f) Të dhënat e matjes të padisponueshme ose paarritshme për më shume së një muaj zëvendësohen me vlera referuese, sipas metodologjisë përkatëse të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë, të aplikueshme për një periudhe jo me të gjatë së tre muaj.

Seksioni 1

Shtojca A – Kategoritë dhe të dhënat e planifikimit

Kategoritë e të dhënave të Planifikimit

1. Për të plotësuar kërkesat e përmendura me lart, të dhënat e planifikimit nga Përdoruesit e Rrjetit të Transmetimit, do të kategorizohen në dy grupe si më poshtë:
   a) Të dhëna Fillestare të Studimit dhe Projektit të Planifikuar;
   b) Të dhëna të Detyruara të Studimit dhe Projektit të Planifikuar.
2. Secili grup të dhënash përmban:
   a) Të dhëna Standarte të Planifikimit;
   b) Të dhëna të Detajuara të Planifikimit;
   c) Të dhëna Vjetore të Planifikimit të Rrjetit të Sistemit të Transmetimit ;
   d) Të dhëna të Planifikimit 10 vjeçar të Rrjetit të Sistemit të Transmetimit;
   e) Të dhëna për studimet dhe Punët në Progres;
   f) Të dhënat Përfundimtare.
3. Çdo Përdorues i Rrjetit të Sistemit të Transmetimit do të paraqesë këto të dhëna në shoqërinë OST sh.a deri në 30 shtator të çdo viti, për vitin/vitet pasardhës të planifikimit.

Të dhënat Fillestare të Studimit apo Projektit të Planifikuar

1. Janë të dhënat dhe informacioni paraqitur në kohën/datën e aplikimit për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes ekzistuese apo dhe përdorim të rrjetit të Sistemit të Transmetimit nga përdoruesit e rrjetit të Transmetimit, të cilat do të quhen të dhëna Fillestare të Studimit apo Projektit të Planifikuar.
2. Të dhënat fillestare të studimit apo Projektit të Planifikuar do të përmbajnë normalisht vetëm të dhënat Standarte të Planifikimit, derisa të kërkohen në mënyrë specifike të dhëna të Detajuara të Planifikimit nga OST.

Të dhënat e Detyruara të Studimit apo Projektit të Planifikuar

1. Pas ofertës të ofruar nga OST, për një Marrëveshje Lidhje dhe të pranuar nga përdoruesi i rrjetit të transmetimit, gjate procesit të hartimit të "Marrëveshjes së Lidhjes" informacioni dhe gjithë të dhënat e paraqitura dhe të marra nga OST, duke u bazuar në Kodin e Planifikimit, do të quhen të dhënat e Detyruara të Studimit apo Projektit të Planifikuar. Këto të dhëna do të formojnë bazën për Planifikimin e Sistemit Elektroenergjitik të vendit.
2. Të dhënat e Detyruara të Studimit apo Projektit të Planifikuar nuk do të trajtohen në mënyrë konfidenciale, në mënyrë që OST të mund ti përfshijë këto të dhëna në sistemin e tij të të dhënave, në pajtueshmëri me dispozitat e këtij Kodi.
3. Të dhënat e Detyruara të Studimit apo Projektit të Planifikuar normalisht do të përfshijnë të dy llojet e të dhënave: të dhënat Standarte të Planifikimit dhe të dhënat e Detajuara të Planifikimit.

Të dhënat Standarte të Planifikimit

1. Për Gjeneruesit (Prodhuesit):
   a) Të dhënat e kërkuara listohen në Shtojca A, Seksioni 1, paragrafi A.1.

b) Të dhënat paraqiten gjatë aplikimit për Lidhje të Re , për shtim të një njësie Gjeneruese, për çdo modifikim të impianteve dhe paisjeve të këtyre gjeneruesve, të cilët ndikojnë në rrjetin e Sistemit të Transmetimit.

2. Të dhënat paraqiten gjatë aplikimit për lidhje të re ose modifikimin e lidhjes egzistuese për gjeneruesit e tipit "të lidhur në Rrjetin e Shpërndarjes "(për gjenerues me fuqi aktive ≥ 5 MW, parqe eolike dhe parqe fotovoltaike me fuqi aktive ≥ 10 MW).
3. Këto të dhëna duhet të paraqiten dhe nga të gjithë gjeneruesit e rrjetit të Transmetimit të lidhur tashmë në rrjetin e Sistemit të Transmetimit.
4. Operatori i Rrjetit të Transmetimit, OST:
   a) të dhënat e kërkuara listohen në Shtojca A, Seksioni 1, paragrafi A.2.
5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes:
   a) të dhënat e kërkuara listohen në Shtojca A, Seksioni 1, paragrafi A.3.
   b) të dhënat duhet të paraqiten me aplikimin për lidhje të reja, për shtesë dhe fuqizim të linjave të reja dhe nënstacioneve, për çdo modifikim të linjave dhe paisjeve, të cilat mund të ndikojnë në rrjetin e Sistemit të Transmetimit.
6. Klientët (Ngarkesa):
   a) të dhënat e Klientëve listohen në Shtojca A, Seksioni 1, paragrafi A.3
   b) të dhënat duhet të paraqiten me aplikimin për lidhje të re në përputhje me këtë Kod, për shtesë të linjave të reja dhe nënstacioneve, për çdo modifikim të linjave dhe paisjeve të cilat mund të ndikojnë në rritjen e ngarkesës, konsumit të energjisë elektrike në rrjetin e Sistemit të Transmetimit.
7. Formatet:
   a) Në të gjitha rastet të dhënat paraqiten në formatet e përshkruara në Shtojca A, Shtojca B, Shtojca C të këtij Kodi dhe në rast së nuk janë në Shtojca të shoqërohen me një shënim që mbulon termat përkatëse që nuk përfshihen në këto Shtojca.

Të dhënat e Detajuara të Studimit apo Planifikimit

1. Të dhënat e kërkuara listohen sipas formateve në Shtojca A, Seksioni 2, Paragrafet: A.4; A.5; A.6; A.7; A.8; A.9; A.10; A.11;
2. Të dhënat e Përdoruesve egzistues të rrjetit të Transmetimit dërgohen deri në 30 Shtator për vitin/vitet pasardhës të studimit apo planifikimit.

Të Dhënat Vjetore të Studimit apo Planifikimit

1. Jepen nga të gjithë përdoruesit egzistues të rrjetit të transmetimit të listuara në formatet sipas Shtojca A, Seksioni 3;
2. Afati kohor për të gjithë përdoruesit egzistues të rrjetit të Transmetimit për dërgimin e këtyre të dhënave është deri me 30 Shtator të vitit, për vitin pasardhës.

Të Dhënat të Planifikimit 2 vjeçar të Zhvillimit

1. Jepen nga të gjithë përdoruesit e rrjetit të sistemit të transmetimit të listuara sipas formateve Shtojca A, Seksioni 3; paragrafi A.9;
2. Afati kohor për të gjithë përdoruesit e rrjetit të Sistemit e Transmetimit për të dërguar të dhënat e tyre është deri me 30 shtator të vitit korrent, për 2 vitet pasardhës.

Të Dhëna për Punimet (Punët) në Progres

1. Jepen nga të gjithë përdoruesit e Rrjetit të Sistemit të Transmetimit të listuara sipas formateve në Shtojca A, Seksioni 3, paragrafi A.10;
2. Afati Kohor për të gjithë përdoruesit e lidhur në rrjetin e Sistemin të Transmetimit është deri me 31 Mars të çdo viti. Ata do të paraqesin këto të dhëna:
   a) të dhënat Përfundimtare të listuara sipas formateve në Shtojca A, Seksioni 3,paragr. A11;

   Të gjithë përdoruesit e lidhur në rrjetin e Sistemit të Transmetimit do të dërgojnë të dhënat në kohën e përfundimit të punimeve dhe kur ata janë të gatshëm për t'u lidhur me rrjetin e Sistemit të Transmetimit.

Seksioni 1 - Të Dhënat Standarte të Planifikimit

A.1 Gjeneruesit

1. Gjenerues Termik i Energjisë Elektrike

a) Lidhja

1	Pika e Lidhjes	Jepet një skemë një fazore e Lidhjes së propozuar me rrjetin e Sistemit të Transmetimit në kopje të printuar dhe elektronike;
2	Vendndodhja gjeografike	Paraqet zonën gjeografike të vendndodhjes se objektit/objekteve në hartë. Kjo harte duhet të jetë e lexueshme dhe jo më e vogël
3	Tensioni nominal	Tensioni nominal në pikat e Lidhjes me rrjetin e Sistemit të Transmetimit në kV;
4	Koha e Planifikuar	Koha e përafërt e planifikuar për lidhjen me rrjetin e Sistemit të Transmetimit, muaji/viti;

b) Kapaciteti i Gjeneruesit

1	Fuqia aktive nominale e instaluar e Gjeneruesit.	Fuqia aktive totale për gjeneruesit egzistues. Fuqia për gjeneruesit e rinj sipas fazave të investimit, në MW;
2	Numri i njësive gjeneruese dhe fuqia	n x MW

c) Të dhëna të Njësive Gjeneruese

1	Njësi Gjeneruese Termike me avull ose e kombinuar (gaz,avull);	Tipi, fuqia nominale aktive në MW
2	Turbinë me avull ose e	Tipi, fuqia nominale aktive në MW
3	Gjeneratori (Alternatori)	Tipi Karakteristika nominale (Sn, Pn në MVA dhe MW) Tensioni Nominal (Un në kV) Faktori Nominal i Fuqisë (cosϕ) Aftësia për Fuqi Reaktive (MVAr) Fuqia e Qarkut të Shkurtër (MVA) Reaktanca sinkrone (ne p.u. të MVA)
4	Transformatori i fuqisë i Bllokut Gjenerator-Transformator.	Tipi Fuqia e plotë Nominale në MVA Niveli i Tensionit (HV/LV) në kV Rrymat nominale (HV/LV) në A Rregullimi i Tensionit (Numri i shkallëve dhe hapat ± %) Tipi i Rregullimit të Tensionit (off-load/on-load)

d) Fuqia për Nevojat Vetiake

1	Fuqia Totale e kërkuar për paisjet vetiake të gjeneruesit.	në MW dhe MVA
2	Fuqia e jashtme totale e kërkuar për Black-Start.	në MW

2. Gjenerues Hidroelektrik

a) Lidhja

1	Pika e Lidhjes	Jepet një skemë një fazore e lidhjes së propozuar me rrjetin e Sistemit të Transmetimit në hardware dhe në soft;
2	Vendndodhja gjeografike	Paraqet zonën gjeografike të vendndodhjes se objektit/objekteve në hartë. Kjo harte duhet të jetë e lexueshme dhe jo më e vogël se formati A3
3	Tensioni nominal	Niveli i tensionit në pikat e Lidhjes me rrjetin e Sistemit të Transmetimit në kV;
4	Tipi i Gjeneruesit Hidrik	Përshkrimi teknik i gjeneruesit, tipi i tij: me rezervuar ose derivacion (Run-of-River) ose i kombinuar; treguesit e veprës hidrike (volumi total i rezervuarit, volumi aktiv i rezervuarit, niveli maksimal i ujit, niveli maksimal i punës, niveli minimal i

b) Kapaciteti i Gjeneruesit

1	Fuqia totale e Gjeneruesit në MW	Fuqia nominale aktive për gjeneruesit egzistues, në MW; Fuqia nominale aktive për gjeneruesit e rinj, sipas fazave të investimit, në MW.
2	Nr. i njësive gjeneruese dhe fuqia aktive nominale	n x MW

c) Të dhëna të Njësive Gjeneruese Hidrike

1	Regjimet e punës	Maksimal, Minimal, Mesatar. Parametrat e Punës në regjimet maksimal, minimal, mesatar.
2	Hidroturbinat	Tipi, fuqia aktive nominale

3	Gjeneratori (Alternatori)	Tipi Karakteristika nominale (Sn, Pn në MVA dhe MW) Fuqia minimale që mund të prodhojë gjeneratori (Pmin në MW) Kufijtë e prodhimit të fuqisë reaktive të gjeneratorit(Qmax, Qmin në MVAr) Tensioni Nominal (Un në kV) Faktori Nominal i Fuqisë (cosϕ) Fuqia e Qarkut të Shkurtër(MVA) Reaktanca sinkrone gjatësore, Xd (ne p.u të MVA) Reaktanca sinkrone tërthore Xq (ne p.u. të MVA) Reaktanca Kalimtare Gjatësore, X'd (ne p.u. të MVA) Reaktanca Superkalimtare Gjatësore, X"d (ne p.u. të MVA) Reaktanca Superkalimtare Tërthore, X"q (në p.u. të MVA) Reaktanca e Renditjes së kundërt, X2(në p.u. të MVA) Reaktanca e Renditjes Nulare, X0(në p.u. të MVA) Numri i Rrotullimeve nominale nn (rrotullime/min) Momenti i Volantit-GD2(Tm2)apo Kontantja e Intercise-H
4	Transformatori i Bllokut	Tipi Fuqia e plotë Nominale në MVA Niveli i Tensionit (HV/LV) në kV Rrymat nominale (HV/LV) në A Rregullimi i Tensionit (Numri i shkallëve dhe hapat ±%); Tipi i Rregullimit të Tensionit (off-load/on-load)

5	Të dhëna për rrjetin TM	Skema e lidhjes së njësive gjeneruese midis tyre në tension të mesëm duke specifikuar: Tensionin nominal të rrjetit TM

d) Fuqia për Nevojat Vetiake

1	Fuqia Totale e kërkuar për paisjet vetiake të	në MW dhe MVA
2	Fuqia e jashtme totale e	në MW

Shënim 1: Reaktanca Kalimtare Gjatësore (ne p.u të MVA) dhe kurba e ngopjes së lidhjes së shkurtër nuk kërkohen për njësitë gjeneruese pa rregullim.

3. Gjenerues Eolik (me erë)

a) Lidhja

1	Pika e lidhjes	Jepet një skemë një fazore të Lidhjes së propozuar me rrjetin e
2	Vendndodhja gjeografike	Paraqet zonën gjeografike të vendndodhjes së objektit/objekteve në hartë. Kjo harte duhet të jetë e lexueshme
3	Tensioni nominal	Tensioni nominal në piken e Lidhjes me rrjetin e Transmetimit
4	Tipi i gjeneruesit eolik	Përshkrimi teknik i gjeneruesit, tipi i tij, etj.
5	Të dhënat metereologjike	Të jepen të dhënat e plota metereologjike për zonën në të cilën do të instalohen njësitë gjeneruese.

b) Kapaciteti i Gjeneruesit

1	Fuqia totale e Gjeneruesit në MW	Fuqia nominale aktive për gjeneruesit ekzistues, në MW;
2	Nr. i njësive gjeneruese dhe fuqia aktive	n x MW

c) Të dhëna të Njësive Gjeneruese Eolike

1	Regjimet e punës	Maksimal, Minimal, Mesatar. Parametrat e Punës në regjimet maksimal, minimal, mesatar.
2	Turbinat	Tipi, fuqia aktive nominale
3	Gjeneratori (Alternatori)	Tipi Karakteristika nominale (Sn, Pn në MVA dhe MW) Fuqia minimale që mund të prodhojë gjeneratori Kufijtë e prodhimit të fuqisë reaktive të gjeneratorit (Qmax, Qmin në MVAr) Tensioni Nominal (Un në kV) Faktori Nominal i Fuqisë (cosϕ) Fuqia e Qarkut të Shkurtër(MVA) Reaktanca sinkrone gjatesore, Xd (ne p.u të MVA) Reaktanca sinkrone tërthore Xq (ne p.u. të MVA) Reaktanca Kalimtare Gjatësore, X'd (ne p.u. të MVA) Reaktanca Kalimtare Tërthore (X'q në p.u të MVA) Reaktanca Superkalimtare Gjatësore, X"d (ne p.u. të MVA) Reaktanca Superkalimtare Tërthore, X"q (ne p.u. të MVA) Reaktanca e Renditjes së kundert, X_2(ne p.u. të MVA)Reaktanca e Renditjes Nulare, X_0(ne p.u. të MVA) Numri i Rrotullimeve nominale n_n (rrotullime/min) Momenti i Volantit-GD^2(Tm^2) apo Kontantja e Intercise-H Konstantja mekanike e kohës, T'_m(ne sek) Konstantja e kohës kalimtare gjatësore për pështjellë të hapur në stator, T'_{do} (ne sek) Konstantja e kohës superkalimtare gjatësore për pështjellë të statorit të hapur, T''_{do} (ne sek) Konstantja e kohës superkalimtare tërthore për pështjellë të statorit të hapur, T''_{qo} (ne sek) Konstantja e kohës kalimtare gjatësore për pështjellë të statorit të lidhur në të shkurter, T'_d (ne sek)

4	Transformatori i Bllokut Gjenerator-Transformator	Tipi Fuqia e plotë Nominale në MVA Niveli i Tensionit (HV/LV) në kV Rrymat nominale (HV/LV) në A Rregullimi i Tensionit (Numri i shkallëve dhe hapat ±%); Tipi i Rregullimit të Tensionit (off-load/on-load)
5	Të dhëna për rrjetin TM	Skema e lidhjes së njësive gjeneruese midis tyre në tension të mesëm duke specifikuar: Tensionin nominal të rrjetit TM

d) Fuqia për Nevojat Vetiake

1	Fuqia Totale e kërkuar për paisjet vetiake të	në MW dhe MVA

Shenim 2: Për tipet e Gjeneruesve që nuk përfshihen në tipet me sipër, të dhënat do të paraqiten sipas kërkesave të veçanta të specifikuara nga OST .

A.2 Linjat Elektrike të Transmetimit

1. Emri i Linjës (nënstacioni në fillim të linjës dhe nënstacioni në mbarim të linjës)
2. Tensioni i Linjës në (kV)
3. Gjatësia e linjës (km)
4. Përcjellësit e linjës (Tipi, Seksioni (mm²))
5. Parametrat e Linjës (në p.u. dhe vlerat Ohmike për km të linjës)
   a) Rezistenca/Induktanca
   b) Përcjellshmëria/konduktanca (B/2 në p.u. dhe μS)
   c) Aftësia transmetuese në temperaturë ambienti 200 C (Rryma e lejuar termike në A).
   d) Përcaktimi i densitetit j-ekonomik në A/mm²;
   e) Tipet e shtyllave që do të përdoren dhe parametrat përkatës;
   f) Terreni ku kalon Linja (informacion mbi terrenin natyror ku kalon linja elektrike)
   g) Harta e Linjës (informacion për topografinë planimetrike të linjës në hartën gjeografike që tregon linjën e propozuar dhe linjat egzistuese).
   h) Për linjat egzistuese do të jepet koha e vënies në punë;
   i) Për linjat e reja të jepet koha kur do të vihet në punë (muaj/viti).

A.3 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Klientët

1. Të përgjithshme

Të dhënat për rrjetin elektrik dhe sistemet/objektet nën administrim të shoqërisë të Sistemit të Shpërndarjes dhe të klientëve të rrjetit të sistemit të transmetimit;

1	Zona e shtrirjes gjeografike për shoqërinë e Sistemit të Shpërndarjes dhe plan vendosja për Klientët, në hartë (me shkallë të lexueshme, jo më të vogël së formati A3).	Paraqet zonën gjeografike në të cilën ushtron aktivitetin e bisnesit shoqëria e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Klientët sipas licensës përkatëse, të paraqitur në hartën shtetërore. Kjo hartë duhet të jetë e lexueshme dhe jo më e vogël se formati A3).
2	Të dhënat për ngarkesat e tyre	Te dhënat si konsumatorë të energjisë elektrike, në MW, MVA.

2. Lidhja

1	Pikat e Lidhjes	Jep një skemë një fazore që tregon pikat e lidhjes me rrjetin e Sistemit të Transmetimit në hardcopy dhe soft;
2	Tensioni nominal	Niveli i tensionit në pikat e lidhjes me rrjetin e Sistemit të Transmetimit në kV;
3	Zona e shtrirjes gjeografike për shoqërinë e Shpërndarjes dhe planvendosja për Klientët në hartë (me shkallë të lexueshme, jo me të vogël së formati A3).	
4	Emrat e nënstacioneve të rrjetit të Sistemit të Transmetimit që ushqejnë pikat e Lidhjes.	

3. Linjat Elektrike dhe Nënstacionet

1	Të dhënat e Linjës elektrike	Jepen gjatësitë e linjës dhe nivelin e tensionit nominal; Jepen të gjithë parametrat e përshkruar në piken A.2
2	Të dhënat e Nënstacioneve elektrike	Jepet skema primare e nënstacionit lidhës me rrjetin e transmetimit. Jepen detajet (fuqia transformuese, konfigurimi i të gjithë elementeve primare dhe sekondare, planimetria, harta, etj.) e nënstacioneve që lidhen direkt me rrjetin e Transmetimit dhe detaje të instalimeve kompesuese (kapacitive ose induktive) të instaluar. Për transformatorin e Fuqisë të jepen parametrat: Tipi Fuqia e plotë Nominale në MVA Niveli i Tensionit (HV/LV) në kV Rrymat nominale (HV/LV) në A Rregullimi i Tensionit (Numri i shkallëve dhe hapat ±%); Tipi i Rregullimit të Tensionit (off-load/on-load) Grupi i lidhjes së pështjellave Impedanca e lidhjes shkurtër në % Humbjet e punimit në ngarkese në kW Humbjet e punimit pa ngarkese në kW Rryma e punimit pa ngarkese në % Lloji i ftohjes (ONAN/ONAF)

4. Ngarkesat konsumatorë

1	Detaje të ngarkesave që ushqehen direkt nga rrjeti i Sistemit të Transmetimit;	Jep emrin e klientit, tensionin e furnizimit, proçesin teknologjik të punës. Kërkesën për energji elektrike sipas kontratës dhe emrin e nënstacionit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit, cila linjë e furnizon, gjatësinë e linjës dhe detaje të pajisjeve kompesuese që marrin pjesë në përmirësimin e cilësisë së furnizimit të parametrave si tensioni, luhatjet; Faktorin e fuqisë, cosϕ;
2	Ngarkesat në pikat e lidhjes	Ngarkesat dhe detajet e ngarkesave të vendosura në pikën e lidhjes, në MW

5. Të dhënat e Kërkesës

(*Shënim:* Ky informacion kërkohet nga Klientët që kërkojnë të lidhen me rrjetin e Sistemin e Transmetimit ose që janë të lidhur në këtë rrjet)

1	Tipi i Ngarkesës	Të dhënat e pikëlidhjes ku furnizohet ngarkesa, sasinë e energjisë elektrike që merr ngarkesa, tipin e saj etj.
2	Tensioni Nominal	Në pikën e lidhjes në rrjetin e sistemit të transmetimit, në kV
3	Ngarkesa elektrike e pajisjeve	Ngarkesa në MW dhe cos ϕ e ngarkesës Të dhënat mbi sasinë e energjisë elektrike vjetore të parashikuar
4	Ndjeshmëria e ngarkesës nga tensioni dhe frekuenca	
5	Maksimumi i harmonikave të ngarkesës	
6	Mesatarja dhe maksimumi i disbalancës së fazave të ngarkesës	
7	Emërtimi i nënstacionit nga i cili furnizohet klienti	Skema e primare e nënstacionit dhe parametrat kryesore të pajisjeve primare, linjat elektrike hyrëse dhe dalëse; Jepen të dhënat sipas pikës A.3

8	Harta gjeografike e zonës	Tregon zonën ku është vendosur klienti, ngarkesa, si dhe linjat eletrike. Jep hartën dhe planimetrinë e vendit ku parashikohet/është vendosur të realizohet lidhja e objektit. Harta dhe planimetria duhet të jenë të lexueshme dhe në formatin jo me të vogël se A3

6. Të dhëna të Parashikimit të Kërkesës

1. Ngarkesa maksimale pik dhe minimum, profili i ngarkesës sipas kategorive, parashikimi i ngarkesës për çdo kategori të ngarkesës për 10 vitet e ardhshme, planifikimi afatgjatë i kërkesës;
2. Detaje të metodologjisë dhe baza e të dhënave në të cilën janë bazuar parashikimet;
3. Parashikimet e kërkesës së energjisë elektrike, MWh, për çdo kategori dhe në total të ngarkesës për 10 vitet e ardhshme, të shoqëruara me Kurbat Ditore të Ngarkesës të përafruara.
4. Detaje të ngarkesave të lidhura direkt me rrjetin e Sistemit të Transmetimit:
   a) Emri i Klientit ekzistues apo i perspektivës;
   b) Pika e Lidhjes dhe natyra e ngarkesës ;
   c) Nënstacioni nga i cili do të furnizohet ngarkesa;
   d) Tensioni nominal i furnizimit të ngarkesës.

Shënim: pikat 1-4 të plotësohen referuar pikës A.3

5. Pajisjet për Kompensim Reaktiv

Për të gjitha paisjet e kompesimit reaktiv të planifikuara për tu lidhur në rrjetin e sistemit të përdoruesit kërkohen informacionet e mëposhtme:

a) Lloji i pajisjes (p.sh. statik apo i ndryshueshëm);
b) Ngarkesën nominale kapacitive dhe/ose induktive ose brezin e tij operues në MVAr;
c) Detajet e çdo kontrolli automatik që mundëson përcaktimin e karakteristikave të operimit;
d) Pika e lidhjes me rrjetin e sistemin të përdoruesit për sa i përket vendndodhjes elektrike dhe tensionit të rrjetit të sistemit;

Seksioni 2 – Të Dhënat e Detajuara të Planifikimit

A.4 Impiantet e gjenerimit

1. Centralet Gjenerues Termik. Të përgjithshme

a) Emri i Gjeneruesit (Prodhuesit);
b) Numri dhe fuqia nominale aktive e njësive gjeneruese (n x MW);

c) Parametrat Nominale të Pajisjeve Kryesore;
d) Kaldaja (temperatura e Avullit/ presioni i avullit);
e) Lloj i lëndës djegëse, të dhënat kryesore të pompave të furnizimit me ujë dhe të burimit të furnizimit me ujë teknik;
f) të dhënat teknike për Turbinat;
g) Të dhënat teknike për Gjeneratorët (Alternatorët);
h) Të dhënat teknike për transformatorin e bllokut " Gjenerator -Transformator"
i) Të dhënat teknike për Transformatorët e nevojave vetiake dhe ngarkesën e saj;
j) Skemë elektrike primare një fazore e Gjeneruesit;
k) Skemat principiale elektrike të kontroll-monitorimit, mbrojtjes rele dhe matjes, telekomunikacionit, SCADA, e tjera;
l) Statusi i Neutrit të statorit të gjeneratorëve (i tokëzuar apo jo), skema e tokëzimit dhe vlera e rezistencës së tokëzimit;
m) Parametrat e sistemit të Eksitimit dhe skema e eksitimit;
n) Statusi i neutrit të transformatorëve ngritës të fuqisë të gjeneruesit në anën e lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe vlerat e rezistencës së tokëzimit.

Shënim: Të dhënat e detajuara teknike do të jepen sipas formateve TIP të aplikimit sipas kërkesave të Seksonit 1

2. Mbrojtja Rele

1. Përshkrimin e plotë të Mbrojtjes Rele, që përfshin tarimet për të gjitha reletë dhe Sistemet e Mbrojtjes Rele të instaluar në Gjeneratorët dhe Transformatorët e njësive gjeneruese, Transformatorët e Nevojave Vetiake dhe motorët elektrik të paisjeve ndihmëse të nevoja vetiake.
2. Përshkrimin e plotë i Mbrojtjes Rele që përfshin tarimet për të gjitha reletë e instaluara në të gjitha linjat elektrike të nënstacionit ngritës të Gjeneruesve.
3. Përshkrimin e plotë të çelësave çkycës në pikën ose pikat e Lidhjes me rrjetin e Sistemit të Transmetimit dhe parametrat e çelësave të fuqisë për veprimet komutuese (fuqia e çkycjes, koha e kyçjes, koha e çkyçjes, e tjera..).
4. Kohëzgjatja më e mundshme e defekteve elektrike në sistemet/objektet e gjeneruesve;
5. Detajimi i skemave të matjes/telematjes të parametrave të energjisë elektrike, që përfshin transformatorët matës dhe kabllot në anën sekondare.
6. Specifikimet teknike të pajisjeve të telekomunikacionit
   a) Specifikimet për OPGW, që duhet të instalohet në linjën që do të lidhë objektin e ri me nënstacionin dhe konfigurimi i lidhjes së fibrave optike ku do të bëhet ndërfaqja, do të jepen nga Zyra e Telekomunikacionit të OST sipas çdo rasti specifik, për shkak të impaktit në rrjetin ekzistues të OPGW që ka OST.
   b) Gjithashtu nga zyra përgjegjëse për telekomunikacionin në shoqërinë OST sha, do të merren dhe spëecifikimet e detajuara për radrizatorët, kabinetet industriale, bateritë dhe paisjet e tjera ndihmëse.
   c) Telefonia duhet të jetë dixhitale dhe analoge.

3. Nënstacionet Elektrike të Gjeneruesve

a) Për transformatorët e bllokut gjenerator-transformator dhe transformatorët e tjerë të fuqisë:

1. Tipi

2. Fuqia e plotë Nominale në MVA
3. Niveli i Tensionit (HV/LV) në kV
4. Rrymat nominale (HV/LV) në A
5. Rregullimi i Tensionit (Numri i shkallëve dhe hapat ± %);
6. Tipi i Rregullimit të Tensionit (off-load/on-load)
7. Grupi i lidhjes së pështjellave
8. Impedanca e lidhjes shkurtër në %
9. Humbjet e punimit në ngarkese në kW
10. Humbjet e punimit pa ngarkese në kW
11. Rryma e punimit pa ngarkese në %
12. Lloji i ftohjes (ONAN/ONAF)

b) Për paisjet komutuese ku përfshihen çelsat, ndarësat-thikat e vendosura në pikat e Lidhjes;
   1. Tensioni Nominal (kV);
   2. Tipi i çelsit, ndarësit-thikës dhe parametrat kryesore të tyre;
   3. Rryma e Lidhjes së Shkurtër 3 fazore dhe 1 fazore, (kA);
   4. Të dhënat të Pajisjes të Rikyçjes Automatike dhe tarimet përkatëse.

c) Detaje të Sistemit të Kontroll-Monitorimit, SCADA lokale e gjeneruesit, telekomunikacioni, RTU (Njësia e Kontrollit në Distance), etj.

d) Niveli i Izolacionit, (kV):
   1. Zbarat;
   2. Paisjet Komutuese (çelsat, ndarsat-thikat);
   3. Transformatorët e rrymës dhe tensionit;
   4. Degëzimet e rregullimit të tensionit në Transformator;
   5. Pështjellat e Transformatorëve;

e) Të dhëna të tjera Teknike të nevojshme me kërkesë të arsyetuar nga OST, për problemet e Operimit, dispecimit, kontrollit të frekuencës, rezervat rregulluese, të rregullimit të tensionit, për Black- Startin, e tjera.

4. Njësitë Gjeneruese

a) Parametrat e Alternatorëve (Gjeneratorëve)

1. Tensioni Nominal (Un në kV)
2. Fuqia e Plotë Nominale (Sn në MVA)
3. Fuqia Aktive Nominale (Pn në MW)
4. Rryma Nominale e Fazës (In në A)
5. Fuqia minimale qe mund të prodhoje gjeneratori (Pmin në MW)
6. Kufinjtë e prodhimit të fuqisë reaktive të gjeneratorit (Qmax, Qmin në MVAr)
7. Faktori i Fuqisë Nominale (Cos ϕ)
8. Frekuenca Nominale (fn në Hz)
9. Shpejtësia Nominale (Nn në rrot/min)
10. Konstante e Inercisë H (MW Sec/MVA)
11. Momenti Volantit (GD^2 në Tm^2)
12. Koeficienti i Lidhjes së Shkurtër (Kc)
13. Reaktanca Sinkrone Gjatësore (Xd në p.u)
14. Reaktanca Kalimtare Gjatësore (X'd në p.u)

15. Reaktanca Superkalimtare Gjatësore (X''d në p.u)
16. Reaktanca Sinkrone Tërthore (Xq në p.u)
17. Reaktanca Kalimtare Tërthore (X'q në p.u)
18. Reaktanca Superkalimtare Tërthore (X''q në p.u)
19. Reaktanca e Renditjes së kundert, X_2 (ne p.u. të MVA)
20. Reaktanca e Renditjes Nulare, X_0 (ne p.u. të MVA)
21. Rezistenca e Statorit për faze në 75 grade C (Ra në om)
22. Konstantja e kohës kalimtare gjatësore për pështjellë statori të hapur (T'd0 në sek).
23. Konstantja e kohës Superkalimtare sipas aksit gjatësor për pështjellë statori të hapur (T''do në sek).
24. Konstantja e kohës kalimtare tërthore për qark të hapur (T'qo në sek).
25. Konstantja e kohës superkalimtare tërthore për qark të hapur (T''qo në sek).
26. Konstantja e kohës e pështjellës së statorit të lidhur në të shkurtër (Ts në sek).
27. Konstantja mekanike e kohes, T'_m (ne sek)
28. Konstantja e kohës kalimtare gjatësore për pështjellë të statorit të lidhur në të shkurter, T'_d (ne sek)
29. Konstantja e kohës superkalimtare gjatësore për pështjellë të statorit të lidhur në të shkurter, T''_d (ne sek)
30. Konstantja e kohës superkalimtare tërthore për pështjellë të statorit të lidhur në të shkurter, T''_q (ne sek)
31. Kurba e Ngopjes së Qarkut të Hapur.
32. Kurba e Aftësisë së Gjeneratorit.

Shënim: Pikat 14,17,23,25,31 përjashtohen si të dhëna për njësitë Gjeneruese pa rregullim.

b) Parametrat e Sistemit të Eksitimit dhe Rregullatorit Automatik të Tensionit (RAT)

Të dhënat e mëposhtme do të shërbejnë për të realizuar studimin e qëndrueshmërisë statike dhe dinamike të rrjetit të Transmetimit.

1. Tipi i Eksituesit
2. Rryma Nominale e Punës së Eksituesit (In në A)
3. Tensioni Nominal i Punës së Eksituesit (Un në V)
4. Rryma Maksimale e Eksituesit gjatë Kohës Kalimtare (Imax. Në A)
5. Tensioni Maksimal i Eksituesit (U max. Në V)
6. Përgjigja Kalimtare e Sistemit të Eksitimit (ne sek)
7. Karakteristika e Përgjigjes së Sistemit të Eksitimit me lak të hapur
8. Karakteristika e Përgjigjes së Sistemit të Eksitimit me lak të mbyllur
9. Karakteristika Dinamike të mbieksitimit dhe kufijtë
10. Karakteristika Dinamike të nëneksitimit dhe kufijtë
11. Skema strukturore e detajuar e të gjithë sistemit të eksitimit, ku tregohen në detaje funksionet transmetuese të elementeve të tij dhe parametrat e elementeve transmetues bazuar në tipin e sistemit të eksituesit dhe skema strukturore, funksionet transmetues dhe parametrat e elementeve të tij bazohen në standartet IEEE (Instituti i Inxhinereve Elektrik dhe Elektronik) dhe ENTSO-E.
12. Modelet e sistemit sipas këtyre standarteve shërbejnë për studimin e qëndrueshmërisë statike dhe dinamike si dhe parametrizimin e rrjetit të Sistemit të Transmetimit.

c) Parametrat e Rregullimit dhe Rregullatorit të Shpejtësisë

1. Tipi i Rregullatorit të Shpejtësisë
2. Koeficienti "k" i përcaktimit të shkallës së futjes në punë të rregullatorit të shpejtësisë (në MW/Hz) siç përcaktohet në standartet
3. Marrja e shpejtësisë dhe konstantja e kohës e tij (TSR)
4. Konstante kohës së servomotorit dhe Aparatit Drejtues (TSM)
5. Valvola e hapjes së rregullatorit të shpejtësisë me numër limit (CV. OPEN)
6. Valvola e mbylljes me numër limit e rregullatorit të shpejtësisë (CV. CLOSE)
7. Kufiri i valvolës së rregullatorit të shpejtësisë (CVmax. dhe CVmin)
8. Bazuar në sistemin e turbinave me avull në CR-IEEE parametrat e mëposhtëm duhet të sigurohen kur është e përshtatshme.
9. Skema Strukturore e Sistemit të Rregullimit dhe Rregullatorit të Shpejtësisë duke treguar funksionet transmetues të elementëve të veçantë dhe të rekomanduar në standartet përkatëse.

5. Gjeneruesit Hidroelektrike

a) Të Përgjithëshme

1. Emri i Gjeneruesit
2. Numri dhe kapaciteti i Njësive gjeneruese (n x MVA)
3. Specifikimi teknik i gjithë Paisjeve Kryesore
   i. Turbinat (MW, kF)
   ii. Gjeneratoret (MW)
   iii. Gjenerator-Transformatorët (MVA)
   iv. Transformatorët e nevojave vetjake (MVA)

Shënim: Të dhënat teknike do të jepen sipas formateve TIP të aplikimit sipas kërkesave të Seksionit 1.

b) Skemë elektrike primare një fazore e Gjeneruesit

c) Skemë e kontroll-monitorimit, mbrojtjes rele dhe automatikës, matjes/telematjes,SCADA;

d) Statusi i tokëzimit të Neutrit të statorit të Gjeneratorit dhe rezistenca e tokëzimit;

e) Sistemi i eksitimit dhe RAT;

f) Statusi i tokëzimi të neutrit të transformatorëve me vlerat e rezistencës të tokëzimit;

g) Të dhënat teknike të Rezervuarit të ujit

1. Karakteristikat kryesore
2. Tipi i Rezervuarit
   i. për shumë qëllime
   ii. për Energji Elektrike
3. Tabela e operimit

Shënim: Pika e) përjashtohet si e dhënë për njësite gjeneruese pa rregullim.

h) Mbrojtja Rele

1. Përshkrim i plotë i mbrojtjes rele që përfshin tarimet për gjithë reletë dhe sistemet e mbrojtjes rele të instaluar në Gjeneratorët dhe Transformatorët e njësive gjeneruese, Transformatorët e Nevojave Vetjake dhe motorët elektrik të paisjeve ndihmëse.
2. Përshkrim i plotë i mbrojtjes rele që përfshin tarimet për gjithë reletë e instaluara në të gjitha linjat dalëse nga nënstacionet ngritës të Gjeneruesve
3. Përshkrim të plotë të çelësave të fuqisë në pikën ose pikat e Lidhjes me rrjetin e Sistemit të Transmetimit dhe të dhënat e çelësave të fuqisë për veprimet komutuese (fuqia e ckycjes, koha e kyçjes, koha e çkyçjes).
4. Kohëzgjatja më e mundshme e defekteve elektrike në sistemet/objektet e Gjeneruesve (njësi gjeneruese, linja, transfomatorë e tjera).
5. Detajimi i funksionimit të mbrojtjes rele, automatikës dhe matjes së energjisë elektrike që përfshin Transformatorët matës dhe kabllot në anën sekondare.

i) Nënstacionet e Gjeneruesve

1. Për transformatorët e bllokut gjenerator-transformator dhe transformatorët e tjerë të fuqisë:
   i. Tipi
   ii. Fuqia e plotë Nominale në MVA
   iii. Niveli i Tensionit (HV/LV) në kV
   iv. Rrymat nominale (HV/LV) në A
   v. Rregullimi i Tensionit (Numri i shkallëve dhe hapat ± %);
   vi. Tipi i Rregullimit të Tensionit (off-load/on-load)
   vii. Grupi i lidhjes së pështjellave
   viii. Impedanca e lidhjes shkurtër në %
   ix. Humbjet e punimit në ngarkese në kW
   x. Humbjet e punimit pa ngarkese në kW
   xi. Rryma e punimit pa ngarkese në %
   xii. Lloji i ftohjes (ONAN/ONAF)
2. Për paisjet komutuese ku përfshihen çelsat, ndarsat-thikat e vendosura në Pikat e Lidhjes:
   i. Tensioni Nominal (kV);
   ii. Tipi i çelsit, ndarësit-thikës dhe parametrat kryesorë të tyre;
   iii. Rryma e Lidhjes së Shkurtër 3 fazore dhe 1 fazore (kA);
   iv. Të dhënat të Pajisjes të Rikyçjes Automatike dhe tarimet përkatëse ;
3. Detaje të Sistemit të Kontroll-Monitorimit, SCADA lokale e gjeneruesit, telematja,RTU (Njësia e Kontrollit në Distance), etj.
4. Niveli i Izolacionit (kV)
   i. Zbarat
   ii. Paisjet Komutuese (çelsat, ndarsat-thikat)
   iii. Degëzimet e rregullimit të tensionit në Transformatorët
   iv. Transformatorët e rrymës dhe tensionit
   v. Pështjellat e Transformatorëve
5. Të dhëna të tjera teknike të nevojshme me kërkesa të arsyetuar nga OST, për problemet e Operimit, dispecerimit, kontrollit të frekuencës, rezervat rregulluese, të tensionit, për Black- Startin, e tjera.

j) Njësitë Gjeneruese

1. Parametrat e Gjeneratorit (Alternatorit)
   i. Parametrat janë të njëjtë si për gjeneratorët e gjeneruesve Termike:
   ii. Regjimi Operues Hidrik Maksimal, Minimal, Mesatar;
   iii. Portat shkarkuese dhe aftësitë e tyre;
   iv. Karakteristikat e turbinës së njësive gjeneruese;
   v. Konsumi i ujit të njësive gjeneruese për nivele të ndryshme në rezervuarin e ujit;
2. Parametrat e Kontrollit të Sistemit të Eksitimit
   i. Të njëjte me parametrat e sistemit të eksitimit të Gjeneratorëve (Alternatorëve) të Gjeneruesve Termikë.
3. Parametrat e Rregullatorëve të Shpejtësisë
   i. Shpejtësia e Rregullimit të RASH;
   ii. Shpejtësia e Lëshimit normal;
   iii. Shpejtësia e Lëshimit në emergjencë;
   iv. Konstante e Kohës së Inercisë së Ujit (Tw);

6. Për Objektin e Gjeneruesve Termik

a) Të Përgjithëshme

1. Studimi i Detajuar i Projektit
2. Studimi Teknik
   i. Toka
   ii. Furnizimi me lëndë djegëse
   iii. Uji
   iv. Ndikimi mbi Mjedisin
3. Miratimi Tekniko-Ekonomik nga autoritetet përkatës sipas Legjislacionit në fuqi.

b) Lidhja

1. Raporti i studimeve për funksionimin në paralel me rrjetin e Sistemit të Transmetimit;
   i. Studime për Shpërndarjen e Flukseve
   ii. Studime për Lidhjet e Shkurtra
   iii. Studime të qëndrueshmërisë Statike dhe Dinamike
2. Propozim për Lidhje me rrjetin e Sistemit të Transmetimit:
   i. Numri i linjave
   ii. Tensioni
   iii. Pika/Pikat e Lidhjes

7. Për Objektin e Gjeneruesve Hidrik

a) Të Përgjithshme

1. Studimi i Detajuar i Projektit
2. Raporti Teknik:
   i. Vëzhgim Topologjik

ii. Vëzhgim Gjeografik
iii. Toka
iv. Ndikimi mbi Mjedisin
3. Miratimi Tekniko-Ekonomik nga autoritetet përkatës sipas Legjislacionit në fuqi.

b) Lidhja me rrjetin e Sistemit të Transmetimit:

1. Raporti i studimeve për funksionimin në paralel me rrjetin e Sistemit të Transmetimit;
   i. Studime për Shpërndarjen e Flukseve
   ii. Studime për Lidhjet e Shkurtra
   iii. Studime të qëndrueshmërisë Statike dhe Dinamike
2. Propozim për Lidhje me rrjetin e Sistemit të Transmetimit
   i. Numri i linjave
   ii. Tensioni
   iii. Pika/Pikat e Lidhjes

8. Të dhëna që paraqiten nga të gjithë tipet e Gjeneruesve

a) Të dhëna për vlerën e Rrymës Maksimale të Lidhjes së shkurtër 3 fazore ose 1 fazore që injektohet nga Gjeneruesi në pikën e lidhjes/pikat e lidhjes me Rrjetin e Sistemit të Transmetimit.

A.5 Të dhëna të Detajuara të Sistemit Elektroenergjitik

1. Të Përgjithshme

a) Skema elektrike primare një fazore e regjimit normal të punës të Sistemit të Transmetimit ku shënohen dhe pikat ku janë lidhur Gjeneruesit;
b) Harta e rrjetit të Sistemit të Transmetimit ku shënohen dhe pikat ku janë lidhur Gjeneruesit;
c) Emrin e Nënstacionit elektrik;
d) Skema elektrike primare e nënstacioneve (të gjeneruesve dhe të gjithë përdoruesve të rrjetit të transmetimit) si më poshtë:

   1. Gjeneruesit;
   2. Transformatorët /Autotransformatorët;
   3. Zbarat e nënstacioneve;
   4. Paisjet komutuese me emërtimet përkatëse (p.sh: dalje-trakt linjë, dalje-trakt transformatori, etj);
   5. Paisjet për kompensimin e Fuqisë Reaktive;

e) Numrin, gjatësinë dhe parametrat e linjave elektrike;

2. Lidhja

a) Raport i detajuar i Projektit;
b) Raport i specifikimeve teknike;
   1. Vëzhgimi i trasesë të Linjës elektrike;

2. Vëzhgimi i Tokës së Nënstacionit;
3. Studimi i ndikimi në Mjedis.

c) Miratimi Tekniko-Ekonomik nga autoritetet përkatëse sipas Legjislacionit në fuqi.

3. Parametrat për linjën elektrike :

a) Emërtimi i Linjës dhe kodi i identifikimit;
b) Gjatësia e Linjës (km);
c) Numri i qarqeve të linjës;
d) Aftësi transmetuese termike për çdo qark në A ose në MVA;
e) Tensioni kV;
f) Reaktanca Fazore e Renditjes së Drejtë (p.u. në 100 MVA), X1;
g) Rezistenca Fazore e Renditjes së Drejtë (p.u. në 100 MVA), R1;
h) Përcjellshmëria Fazore e Renditjes së Drejtë (p.u. në 100 MVA), B1;
i) Reaktanca Fazore e Renditjes Nulare (p.u. në 100 MVA), X0;
j) Rezistenca Fazore e Renditjes Nulare (p.u. në 100 MVA), R0;
k) Përcjellshmëria Fazore e Renditjes Nulare (p.u. Në 100 MVA), B0;

4. Parametrat e transformatorëve dhe autotransformatorëve (për të gjithë transformatorët dhe autotrasformatorët)

Tipi

Fuqia e plotë Nominale në MVA

a) Niveli i Tensionit (HV/LV) në kV
b) Rrymat nominale (HV/LV) në A
c) Rregullimi i Tensionit (Numri i shkallëve dhe hapat ± %);
d) Tipi i Rregullimit të Tensionit (off-load/on-load)
e) Grupi i lidhjes së pështjellave
f) Impedanca e lidhjes shkurtër në %
g) Humbjet e punimit në ngarkese në kW
h) Humbjet e punimit pa ngarkese në kW
i) Rryma e punimit pa ngarkese në %
j) Lloji i ftohjes (ONAN/ONAF)

5. Specifikime teknike të Paisjeve (Për të gjithë nënstacionet elektrike)

a) Transformatorët / autotransformatorët e fuqisë;
b) Çelsat, Ndarsat-Thikat;
c) Zbarat, Izolatorët; Shkarkuesit;
d) Transformatorët e Rrymës dhe të Tensionit;

6. Specifikime të Mbrojtjes Rele :

a) Detaje të Mbrojtjes Rele të instaluar për të gjithë transformatorët dhe autotransformatorët, tarimet e tyre dhe koordinimi i selektivitetit me Përdoruesit e rrjetit të Sistemit të Transmetimit;
b) Detaje të Mbrojtjes Rele të instaluar për të gjitha linjat, tarimet e tyre dhe koordinimi i selektivitetit me Përdoruesit e rrjetit të Sistemit të Transmetimit;.

c) Detajet e Matjes së Energjisë Elektrike dhe të Telematjes.

7. **Studime të Sistemit Elektroenergjitik:**

1. Studime për shpërndarjen e flukseve të fuqisë (Pikun dhe Mimimumin e ngarkesave, për gjenerimin maksimal dhe minimal hidro dhe termo);
2. Studime të proçeseve kalimtare për lidhje të shkurtra dhe hapje (këputje) një dhe tre fazore në linja, transformatorë dhe zbara, si dhe për ngacmime të vogla;
3. Studime të qëndrueshmërisë statike e dinamike dhe përcaktimi i kohës kritike të çkyçjes. Studime të qëndrueshmërisë këndore dhe të kolapsit të tensionit në Sistem;
4. Studime për lidhje të shkurtër tre fazore dhe një fazore me tokën në nyjet kryesore të Sistemit dhe vlerat maksimale të rrymave të lidhjes shkurtër tre fazore dhe një fazore me tokën në pikat e Lidhjes me përdoruesit e rrjetit të Sistemit të Transmetimit;
5. Studime për humbjet teknike të fuqisë dhe energjisë në Rrjetin e Sistemit të Transmetimit;
6. Studime afatmesme për flukset tregëtare (TTC, NTC) të fuqisë në linjat e interkoneksionit me rajonin dhe me rrjetin sinkron evropian ENTSO-E.

A.6 Të dhënat e Detajuara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Klientëve

1. **Të Përgjithëshme**

a) Harta e zonës gjeografike që administrohet dhe operohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Klienti përkatës që tregojnë gjithë rrjetin, linjat dhe nënstacionet që i përkasin OSSH dhe rrjetin në pronësi dhe operim prej Klientit;
b) Skemë elektrike primare një fazore e rrjetit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Klientit (që tregon linjat elektrike nga pika e lidhjes me rrjetin e Sistemit të Transmetimit, nënstacionet 110/TM kV, nënstacionet TM/TM kV), përfshirë specifikimet teknike përkatëse të elementeve të rrjetit etj.;
c) Numrin dhe emërtesën e linjës dhe të nënstacionit sipas kodit të identifikimit;
d) Të dhënat historike të nivelit të humbjeve teknike në bazë vjetore dhe të monitorimit ditor për ditët karakteristike të vitit të humbjeve teknike në rrjetin sistemet/objektet e tyre.

2. **Lidhja**

a) Pikat e lidhjes (Jep detaje të paisjeve egzistuese dhe instalimeve të pikave të lidhjes);
b) Detaje të telematjes dhe matjes së energjisë së plotë, aktive, reaktive në pikat e lidhjes;
c) Detaje të Mbrojtjes Rele, monitorim - kontrollit, instalimeve të kompesimit të fuqisë reaktive, SCADA lokale dhe telekomunikacionit në pikat e lidhjes.

3. **Ngarkesa (Fuqia aktive)**

a) Ngarkesa e Lidhur (Tipi/Kategoria, detajet e ngarkesës, e konsumatorit, regjimi i tyre i operimit dhe shfrytëzimit);
b) Grafikun ditor në 24 ore (për ditë karakteristike/specifike të vitit (e mërkura e tretë dhe e djela e tretë, përpara të mërkurës, për çdo muaj) të ngarkesës për çdo nënstacion te
c) Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Klientit, ose sipas kërkesës së veçantë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit për ditën dhe orët e nevojshme të horizontit kohor të studimit apo analizës së nevojshme.

d) Grafikun me bazë ditore (sezonal dhe vjetor) për kërkesën/ngarkesën në tërësi të Operatorëve të Sistemit të Shpërndarjes dhe Klientit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit.

A.7 Të dhënat që jepen me kërkesë të Shoqërisë OST sh.a

1. Të Përgjithëshme

a) Raport të detajuar të projektit (për fuqizimin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimin e rrjetit të sistemeve/ objekteve të rinj të Përdoruesit të Rrjetit të Sistemit të Transmetimit).
b) Raport i Gjendjes aktuale të rrjetit të ngarkesave dhe të performancës teknike dhe ekonomike egzistuese;
c) Parashikim i ngarkesës për 5 vitet e ardhshme;
d) Skeme elektrike primare një fazore (që tregon linjat dhe nënstacionet e rinj të propozuar, elementet të tjerë primare të rrjetit);
e) Analiza social-ekonomike;

2. Lidhja

a) Pikat e lidhjes së Aplikuesve për lidhje:
   1. të reja;
   2. Përmirësimin/modifikimi lidhjeve egzistuese;
b) Ndryshime/modifikime/modernizime në paisjet e mbrojtjes rele ose të telematjes/matjes, e tjera, në pikat e lidhjes;

3. Ngarkesat si Fuqi Aktive dhe si Kërkesë për Energji Elektrike

a) Detaje të ngarkesës si dhe parashikimin për 5 vitet e ardhshme;
b) Detaje të instalimit dhe shpërndarjes së ngarkesave në nënstacionet e projektuar, për 5 vitet e ardhshme;
c) Detaje të ngarkesave kryesore që do të kontraktohen në 5 vitet e ardhshme;

4. Përmirësimi i Skemave të Lidhjes Primare të Përdoruesve të Rrjetit të Sistemit të Transmetimit që Ndikojnë për Uljen e Humbjeve Teknike në Rrjetin e Sistemit të Transmetimit.

a) Paraqitje dhe analizë e vlerësimit të humbjeve teknike të fuqisë dhe energjisë të shkaktuara nga Përdoruesit e Rrjetit në Sistemin e Transmetimit për 5 vitet e ardhshme;
b) Relacion i përmbledhur i skemave të përmirësuara për uljen e humbjeve teknike (i paraqitur si raport teknik) duke analizuar:
   1. Linja të reja;
   2. Përmirësim i linjave egzistuese;
   3. Nënstacione të rinj dhe përmirësimi i atyre ekzistues;
   4. Rishpërndarjen e ngarkesave dhe të regjimit të shfrytëzimit dhe operimit;
   5. Instalimi i instalimeve kompesuese të fuqisë reaktive të nevojshme.

Seksioni 3 – Të Dhëna të tjera të Planifikimit

(Do të jepen nga të gjithë Përdoruesit e Rrjetit të Sistemit të Transmetimit)

A.8 Planifikimi Vjetor i Sistemit Elektroenergjitik

1. Qëllimi (përshkruan detajet e punës të përfshira në planin vjetor);
2. Gjendja (në së vazhdon nga viti i mëparshëm ose është një punë e re)
3. Plani i Shpenzimeve,
4. Analiza kosto përfitim, rritja e Përfitimeve.
5. Gjeneruesit (Prodhuesit)
   a) Shtimi i Kapacitetit(fuqisë aktive të instaluar) dhe njësive gjeneruese;
   b) Përmirësim i parametrave dhe shërbimeve teknike të Gjeneruesit;
6. Operatori i Sistemi të Transmetimit, OST sh.a
   a) Përmirësimi i qëndrueshmërisë statike dhe dinamike, të sigurisë operacionale dhe të furnizimit me energji elektrike të OSSH dhe Klientëve të Rrjetit të Sistemit të Transmetimit
   b) Reduktimi i humbjeve teknike;
   c) Planifikimi për rritjen e kapaciteteve për shpërndarjen e flukseve të fuqive aktive të Rrjetit të Sistemit të transmetimit;
7. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Klientët/Konsumatorët
   a) Për reduktimin e humbjeve teknike të fuqisë dhe energjisë elektrike;
   b) Për përmirësimin e nivelit të tensionit dhe skemat e kompesimit të fuqisë reaktive;
   c) Zhvillimi për mbulimin e rritjes së ngarkesës në zonën përkatëse gjeografike të Operatorit të Shpërndarjes apo të Klientit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit.

A.9 Të Dhëna të Planifikimit afatgjatë 10 Vjeçar të Rrjetit të Sistemit Transmetimit

Të jepen nga të gjithë Përdoruesit e rrjetit të transmetimit:

1. Planifikimi i Zhvillimit dhe Projektimit për 10 vitet e ardhshme;
2. Gjendja aktuale dhe skenarët e zhvillimit të Sistemit Elektroenergjitik.

A.10 Të Dhëna për Punët në Progres

Te jepen nga gjithë Përdoruesit e rrjetit të Sistemit të Transmetimit:

1. Raport mbi punët që kryhen në gjeneruesit që lidhen me Rrjetin e Sistemit të Transmetimit.
2. Grafiku për punët e kryera në zonat gjeografike përkatëse të rrjetit të shoqërisë/shoqërive të Shpërndarjes, përfshirë Operatorët e mbyllur të Shpërndarjes;
3. Grafiku për punët e kryera në rrjetin e Klientit/Konsumatorit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit;

A.11 Të Dhënat Përfundimtare

Të jepen nga të gjithë Përdoruesit e Rrjetit të Sistemit të Transmetimit)

Të dhënat Përfundimtare paraqesin datën e përfundimit të punimeve dhe datën e energjizimit për tu lidhur me rrjetin e Sistemit të Transmetimit të sistemeve/objekteve me faza, të Përdoruesit të këtij rrjeti, që ndikojnë në sjelljen operacionale të Sistemit të Transmetimit dhe në tërësi të sistemit Elektroenergjitik të vendit.

Shtojca B – Kriteret e Planifikimit

B.1 Kriteret e Planifikimit të Gjeneruesit

Kapaciteti i Pjesëmarrjes në Pikun e Ngarkesës (Max. e ngarkesës).

a) Aftësi e pjesëmarrjes në pikun (max) e ngarkesës të Sistemit Elektroenergjitk të çdo gjeneruesi Hidrik është fuqia maksimale në MW që mund të injektojë (prodhojë) në orët e pikut:
   1. Nëse Gjeneruesi është Run-of-River (me derivacion) kjo fuqi duhet t'i korrespondojë prurjeve të ujit me 90% siguri;
   2. Nëse Gjeneruesi është me Rezervuar (liqen), kjo fuqi do të varet nga niveli i rezervuarit, prurjeve me siguri 75% dhe kushteve hidrologjike;
   3. Për Gjeneruesit termike, kapaciteti i pjesëmarrjes në pikun e ngarkesës është fuqia maksimale neto e gjeneruesit në MW (minus fuqinë për nevojat vetiake).
b) Për njësitë e reja Termike kapaciteti i pjesëmarrjes në pikun e ngarkesës duhet vlerësuar në masën 86% të kapacitetit të instaluar. Kjo lejon në mënyrë të përafërt që 10% të përdoret për nevojat vetiake të gjeneruesit dhe 4% për humbjet në transformatorët e bllokut ose ngritës, të vlerësuara këto përkundrejt kapacitetit të instaluar të çdo njësie gjeneruese.

Kriteret e Planifikimit të Rezervave Rregulluese të Frekuencës

a) Rezervat Rregulluese të Kontrollit të frekuencës, FRR(Rezerva e restaurimit të frekuencës dhe RR (Rezerva e zëvendësimit të frekuencës) përshkruhen në këtë Kod, Kodi i Operimit dhe i Dispeçerisë dhe kryhet në zbatim të Kodit të Kontrollit Ngarkesë -Frekuencë dhe të Rezervave të rrjetit evropian të transmetimit ENTSO-E.

Kriteri i Planifikimit të Energjisë Elektrike të Rezervuar

a) Energjia elektrike e planifikuar si rezervë (jo energjia për rezervat rregulluese të frekuencës) nuk do të kalojë 0,15% të energjisë mesatare totale vjetore të kërkuar, sipas parashikimit të planifikimit operacional (deri në 1 vit).

Planifikimi i Prodhimit të Energjisë

a) Energjia Elektrike Vjetore e përllogaritur në një gjenerues Hidrik përcaktohet si Energjia Elektrike e mundshme për t'u prodhuar nga Gjeneruesi Hidrik me skenare me prurje 90%, 75% dhe 50 % siguri hidrologjike. OST merr planet e prodhimit nga të gjithë gjeneruesit hidrik të lidhur në rrjetin e sistemit të transmetimit dhe sistemin e shpërndarjes dhe në bazë të këtij informacioni dhe të dhënave përkatëse, harton planin për prodhimin e energjisë elektrike në rang vendi.
b) Për Gjeneruesit Termike apo biomase, energjia elektrike e prodhuar vlerësohet si produkt i kapacitetit(fuqisë aktive) të instaluar për 4000-6000 ore punë në vit, sipas tipit dhe veçorive të gjeneruesit elektrik termik apo biomase.
c) Për Gjeneruesit e energjisë së rinovueshme, eolike dhe fotovoltaike, energjia elektrike e prodhuar vlerësohet si produkt i kapacitetit (fuqisë aktive) të instaluar për 2000-2800 orë punë në vit, sipas tipit dhe veçorive të gjeneruesit elektrik të energjisë së rinovuar, eolik apo fotovoltaik.

B.2 Kriteret e Planifikimit të Rrjetit të Sistemit të Transmetimit

1. Rrjeti i Sistemit të Transmetimit do të planifikohet të operojë në mënyrë të sigurt dhe dinamikisht të qëndrueshëm, me një shërbim cilësor, me kosto të ulët dhe efiçent për të gjithë përdoruesit e rrjetit të transmetimit pa dallim, për të garantuar furnizimin e pandërprerë me

energji elektrike për të gjithë Klientët, me parametrat e lejuar cilësorë të tensionit dhe frekuencës, sipas kritereve të përshkruara në këtë Kod. Për rrjetin elektrik me tension150 kV, si rrjet jo standart, nuk duhet të bëhet planifikim të zhvillimit të tij për qëllim të mos zgjerimit të tij dhe zbatimit të dispozitave të Planifikimit të Rrjetit evropian ENTSO-E, për rrjetat jo standart.

2. Kriteri (n-1) në Planifikimin e Rrjetit të Sistemit të Transmetimit
   a) Për Planifikimin e Rrjetit të Sistemit të Transmetimit përdoret Kriteri (n-1) për:
      1. Vlerësimin e nivelit të përdorimit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit nga Përdoruesit e rrjetit për gjendjen ekzistuese dhe për zhvillimin e tij;
      2. Vlerësimin e ngarkesës /konsumit që duhet kufizuar për gjendjen ekzistuese mbështetur në kushtet e operimit normal, gjendje alarmi dhe emergjence të Sistemit Elektroenergjitik;
      3. Vlerësimin e niveleve të tensionit në rrjetin e Sistemit të Transmetimit;
      4. Planifikimin dhe Skedulin kalendarik të Zhvillimit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit;
      5. Për vlerësimin e sigurisë operacionale të rrjetit të sistemit të transmetimit dhe në tërësi të Sistemit Elektroenergjitik të vendit.
   b) Kriteri (n-1) zbatohet për regjime me ngarkesa maksimale të parashikuara, programuara, si vijon:
      1. Për linjat elektrike 400 kV, 220 kV, kriteri (n-1) përdoret për përcaktimin e seksionit ekonomik të përcjellësit të linjave të rrjetit të Sistemit të Transmetimit, për rrymën termike dhe me densitet të lejuar ekonomik, që kalon në çdo linjë të këtij rrjeti, duke ju referuar regjimit max (pik) bazë të operimit, i cili presupozon mosplanifikimin e daljeve nga puna të gjenerueseve kryesorë të Sistemit Elektroenergjitik.
      2. Për linjat elektrike 110 kV, kriteri (n-1) zbatohet duke:
         i.mbajtur të gjitha unazat 110 kV të mbyllura;
         ii.ne regjimin normal të operimit me unazat 110 kV të hapura të përcaktuara
         iii.çkyçur linjat 110 kV që intersektohen dhe janë poshtë apo si qark në të njëjtin shtyllëzim dhe vendosje paralele me linjat 400 kV ose 220 kV.
3. Kriteret Teknike për kontrollin e planifikimit të rrjetit të Sistemit Energjitik nga pikëpamja e qëndrueshmërisë Statike dhe Dinamike (Qëndrueshmëria këndore).
   a) Kriteri Teknik për verifikimin e qëndrueshmërisë statike dhe dinamike të Sistemit Elektroenergjitik dhe reagimin për ketë kriter të rrjetit të Sistemit të Transmetimit, do të realizohet duke marrë në konsideratë:
      1. regjimet me ngarkesa maksimale për çdo sezon, dimër dhe verë;
      2. periudhën e verifikimit çdo 5 vjet;
      3. një listë kontigjencash të miratura dhe të përpiluar nga arsyetimi për skemën operative përkatëse të Sistemit Elektroenergjitik dhe nga përvoja operative e rrjetit të sistemit të transmetimit;
4. Kriteri Teknik për përcaktimin e Pajisjeve Kompensuese të Fuqisë Reaktive
   a) Studimi dhe përcaktimi i instalimeve për gjenerimin/absorbimin e fuqisë reaktive bëhet duke analizuar nivelet e tensionit në të gjitha nyjet e rrjetit të Sistemit të Transmetimit, në të gjithë regjimet e operimit të rrjetit në konfiguracion (n) dhe praninë e kontigjencave sipas kriterit (n-1) duke respektuar nivelet e lejuara të tensionit.
   b) Studimi dhe analizat për përcaktimin teknik të instalimeve për gjenerimin/absorbimin e fuqisë reaktive bëhet për të optimizuar dhe përmirësuar performancën teknike dhe ekonomike të operimit të rrjetit të Sistemit të Transmetimit dhe të Sistemit

Elektroenergjitik, sepse operimi i rrjetit me tensione brenda niveleve të lejuara,redukton humbjet teknike në rrjetin e Transmetimit dhe rritë marxhinën e qëndrushmërisë dinamike të operimit (kolapsi i tensionit, qëndrueshmëria këndore) të Sistemit Elektroenergjitik të vendit. Ndikimi i devijimeve plus është më i favorshëm përsa i përket performancës teknike dhe ekonomike të Sistemit Elektroenergjitik. Studimi dhe analizat për këtë qëllim bëhen për një horizont kohor 2 vjeçar, duke vlerësuar si regjimet me ngarkesa maksimale ashtu dhe ato me ngarkesa minimale të sistemit Elektroenergjitik.

B.3 Referencat dhe Standartet

1. Standartet dhe Referencat që do të përdoren për planifikimin e rrjetit të Sistemit të Transmetimit do të jenë standartet dhe rregullat e planifikimit të zhvillimit të rrjetit evropian ENTSO-E dhe ato bashkëkohore të planifikim dhe zhvillimit:
   a) Në projektimin, ndërtimin ose modifikimin e elementeve të rrjetit të Sistemit të Transmetimit (linjat ajrore, linjat kabllore, nënstacionet, instalimet e kompesimit të fuqisë reaktive, telematja, mbrojtja rele, kontroll-monitorimi, SCADA/EMS e tjera);
   b) Ne projektimin, ndërtimin ose modifikimin nga përdoruesit e rrjetit të transmetimit për rrjetin, sistemet/objektet e tyre;
2. Kriteret e Projektimit Teknik të Rrjetit të Transmetimit do të jenë si vijon:
   a) Linjat e rrjetit të Transmetimit në Sistemin Elektroenergjitik duhet të projektohen teknikisht si rregull si linja me dy qarqe;
   b) Për linjat egzistuese të transmetimit me një qark të shihet mundësia teknike e një qarku tjetër;
   c) Traseja e zgjedhur e linjës së transmetimit duhet të jetë sa me optimale në lidhje me terrenin ku kalon dhe të ketë studimin e fizibilitetit për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
   d) Projektimi teknik, zbatimi dhe ndërtimi i linjave duhet të jetë konform Standarteve bashkëkohore të kushteve dhe normave të projektimit dhe zbatimit të rrjetit elektrik dhe elementeve të këtij rrjeti, duke zbatuar dispozitat përkatëse të Legjislacionit dhe Standartet e adaptuara shtetërore në fuqi;
   e) Rrjeti i Sistemit të Transmetimit duhet të sigurojë një funksionim operacional të integruar të Sistemit Elektroenergjitik për të gjitha situatat e mundshme që paraqiten;
   f) Aftësitë e rrjetit të Sistemit të Transmetimit vlerësohen dhe analizohen çdo vit, duke realizuar studime dhe analiza të tilla:
      1. Studime të Shpërndarjes të flukseve të fuqisë;
      2. Analizat për Lidhjet e shkurtra 3 fazore dhe 1 fazore në rrjetin e transmetimit dhe të statusit të neutrit të transformatorëve të fuqisë në anën 110 kV, 150 kV, 220 kV, 400 kV
      3. Mbi Qëndrueshmërinë Statike dhe Dinamike (kolapsin e tensionit dhe qëndrueshmërinë këndore).
      4. Studime për mbrojtjet rele në sistemin elektroenergjitik SHAF, SHAM, SHAT.
   g) Studimet dhe analizat do të bëhen për regjimet e mëposhtme, për të parë nëse rrjeti i Sistemit të Transmetimit operon sipas kritereve të sigurisë statike:
      1. Sistemi Elektroenergjtik do të planifikohet të ruajë tensionin nominal , devijimet e lejuara dhe të eleminojë mbingarkimin e rrjetit për kriterin (n) dhe (n-1) të sigurisë statike të operimit. Kriteri (n-1) zbatohet për çkycje të njësive gjeneruese, transformatorëve apo linjave transmetuese dhe kontigjencave të tjera përkatëse;
      2. Piku (max) i ngarkesës do të analizohet që të mbulohet për këto dy raste:

i. Mimumin e gjenerimit nga Centralet Termik
ii. Minimumin e gjenerimit nga Centralet Hidrik dhe të burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike.

h) Optimumi i kompensimit reaktiv në rrjetin e Sistemit të Transmetimit do të përcaktohet nga studimet e kryera, duke identifikuar dhe matur rrymat në linjat dhe ngarkesat në transformator, për të përcaktuar nivelet e tensionit në pikun e ngarkesës të rrjetit të transmetimit. Të gjithë instalimet kompesuese (kapacitorët ose reaktorët) duhet të jenë të tipit të rregullueshëm.

i) Mbrojtja rele duhet të projektohet dhe instalohet që të eleminojë defektet apo avaritë me shpejtësi veprimi brenda kohës të mëposhtme:
1. ≤80 milisekonda për elementet e rrjetit 400 kV;
2. ≤110 milisekonda për elementet e rrjetit 220 kV;
3. ≤120 milisekonda për elementet e rrjetit 110 kV-150 kV.

j) Kryhen studime të qëndrueshmërisë nga Mbitensionet Kalimtare në linjat 400 kV, 220 kV, 110 kV, për të siguruar që frekuenca dhe vala e mbitensioneve të mos kaloje vlerat e lejuara të nivelit të izolimit të paisjeve kryesore dhe të paisjeve mbrojtëse-shkarkuese.

3. Kriteret e Projektimit Teknik të Nënstacioneve elektrike

a) Nënstacioni elektrik duhet të projektohet duke marrë në konsiderate faktorët e mëposhtëm:
1. Shkalla e dëshiruar e fleksibilitetit;
2. Thjeshtësi në operim dhe mirëmbajtje;
3. Siguri e jetës dhe shëndetit të personelit operues dhe të mirëmbajtjes;
4. Kushti për hapësira të lira për zgjerim në të ardhmen të nënstacionit;
5. Të garantoje sigurinë e paisjeve për të parandaluar funksionimin e gabuar të paisjeve elektrike;
6. Të ketë pajisje të përshtatshme për izolimin dhe shuarjen e zjarrit sipas Legjislacionit në fuqi që të garantoje sigurinë e personelit dhe të shmange dëmtimin e paisjeve;
7. Tensioni i hapit dhe i prekjes duhet të jenë brenda normave të sigurimit teknik.

B.4 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Klientët/Sistemet/Objektet e konsumatorëve

1. Nënstacionet, Sistemet/Objektet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes që janë lidhur me rrjetin e Sistemit të Transmetimit në nivelin e tensionit të rrjetit 110 kV zbatojnë kriteret e projektimit sipas këtij Kodi;
2. Klientët e rrjetit të transmetimit për nënstacionet e tyre 220/TM; 110-150 kV/TM zbatojnë kriteret e projektimit sipas këtij Kodi, ndërsa për pjesën tjetër të nënstacionit në përputhje me kufirin pronësor, zbatojnë kriteret e projektimit të përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes.

Shtojca C – Të dhënat për Mbrojtjen Rele

Këto të dhëna paraqiten në tabelën si vijon:

Çështjet	Për tu Paraqitur
Përdoruesit e rrjetit të transmetimit duhet të paraqesin të dhënat e Detajuara të kërkesave të mbrojtjes rele, skemat përkatëse elektrike principiale të instalimit të mbrojtjes rele, si përshkruhen në Shtojca A, Seksioni 2;	Siç veprohet për të dhënat e Detajuara të Planifikimit
OST do të paraqesë detaje të mbrojtjes rele dhe të skemave të instalimeve të mbrojtjes rele, si përshkruhen në Shtojca A, Seksioni 2.	Siç veprohet për të dhënat e Detajuara të Planifikimit.

Shtojca D – Raportimi i Ngjarjes me Incident

NUMRI I RAPORTIMIT.....…….. Vendi ..... Data….....…
Ora….....…..

Data dhe ora e ngjarjes me incident:.....
Vendi i ngjarjes me incident:.....
Tipi i ngjarjes me incident:.....
Parametrat e së para ngjarjes me Incident:.....
Parametrat e së pas ngjarjes me incident:.....
Parametrat dhe Konfiguracioni i Rrjetit para ngjarjes me incident:.....
Tregimet e Mbrojtjeve Rele dhe sjellja e tyre:.....
Paisjet e dëmtuara:.....
Veprimet operative riparuese të marra:.....
Ndërprerja e Furnizimit dhe kohëzgjatja:.....
Shkaku i ngjarjes me incident:.....
Rekomandimet për përmirësime në të ardhmen, në rast përsëritje të ngjarjes me incident.
me incident:.....

Emrat dhe Firmat e Stafit Përgjegjës Operues
(.....)

Shtojca E – Investigimi i Ngjarjes me Incident

1. Qëllimi i një investigimi është ti beje të mundur OST të përftojë informacionin në lidhje me paisjet dhe proçedurat operative.
2. OST për të arsyetuar dhe dhënë konkluzion mbi incidentin, dërgon përfaqësues tek Përdoruesi i rrjetit të transmetimit, për të investiguar proçedurat operative të përdorura duke përfshirë, por pa u kufizuar në investigimin e:
   a) Zbatimit të urdhërave të lëshuara nga Qendra Kombëtare Dispeçer;
   b) Pajtueshmërisë së veprimeve operative të Përdoruesit të rrjetit të transmetimit me urdhërat operative të lëshuara nga Qendra Kombëtare Dispeçer.
3. Investigimi mund të mbështetet vetëm në çështjet operative të SE, por nëse është e nevojshme dhe e domosdoshme, investigimi mund të shtrihet në kohë dhe analizë duke parë edhe elemente të tjerë nëpërmjet deshifrimit të paisjeve regjistruese dhe instalimeve SCADA të OST dhe të Përdoruesit të rrjetit të transmetimit.

4. Përdoruesit e rrjetit të transmetimit duhet të lejojnë përfaqësuesit e OST dhe duhet të furnizojnë ata me të gjitha dokumentet përkatëse.
5. Proçedura e investigimit përcaktohet nga OST .

Struktura e tarimit të SHAF

SHAF-1			
Shkalla	Frekuenca (Hz)	% e ngarkesës së çkycur	Koha e veprimit
1	49.0	10%	0.2 sekonda
2	48.8	15%	0.2 sekonda
3	48.2	15%	0.5 sekonda
4	47.8	15%	0.5 sekonda

SHAF-2						
Tipi	Gradienti (Hz/sek)	49.0 Hz	48.8 Hz	48.2 Hz	47.8 Hz	Ngarkesa totale në %
49.0	-0.8	17.77%	7.17%	-	-	2.85%
49.0	-1.0	22.65%	10.43%	15.93%	-	6.22%
49.0	-1.7	-	12.8%	16.97%	25.90%	8.35%
49.0	-2.0	-	10.43%	25.69%	39.70%	11.37%
Totali ngarkesës		40.42%	40.83%	58.56%	65.60%	28.8%

Referencat

Ligji nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"
Rregullorja e Komisionit (BE) 2016/631 Rregullorja e komisionit (KE) 2016/631 e dt. 14 Prill 2016 per vendosjen e kodit të rrjetit per kerkesat per lidhjen e gjeneruesve ne rrjet (http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32016R0631&from=EN)
[NC DC] - Kodi i Rrjetit ENTSO-E për Lidhjen e Kërkesës (21/12/2012)
(https://www.entsoe.eu/fileadmin/user_upload/_library/resources/DCC/ENTSOE_finalises_DCC/121221_final_Network_Code_on_Demand_Connection.pdf)
[NC OS] Kodi i rrjetit ENTSO-E Për Sigurinë Operacionale (24/09/2013)
https://www.entsoe.eu/fileadmin/user_upload/_library/resources/OS_NC/130924-AS NC_OS_2nd_Edition_final.pdf
[NC OP&S]Kodi i Rrjetit ENTSO-E mbi Planifikimin Operacional dhe Skedulimin (24/09/2013)
https://www.entsoe.eu/fileadmin/user_upload/_library/resources/OPS_NC/130924-AS_NC_OPS_2nd_Edition_final.pdf
Rregullorja e Komisionit (BE) 2015/1222 Rregullorja e komisionit (KE) 2015/1222 e dt. 24 Korrik 2015 per vendosjen e një udhëzuesi për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e konxhestionit
(http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32015R1222&from=EN)
Platforma e Transparencës e ENTSO-E.(https://transparency.entsoe.eu/)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja KRISTALINA
Tiranë, 2017

Çmimi 1008 lekë